
بسم الله الرحمن الرحیم

MEDH'HEBI MBROJTËS

Shi'izmi në mendimin e Imam Khomeinit

Tiranë, 2026

Titulli: **Medh'hebi mbrojtës - Shi'izmi në mendimin e imam Khomeinit**

Autori: **Shejkh Hasan Fuad Hamada**

E përktheu nga arabishtja: **Haxhi Shejkh Vullnet MERJA**

E redaktoi: **Jerida KULLA**

E korrektoi: **Isra MERJA**

E përgatiti për shtyp: **Sabrie FEZA**

Kopertina: **Sabrie FEZA**

Botoi: Shoqata "Flladi"

بسم الله الرحمن الرحيم

Parathënia e botuesit

Prej kohësh armiqtë e Islamit dhe të Revolucionit Islamik, që nga fitorja e tij në vitin 1979, janë përpjekur ta shtrembërojnë imazhin e tij, të shpifin për mesazhin e tij dhe të shkaktojnë herë pas here luftëra, trazira dhe bllokada, duke sjellë probleme të shumta e të mëdha. Një nga komplotet e ndyra, mbi të cilat u përqendruan armiqtë, ishte përballja me Shi'izmin, sepse ky ishte shkolla e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), e udhëheqësit të Revolucionit Islamik.

Prandaj, ata u përpoqën ta shtrembëronin dhe ta nxinin këtë shkollë autentike islame. Fatkeqësisht patën mjaft sukses me anë të këtij komploti mashtrues dhe të poshtër.

Emërtimi i librit me titullin "Medh'hebi mbrojtës", Shi'izmi në mendimin e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka ardhur nga fakti se ai e konsideronte Shi'izmin si rojtarin e Islamit, i themeluar nga Allahu i Madhëruar dhe i Dërguari i Tij (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), i zbatuar nga Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) dhe bijtë e tij të pagabueshëm dhe i ndjekur nga ithtarët dhe dashamirët e drejtësisë hyjnore.

Ky libër, në mënyrë të hapur dhe duke u mbështetur në shumë fjalime dhe tekste të Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), shpalos një të vërtetë thelbësore: se Shi'izmi, sipas Imam Khomeinit, nuk është thjesht një doktrinë teologjike e ngarkuar nga Zoti dhe profetikisht në ruajtje të Islamit deri në Ditën e Kiametit. Siç ka treguar libri, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e pa këtë kuptim të qëndrueshëm të Islamit dhe Shi'izmit, si dhe zbatimin e saktë e të guximshëm të tyre në fushat e revolucionit, të shtetit, të xhihadit, të ndërtimit dhe qytetërimit, si dëshmi që ai ishte besnik ndaj Imamëve të pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!), roje i sigurt i Islamit dhe Kur'anit në këtë epokë, dhe mbrojtës i umetit islam dhe i të shtypurve në botë nga rreziku më i madh që përfaqësohet nga fuqitë arrogante botërore, me në krye Amerikën, Britaninë dhe Sionizmin.

Ai jo vetëm që nuk e la Islamin të mbetej i nënshtruar ndaj fuqive botërore të arrogancës, por e vendosi Islamin dhe umetin në rrugën e fitoreve të mëdha dhe realizimit të projektit hyjnor profetik.

Hyrje

Njerëzit nuk kanë ndryshuar kurrë mes tyre, siç kanë ndryshime në dallimet e kuptimit dhe të shikimit ndaj çështjeve. Kjo, sepse, në çdo gjë, ka afërsisht dallime**: "Dhe ata nuk do të reshtin së kundërshtuari, përveç atyre që Zoti yt ka mëshiruar, e për këtë Ai i ka krijuar ata".**[1]

Nga këndvështrimi i universit dhe Krijuesit, cilësive të Tij, natyrës dhe prapaskenave të saj, jetës dhe vdekjes, fesë apo medh'hebeve të ndryshme, politikës, ekonomisë, shoqërisë dhe të tjera, ka pasur gjithmonë dallime të shumta. Shpesh këto kanë çuar në përplasje dhe konflikte mendimesh, dhe në shumë raste në përballje dhe përplasje historike, të cilat vazhdojnë, sidomos kur duart e politikës lodhen duke i shfrytëzuar këto dallime.

Fetë, për shkak të bindjeve të tyre, që lidhen me Botën Tjetër, me çështje të fshehta metafizike, me realitete të padukshme dhe mendime, kanë qenë një nga fushat më të ndjeshme, ku mendimet janë përplasur më ashpër dhe përçarjet kanë qenë më të forta, duke ndjekur natyrën e të padukshmes dhe të fshehtësisë së saj nga shqisat, në shtesë të një faktori tjetër më të rëndësishëm, që është përballja e feve dhe profetëve me sunduesit arrogantë dhe tiranët e padrejtë, të cilët, kur i mashtronin njerëzit dhe i udhëhiqnin drejt realizimit të interesave të tyre të ngushta dhe të padrejta në dëm të popujve dhe kombeve, i largonin nga rruga e drejtë njerëzore.

1 Sure "Hud", ajeti 118–119.

Historia është e mbushur me mijëra tregime për përplasjet e vazhdueshme mes profetëve dhe të dërguarve nga njëra anë, dhe tiranëve, faraonëve, mendjemëdhenjve dhe pasuesve të tyre, nga ana tjetër. Shumë ajete të Kur'anit fisnik flasin për ato tregime, që ndoshta njerëzit të marrin udhëzim.

Nëse shohim historinë e feve hyjnore të njohura, dhe të fundit prej tyre Islamin, do të kuptojmë përmasën e madhe të dallimeve në vizion dhe qëndrim, si midis pasuesve të atyre feve, qoftë në jetën e vetë profetëve, qoftë pas tyre, deri në ditët tona. Mjafton si dëshmi ajo që shohim sot nga numri i madh i sekteve që janë ndarë nga çdo fe, për shkak të mendimeve, bindjeve intelektuale dhe doktrinore dhe shpesh për shkak të interesave politike. Madje, shpesh, brenda të njëjtit sekt kanë lindur dhjetëra rryma, doktrina. Përmasat e dallimeve kanë arritur deri aty sa të kthehen në sekte të reja, madje edhe në fe të reja.

Shi'izmi, si një doktrinë thelbësore në Islam, nuk bën përjashtim nga rrymat hyjnore të mëparshme. Edhe ai është ndarë në shumë grupe dhe brenda secilit grup janë shfaqur rryma të shumta, ashtu siç ka ndodhur edhe me medh'hebet e tjera islame dhe me fetë e tjera monoteiste.

Duhet të theksojmë se feja e vërtetë është ajo që Allahu i Lartësuar i ka shpallur njerëzimit nëpërmjet të gjithë profetëve, për udhëzimin e tyre, është një dhe e vetme në nivelin e synimeve dhe objektivave, dispozitave themelore, rregullave morale dhe normave edukative e mësimore njerëzore. Ajo fe përputhet me natyrën e pastër (fitra) dhe me mendimin e përbashkët të njerëzve të mençur përgjatë historisë. Të gjitha këto janë të qarta dhe të dukshme në librat hyjnorë të shpallur, edhe pse mund t'u jenë bërë

ndryshime përmes shtesës ose heqjes, ato janë të transmetuara në porositë dhe hadithet e profetëve, të cilat njerëzit i kanë ruajtur ose në formë shkrimi, ose kulture.

Prandaj, rregullsia dhe qëndrueshmëria e çdo medh'hebi apo rryme, qoftë islame ose joislame, nuk matet me pretendimin e tij apo me forcën e tij, por me masën e përputhshmërisë së tij me ato synime, qëllime dhe rregulla mbi të cilat ka një mendim të përbashkët, me masën e të qenit afër ose larg me mendjen e shëndoshë, logjikën e kthjellët, natyrën e pastër njerëzore, me rregullat e profetëve dhe mesazhet e tyre, me thelbin e thirrjes së tyre, që nuk mund t'u fshihen njerëzve me arsye të shëndoshë, pavarësisht formave, ngjyrave dhe llojeve të ndryshme të akuzave që u bënë atyre dhe vlerave të larta njerëzore, me qëllim dobësimin e të vërtetës dhe të realitetit.

Duke vështruar historinë e largët, të afërt dhe të sotme, gjejmë se sa më shumë rriteshin duart e politikës dhe intrigat e arrogantëve për të vënë në lëvizje ndryshueshmërinë, përhapjen e mospajtimeve, ushqyerjen e shpirtit të fanatizmit mes popujve, medh'hebeve, sekteve dhe rrymave, aq më tepër u shfaqën të përbashkëtat fetare dhe njerëzore, u shfaq fryma e unitetit, pajtimit dhe bashkëpunimit, nga ana tjetër.

Atë që u tha më lart, e sqaron edhe fjala e Allahut të Lartësuar: **"Dhe po të donte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit një bashkësi të vetme, por ata do të vazhdojnë të jenë të ndryshëm".**[1] Gjithashtu, e sqarojnë edhe shumë ajete të tjera, jeta e profetëve, e kujdestarëve (evlijatë) dhe mënyra e tyre e bashkëpunimit me

1 Sure "Hud", ajeti 118.

njerëzit me mendime të ndryshme, qoftë edhe të tepruara e të çuditshme. Mospajtimi në mendim dhe përpjekje është diçka e natyrshme dhe e lindur te njerëzit, dhe kurrsesi nuk mund të mendohet asnjë fe apo shkollë mendimi që nuk përjeton përpjekje dhe kuptime të shumta. Kjo nuk përbën ndonjë problem për fenë, përkundrazi është një ndryshim i lavdëruar dhe dëshmi e thënies: "ndryshimi i umetit tim është mëshirë"[1], siç thuhet në një hadith. Ndoshta kjo është ajo që i referohet fjala: "Rrugët e mbërritjes te Allahu janë sa frymëmarrjet e njerëzve".[2]

Feja monoteiste islame, në mënyrë të veçantë, përfshin të gjitha ato mendime dhe përpjekje dhe ka strukturat e nevojshme për t'i shndërruar këto ndryshime në një larmi të pasur dhe të gjallë në lëvizje dhe rrugëtim. Ajo që është e qortueshme, është përçarja dhe përplasja, për shkak të atyre përpjekjeve të ndryshme dhe ky është ushqim në duart e politikanëve dhe tiranëve gjatë gjithë historisë.

Në shekujt e fundit, veçanërisht në shekullin e fundit, feja e monoteizmit, në përgjithësi dhe Islami, në veçanti, u ekspozuan ndaj një sulmi kolonial të egër, që kishte për qëllim shkatërrimin e fesë, Islamit dhe edukatës islame dhe zhytjen e njerëzimit në errësirat e materializmit, epsheve dhe gjërave të kota, korrupsionit, në të gjitha format e tij dhe shkatërrimit të njeriut nga rruga e drejtë njerëzore. Kolonializmi perëndimor dhe britanik, në fillim, mori rolin kryesor në këtë sulm, më pas u pasua nga kolonializmi lindor

1 "Ilelu Esh Sherai'u", i Shejkh Sadukut, vëll. 1, f. 85, Botim i shtypshkronjës "Hajdarije", Nexhef, 1385 hixhri- 1966 gregorian.

2 "Biharul Enuar", i eruditit El Mexhlisi, vëll. 64, f. 138, botoi "Darul ihja et turathul arabij", Bejrut- Liban, Botimi i tretë i korrigjuar, 1403 hixhri, 1983.

sovjetik. Sot rolin kryesor e luan SHBA-ja, së bashku me Britaninë dhe sionizmi "i përkëdheluri i tyre, Izraeli" dhe lëvizja vehabiste saudite. Këta mbollën në botën tonë islame idetë e tyre, për të përhapur përçarjen, konfliktin sektar dhe fetar dhe për ta çuar umetin islam rob të armiqtë.

Këta janë armiqtë e Islamit dhe të feve hyjnore, përfshirë edhe fenë e krishterë, e cila ka pësuar pjesën më të madhe të përçarjes nga komplotet e kolonializmit perëndimor. Këta ushqyen dallimet fetare dhe sektare, në mënyrë të madhe, për të realizuar trazira, përçarje dhe për të shkatërruar fetë monoteiste dhe medh'hebet, veçanërisht për të shkatërruar fatin e umetit islam. Ata ende vazhdojnë.

Me keqardhje, armiqtë janë afruar shumë në realizimin e qëllimit të tyre ogurzi, në një përqindje të madhe, në prag të shekullit të pesëmbëdhjetë hixhri, pra, në fund të shekullit të njëzetë të erës sonë. Kjo gjendje arriti deri aty feja u kthye në një çështje individuale që lidhet vetëm me njeriun dhe Zotin e tij, sidomos në xhami dhe në kishë. Shumica e njerëzve u drejtuan drejt ndjekjes së njërës nga këto dy ideologji materialiste: komunizmit apo kapitalizmit- me format dhe me emërtimet e tyre të ndryshme, derisa gjendja pothuajse çoi në mbylljen e dyerve që të çon tek Allahu i Lartësuar.

Allahu i Lartësuar ka thënë në Librin e Tij fisnik: **"Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre, por Allahu e plotëson dritën e Tij, edhe sikur ta urrejnë jobesimtarët".**[1]

1 Sure "Es Saff", ajeti 8.

Ka thënë: **"Ai është që e ka dërguar të Dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, për ta ngritur mbi të gjitha fetë, edhe sikur ta urrejnë idhujtarët".**[1]

Dhe ka thënë: **"Unë dhe të dërguarit e Mi do të triumfojmë".**[2]

Prandaj, në fillim të shekullit të katërmbëdhjetë hixhri, Ai dërgoi një nga robërit e Tij për ta pastruar fenë nga shtrembërimet e shumta, për të rrëzuar të pavërtetat dhe për të udhëhequr një revolucion të madh fetar dhe shoqëror përmirësues, i cili fillon me korrigjimin e koncepteve dhe me drejtimin e vështrimit të njerëzve drejt të vërtetave të krijimit, botës, Islamit dhe fesë.

Revolucioni i Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ishte një revolucion kundër të gjitha realiteteve të prishura, jo vetëm për myslimanët, por për të gjithë të shtypurit në botë, pasuesit e profetëve dhe të gjitha feve. Ai riktheu vlerën e fesë dhe të parimeve të saj, si dhe të botës shpirtërore dhe të mbinatyrshmes, përballë tiranisë së materializmit, duke forcuar dimensionet njerëzore të njeriut.

Parullat më të shquara të revolucionit ishin: *"As Lindje, as Perëndim, Republikë Islamike!" dhe "O ju të shtypur, bashkohuni!"*. Revolucioni e drejtoi gishtin akuzues ndaj kriminelëve amerikanë dhe sovjetikë, ndaj Sionizmit, Familjes Saudite (Ale Saud) dhe Vehabizmit, si mjete për shkatërrimin e feve monoteiste dhe Islamit, duke përfituar nga ushqimi i konflikteve të ndryshme, e më

1 Sure "Et Teube", ajeti 33.

2 Sure "El Muxhadile", ajeti 21.

të rëndësishmit, konflikti fetar dhe sektar, si dhe mbjellja e përçarjes dhe trazirave në çdo kohë dhe vend.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e udhëhoqi revolucionin e tij kundër çdo teprimi dhe lëshimi, kundër çdo devijimi kudo që gjendej, dhe përpara pasuesve të çdo shkolle apo feje, madje edhe nëse vetë Shi'izmi do të devijonte, ai (Khomeini) do ta përballte atë. Ky ishte revolucioni më i madh, flakët e të cilit u ndezën nga agimi i Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe pasuesit e tij.

Ishte krejtësisht e natyrshme që shigjetat e armiqve të drejtoheshin me forcë nga Lindja dhe nga Perëndimi dhe agjentët e tyre, kundër këtij Imami të madh, kundër revolucionit të tij dhe shtetit të tij të ri, për ta shuar atë që në lindje, nëse do të mundnin, ose për ta larguar nga rruga e tij hyjnore, me kalimin e kohës, ose për ta rrethuar dhe për t'i mbytur parullat e tij revolucionare, reformuese dhe unitare, në mënyrë që ato të mos arrijnë në veshët e botës. Dhe përballja vazhdon e ashpër deri në këtë çast.

Megjithëse armiqtë nuk arritën ta shuanin revolucionin apo ta largonin nga rruga e tij e shenjtë, fatkeqësisht ata arritën, në një masë të madhe, ta rrethonin atë dhe ta shtrembëronin imazhin e tij në sytë e shumë myslimanëve dhe jobesimtarëve. Sa shumë ai (revolucioni) ka humbur nga shkëlqimi i saj dhe ndikimi i saj në zgjimin islam dhe botëror.

Ndër mjetet më të ashpra të ngushtimit, shtrembërimit dhe mjegullimit kundër revolucionit islamik dhe parimeve të tij, ishte fushata e padrejtë që u drejtua kundër shi'itëve dhe Shi'izmit, duke e konsideruar si shkollën e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i

kënaqur me të!) dhe të shumicës absolute të popullit të Iranit, që përqafoi revolucionin me zemër dhe shpirt, dhe që ngriti për Iranin një shtet të Islamit dhe drejtësisë.

Armiqtë mobilizuan dhe vazhdojnë të mobilizojnë jo vetëm ushtritë dhe partitë e tyre, por edhe qendrat e tyre djallëzore dhe të fëlliqura. Kanë lëshuar shigjetat e tyre helmuese, të mbushura me gënjeshtra dhe mashtrime kundër këtij revolucioni dhe kundër Shi'izmit, i cili në të vërtetë është një shkollë e vjetër, me rrënjë të thella në Islam, e themeluar me urdhër të Allahut të Lartësuar nga Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) për ruajtjen e Islamit, me udhëheqjen e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).

Fatkeqësisht, magjia e këtyre mashtrimeve ndikoi mbi miliona myslimanë të pafajshëm nga medh'hebet e ndryshme islame, aq sa fjala "Shi'izëm" në sytë e këtyre u bë e barabartë me largim nga feja dhe nga umeti.

E emërtova këtë libër "Medh'hebi mbrojtës"- Shi'izmi në mendimin e Imam Khomeinit" për t'u bërë i qartë për mbarë botën dhe posaçërisht për myslimanët, si dhe për vetë shi'itët me dallimet e medh'hebeve, grupeve dhe rrymave të tyre: çfarë do të thotë Shi'izëm, si: kuptim, besim, veprim dhe praktikë në mendimin e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Ky është reformator i madh që Allahu e dërgoi në fillim të shekullit të pesëmbëdhjetë hixhri, për të përballuar komplotin që synonte zhdukjen e Islamit dhe të feve monoteiste, për të ruajtur fenë hyjnore nga shuarja dhe harresa, ashtu siç vepruan para tij të

parët e tij nga pasardhësit e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe imamët e pastër.

Pa dyshim, shi'izmi i Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), në kohën tonë, përfaqëson modelin më të afërt të kuptimit të vërtetë të Shi'izmit dhe i praktikimit të Islamit të vërtetë të Muhamedit. Modeli më i afërt me thelbin e fesë së drejtë, e cila përputhet me natyrën njerëzore, duke ndjekur jetën e profetëve dhe të evlijave në mesazhet e tyre hyjnore; duke e shoqëruar me të urtët dhe mendimtarët në rreshtat e arsyes dhe mençurisë; duke mbështetur të shtypurit nga çdo komb apo fe në fushat e ngritjes, revolucionit, kujdesit, reformës dhe pavarësisë.

Lexuesi, nëpërmjet kapitujve të këtij libri, do të njihet me vizionin e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), lidhur me fetë monoteiste, Islamin dhe Shi'izmin, si dhe me jetën e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), duke hedhur një vështrim mbi qëllimet e profetëve dhe mbi filozofinë e fesë. Gjithashtu, ai do të mund ta shohë kuptimin e saktë të mesazhit islam në lidhje me çështjet e njeriut, të kësaj bote dhe të Botës Tjetër, të lirisë dhe të çështjeve shoqërore në tërësi, sipas asaj që e paraqiti Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili, përmes personalitetit të tij, pasqyroi Islamin e vërtetë dhe Shi'izmin e drejtë. Ai i zbatoi të gjitha ato parime dhe vlera me punë, me përpjekje dhe me revolucion, duke realizuar ëndrrën e profetëve në këtë epokë, me themelimin e një shteti islam, që qëndron me krenari dhe qëndrueshmëri përballë komplotit të armiqve të Islamit dhe të njerëzimit.

Duhet thënë se Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!), me personalitetin e tij, me qëndrimet dhe veprën e tij, mishëroi

jetën e profetëve të mëdhenj, të Profetit të Islamit dhe të Imamëve të pastër në këtë epokë, dhe u bë një përkthim i gjallë i Kur'anit dhe i ajeteve të tij, i Islamit dhe i ligjeve të tij. Kështu, metoda e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) u bë udhërrëfyese për Islamin dhe një vijë udhëzuese për rrugëtimin e besimit dhe të përpjekjes. Duke ndjekur këtë metodë dhe duke iu përmbajtur kësaj rruge, çdo njeri, si individ dhe çdo umet e bashkësi, në këtë epokë dhe në epokat e ardhshme, mund të afrohet te kënaqësia e Allahut, duke ndërtuar një shoqëri dhe një individ të përkryer, për të cilin erdhën të gjitha shpalljet dhe të dërguarit gjatë historisë.

Shi'izmi në mendimin e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) nënkupton shkollën mbrojtëse të Islamit, duke ruajtur parimet e tij si besim, mendim, jurisprudencë dhe praktikë, si dhe duke mbrojtur umetin islam dhe kryetarin e lirisë së tij. Shkolla flijuese shi'ite, nëpërmjet udhëheqësve të saj të mëdhenj, duke filluar nga Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) që u martirizua në vendfalejn (mihrabin) e tij në xhami, pastaj me Imam Hasanin (Paqja qoftë mbi të!), që përballoi helmin e marrëveshjes së paqes për të ruajtur Islamin dhe umetin, më pas me Imam Hysenin (Paqja qoftë mbi të!), i cili, me sakrificën e tij historike në Kerbela, e mbrojti Islamin dhe e ringjalli atë, madje edhe të gjitha fetë monoteiste.

Pastaj, Imam Zejnul Abidini (Paqja qoftë mbi të!), i cili udhëhoqi rrugën në kohët më të vështira dhe më të rrezikshme, përmes lutjeve të tij të ndriçuara. Imam Bakiri dhe Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi ta!), me përpjekjet e tyre shkencore dhe me njohuritë e tyre juridike, duke shpjeguar jurisprudencën islame në të gjitha dimensionet e saj, e ruajtën Islamin.

Pas tyre, imamët e tjerë të pastër dhe në fund Imam Mehdiu i pritur (Allahu ia shpejtoftë ardhjen!), për të cilin është përgatitur vendosja e drejtësisë së pritur dhe realizimi i qëllimeve të profetëve.

E gjithë kjo linjë vazhdon me mijëra dëshmorë nga pasardhësit e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), nga pasardhësit e Fatimes së pastër (Paqja qoftë mbi të!), si dhe me qindra mijëra dëshmorë nga dijetarët, hulumtuesit, luftëtarët dhe durimtarët. Kjo vazhdoi deri në kohën tonë, në kohën e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe revolucionit të tij, e cila me qëndron e palëkundur për mbrojtjen e Islamit dhe umetit islam përballë sulmit më të ashpër ndaj Islamit dhe umetit në historinë islame. Prandaj, edhe nëse duam t'i japim Shi'izmit një emër tjetër, nuk gjejmë më të përshtatshëm se "Medhehbi mbrojtës" (El Medhhebu El Harisu).

Është e qartë se në këtë libër jam mbështetur në mënyrë thelbësore mbi tekstet dhe fjalët e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), të cilat gjenden në të gjitha temat dhe hulumtimet e nevojshme. Janë mbledhur fjalët, predikimet dhe qëndrimet e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) në një përmbledhje prej 22 vëllimesh, me titull "*Sahifetul Imam"*, të cilat janë përkthyer në gjuhën arabe. Pikërisht kjo përmbledhje do të shërbejë si burimi kryesor në këtë libër.

Unë kërkoj, me përulësi, nga të gjithë lexuesit e këtij libri, veçanërisht nga ata që nuk janë shi'itë, që të mos më gjykojnë për këtë që them, vetëm pasi t'i kenë lexuar të gjitha faqet e librit, ashtu siç e kërkon natyra e shëndoshë njerëzore. Të jenë të lirë në mendimet dhe përfundimet e tyre, larg fanatizmit të verbër dhe

imitimit të dënueshëm. Allahu është Ai që udhëzon drejt së vërtetës.

Autori

Kapitulli i pare

Fetë monoteiste

- Hyrje
- Dallimi mes feve monoteiste dhe shkollave materialiste
- Arrogantët pengojnë arritjen e objektivave të feve monoteiste
- Nevoja e bashkimit të feve monoteiste përballë tiranëve
- Shenjat e fesë së vërtetë
- Profetët dhe uniteti i qëllimit
- Revolucioni Islamik ringjalli fetë monoteiste
- Të përbashkëtat e feve monoteiste
- Marrëdhënia vëllazërore mes pasuesve të feve monoteiste
- Kombi i krishterë
- Feja hebraike

- Rrëzimi i thënies: "Feja është opium i popujve"
- Përfundimi i studimit

Hyrje

Që nga lashtësia, feja ka qenë dhe është një çështje që ka angazhuar individët dhe shoqëritë njerëzore. Njerëzit, që prej fillimit të njerëzimit e deri më sot, kanë qenë gjithmonë në një gjendje të të menduarit të natyrshëm mbi çështjet fetare, qofshin të sakta apo të gabuara. Ata filluan nga Krijuesi, cilësitë e Tij, thelbi i Tij, fuqia dhe shfaqjet e Tij, duke kaluar te bota pas vdekjes, ringjallja, Xheneti dhe Xhehenemi, e deri te ajo që feja ka urdhëruar ndjekësit e saj: nga dispozitat, morali, sjelljet, deri te vizioni i fesë për njeriun, jetën, botën dhe çështjet e shoqërisë dhe njerëzve.

Me gjithë shumësinë e feve monoteiste dhe dallimet e mëdha në degë dhe detaje, sipas kohës dhe rrethanave të atyre feve, dhe për shkak të ndryshimeve në kuptim, duarve të shtrembërimit dhe largësisë nga koha e shpalljes, prapëseprapë mund të thuhet se ekzistojnë përbashkësi thelbësore dhe të vërteta të përgjithshme e qëllime madhore mbi të cilat pajtohen të gjitha fetë monoteiste. Ndër këto është edhe vetë ekzistenca e një Krijuesi të Plotfuqishëm, Dëshirues, i Drejtë, i Gjallë dhe Ngadhënjyes. Ndër to është realiteti i ekzistencës së botës përtej natyrës, ku besimtarët shpërblehen me Xhenet dhe keqbërësit dhe kriminelët ndëshkohen me zjarr. Prej tyre është vëllazëria njerëzore, thirrja për dashuri dhe bashkëpunim mes njerëzve, refuzimi i padrejtësisë, përhapja e drejtësisë dhe thirrja drejt virtyteve të moralit, si: sinqeriteti, bamirësia, drejtësia, besnikëria, bujaria, guximi dhe braktisja e asaj që i kundërshton ato, si: gënjeshtra, mashtrimi, tradhtia, koprracia dhe frika.

Prandaj, mund të arrihet në përfundimin vijues: në thelb dhe duke u nisur nga këto të përbashkëta, duhet të mbizotërojnë konceptet e përgjithshme fetare ndërmjet njerëzve, pavarësisht ndryshimit të feve dhe shkollave të tyre, në mënyrë që të realizohet siguria dhe paqja, të arrihet bashkëpunimi dhe të zgjidhen dallimet dytësore, duke u kapur pas thelbeve madhore dhe sublime. Të gjitha fetë monoteiste kanë ardhur për të mirën dhe interesin e njeriut. Armiqësitë dhe luftërat ndërmjet ndjekësve të feve, për shkak të dallimeve të pjesshme doktrinare apo të tjera, bien ndesh me shpirtin e fesë dhe mesazhin e saj hyjnor të vetëm, dhe janë vepër e politikanëve përfitues dhe mendjemëdhenjve në çdo kohë dhe vend.

Kjo është ajo që do të sqarohet në këtë kapitull nga qëndrimet dhe fjalët e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), lidhur me fetë monoteiste, qëndrimin ndaj ndjekësve të tyre dhe mënyrën e bashkëpunimit me ta, duke u nisur nga kuptimi i drejtë i fesë islame.

Dallimi midis feve monoteiste dhe shkollave materialiste

Një nga gjërat që e veçon fenë monoteiste nga fetë e tjera në botë, është se feja e monoteizmit e edukon njerëzimin dhe i nxjerr ata nga errësira në dritë. Ndërsa besimet e tjera që kanë synime materialiste, i largojnë njerëzit nga rruga e dritës, për t'i rikthyer ata në errësirë. Në të vërtetë, të gjitha besimet, jomonoteiste, me përmbajtje materialiste, qofshin ato që punojnë kundër feve monoteiste apo ato që nuk kanë lidhje me to, i drejtojnë njerëzit drejt çështjeve materiale, për t'i zhytur ata në errësira dhe për t'i larguar nga drita.[1]

"Në kohën që fetë monoteiste merren me çështjet materiale dhe në krye të tyre feja islame, ajo synon vetëm edukimin e njeriut, në mënyrë që të kuptojë prej saj se çështjet materiale nuk duhet të shndërrohen në pengesë për shpirtëroren, por duhet të jenë në shërbim të shpirtërores. Nëse interesi përqendrohet vetëm te materialet, atëherë kjo do të çojë në errësira, ashtu siç shohim në doktrinat materialiste që e drejtojnë njerëzimin drejt luftërave dhe gjakderdhjes, siç është rasti në komunizëm, ku udhëheqësit e tyre, sa herë që arrinin pushtetin, nuk ngurronin të vrisnin mijëra njerëz të pafajshëm, madje qindra mijëra.

E njëjta gjë ndodh edhe me materializmin në Amerikë dhe vendet perëndimore jokomuniste, ku interesat dhe pretendimet e tyre sillen vetëm

1 Shkrimi pa bold në të gjithë librin janë fjalët e autorit, kurse ato të pjerrëta janë thëniet e Imam Khomeinit.

rreth materiales e çështjeve materiale, dhe për hir të tyre derdhin gjakun e miliona njerëzve në vende të ndryshme të botës. Dy prej shembujve është ajo që ndodhi në Afganistan dhe në vende të tjera.

Ndërsa fetë monoteiste nuk pushtojnë vende dhe nuk e trajtojnë popullin me dhunë, por kërkojnë të nxjerrin njerëzit nga errësira drejt dritës, duke përqendruar gjithçka në adhurimin e Allahut. Ne shohim se fetë monoteiste e theksojnë sjelljen e mirë, thirrjen në adhurim të Allahut, dhe përpiqen sa të jetë e mundur t'i rikthejnë njerëzit në rrugën e drejtë dhe të vërtetë, duke përdorur të gjitha mjetet paqësore, larg gjakderdhjes, përveç rastit, nëse ka ndonjë komplot kundër saj, në atë rast ajo vepron sipas urdhrave të Kur'anit dhe godet me dorë të hekurt. Përveç këtij rasti, njerëzit janë të lirë në atë që dëshirojnë.[1]

Dallimi midis Islamit dhe feve të tjera monoteiste, Islami është më i madhi i tyre, dhe pjesës tjetër të feve, është se kjo natyrë ka një kuptim tjetër; ka një kuptim tjetër për mjekësinë, inxhinierinë dhe yjet… Kush e lexon Kur'anin e shenjtë e sheh këtë kuptim, se të gjitha shkencat natyrore në Kur'an kanë një anë shpirtërore.

Në një hadith thuhet se Allahu i Lartësuar kur shikon botën, ose natyrën që Ai ka krijuar, e sheh atë me mëshirë, sepse ajo është pjesë e mëshirës së Allahut. Por shikimi vetëm te kjo botë, te kjo natyrë, pa parë përtej saj, është i mangët.

Këta që pretendojnë se e njohin këtë botë dhe natyrën, ata që thonë: "Ne e njohim botën dhe realitetet e saj, dhe jemi bindur me to", në të vërtetë, nuk e kanë njohur realisht njeriun. Ata vetëm sa kanë njohur një

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe nga Fondacioni i Sistemimit dhe i Publikimit të Trashëgimisë së Imam Khomeinit", vëll. 2, f. 220-221, Botimi i parë, Iran, 2009.

hije të shtazërisë së njeriut dhe e kanë menduar atë si të vërtetën e njeriut. Ndërsa ata që pretendojnë se e njohin Islamin dhe janë bindur me të, nëse e kanë parë vetëm si një shkallë të ulët nga realitetet e Islamit, atëherë nuk e kanë njohur Islamin siç duhet dhe e kanë keqkuptuar atë.

Islami i kthen të gjitha ndjesitë dhe botën në shkallën e teuhidit (njësimit të Allahut). Mësimet e tij nuk janë thjesht shkenca natyrore, as matematikë, as vetëm mjekësi. Përkundrazi, në të ka gjithçka. Mësimet e tij nuk janë shkenca të kufizuara, por të gjitha këto shkenca përfshihen brenda tij, madje të lidhura dhe të kushtëzuara me teuhidin. Kjo do të thotë se çdo gjë në natyrë dhe çdo hije e errësirës materiale duhet të kthehet te pozita ndriçuese hyjnore, që është shkalla më e lartë e hyjnisë.

Prandaj, kuptimi që duam për shkencat natyrore dhe për të gjitha shkencat materiale, duhet të jetë me veçorinë që Islami dëshiron, dhe kjo veçori nuk njihet nga Perëndimi. Edhe nëse ata dinë diçka prej saj, është vetëm në kuptimin më të ulët të saj. Por, kuptimi që duam ne për universitetet tona dhe për shkollat tona nuk është ky kuptim sipërfaqësor që i përkiste shkollave të vjetra dhe që disa e marrin tani si të mjaftueshëm, në dukje. Ky kuptim sipërfaqësor, në dukje, është i bukur dhe puna e tyre është e lavdërueshme, por nuk është ajo që dëshiron Islami.

Kuptimi që dëshiron Islami, qoftë nga shkencat natyrore apo të tjera, është që ato të jenë të lidhura me shkencat hyjnore dhe të ndihmojnë drejt teuhidit. Çdo shkencë duhet të ketë dimension hyjnor, pra, kur njeriu e sheh natyrën, ai sheh Allahun në të; kur sheh materien, ai sheh Allahun në të; kur sheh të gjitha ekzistencat, ai sheh Allahun në to.

Ajo që synon Islami, është të kthejë të gjitha ekzistencat natyrore dhe të gjitha shkencat natyrore drejt dijeve hyjnore. Ky është kuptimi që synohet për universitetet dhe për vetë mjekësinë, e cila duhet të jetë për njeriun, për trupin dhe shërimin fizik, por thelbësore është qendra e

fokusit, që është teuhidi. Pra, të gjitha këto duhet të kthehen te Hyjnia, dhe nuk duhet imagjinuar që shkencat në Islam të jenë si shkencat që ekzistojnë për të gjithë njerëzit apo si sistemet e zakonshme.[1]

Islami, në të gjitha kuptimet e tij, kërkon synimin më të lartë. Të gjitha ekzistencat natyrore duhet t'i drejtojnë shikimet drejt asaj ane shpirtërore dhe asaj shkalle të lartë. Kur njeriu sheh natyrën, ai e sheh atë si një shëmbëlltyrë të Hyjnisë dhe një dallgë nga bota e të fshehtës. Kur njeriu sheh një të krijuar, ai e sheh atë si një shëmbëlltyrë që e bën të pranishëm Krijuesin.

Edhe edukimi islam është edukim hyjnor, ashtu siç edhe qeveria islame është qeveri hyjnore. Dallimi midis qeverisë së Islamit dhe qeverive të tjera është se këto të fundit duan që disa prej tyre të sundojnë mbi të tjerat. Islami nuk është kështu, as nuk e sheh në këtë mënyrë. Islami nuk dëshiron të pushtojë vendet për t'i shfrytëzuar, por dëshiron t'i tërheqë njerëzit drejt një bote tjetër dhe t'i edukojë ata me një edukim njerëzor, jo t'i shfrytëzojë. Ndryshe nga sistemet që keni parë dhe keni përjetuar si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim, të cilat nuk shohin gjë tjetër veçse sundimin dhe shfrytëzimin material. Në këndvështrimin islam, nuk ka ndikim materiali, në vetvete. Ai që lexon Kuranin, sheh në të se çdo gjë lidhet jo me materialen, por me thelbin dhe qëllimin.

Ajo që dëshiron qeveria islame, është që të vendoset në botë qeveria e Allahut, domethënë: dëshiron që ushtari mysliman të jetë ndryshe nga ushtarët e tjerë; që të jetë ushtar hyjnor. Kryeministri mysliman të jetë ndryshe nga kryeministrat e tjerë në sistemet e tjera. Pra, kjo është një ekzistencë hyjnore; kudo që të shkojmë nëpër vende, ajo që ekziston është përmendja e Allahut. Këtë dëshiron Islami. Islami dëshiron të hapë vendet, në mënyrë që emri i Allahut të shfaqet në gjithë botën, për të edukuar një

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 327-328.

edukim hyjnor në gjithë botën, një edukim njerëzor që e çon njeriun drejt asaj shkalle që nuk të shkon mendja. Mbi këtë bazë, duhet të bëjmë dallimin mes shkencave që kanë ekzistencë të pavarur dhe shkencave që i ka sjellë Islami. Shkencat islame janë të gjitha këto, përveç se kanë edhe një veçori tjetër që nuk ekziston në të tjerat. Dallimi midis shkencave islame dhe fushave të tjera shkencore është se ato në Islam nuk janë si në të tjerat. Ato shkenca gëzojnë një shtesë dhe ajo shtesë është në anën shpirtërore dhe hyjnore".[1]

1 "Sahifetul imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 327-328.

Arrogantët pengojnë arritjen e qëllimeve të feve monoteiste

"Feja hyjnore monoteiste, e cila ishte e përhapur mes njerëzimit, fatkeqësisht nuk u zbatua në formën e kërkuar, sepse arrogantët e penguan këtë gjë, sidomos fenë e Profetit Isa (Paqja qoftë mbi të!), e cila ra në duart e sekteve dhe në të ndodhën shtrembërime, duke u përmendur gjëra që nuk përputhen me madhështinë e Profetit Isa.

Më e keqja se kjo ishin sundimtarët që ua atribuonin vetes së tyre fenë e krishterë, por që nuk ishin aspak të krishterë në veprime, pasi nuk zbatuan mësimet e Profetit Mesih (Paqja qoftë mbi të!). Pra, gjendja e tyre ishte pa asnjë lidhje me mësimet e Mesihut (Paqja qoftë mbi të!).

Sikur mësimet e profetëve të zbatoheshin ashtu siç duhet dhe ashtu siç ata dëshironin, sikur mësimet e Profetit Mesih (Paqja qoftë mbi të!) të zbatoheshin në mesin e të krishterëve dhe sikur mësimet e Musait (Paqja qoftë mbi të!) të zbatoheshin në mesin e hebrenjve, dhe mësimet e Profetit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) të zbatoheshin mes myslimanëve, nuk do të ndodhnin fatkeqësi, nuk do të kishte vështirësi dhe probleme kudo në botë.

Sot ju shihni krimet e mëdha që janë kryer në emër të Krishterimit, në emër të përkatësisë ndaj fesë së Profetit Mesih (Paqja qoftë mbi të!), si dhe nga krerë shtetesh që pretendojnë se janë myslimanë dhe mbajnë emrin e Islamit. Por këta udhëheqës nuk kanë lënë krim pa kryer. Ju patë Mohamed Rizain, këtu (në Iran), si ai shtirej si i lidhur me Islamin, kopjonte nga Kur'ani, e shfaqte veten si i përkushtuar ndaj Islamit, por,

në të vërtetë, veprat e tij ishin krejtësisht kundër Islamit. Një shembull i ngjashëm në Krishterim ishte Karteri, i cili shkonte në kishë, lutej dhe ftonte të tjerët për lutje, por megjithatë mbushi botën me padrejtësi dhe krime, në kundërshtim me mësimet e Profetit Mesi (Paqja qoftë mbi të!). Kështu, fetë hyjnore, që nga fillimi, janë përballur me këta tiranë".[1]

"Që prej fillimit të shfaqjes së feve në botë, kanë ekzistuar edhe tiranët. Ata përpiqeshin t'i largonin njerëzit nga e vërteta dhe të korruptonin mendjen e tyre. Nëse njeriu mbetej i shthurur, ai bëhej më i keq se kafshët. Për këtë arsye, Allahu dërgoi profetët, që të frenonin epshet e njeriut. Por profetët nuk arritën gjithmonë ta zbatonin misionin e tyre në formën e plotë që dëshironin, megjithatë, po të zbatohej, bota do të ishte e sigurt dhe e qetë. Kjo është detyra e feve hyjnore.

Nëse përjashtojmë sundimtarët, atëherë shumica e njerëzve nga hebrenjtë, të krishterët dhe myslimanët janë të përkushtuar në masën e mësimeve të profetëve të tyre. Kjo është ajo që siguron paqen e tyre në këtë botë. Por, nëse nuk do të ekzistonte kjo përpjekje e profetëve, njerëzit do të përballeshin me përplasje dhe beteja të përgjakshme, duke u sjellë më keq se kafshët.

Nëse do të frenohej shfrenimi i sundimtarëve, atëherë kjo masë e paqes që ekziston tani, do të mjaftonte që njerëzit të jetonin në qetësi. Kjo paqe është rezultat i përpjekjeve të profetëve. Përpjekjet e tyre bënë që shumë ndjekës të çdo feje të qëndrojnë të lidhur me mësimet e profetëve të tyre dhe, për këtë arsye, ata përmbahen nga kryerja e krimeve që do t'i kishin bërë, nëse nuk do të ishin besimtarë. Pra, ky është fryti i mundit të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 38.

profetëve. Sikur të mos ishte ky mundim i profetëve, do të ishte e qartë se deri ku do të arrinte kaosi në këtë botë.[1]

Por, për fat të keq, nuk kemi parë në asnjë epokë që njerëzit të kenë njohur Islamin në të vërtetën e tij. Më e dhimbshmja është se edhe tani, ndonëse jetojmë në një shtet islam, Islami nuk është zbatuar, në kuptimin e tij të plotë. E kur Islami të zbatohet plotësisht, me dëshirën e Allahut, atëherë do të shfaqen rezultatet e tij, do të shihni se si do sillen me të krishterët dhe me pjesëtarët e feve të tjera! Do të shihni se me çfarë lloj paqeje, dashurie dhe butësie do të ketë.

Ky është udhëheqësi i medh'hebit tonë, Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu (Paqja qoftë mbi të!). Kur ai dëgjoi se një grua jomyslimane (dhimmijetu) dhe ndoshta ishte hebreje, iu rrëmbye zinxhiri nga këmba, nga një ushtar i një ushtrie, u trondit aq shumë, sa tha: 'Sikur një burrë mysliman të vdiste nga ky lajm, nuk do ta qortoja për këtë, madje do ta konsideroja të denjë për atë!'[2]

Ky është shembulli i qeverisë së drejtë që dëshiron Islami dhe Allahu i Madhëruar. Nëse një qeveri e tillë vendoset në Iran dhe në shtetet e tjera islame, atëherë dera e padrejtësisë do të mbyllet dhe do të zhduket çdo shkelje e çdo dhunë. Atëherë qeveritë nuk do të jenë kurrë shtypëse, madje as që do t'ju shkojë ndër mend të bëjnë padrejtësi. Ushtria dhe të gjitha forcat e shtetit do të jenë në shërbim të njerëzve".[3]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 38.
2 "Nehxhul Belaga", Hytbja 27.
3 "Sahifetul imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 39.

Nevoja e bashkimit të feve monoteiste përballë tiranëve

"Profetët e mëdhenj, duke filluar nga Ademi dhe duke përfunduar me Profetin e fundit, si dhe profetët "Ulu'l-Azm" (profetët e vendosmërisë së lartë), të gjithë u dërguan për të ngritur flamurin e njësimit të Zotit dhe për të vendosur drejtësinë mes popujve.

Profetët, gjatë gjithë historisë, nuk u dërguan vetëm për të dhënë këshilla, por për të ndrequr moralin e njerëzve në fjalë e vepra. Ata u dërguan për edukimin e njeriut dhe zhvillimin e krijesës njerëzore, që shoqëria të ndriçohej me vlera njerëzore. Ata sakrifikuan gjithçka kishin, u përpoqën me veprat dhe fjalët e tyre për të vendosur parime dhe vlera njerëzore. Ata arritën ta realizonin këtë, pa u ndalur përpara vështirësive, sado të mëdha që ishin ato. Është për t'u habitur, se, me gjithë përpjekjet dhe mundimet që bënë profetët për të udhëzuar njerëzit, për t'i përmirësuar ata dhe për të pasuruar anët shpirtërore të jetës së tyre, përsëri ne shohim që qeveritë, gjatë gjithë historisë, qoftë në shtetet islame apo në vendet e feve të tjera, në shumicën e rasteve, kanë vepruar në kundërshtim me udhëzimet e profetëve.

Sot ju shihni se si bota vuan nga sundimtarë dhe prijës që pretendojnë se janë të krishterë, hebrenj dhe myslimanë. Por largimi i popujve nga feja dhe vështirësitë që kalojnë sot, janë rezultat i veprimeve të këtyre udhëheqësve. Ky ka qenë gjithmonë fati i profetëve, që nga fillimi i krijimit e deri te vula e profetësisë, një grup tradhtarësh që vepronin në mënyrë të errët në faqen e historisë, dhe prijësit e tyre mbulonin faqen e

historisë me errësirë. Ata e bënin fenë mjet të fuqisë së tyre dhe e shndërronin atë në një turp përpara Allahut të Madhëruar.

Mendoni sikur të vinte sot Profeti i Islamit dhe të pyetej për veprat e këtyre individëve dhe këtyre qeverive që pretendojnë Islamin, cila do të ishte përgjigjja e tij? Sigurisht që do të thoshte: "Unë e përçova mesazhin, por ata nuk dëgjuan". Nëse do të vinte profeti Isa dhe të pyetej për veprat e këtyre qeverive që pretendojnë se janë të krishtera, cili do ishte reagimi i tij? Shikoni Amerikën se çfarë u bën njerëzve. Amerika që pretendon Krishterimin, Amerika që thotë se është e lidhur me Krishtin, ndërkohë që Krishti (Paqja qoftë mbi të!) e shpenzoi gjithë jetën e tij duke i drejtuar njerëzit drejt shpirtërores, për ta bërë jetën e tyre të pastër dhe të moralshme. Veprat e saj (Amerikës) nuk ndryshojnë aspak nga veprat e paganëve dhe idhujtarëve që nuk besonin në parime dhe as në Botën Tjetër. Po kështu janë edhe këta prijës që thonë se i përkasin Krishterimit, Hebraizmit apo Islamit, ata nuk ndryshojnë. Ata shtypin popujt e pafajshëm me këmbët e tyre. Sot ju shihni se si Sionizmi botëror, që pretendon Judaizmin, çfarë nuk bën me njerëzit. Po kështu, ata që pretendojnë Islamin, veprojnë njësoj. Kjo është ajo që përjeton sot populli ynë mysliman nga dora e Sadamit, kjo është ajo që po përjeton populli i shtypur në Liban e në vende të tjera, nga dora e sionistëve, që po ia nxijnë fytyrën historisë".[1]

"Të shtypurit e historisë duhet të ngrihen përballë djajve. Unë nuk e imagjinoj që ndonjëherë në botë të ketë ekzistuar një kohë me djaj të tillë si kjo e jona. Djalli gjithmonë ka qenë i pranishëm, natyrisht, në çdo kohë dhe djajtë njerëzorë kanë ekzistuar gjithmonë përgjatë historisë, por sa më shumë që është zhvilluar bota, aq më shumë janë zhvilluar edhe veprat e tyre djallëzore. Këtë periudhë që sot e quajnë 'epoka e qytetërimit dhe e

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 17, f. 89-90.

përparimit', në të vërtetë duhet ta quajmë 'epoka e djajve'. A nuk shihni se sot bota, anembanë saj, është në duart e djajve, me përjashtime shumë të rralla? Këta kanë marrë në zotërim mjete, armë dhe instrumente djallëzore në çdo vend dhe janë në një zhvillim të vazhdueshëm. Çdo ditë përgatisin grusht-shteti, komplote dhe konspiracione të mëdha. Prandaj është detyrë e njeriut të ngrihet dhe të qëndrojë përballë këtyre djajve modernë, djajve të qytetërimit, ashtu siç u ngritën profetët e mëdhenj dhe miqtë e Allahut, qëndruan dhe sakrifikuan gjithçka kundër së keqes. Në këtë epokë, gjithashtu, është detyrë mbi ju, mbi të gjithë dijetarët fetarë, mbi të gjitha kombet dhe të shtypurit e botës, që gjatë gjithë historisë të ngrihen me fytyra të vendosura kundër këtyre djajve. Nëse ju tregoheni të dobët përballë tyre, atëherë djajtë do të përpijnë gjithë botën. Këta, në emër të paqes dhe sinqeritetit, janë të parët që ndezin luftërat në botë. Në emër të të drejtave të njeriut, ata janë shkelësit më të mëdhenj të të drejtave të njeriut. Ata që e thërrasin veten 'bamirës', nuk duan asgjë tjetër veçse të bëjnë padrejtësi dhe të shtypin të tjerët".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 208-209.

Shenjat e fesë së vërtetë

Profetët, nga i pari deri te i fundit, si dhe zëvendësit pas tyre, kanë qenë roje të Islamit dhe mbrojtës të fesë së vërtetë. Feja e së vërtetës gjatë gjithë epokave ka qenë Islami dhe nënshtrimi ndaj Allahut të Lartësuar. Ata nuk e ruajtën atë vetëm me fjalë, por me veprat e tyre praktike. Veprat e tyre në histori ishin një model për ne dhe për gjithë njerëzit. Është e domosdoshme që kjo të mbetet e tillë deri në Ditën e Gjykimit. Kur vërejmë jetën e profetëve, shohim se ata kanë sakrifikuar gjithçka në këtë rrugë. Ata përballuan lodhje, vështirësi dhe vuajtje të gjata përgjatë historisë. Ashtu siç ndodhi në kohën e prijësit të dëshmorëve, Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!), që ndodhi në një periudhë të caktuar, por njësoj ka ndodhur me çdo mik të Allahut, që sakrifikoi veten për hir të një qëllimi të vetëm, pavarësisht rrethanave dhe kushteve. Ky qëllim ishte ruajtja e Islamit, mbrojtja e ligjeve të tij, përhapja e njohjes së teuhidit dhe, në një shprehje tjetër: "ndërtimi i njeriut". Në thelb, profetët erdhën për njeriun, për ta shpëtuar njeriun nga dredhitë e djallit, i cili betohet të mashtrojë, për ta drejtuar atë në rrugën e drejtë njerëzore dhe për t'i treguar qartë se cili është udhëzimi i drejtë. Prandaj është detyrë që njeriu të ngrihet dhe të qëndrojë përballë djajve, qofshin ata djaj njerëzorë apo djaj të tjerë jonjerëzorë. Kjo bëhet përmes ushtrimeve shpirtërore të njeriut, me veprat e mira dhe përpjekjet e palodhura në rrugën e arritjes së qëllimeve, përballë djajve njerëzorë".[1]

"Profetët, në misionin e tyre, nuk patën për qëllim zhdukjen e kundërshtarëve të teuhidit, por synimi i tyre kryesor ishte që të përhapnin

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 208.

njësimin (teuhidin) e Zotit në botë dhe të dominonte feja e vërtetë në të, kurse tiranët ishin pengesë ndaj saj. Profetët e shihnin të domosdoshme heqjen e kësaj pengese, në mënyrë që të arrihej qëllimi.

Qëllimi i të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk ishte thjesht të largonte idhujtarët e Mekës apo idhujtarët e Gadishullit Arabik, por ishte përhapja e fesë islame dhe vendosja e një qeverie të bazuar në Kur'an, qeveri e Islamit".[1]

Islami erdhi që t'ua shpjegojë njerëzve dhe botës rrugën e drejtë, për t'i rikthyer në rrugë të drejtë ata që ishin devijuar. Jo vetëm Islami, por të gjitha fetë monoteiste përgjatë historisë, kanë ardhur për përmirësimin e njeriut.

"I Dërguari i nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) mërzitej dhe trishtohej për gjendjen e idhujtarëve, të cilët po e çonin veten në zjarrin e Xhehenemit. Islami është fe e mëshirës dhe fe e drejtësisë. Ai është ligj; prandaj, binduni ligjeve të Islamit dhe nënshtrohuni atyre!"[2]

Fetë monoteiste dhe feja e së vërtetës, ndryshe nga akuza e krenarëve, se ato lidhen me prapambetje dhe shmangie nga shenjat e përparimit dhe qytetërimit – janë fe për ngritjen e njeriut dhe përparimin e tij, duke e zhvilluar atë si në aspektin material, ashtu edhe në atë shpirtëror.

"Nëse me shenjat e qytetërimit dhe përparimit nënkuptohen shpikjet, inovacionet dhe industritë e përparuara, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e njerëzimit dhe në rritjen e qytetërimit të tyre, atëherë Islami

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 270.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 40.

dhe të gjitha fetë monoteiste kurrë nuk e kanë kundërshtuar dhe nuk do ta kundërshtojnë kurrë. Përkundrazi, Islami dhe Kur'ani fisnik e theksojnë domosdoshmërinë e shkencës dhe të industrisë.

Por, nëse me përparim dhe qytetërim nënkuptohet ai kuptim i shpikur nga disa përfaqësues të kulturës së shthurjes, që thërrasin për imoralitet dhe legalizim të të gjitha të këqijave e ndyrësive, deri tek devijimet seksuale dhe gjëra të ngjashme, atëherë të gjitha fetë hyjnore, të gjithë dijetarët dhe njerëzit e mençur e kundërshtojnë këtë. Edhe nëse disa të varur nga Perëndimi apo Lindja e përhapin këtë me verbërinë e tyre imitues, nuk ka dyshim se kjo nuk është qytetërim.

Njeriu nuk mund ta arrijë lirinë dhe lumturinë e vërtetë veçse me bekimin e feve monoteiste dhe pasuesve të tyre besimtarë. Shtetet që pretendojnë Krishterimin apo Judaizmin, si dhe qeveritë që quhen islame, janë të paafta ta realizojnë këtë, nëse nuk përmbahen me sinqeritet ndaj Islamit".[1]

Duke u bazuar në atë që u tha, ruajtja e fesë së vërtetë dhe feve monoteiste, Islamit dhe Republikës Islamike, e themeluar nga Imami Khomeini (Allahu e mëshiroftë!), bëhet një nga detyrat më të mëdha, madje detyra më e rëndësishme për të gjithë myslimanët, për të gjithë ndjekësit e feve monoteiste dhe të shtypurit në botë.

"Detyra e ruajtjes së këtij vendi dhe të Republikës Islamike është për çdo individ në këtë tokë. Rëndësia e saj është më e madhe se rëndësia e namazit, sepse brenda Islamit, namazi është një degë, ndërsa ruajtja e Islamit është rrënja e tij. Kjo është detyrë mbi të gjithë ne, pa dallim, nëse jemi turq, persianë, arabë, sistanë, balushistan, turkmenë apo të tjerë.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 364.

Ruajtja e fesë së vërtetë është detyrë për të gjithë njerëzit e botës dhe është kreu i të gjitha detyrave. Ndoshta jomyslimanët, për shkak të mosbesimit të tyre në Islam, thonë: "Po, Islami e ka bërë detyrë mbrojtjen e tij, por ç'punë kemi ne me të?" Por ne myslimanët e besojmë këtë detyrë. Prandaj, edhe ruajtja e Republikës Islamike është detyrë e domosdoshme islame për myslimanin në Afrikë, sepse është e mundur që drita e saj (Republikës Islamike) të ndriçojë të gjithë botën në të ardhmen, me dëshirën e Allahut. Vërtet, kjo ka ndodhur tashmë".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 418.

Profetët dhe uniteti i qëllimit

Pavarësisht përpjekjeve të armiqve të njerëzimit dhe fesë, të cilët janë përpjekur të shtrembërojnë imazhin e profetëve, mesazhet dhe personalitetin e tyre në të gjitha epokat, ata nuk kanë mundur t'i fshijnë tiparet dhe shenjat ndriçuese të atyre personaliteteve. Ajo që i bashkon të gjithë në personalitetin dhe misionin e tyre, është thirrja e përbashkët për adhurimin e Allahut, Krijuesit të Plotfuqishëm, të Diturit, të Urtit, paralajmërimi kundër tundimeve dhe zbukurimeve të kësaj bote, punimi për Botën e Përhershme, largimi i njeriut nga errësira drejt dritës, nga ngushtësia shtazarake drejt gjerësisë së pafundme njerëzore. Ata ishin të gjithë vëllezër, të bashkuar, të solidarizuar dhe të përbetuar në çdo kohë dhe vend.

"Sigurisht, nëse të gjithë profetët do të mblidheshin në një vend, nuk do të kishte mes tyre asnjë mospajtim, sepse qëllimi i tyre ishte një, shtegu i tyre ishte një dhe shpirtrat e tyre ishin shkrirë deri në një pikë që nuk do të mbetej më asnjë dallim mes tyre, por një shpirt i vetëm".[1]

"Të gjithë profetët kanë ardhur për të reformuar shoqërinë dhe e shihnin se individi duhet të sakrifikohet për shoqërinë, pavarësisht pozitës së tij. Mbi këtë themel u ngrit prijësi i dëshmorëve (Imam Hyseni), duke sakrifikuar vetveten dhe shokët e tij, që sakrifica e individit të bëhet për përmirësimin e shoqërisë. Duhet të realizohet drejtësia në mesin e njerëzve dhe në shoqëri të ngrihen mbi drejtësinë dhe të vendoset barazia mes tyre.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 168.

Ata kanë sakrifikuan me jetët dhe pasuritë e tyre dhe përballuan shumë vështirësi. Nuk mund të thuhet se i Dërguari ka fjetur i qetë natën apo ka pushuar qoftë edhe një ditë të vetme. Përkundrazi, ai e dha gjithë jetën e tij për të përmirësuar shoqërinë përmes Kur'anit, haditheve të tij, fjalëve dhe këshillave të tij. Ai e pa të pamundur ta arrinte këtë ndryshe, përveçse me shpatë, sepse kishte njerëz që dëshironin të shkatërronin shoqërinë dhe të korruptonin umetin. Kur vepra nuk mjaftonte me qëllimin dhe ekuilibrin, atëherë ai vepronte me hekur (d.m.th. me forcë)".[1]

Me të vërtetë, qëllimi i veprës së profetëve ka qenë ndërtimi i njeriut. Të gjithë profetët dhe të gjithë librat qiellorë erdhën për hir të ndërtimit të njeriut, edukimit dhe përgatitjes së njeriut fisnik. Përkundrazi, përballë profetëve ishin sistemet materiale, të cilat nuk donin që njeriu të bëhej njeri i mirë; ato nuk dëshironin që ai të bëhej fisnik, por që të mbetej në nivelin shtazarak lëvizës, të cilin e ndajnë të gjitha kafshët. Pra, të mbetej në këtë nivel, edhe sikur të ishte mjeshtër në ndonjë zeje apo të ishte një specialist i madh. Ajo që ka rëndësi, është që ai të mos kishte virtyte. Mund të ndodhë që dikush të prodhojë një 'fantom'[2]*, por kjo nuk është një virtyt njerëzor. Mund të ndodhë që dikush të jetë një mjek shumë i shquar, por, nëse nuk zotëron virtyte njerëzore, ai është veçse një mashtrues. Ata nuk kanë frikë nga mjeku dhe as nga shpikësi, por ata kanë frikë nga njeriu i vërtetë. Prandaj, po të shfaqej një njeri i tillë në ndonjë vend, ata do t'ia prisnin duart".*[3]

Në të vërtetë, çështja kryesore, objekt i të gjithë profetëve, ka qenë njeriu. Nëse çdo qeveri do të kishte një program, atëherë programi i të Dërguarit të nderuar, mund të thuhet se është ajo surja e parë që zbriti: **"Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi, krijoi njeriun prej një cope**

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 15, f. 190.

2 Lloj avioni luftarak.

3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 320.

gjaku të ngjitur. Lexo! E Zoti yt është më Bujari, Ai që mësoi (shkrimin) **me pendë, ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte".**[1]

Tema e hulumtimit të të gjithë profetëve, qëllimi i tyre edukues, ishte njeriu. Ata erdhën për ta ngritur këtë qenie nga niveli i materies në një gradë më të lartë, që është mbi materien. Pra, çdo mision i profetëve ka qenë i lidhur me njeriun, për edukimin dhe formimin e tij. Ky ajet i lartë përcakton programin, sipas rëndësisë dhe shkallës së saj.

Kështu, kjo është një thirrje drejtuar të Dërguarit të nderuar, por edhe një udhëzim i përgjithshëm: **"Lexo me emrin e Zotit tënd".** *Pra, kur fillon leximi, duhet të përcaktohet se si duhet të fillojë: duhet të fillojë me emrin e Zotit".*[2]

"Profetët dhe miqtë e Allahut, që nga fillimi i krijimit e deri më tani, kanë përballuar shumë vështirësi për të ngritur pozitën e njeriut dhe për ta çuar atë në nivelin e plotë të njeriut, në kuptimin e vërtetë.

Po të studionim të gjithë librat qiellorë që zbritën mbi profetët, do të shihnim se ata e kanë theksuar vazhdimisht rëndësinë e edukimit të njeriut, udhëzimit dhe qetësimit të tij, në mënyrë që ai të zërë vendin e tij natyror, si krijesa më e mirë. Gjithashtu, ata kanë paralajmëruar për rrezikun, se nëse kjo krijesë lihej pa udhëzim dhe edukim, ajo shndërrohet në krijesën më të rrezikshme.

Duke u nisur nga kjo pikë, janë ngritur lëvizjet islame dhe teuhidite për udhëzimin e njerëzimit. Islami ka ardhur për ta lartësuar pozitën e njeriut, për ta çuar atë drejt përsosmërisë dhe humanizmit të vërtetë. Natyrisht, përplasja e përhershme mes së vërtetës dhe të kotës

1 Sure "El Alak", ajetet 1-5.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 253.

brenda tij (njeriut) mund ta ketë bërë atë një krijesë të frikshme dhe e të rrezikshme, e cila bëhet shkatërrimtare, në rast se mbetet pa udhëzim dhe edukim. Prandaj Allahu i Madhëruar dërgoi profetët, për të parandaluar shfaqjen e prishjes, ndezjen e luftërave dhe problemet e tjera që i shohim në botën tonë sot. Profetët morën mbi vete flamurin e udhëzimit, për ta çuar njeriun drejt përsosmërisë dhe për ta larguar nga mëkatet dhe prishja, në vend të përhapjes së së keqes në botë.

Nga ky këndvështrim, profetët mund t'i quajmë mësues dhe njerëz që nxjerrin shpirtrat nga errësira.

Të gjithë profetët që ngritën lëvizje në këtë botë materiale, të cilët nuk e dinin sekretin e tyre përveç Allahut, qëndruan përballë tiranëve që nga fillimi, duke i vënë qëllimet e tyre mbi të gjitha. Ky duhet të jetë një shembull për myslimanët, për ata që janë me të vërtetë besimtarë dhe që lidhen me Profetin e Islamit, me Ehli Bejtin e pastërtisë dhe të dëlirësisë. Po ashtu, edhe pasuesit e feve të tjera duhet të marrin shembull nga profetët e tyre dhe të shohin në jetët e tyre përkthimin praktik të mësimeve hyjnore. Çfarë bëri Musai, biri i Imranit, në jetën e tij? Çfarë bëri Ibrahimi, i dashuri i Allahut dhe cila ishte jeta e tij? Të gjithë ngritën lëvizje për të përballuar padrejtësinë dhe për t'i dalë përpara errësirës. Të gjithë ata ishin udhëheqës të vërtetë të lëvizjeve. Ky është kuptimi i vërtetë dhe nga këtu ne duhet t'i marrim shembull ata".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 132-133.

Revolucioni Islamik ringjalli fetë monoteiste

Nuk i fshihet studiuesit dhe ashtu siç është përmendur shumë herë në fjalët e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se arrogantët hartuan plane dhe programe për të përjashtuar fetë monoteiste, veçanërisht Islamin, nga fusha e ndikimit në të gjitha shoqëritë. Në vitet e shkuara, vërehet se këta armiq u afruan shumë drejt realizimit të synimeve të tyre ogurzeza që nga fillimi i shekullit të njëzetë, duke arritur t'i mashtrojnë ndjekësit e feve monoteiste, në veçanti myslimanët dhe t'i bindin ata se feja është "opiumi i popujve". Ata e ndanë fenë nga politika dhe e larguan popullin nga përkushtimi ndaj fesë dhe vlerave shpirtërore, duke e drejtuar drejt ateizmit, shthurjes dhe korrupsionit, si dhe duke i shtyrë drejt përqafimit të ideologjive marksiste, komunizmit, socializmit dhe partive nacionaliste të pretenduara.

Me suksesin e Revolucionit Islamik në Iran, në vitin 1979, nën udhëheqjen e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të), dhe me përmbajtjen e tij, të mbështetur në qëllime e parime të sinqerta fetare, si dhe në kthimin drejt fesë dhe shpirtërores, jeta fetare mori një hov të ri brenda feve monoteiste, me Islamin në krye, në të gjitha drejtimet dhe rrymat e tij. Ky revolucion hapi dritare shprese për të shtypurit e botës, duke i nxitur drejt ngritjes, çlirimit dhe arritjes së fitoreve të tyre.

"Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!), në përgjigje të një pyetjeje rreth shfaqjes së një zgjimi të ri për besimin katolik në Evropë,

tha: "Shkaku i shfaqjes së këtij zgjimi fetar në Evropë është fakti se njerëzit janë lodhur nga përparimi material, i cili, sipas besimit të tyre, nuk u ofron atyre jetën e qetë dhe të sigurt që dëshiron njerëzimi, por, përkundrazi është shkak për shkatërrimin e jetës së tyre, një gjë e dëmshme dhe jo e dobishme për ta. Ajo që i duhet njerëzimit sot është ajo që i jep qetësi dhe siguri, dhe kjo nuk ofrohet veçse nga feja. Prandaj, është e pamundur që të ketë qetësi të vërtetë përveçse nën hijen e fesë. Përse? Sepse nuk ka siguri në çështjet materiale. Ka edhe veprime që bien ndesh me qetësinë që kërkon njeriu".[1]

"Na kanë thënë se revolucioni iranian solli një zgjim në shumë rajone; një zgjim që u shfaq te popujt arabë dhe në vende të tjera si frymëzim nga ky revolucion. Shpresoj që popujt e tjerë të arrijnë, gjithashtu, të realizojnë synimet e tyre njerëzore".[2]

"Revolucioni iranian nuk i përket vetëm Iranit, por është një revolucion për të shtypurit në përgjithësi dhe është ngritur për t'u vënë në shërbim të të gjithë atyre që besojnë në vlerat njerëzore dhe të drejtat e njeriut. Ky revolucion, padyshim, do të vazhdojë".[3]

"Valët e revolucionit tuaj janë përhapur në botë. Tingujt e fitoreve tuaja po jehonin në çdo cep të globit. Irani që bota e njihte dikur si një shërbëtor të Amerikës, sot është bërë burim frymëzimi për të shtypurit. Të gjithë të shtypurit e botës janë të bindur se Republika Islamike është fitimtare dhe se ajo çdo ditë po arrin gjithnjë e më shumë fitore".[4]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 11.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 84.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 6, f.420.
4 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 17, f. 55.

"Revolucioni iranian nuk i përket vetëm Iranit. Islami nuk është i kufizuar për një grup e jo për një tjetër, por ai është për mbarë njerëzimin, nuk është vetëm për myslimanët dhe as vetëm për Iranin. Profetët u dërguan për të gjithë njerëzit, dhe po ashtu Profeti i Islamit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) i drejtohej të gjithëve me fjalët: "O ju njerëz!"

Republika jonë është Republikë islame dhe revolucioni ynë ishte për hir të Islamit. Një revolucion që ngrihet për hir të Islamit, nuk mund të kufizohet vetëm në një vend, madje jo vetëm në vendet islame, sepse ai është vazhdim i vijës së profetëve dhe i revolucioneve të tyre. Revolucioni i profetëve nuk ishte kurrë i kufizuar në një vend të caktuar. Profeti fisnik (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishte nga Gadishulli Arabik, por thirrja dhe mesazhi i tij nuk ishin të kufizuara në atë gadishull, por ishin për mbarë botën".[1]

"Edhe ringritja jonë është islame, përpara se të jetë iraniane. Ajo përfaqëson një ringritje e të gjithë të shtypurve të botës, përpara se të lidhet me një vend të caktuar. O myslimanë të botës, o të shtypur, ngrihuni! O oqean i pafund i njerëzimit, ngrihuni dhe mbroni Islamin dhe qenien tuaj".[2]

"Shpresoj që ky revolucion i pastër islamik dhe popullor të mund të bëhet një shembull për popujt e privuar të botës, në mënyrë që ata të mbështeten te Zoti i Madhëruar dhe me ndihmën e masave popullore të shpëtojnë veten nga sundimi kolonial i Lindjes dhe i Perëndimit, veçanërisht nga Amerika kriminele".[3]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 325.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 99.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 429.

"Sot, me shpalljen zyrtare të themelimit të Republikës Islamike dhe me qëndrueshmërinë e këtij amaneti hyjnor në Iran, si dhe me arritjen e rezultateve të mëdha brenda një kohe të shkurtër, është detyrë për popullin iranian, në veçanti dhe për myslimanët, në përgjithësi që të bëjnë përpjekje të mëdha për ta ruajtur atë, për të gjetur faktorët e qëndrueshmërisë së saj dhe për të larguar pengesat dhe vështirësitë nga rruga e saj. Shpresa është që drita e saj të ndriçojë mbi të gjitha vendet islame dhe të realizohet harmonia ndërmjet të gjitha vendeve dhe popujve mbi këtë çështje vendimtare, në mënyrë që të priten përgjithmonë duart e fuqive të mëdha dhe shfrytëzuesve, kriminelëve të historisë kundër të shtypurve dhe të persekutuarve".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 362.

Të përbashkëtat e feve monoteiste

Duke marrë parasysh se thelbi i të gjitha feve qiellore është një, pavarësisht ndryshimeve në besimet, degët, dispozitat dhe mësimet juridike të tyre, të përbashkëtat midis këtyre feve mbeten shumë më të mëdha se dallimet. Këto përbashkësi përfaqësojnë, në të vërtetë, thelbin dhe filozofinë e feve monoteiste qiellore me të njëjtin burim dhe prejardhje, dhe Ai është Zoti i robërve dhe Krijuesi i gjithësisë. Në krye të përbashkësive doktrinore qëndron besimi në Krijuesin e botës dhe atributet e Tij të përsosmërisë dhe bukurisë, si dhe ajo që Krijuesi i Lartësuar ka premtuar në një botë tjetër, pas kësaj bote natyrore, ku njeriu shpërblehet ose ndëshkohet sipas veprave të tij në këtë botë. Gjithashtu, fetë ndajnë përbashkësi juridike dhe praktike, si: braktisja e ndyrësive dhe gjërave të ndaluara, ndalimi i imoralitetit, respektimi i familjes dhe i lidhjeve familjare, respektimi i njeriut dhe lartësimi i virtyteve të tij.

"Të gjitha fetë monoteiste qiellore besojnë në ekzistencën e një realiteti më të lartë për njeriun, përtej këtij trupi dhe jetës tokësore, dhe synojnë zhvillimin dhe përsosjen e këtij njeriu–shpirtit ose vetes jomateriale, përmes mësimeve fetare, morale dhe vlerave njerëzore. Po të mos i kishte marrë njerëzimi gjatë historisë së tij mësimet e feve monoteiste, bota sot do të kishte përjetuar padrejtësi shumë më të rënda se sa ato që njohim. Sistemet jomonoteiste dhe ato që nuk u sollën nga profetët, janë të kufizuara në horizontin e tyre. Edhe sikur të supozojmë se ato kanë qenë të sinqerta për umetin dhe të mëshirshme ndaj popujve, prapëseprapë duhet të vërejmë kufizimin e mendimit njerëzor, paaftësinë e

njeriut për të udhëhequr dhe masën e nevojave të tij. A mundet mendimi njerëzor të përfshijë gjerësinë e ekzistencës hyjnore dhe aftësinë e njeriut për përsosje? Po të supozojmë se ka individë të dhembshur që duan t'u shërbejnë popujve, a do të jenë ata në gjendje t'i shërbejnë realisht? A ka kufi për këtë? Nëse shohim etapat e rrugëtimit të njeriut nga natyra drejt asaj që është më lart, ai arrin deri te pozita e hyjnisë, duke u lidhur nga natyra me një gradë që nuk sheh në të asgjë tjetër përveç Allahut të Madhëruar. Dhe shohim shkallët e njeriut shpirtëror, i cili është i aftë të ecë nga kjo natyrë dhe të zbulojë të gjitha vlerat shpirtërore brenda vetes përmes edukimit të drejtë, derisa të arrijë një nivel më të lartë se engjëjt e Allahut. Këto çështje janë nevoja të njeriut. Njeriu nuk është si kafsha, që nevojat e tij kufizohen në ushqim, pije dhe gjumë. Përkundrazi, ai është një krijesë e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar, që brenda vetes përmban gjithçka që ekziston në këtë botë, por me forcën dhe aftësinë për përgatitje. Kjo forcë duhet të kalojë nga potenciali në veprim dhe realizim".[1]

"Të gjitha sistemet johyjnore që janë shfaqur nga duart e profetëve johyjnorë, janë kufizuar në horizontin e kësaj natyre. Ato mund të plotësojnë nevojat materiale dhe të arrijnë mirëqenie më të madhe. Dikur, udhëtimi bëhej mbi gomarë e kuaj, ndërsa sot bëhet me avionë; mjekësia ishte e kufizuar, ndërsa sot është më e plotë, nesër do të jetë edhe më e përsosur. Të gjitha këto gjëra zhvillohen nga dora e njeriut dhe të gjitha këto mbeten brenda kufijve të natyrës. Të gjitha këto gjëra që njerëzit i shohin me sytë e tyre dhe i njohin me intelektin e tyre, janë të kufizuara dhe dora e njeriut nuk arrin dot të shkojë përtej kësaj bote të kufizuar natyrore. Edukimi që bëhet nga profetët johyjnorë, është vetëm i kësaj bote materiale. Mjeku, për shembull, trajton trupin tonë dhe shëron sëmundjet trupore, por nuk është në gjendje të shërojë sëmundjet shpirtërore, sepse ato nuk lidhen me të, dhe çfarëdo mjeku që të jetë, nuk ka lidhje me to. Sa

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 313.

më shumë të përparojë shkenca, aq më tepër do të shihet se nuk ka lidhje me atë dimension. Shkenca nuk mund të arrijë kurrë ta çojë njeriun drejt atyre gjërave shpirtërore që ai ka nevojë përtej natyrës dhe "xheneti shpirtëror" është mbi natyrën dhe nuk arrihet nga shkencat njerëzore, edhe sikur të supozonim se sistemet njerëzore janë të drejta. Ne e dimë se shumica e tyre nuk janë të tilla, pasi ato e drejtojnë njeriun vetëm brenda kufijve të mendimit dhe dijes së tij dhe përtej kësaj nuk mund të ecin më tej.

Prandaj, shohim se sistemet që nuk janë të lidhura me shpalljen dhe me parimin hyjnor, nuk kanë të bëjnë aspak me njeriun, domethënë me cilësitë e tij të brendshme. Qeveritë nuk kanë lidhje me atë se si ti mendon, çfarë beson apo çfarë ke nga aftësitë shpirtërore. Ato nuk merren fare me këto gjëra. Detyra e qeverive të drejtësisë është të ruajnë rregullin material, që tregjet të jenë të rregullta, qytetet e tyre të organizuara, të pengojnë vjedhësit dhe të ndëshkojnë të papunët. Kaq është ajo me të cilën merren këto sisteme. Nuk kanë të bëjnë me atë që bëni në shtëpitë tuaja apo me jetën tuaj private. Ato kanë për qëllim vetëm ruajtjen e rendit jashtë shtëpive. Ndërsa brenda shtëpive tuaja, ju jeni të lirë; nuk ka ligj që ndjek këto sisteme mbi çështjet tuaja personale.

Shkolla e vetme që ka të bëjë me njeriun, është ajo që sollën profetët. Në botë nuk ka shkollë tjetër përveç shkollës së profetëve, që të merret me njeriun. Për shembull, gruaja lidhet me burrin që zgjedh dhe me të cilin bashkohet dhe burri lidhet me gruan që e kënaq. Ky drejtim nuk ka asnjë lidhje me ato sisteme (johyjnore). Ato nuk merren fare me çështje të tilla; në ligjet e tyre nuk ka asgjë që të përcaktojë çfarë bën gruaja gjatë shtatzënisë apo çfarë bën gjatë ditëve të gjidhënies dhe kujdesit për fëmijën, as nuk përcaktojnë rolin e nënës, kur fëmija është nën kujdesin e saj. Këto çështje nuk ekzistojnë në ligjet materiale dhe në sistemet johyjnore. Ata shikojnë te njeriu vetëm kur hyn në shoqëri, për t'ia përcaktuar të drejtat

dhe për ta penguar nga të këqijat që mund të bëjë. Janë pikërisht të këqijat që dëmtojnë rendin shoqëror. Sa për të këqijat e alkoolit, imoralitetit dhe epsheve të ndaluara, ato nuk janë objekt i ligjeve të tyre; ndoshta as nuk i përmendin, sepse nuk shqetësohen për atë që ndërton njeriun apo e formon atë. Ata nuk bëjnë dallim mes njeriut dhe kafshës. Në mendjen e tyre, përparimi është vetëm në materie: kafsha nuk mund të prodhojë një aeroplan, as nuk mund të bëhet mjek; ndërsa njeriu arrin t'i bëjë këto gjëra, por gjithnjë brenda kufijve materialë. Sa për kuptimin e brendshëm të gjërave, ata nuk shohin asgjë.

Për shembull, njeriu që sheh vlerën e njeriut, përpara martesës dhe zgjedhjes së bashkëshortit, thotë se para martesës, njeriu duhet të përgatitet që të jetë një qenie e shëndoshë, e plotë. Ai që martohet, duhet të jetë një njeri i përsosur, ashtu si edhe gruaja duhet të jetë e përsosur, që martesa të ndërtohet mbi bazën e duhur. Përse ekziston kjo urdhëresë? Sepse gruaja që martohet dhe burri që martohet, janë si fermeri që mbjell në tokë, ai zgjedh tokën më të mirë për të mbjellë dhe llojin më të mirë të farës që dëshiron të mbjellë, që të japë prodhim të mirë".[1]

"Ky është këndvështrimi i Islamit ndaj njeriut: që bashkëshorti i zgjedhur të jetë i drejtë, njeri i mirë dhe gruaja e zgjedhur të jetë, gjithashtu e mirë, në mënyrë që nga këta dy bashkëshortë të vijë në jetë një brez i shëndetshëm e i denjë. Prandaj, duhet të ketë etikë për martesën, etikë për kohën e shtatzënisë dhe etikë për periudhën e gjidhënies. Cilat janë këto rregulla? Të gjitha këto janë sjellë nga fetë monoteiste, të cilat Allahu i Madhëruar i ka dërguar për ndërtimin e njeriut. Nuk kanë ardhur për të krijuar një kafshë të paditur, por për të ndërtuar një njeri të vetëdijshëm, përtej kufijve të instinkteve shtazore dhe synimeve kafshërore. Ato nuk bëjnë tjetër veçse e ngrenë njeriun mbi kafshën, duke e çuar atë

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 314.

drejt qëllimit përfundimtar. Pra, gjithçka që kanë sjellë këto fe, është për ndërtimin e njeriut dhe nuk ka sistem si Islami për të formuar njeriun.

Islami, në kuptimin e tij të thellë, mund ta mësojë njeriun të ngjitet nga niveli i natyrës te shpirti dhe përtej shpirtit. Ai nuk është si fetë dhe sistemet johyjnore që kanë të bëjnë vetëm me çështje të natyrës dhe asaj që është pas saj, sepse mendimet e tyre nuk arrijnë deri në përfundim. Ata e masin njeriun vetëm me veprat e tij brenda natyrës dhe me atë që merr prej saj. Ndërsa Islami e lidh njeriun me shpalljen hyjnore dhe me atë që është përtej saj. Para së gjithash, profetët janë ata që e përcjellin këtë lidhje.

Islami nuk është si qeveritë e tjera. Dallimi mes tyre është se Islami është i drejtë, ndërsa ato jo. Në fakt, dallimet janë të shumta. Dallimi më i rëndësishëm është se Islami kërkon një qeveri të drejtë, ndërsa qeveritë e tjera nuk e kërkojnë këtë. Cilat janë cilësitë e një sundimtari? Cilat janë cilësitë e një oficeri? Cilat janë cilësitë e një ushtari? Cilat janë cilësitë që duhet të kenë punonjësit e shtetit? Islami i ka vendosur të gjitha këto dhe këto janë dallime madhore e mbi të gjitha dallime shpirtërore.

Islami erdhi për ta ngritur njeriun nga natyra drejt shpirtit dhe për ta mbrojtur nga dhuna e saj. Ajo që Islami u thotë të gjithëve, nuk ka të bëjë me natyrën, por me shpirtin dhe me një civilizim më të lartë. Islami e pranon çdo formë të qytetërimit dhe synon ta plotësojë atë. Për këtë arsye, qeveritë islame janë qeveri progresive që nuk pengojnë asnjë formë të qytetërimit, por, përkundrazi, e pranojnë dhe synojnë të ofrojnë më shumë.

Në kohën kur këto shtete natyrore shohin vetëm te natyra, vetëm Islami e orienton qytetërimin drejt shpirtit dhe udhëzimit të monoteizmit. Nga kjo pikëpamje bëhet dallimi mes Islamit dhe të tjerëve, mes qeverive islame dhe joislame, dhe mes çështjeve që solli Islami dhe atyre që sollën fetë e tjera. Shumë prej feve të paplota e paraqesin veten sikur janë të plota, por kufizimi i këtij mendimi i bën ato të mbeten të mangëta. Feja islame,

me idenë e saj që e përfshin gjithçka, i tejkalon këto kufizime, sepse dynjaja, sipas saj, është e qortueshme në gjuhën e profetëve".[1]

Udhëheqësi dhe drejtimi në fetë qiellore, veçanërisht në Islamin e madhërishëm, nuk kanë vlerë në vetvete, sa të bëhen shkak që njeriu të rrëshqasë drejt mendjemadhësisë dhe arrogancës. Kjo është ajo për të cilën nënkuptoi Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), kur tha: "Është një sprovë e madhe për një njeri, kur e quajnë prijës".[2]

Profetët nuk erdhën që të bëheshin sundimtarë, por për të shërbyer si robër të Allahut, për udhëzim dhe edukim, për t'i shërbyer të dobëtit, të shtypurit dhe të margjinalizuarit, për të ngritur drejtësinë individuale dhe shoqërore dhe për t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë. Standardi që profetët dhe të afërmit e Allahut shohin, është ai që ka rrënjë në Kur'anin e shenjtë dhe në traditën e të Dërguarit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ky standard përfaqësohet nga dija dhe devotshmëria, të cilat janë të pandara.

Dija e vetme nuk ka vlerë ose ka pak vlerë dhe devotshmëria e vetme, gjithashtu, nuk ka vlerë të plotë. Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Shpina ime u thye nga dy lloje njerëzish: një dijetar i shthurur dhe një injorant i devotshëm". Injoranti që nuk e njeh ekuilibrin e njerëzimit islamik, nëse është i devotshëm, por i paditur, vepron në kundërshtim me jetën e profetëve. Dëmi i një dijetari të shthurur, që nuk ka devotshmëri, është edhe më i madh, sepse Islami bazohet mbi dijen dhe devotshmërinë, bashkërisht. Çdo gjë tjetër pranohet vetëm kur bashkohen të dyja. Kur'ani e ka lavdëruar shumë dijen, por gjithnjë duke e lidhur atë me devotshmërinë, sepse vetëm dija nuk sjell dobi të vërtetë për njeriun, veçse kur është në përputhje me

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 315.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 243.

etalonët e natyrës. Po ashtu, edhe devotshmëria pa dije nuk e çon njeriun në plotësim".[1]

Ashtu siç përmendëm në hyrjen e këtij studimi, të gjitha të dhënat monoteiste nuk kundërshtojnë përparimin dhe qytetërimin modern, por kundërshtojnë prishjen që mund ta shoqërojë atë.

"Nëse me përparim dhe qytetërim nënkuptohet shpikja, të rejat dhe industritë e zhvilluara që kontribuojnë në ngritjen e njerëzimit dhe përparimin e qytetërimit të tij, atëherë Islami dhe të gjitha fetë e tjera monoteiste nuk e kundërshtojnë këtë aspak. Përkundrazi, Islami dhe Kur'ani i shenjtë e urdhërojnë atë në formën e shkencës dhe të industrisë.

Por, nëse me përparim dhe qytetërim nënkuptohet kuptimi i pretenduar nga disa përfaqësues të kulturës që pranojnë imoralitetin në të gjitha shëmtitë dhe turpet, deri te shthurja seksuale dhe të ngjashme, atëherë të gjitha fetë qiellore, të gjithë dijetarët dhe të mençurit e kundërshtojnë këtë, edhe nëse përfaqësuesit e saj janë nga Perëndimi apo nga Lindja. Arsyeja për këtë është se ata e shohin nga këndvështrimi i traditës së tyre të verbër".[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 17, f. 365.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 365.

Marrëdhënia vëllazërore mes pasuesve të feve monoteiste

Filozofia e feve monoteiste, të cilat u ngritën mbi besimin në Një Zot të vetëm dhe të fuqishëm, u bashkuan në thirrjen për drejtësi, vëllazëri dhe dashuri. Të gjithë profetët u bashkuan në këtë mesazh dhe e konsideruan veten vëllezër, edhe pse i ndanin kohëra të ndryshme. Kjo filozofi e bën të domosdoshme përsosjen e plotë në arritjen e synimit të shpalljes së vetme dhe dëshirave të përbashkëta të profetëve. Është e pamundur që të mohojnë njëra-tjetrën dhe të mos punojnë për anulimin e secilës. Të gjitha fetë monoteiste dhe librat e shenjtë, me në krye Islamin dhe Kur'anin e shenjtë, thërrasin në këtë plotësim të ndërsjellë të feve qiellore dhe pasuesve të tyre. Çdo gjë tjetër që kemi parë, përplasje dhe konflikte mes pasuesve të feve qiellore, ka qenë për shkak të duarve të politikanëve dhe lakmitarëve, të cilët nganjëherë i ngatërrojnë edhe disa dijetarë të feve.

Më poshtë do të paraqesim disa tekste të Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), të cilat theksojnë natyrën dhe vërtetësinë e lidhjes vëllazërore mes pasuesve të feve monoteiste në çdo kohë e vend, madje edhe në mesin e pakicave në vendet islame.

"*Pakicat fetare gjithmonë kanë qenë të respektuara në Islam dhe harmonia mes feve dhe dashuria e madhe mes tyre është çështje e domosdoshme për arritjen e përparimit njerëzor. Besimi i popullit dhe fuqia e Islamit, të cilat u fuqizuan nga përballimi i tiranisë, shtypjes dhe*

kolonializmit, janë siguri për këtë rrugë. Shpresojmë që të gjithë popujt të bashkohen me ne në këtë rrugë.[1]

"Shpresoj që kjo kryengritje të jetë një e mirë e hapur për të gjitha fetë dhe pakicat fetare që jetojnë në Iran. Ne e dimë që të gjitha pakicat në Iran, qofshin myslimanë apo jobesimtarë, kanë jetuar nën vuajtje dhe shtypje gjatë qeverisjes së Shahut dhe babait të tij. Ne e dimë që Islami gjithmonë ka vepruar me respekt ndaj pakicave fetare. Imami Aliu (Paqja qoftë mbi të!), për çështjen e një hebreu që kishte vjedhur një varëse nga një grua, ka thënë: "Po të vdiste ndonjë mysliman pas kësaj ngjarjeje, nuk do t'i vija faj, sepse do ishte i shfajësuar përpara meje".[2]

"Ne besojmë në respektimin e pakicave fetare. Këta janë bijtë e popullit tonë dhe nga banorët e vendit tonë. Shpresoj që qeveria e drejtësisë islame të jetë e dobishme për ta dhe ata të jetojnë nën hijen e Islamit të ndershëm, të lirë dhe në mënyrë të natyrshme, të begatshëm.

Bijtë e pakicave fetare që jetonin mes myslimanëve, në fillim të Islamit, pas pushtimeve, nuk ishin si idhujtarët që komplotonin, as si disa grupe që bënin plane, nxisnin trazira dhe turbullira. Këta që ishin nga pakicat fetare, gëzonin gjithmonë respekt të plotë në Islam".[3]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 6, f. 143.
2 "Nehxhul Belaga", Hytbja 27.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 219.

Kombi i krishterë

Kombi i krishterë konsiderohet si më i madhi ndër fetë monoteiste, për nga numri i pasuesve në kohën tonë. Pasuesit e tij janë të përhapur në shumicën e vendeve të banuara. Ky është kombi i Isait, birit të Merjemes, frymë e Allahut (Paqja qoftë mbi të!), i cili pati një rol të madh dhe ende e ka këtë rol, në forcimin e filozofisë së fesë dhe shpirtit fetar te njerëzit, duke përhapur virtytet morale dhe thirrjen për dashuri mes njerëzve në të gjitha anët e botës.

Megjithatë, ky komb dhe mesazhi i tij i krishterë u përball me sulme të njëpasnjëshme nga armiqtë e feve qiellore, me synimin për të goditur fenë dhe për të përhapur ateizmin dhe shthurjen morale. Ai ka qenë dhe vazhdon të jetë objekt i këtyre komploteve. Fjalia e famshme "feja është opium i popujve" nuk u shpik përballë këtij kombi, por kundër gjithë umetit, pastaj u përdor edhe kundër fesë islame.

Ndër komplotet më të rënda që arritën me sukses të madh të shtrembërojnë imazhin humanitar të kombit të krishterë, ishte shfrytëzimi i shumtë nga mbretërit dhe perandoritë e mëparshme dhe shtetet kolonialiste të sotme të emrit të fesë së krishterë, duke kryer krime që turpërojnë njerëzimin, në emër të fesë së dashurisë. Për fat të keq, kjo çështje vazhdon ende deri në ditët tona, sidomos me pretendimin e administratave amerikane grabitqare ndaj botës, se ato po zbatojnë mësimet e Profetit Mesi (Paqja qoftë mbi të!). Kjo

çështje u ngarkon dijetarëve të krishterë, të sinqertë dhe të ditur, përgjegjësi të madhe njerëzore, për t'u përballur me këto pretendime dhe për të çliruar fenë dhe kombin e krishterë nga kjo njollë. Duhet të theksojmë gjithashtu se edhe umeti islam nuk ka qenë i kursyer nga këto fatkeqësi dhe, për fat të keq, ende nuk është. Pikërisht kjo çështje do të trajtohet në kapitullin e dytë të këtij libri.

Le të përmendim një tekst të Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ku ai i drejtohet një delegacioni të priftërinjve të krishterë perëndimorë dhe amerikanë:

"Sot, popujt e botës janë të sprovuar me forca të mëdha, të cilat janë forca djallëzore që u qëndrojnë përballë profetëve dhe nuk lejojnë përhapjen e mësimeve të tyre. Dijetarët e fesë së krishterë kanë një tipar të veçantë, sepse ato forca të mëdha pretendojnë fenë e krishterë. Këto forca të mëdha janë ato që veprojnë kundër mësimeve të Allahut të Madhëruar dhe kundër mësimeve të Profetit Isa (Paqja qoftë mbi të!). Dijetarët e fesë së krishterë janë të ngarkuar, sipas mësimeve të Mesihut dhe sipas mësimeve të Allahut të Madhëruar, që të përballen me këto forca që veprojnë në kundërshtim me Mesihun. Ata duhet t'i udhëzojnë këta njerëz drejt fesë së Mesihut dhe sipas rrugës së profetëve. Është detyrë e tyre t'i udhëzojnë popujt e krishterë, që të mos i ndjekin këto forca që veprojnë në kundërshtim me Mesihun. Kur unë takohem me dijetarët e fesë së krishterë, duhet të diskutoj me ta çështje që lidhen me fenë. Çështjet e veçanta fetare janë për ju, ndërsa për mua është që t'i shqyrtojmë çështjet botërore ashtu siç janë dhe të arrijmë tek ajo që popujt kanë përjetuar nga armiqtë e Krishterimit. Ju erdhët në Iran dhe nuk është e panjohur për ju se, sa kohë qëndruat aty, nuk keni mundur të mos shihni varret e dëshmorëve tanë. Ju vizituat Varrezat e Zehrasë dhe patë sa dëshmorë ndodhen atje.

Por, kur të hyni brenda Iranit, do të shihni shumë varre, do të shihni ata që humbën duart dhe këmbët, ata që u plagosën dhe mbetën të paaftë, dhe do të shihni jetë të shkatërruara. Sa mirë do të ishte sikur dijetarët e fesë së krishterë, ju që jeni dijetarë të fesë së krishterë, të qëndronit më gjatë në Iran, të udhëtonit në qytetet dhe fshatrat iraniane, të shikonit gjurmët dhe dëshmitë e krimeve të atij njeriu që e mbështeste presidenti i Amerikës dhe të gjithë presidentët e Republikës së Amerikës, dhe ata që e detyruan popullin tonë nën tiraninë e tyre".[1]

Me rastin e lindjes së hazreti Mesihut (Paqja qoftë mbi të!), në vitin 1399 hixhri, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) iu drejtua kombit të krishterë në botë me një mesazh. Midis të tjerash, ka thënë:

"Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Paqja dhe bekimet e Allahut të Madhëruar qofshin mbi Isain, birin e Merjemes, Shpirtin e Allahut, profetin me pozitë madhështore, i cili ringjalli të vdekurit dhe zgjoi të fjeturit. Paqja e Allahut qoftë mbi nënën e tij të madhe, Merjemen e virgjër, të drejtën e të besuarën, e cila erdhi për t'u dhuruar të eturve për mëshirën hyjnore një frymë të pastër qiellore.

Përshëndetje për burrat e fesë dhe murgeshat që thërrasin me mësimet e Isait, birit të Merjemes, shpirtit të lirë të Zotit, nga shpirti i përulur drejt bindjes. Përshëndetje për kombin e krishterë dhe për ata që ndjekin mësimet hyjnore të Isait, shpirtit të Allahut!

Unë të bëj thirrje ty, o komb i krishterë, në emër të popullit të shtypur iranian, që në ditët e tua të bekuara të ngresh duart drejt Zotit, kundër sundimtarit tiran dhe të kërkosh nga Ai çlirim për kombin tonë të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 324.

vuajtur. Po ashtu, të kërkoj ty, o komb i madh, që t'i paralajmërosh disa udhëheqës të vendeve të krishtera, të cilët e mbështesin Shahun tiran me fuqitë e tyre djallëzore. Ata e kanë shtypur një popull të tërë nën presionin e padrejtësisë dhe nuk veprojnë sipas mësimeve të Profetit Mesih. Unë, gjithashtu, u bëj thirrje dijetarëve të krishterë që të këshillojnë disa udhëheqës të mëdhenj të vendeve të krishtera, që të heqin dorë nga mbështetja e tyre për ata që i shëmtojnë mësimet qiellor.

Kur'ani i shenjtë e përmend Jezusin e nderuar me madhështi dhe ka nderuar zonjën Merjem. Është detyrë e kombit të krishterë që të përmbushë fenë e tij me besnikëri. Paqja qoftë mbi kombin mysliman dhe mbi Shpirtin e Zotit, Isain (Paqja qoftë mbi të!)".

Ruhullah Musauij Khomeini

Më 19 Dhul Hixhe të vitit 1399 hixhri, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) priti në qytetin e shenjtë Kum, Peshkopin Hanibal Bukenini, të dërguarin e papës, udhëheqësit të katolikëve në botë. Imami mbajti një fjalim të gjatë dhe të rëndësishëm, lidhur me temën tonë.

"Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Nëse disa përgjegjës, përveç jush, do të më kërkonin takim për ta diskutuar këtë në këtë kohë delikate, nuk do të pranoja t'i takoja. Por pozita shpirtërore e umetit të krishterë dhe Papës së madh, të cilët gëzojnë respekt të veçantë te ne, na bëri ta pranojmë takimin. U gëzova për letrën që dërgoi Papa dhe do t'i përgjigjem, duke përmendur diçka që duhet theksuar. Unë dhe populli im, dhe të gjithë popujt e botës së shtypur, myslimanë, të krishterë e të tjerë, ndiejmë rëndësinë e një çështjeje që tani dua ta përmend: ajo është se tridhjetë e pesë milionë iranianë ishin nën peshën e kolonializmit dhe shtypjes amerikane, veçanërisht nga zoti Karter, dhe miliona të shtypur në botë kishin veshët e tyre të drejtuar për të dëgjuar nga Selia e Shenjtë, nga pozita shpirtërore e Papës, një fjalë sado të vogël për të pyetur për gjendjen e tyre, për të paralajmëruar shtypësit që i shtypën ata dhe i bënë ta përjetojnë këtë shtypje, dhe për të ndërmjetësuar mes popujve të shtypur dhe forcave kolonialiste që pretendojnë se janë të krishterë. Por deri tani, askush nuk e ka dëgjuar atë thirrje shpirtërore.

Ne kemi dhënë viktima në mënyrë kolektive për pesëdhjetë vjet me radhë dhe kemi qenë nëpër burgje, ato burgje që shkelin të drejtat e njeriut,

pasi aty u burgosën burrat më të mirë të këtij populli; i torturonin me gjëra që binin ndesh me humanizmin. Me gjithë këto padrejtësi, nuk pamë ndonjë përpjekje serioze për t'i çliruar këta të shtypur. Përse zoti Papa i Madh nuk mendoi ta mbështesë këtë popull të shtypur? Pse nuk ndërmjetësoi, të paktën, për lirimin dhe shpëtimin e këtyre të shtypurve nga padrejtësia? Unë nuk mund të besoj se Vatikani nuk ishte i vetëdijshëm për krimet që ndodhnin. Nuk di se çfarë të them në këtë pikë, për të dhënë shpjegim. Si të përgjigjem për këtë, nëse më pyet popullin im?! A pajtohen dijetarët e fesë së krishterë me këto krime, të cilat i kryen ata të padrejtë? Nuk e di se çfarë të them për këto krime. Dijetarët e fesë së krishterë e dinë se Kur'ani i shenjtë e dëshmon vërtetësinë e Isait dhe të nënës së tij të pastër, dhe e ka mbrojtur atë, duke hedhur poshtë qartë çdo shpifje që i atribuohej asaj të dëlire. Ashtu siç Kur'ani i shenjtë e ka mbrojtur Isain (Paqja qoftë mbi të!), po ashtu edhe dijetarët dhe priftërinjtë e krishterë.

Ne prisnim që në këmbim të këtij respekti të dëgjonim fjalët e Papës, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, duke pyetur Karterin për ta sqaruar: 'Përse ky popull po jeton një jetë tragjike? Përse ia dhatë pushtetin një njeriu të tillë mbi këtë popull? Përse ky kriminel, që vazhdoi krimet dhe tradhtitë e tij për më shumë se tridhjetë vjet, nuk u ndalua, por, përkundrazi, u mbështet dhe u përforcua?' Përse doni të vazhdoni komplotet tuaja? Ne nuk çuditemi nga fjala boshe e Karterit dhe nga hutia e tij, sepse ai është person i politikës jo të saktë, që vepron për interesat e veta personale, duke i paraqitur si të ishin interesa të popullit të tij. Për këtë arsye, ne atë e shohim duke kryer lloje të ndryshme krimesh, me të gjitha mjetet dhe fuqinë që ka në dispozicion, duke punuar për t'i mbajtur të fshehta ato sekrete që, po të zbuloheshin, do të nxirrnin në pah krimet e tij, pengjet dhe të burgosurit që ai i ka shkatërruar.

Është detyrë e Papës që të vepronte për këtë çështje. Përse nuk e bëri këtë zotëri Papa, që pretendon se është ndërmjetës për të mbrojtur të drejtat e populli të shtypur, i cili donte t'i tregonte botës padrejtësitë ndaj tij?! Unë u them njerëzve të shtypur: Cila është rruga e padrejtësisë dhe si është ajo? Sikur të ishte në mundësinë tonë, ne do ta ngrinim çështjen e këtij tirani në një vend tjetër për ta gjykuar, duke paraqitur dëshmitë dhe provat, por u referohemi asaj që ka ndodhur më parë, nuk do vonoheshim asnjë çast për krimet e shumta që ai njeri ka kryer. Dosjet që kemi gjetur për ato krime, miliona dëshmitarë që u shtypën prej tij, nga fshatarët, punëtorët, dijetarët e fesë dhe akademikët, të gjithë këta janë dëshmitarë për ne dhe kundër tij.

Por ne nuk mund t'i dërgojmë këta miliona dëshmitarë jashtë vendit për të dëshmuar, sepse ata tejkalojnë njëzet milionë dëshmitarë. Prandaj, nga respekti për pozitën papale, jemi të gatshëm të pajtohemi që këtu, në praninë e përfaqësuesve të Papës dhe të kujtdo nga çdo shtet apo organizatë ndërkombëtare, madje edhe të atyre që janë armiqtë tanë, si Karteri, ky njeri të gjykohet këtu, me praninë e atyre përfaqësuesve, dhe të pranojmë çdo vendim që kjo gjykatë do të nxjerrë".[1]

"Papa duhet të interesohet për çështjet e kombit të krishterë, por, gjithashtu, duhet të interesohet për çështjet e të gjithë popujve të shtypur dhe të kujdeset për nderin e të krishterëve. Po ashtu, Papa duhet t'i bëjë të ditur popullit amerikan dhe të gjithë popujve të krishterë numrin e krimeve që Karteri ka kryer në emër të Mesihut, dhe që janë në kundërshtim me mësimet e tij. Prandaj është e nevojshme që popujt e krishterë të informohen për këtë, ashtu siç ne ua bëmë të ditur njerëzve të vërtetën për veprat e Muhamed Rizait, edhe pse njerëzit i dinin, por ne ua shpërndamë atëo njerëzve. Prandaj edhe ju bëjeni këtë veprim. Në këtë rast ne do t'ju

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 35-36.

falënderojmë për këtë. Kjo padrejtësi që ju themi, është bërë kundër popullit të krishterë dhe ne, me gjykimin e kësaj padrejtësie, shpallim ankesën tonë para jush, që ta shpëtoni popullin e krishterë. Lëreni kombin islamik dhe çështjen e tij, por shpëtoni kombin e krishterë nga veprat e udhëheqësve të mëdhenj të shteteve që kryejnë krime në emër të Mesihut. Kjo është diçka që cenon nderin e Mesihut (Paqja qoftë mbi të!), dëmton reputacionin e të krishterëve dhe njollos emrin e tyre. Dhe unë, o i nderuar Papë, po ju them: Sikur Mesihu (Paqja qoftë mbi të!) të ishte në këtë kohë, nuk do t'i përgjigjej Karterit dhe do të na shpëtonte nga kthetrat e këtij armiku të njerëzimit. Ju jeni përfaqësuesi i Mesihut, prandaj është e domosdoshme që të veproni ashtu siç do të vepronte Mesihu".[1]

Në vitin 1400 hixhri, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) iu drejtua të krishterëve të botës me një thirrje, ku tha:

"Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

O ju që besuat! Qëndroni gjithmonë të drejtë për hir të Allahut, dëshmitarë me drejtësi. E mos lejoni që urrejtja ndaj një populli t'ju shtyjë të mos veproni me drejtësi. Bëhuni të drejtë, sepse drejtësia është më afër devotshmërisë. Kini frikë Allahun, se me të vërtetë Allahu është i Dijshëm për atë që veproni". (Kur'ani famëlartë)

Lum ata që kanë etje për drejtësi, sepse ata do të ngopen. (Ungjilli sipas Mateut) Lum ata që punojnë për arritjen e drejtësisë, sepse mbretëria do të jetë për ta. (Ungjilli sipas Mateut)

Uroj popujt e shtypur në botë, kombin e Mesihut dhe të krishterët në Iran, me rastin e përvjetorit të lindjes së Mesihut, profetit të madh në pozitë, i cili u dërgua për të mbrojtur të shtypurit, me mesazhin e drejtësisë

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 37.

dhe mëshirës, me fjalën e tij qiellore dhe shpirtin mbretëror, që i dënoi tiranët dhe shtypësit, dhe mbështeti të shtypurit dhe të dobëtit. O ju, udhëheqës të kishës dhe dijetarë të fesë që e pasoni Mesihun, ngrihuni dhe mbroni të shtypurit e botës, ngrihuni dhe mbroni ata që vuajnë padrejtësi dhe të shtypurit nën kthetrat e arrogantëve! O kambanat e kishave, bini qoftë edhe për një herë, për hir të mbrojtjes së të shtypurve të Iranit dhe për dënimin e tiranëve, duke synuar me këtë kënaqësinë e Allahut dhe ndjekjen e urdhrave të hazretit Mesih!

Karteri, udhëheqësi i tiranëve në botë, kërkoi që kambanat të bien në të gjitha anët e Amerikës, për hir të spiunëve dhe përballjes me popullin e shtypur iranian. Sa mirë do të ishte sikur, në vend të kësaj, kambanat të binin me urdhër të Krijuesit të botës dhe me urdhrin e Profetit Mesih, në mbrojtje të popujve të shtypur, të cilët po vuajnë nën tiraninë dhe mizorinë e Karterit dhe që u është shkatërruar jeta.

Lum ata të uritur e të etur për drejtësi, që përpiqen me gjithë fuqinë për ta arritur atë! Mjerë ata që shpenzojnë përpjekjet e tyre në shërbim të tiranëve dhe spiunëve, duke i privuar popujt nga të drejtat e tyre, në kundërshtim me urdhrat e Profetit Mesih dhe në kundërshtim me urdhrat e të gjithë profetëve! O popull i Mesihut, o komb i Jezusit, Shpirti i Allahut, ngrihuni dhe mbroni nderin e Mesihut dhe të popullit të krishterë! Mos lejoni që armiqtë e mësimeve qiellore t'i paraqesin të krishterët dhe popujt e shtypur të botës në një dritë të keqe.

Mos u mashtroni nga prania në tempuj e atyre që kanë pushtet, duke ngritur duart e tyre në lutje për interesat e spiunëve dhe tradhtarëve të feve të krishtera mbi të shtypurit dhe të dobëtit, sepse ata nuk mendojnë gjë tjetër, veçse për arritjen e pushtetit dhe marrjen e udhëheqjes së botës, gjë që është në kundërshtim me urdhrat hyjnorë.

Popujt tanë kanë vuajtur për shumë vite nga hipokrizia e tiranëve dhe janë lodhur nga dhimbjet e tyre.

O popull i krishterë! Pse zoti Karter nuk ngriti duart të lutej, pas operacioneve të shtypjes masive në Iran, Vietnam, Palestinë, Liban dhe në të gjitha zonat e tjera? Pse nuk kërkoi të bien kambanat? Sot ai e bën këtë vetëm për të arritur fronin presidencial, ndërkohë që për vite të tjera do të vazhdojë padrejtësia ndaj popujve të shtypur, do të ngrejë duart e tij për lutje dhe do t'ju ftojë që t'u bien kambanave.

O priftërinj të kishave, ngrihuni dhe shpëtoni Jezusin nga armiqtë, sepse ai profet i madh e urrente padrejtësinë. Ai kurrë nuk do ta përdorte fenë dhe lutjen si mjet për të arritur te padrejtësia ndaj robërve të Allahut. Të gjitha urdhëresat qiellore kanë zbritur për të shpëtuar të shtypurit! O popuj të shtypur të botës, o komb i Jezusit, ngrihuni, bashkohuni dhe përzini tiranët nga fusha, sepse toka i përket Allahut dhe është për ata që Ai i ka përcaktuar nga të shtypurit!

O popull amerikan! Mos i dëgjoni propagandat e presidentëve tuaj, të cilët nuk mendojnë gjë tjetër veçse për marrjen e pushtetit. Dijeni se të rinjtë tanë që përballen me spiunët, e bëjnë këtë vetëm si një vepër që e kënaq Allahun, sepse mësimet e Islamit e theksojnë mëshirën, edhe ndaj robërve, edhe nëse ata janë spiunë.

O ti popull i madh amerikan, kërko nga Karteri që të mos e rikthejë Shahun e rrëzuar dhe kriminelin në Iran, sepse çelësi i lirimit të spiunëve është në duart e tij. Ju, o bijtë e kishave, ngrini duart tuaja në lutje, u bini kambanave dhe lutuni tek Allahu i Madhërishëm, që t'i frymëzojë udhëheqësit e republikës suaj me pak drejtësi dhe barazi.

Lum ata që punojnë për përhapjen e drejtësisë dhe thërrasin për të!".[1]

Një gazetar perëndimor i drejtoi Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) një pyetje domethënëse: "A mendoni se ndjekësit e feve dhe të besimeve të tjera, si Kisha Katolike dhe Kisha Ortodokse do t'ju ndihmojnë juve në kryengritjen tuaj kundër dallimit shtresor dhe padrejtësisë?"

Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) iu përgjigj: *"I nderuari Papë dërgoi të dërguarin e tij këtu (në Iran) dhe negociuam për çështjen e pengjeve. Ai shprehu mendimin se ne duhet t'i lirojmë këta spiunë, të cilët po spiunonin brenda në strofkën e spiunazhit. Ne i paraqitëm të dërguarit disa çështje dhe i shpjeguam krimet që ndodhën këtu. Ka gjasa që lajmet nuk i kanë arritur Papës në formë të saktë e të plotë. Ashtu siç e qortuam, sepse ti e konsideron veten at shpirtëror dhe pasues i Mesihut (Paqja qoftë mbi të!), prandaj, duhet të ndjekësh rrugën që ndoqi Mesihu, ashtu siç e ndoqi Mesihu i vërtetë. Po të ishte gjallë Mesihu sot, a mendon Papa dhe krerët e feve të tjera se ai do të bashkohej me Karterin dhe me Shahun e rrëzuar, duke braktisur këtë popull të shtypur?*

Nëse Papa ose krerët e tjerë të Krishterimit dhe feve të tjera pyesin: Po të ishte Mesihu midis nesh, a do të bashkohej me shtypësit apo me të shtypurit? Ne jemi një popull që për pesëdhjetë vjet ka vuajtur, thesaret tona janë grabitur dhe kultura jonë është shkatërruar. Shahu ishte sundues absolut mbi çdo gjë, por tani populli është ngritur, e ka rrëzuar Shahun dhe Karteri e ka marrë atë vrasësin tonë dhe e ka mbajtur atje. Ne kërkojmë që ai të na e kthejë këtë kriminel. Sa për pengjet, ne nuk kemi prova se ata janë nga stafi diplomatik i ambasadës. Ambasadori dhe zyrtarët nuk janë midis tyre. E rëndësishme është se ne nuk kemi dëshmi që këto pengje janë

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 200-201.

nga personeli diplomatik i ambasadës. Përkundrazi, për ne është bërë e qartë se ata nuk janë diplomatë, por kanë ardhur këtu për spiunazh dhe sabotim të vendit tonë. Ne kemi shumë prova për këtë, se ata kanë ardhur në këtë strofkë spiunazhi. Pra, sikur Jezusi (Paqja qoftë mbi të!) të ishte këtu e të na nderonte e ne t'i paraqisnim atij kërkesat tona, të cilat ia thamë Papës, ai (Jezusi) do t'i dëgjonte fjalët tona dhe do t'i kushtonte vëmendje këtij populli të shtypur. Nëse Papa beson të kundërtën, atëherë kjo do të thotë se Mesihu mbështet shtypësin dhe ky veprim është në kundërshtim me fenë e Mesihut. Nuk është kjo feja e Mesihut. Prandaj, nëse Papa nuk beson të kundërtën e Mesihut, atëherë përfundimi është se profeti i madh, Mesihu Isa (Paqja qoftë mbi të!), nëse do të ishte këtu mes nesh, do të na ndihmonte të ngrinim padinë kundër armiqve të këtij populli të shtypur, dhe do të ishte detyrë e tij ta shpëtonte këtë popull të shtypur. Kështu që, sot u takon priftërinjve të krishterë dhe Papës, i cili beson se është pasues i Mesiut, si dhe priftërinjve të tjerë të besimit të krishterë që besojnë te Mesihu, që ta konsiderojnë veten ndjekës të Krishtit dhe ta mbështesin Krishtin. U takon të gjithëve atyre të jenë me ne, sepse po të ishte Krishti në këtë kohë, ai do të ishte me ne".[1]

"Pra, sipas fesë së krishterë dhe sipas pozitës së hazretit Mesih, e cila është pozitë e lartë dhe gradë e madhe, e bën të domosdoshme të kundërshtohet padrejtësia, të ndalohet shtypësi. Kjo është detyra juaj dhe detyra e çdo kujt që ndjek hazretin Mesih, veçanërisht ju klerikë të krishterë dhe popuj të krishterë. Këta popuj duhet ta ndjekin Mesihun, sepse ata nuk besojnë se hazreti Mesih pajtohet me padrejtësinë dhe është kundër të shtypurve. Unë nuk mendoj se gjendet ndonjë i krishterë që e beson këtë.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 132.

Pasi të themi këtë, u themi klerikëve të krishterë dhe popullit amerikan dhe popujve të krishterë dhe i pyesim: A besoni se ndiqni hazretin Mesih (Paqja qoftë mbi të!)? Le të supozojmë se Mesihu është i pranishëm këtu tani, a mund ta pranoni që ai bie dakord me Karterin dhe mbështet veprimet e tij? A mund ta pranoni që ai të veprojë ashtu siç veproi Karteri? Ata vranë shumë nga të rinjtë tanë. Policia na lëndoi, madje lëshoi qentë policorë mbi bijtë tanë dhe qëlloi me armë mbi të rinjtë tanë. A mund ta pranojë populli i krishterë që Mesihu mund të ishte dakord me këto veprime apo ata mendojnë se Mesihu i pranon këto mizori? Nëse ata besojnë një gjë të tillë, atëherë kjo bie ndesh me fenë e krishterë. Përkundrazi, ky është një mohim i Mesihut. Ne nuk e pranojmë asnjëherë një supozim të tillë, përkundrazi, ne e konsiderojmë Mesihun të pastër dhe të shenjtë. Pra, ata që nuk mund ta pranojnë këtë, duhet të qëndrojnë në krahun tonë. Fakti që Karteri zotëron tanke, armë, aeroplanë dhe artileri nuk është justifikim për frikën e popujve të krishterë, të popujve myslimanë dhe të udhëheqësve të tyre. Përkundrazi, kjo duhet t'i shtyjë ata të largohen prej tij dhe të mbështesin popujt e shtypur. Prandaj, ju duhet të qëndroni në krahun tonë dhe të largoheni nga Karteri, qofshi të krishterë, hebrenj dhe zoroadistë.

I kemi thënë zotërisë Papë: 'Ne po ngremë ankesën tonë te ju dhe ju kërkojmë që ta ndiqni këtë ankesë deri në arritjen e rezultatit, sepse ne jemi një popull i shtypur dhe shpresojmë që ju t'i ndiqni këto krime të mëdha që janë kryer nga këta njerëz dhe krimet e mëdha që po i kryen tani Karteri, në mënyrë të hapur'. Këtë fjalë që ia thamë zotërisë Papë, ua themi edhe të gjithë të krishterëve në botë, të gjithë hebrenjve në botë, të gjithë zoroastrianëve në botë dhe të gjithë myslimanëve në botë. Ne ua themi të gjithëve: 'Ju jeni përgjegjës, sepse, nëse e besoni fenë tuaj dhe i keni pranuar të dërguarit tuaj, atëherë kjo kërkon që ju të jeni në krah të të

shtypurve dhe të mos qëndroni pranë Karterit, sepse profetët tuaj dhe të dërguarit tuaj gjithmonë qëndronin në krah të shtypurve.[1]

"O ju dijetarë të fesë së krishterë, ju duhet ta shpëtoni Mesihun nga kjo gjendje e vështirë që ia kanë krijuar presidentët e republikës suaj. Mesihu caktoi dijetarët e fesë së krishterë dhe bartësit e sheriatit që ta shohin dhe të shohin çfarë bëni ju me tiranët që veprojnë kështu me njerëzit. A u përmendën apo u diskutuan këto krime në kishat tuaja? A i dënoi Papa këto praktika? A ishte Papa ai, që sipas asaj që doli në gazeta, reagoi për çështjen e pengjeve? A e dinte ai se kush janë ata dhe për çfarë? A i dënoi Papa veprimet e një populli të shtypur apo i konsideroi këto si një çështje botërore dhe e pa si diçka që nuk lidhej me fenë e krishterë? A është e drejtë që një fe e madhe, si Krishterimi, të mos e dënojë punën e atyre që kanë jetuar nën shtypje për pesëdhjetë vjet, nën tiraninë e qeverive të tyre? A i dënuan dijetarët e Krishterimit këto vepra dhe praktika që bien ndesh me mësimet e Mesihut (Paqja qoftë mbi të!)? A i dënuan ata këto vepra? Ne kemi thirrur për këtë në Paris, në përvjetorin e lindjes së Krishtit, kemi folur për këtë padrejtësi dhe kemi shkruar shumë gjëra, por për fat të keq, Papa nuk i lejoi të botohen. A nuk duhet që një botë që i përket fesë së krishterë, të ngrejë zërin në nivel botëror për të mbrojtur të shtypurit? Pse nuk duhet që dijetarët e fesë së krishterë të dënojnë krimet e tiranëve dhe të ngrinin zërin kundër padrejtësisë? A nuk e dini se këto krime kanë ndodhur? A nuk e dini se një popull u plaçkit, iu vodh pasuria, iu grabitën të gjitha burimet dhe mbeti i uritur? A nuk e dini se ata i bënë presion popullit për shumë vite dhe praktikuan lloje të ndryshme të torturave dhe mundimeve, dhe pasuritë e tij u ndanë mes qeverive të mëdha? A nuk e dinë dijetarët e krishterë se kjo është krejtësisht në kundërshtim me mësimet e të gjithë profetëve? Profeti Mesih, ashtu si të gjithë profetët, e dënonte veprën e Karterit që ngrinte dorë mbi pasuritë e

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 133.

iranianëve, i ngrinte ato në të gjitha bankat dhe kërkonte që njerëzit të jetonin në drejtësi. A mos vallë Krishti, i cili erdhi për të përhapur drejtësinë dhe për të siguruar mirëqenie për njerëzit, do të kënaqej me këtë? Edhe pse ju jeni të ngarkuar me detyrë që të veproni sipas mësimeve të Mesihut, pavarësisht veprave të tiranëve, ju heshtni. A e dini se embargoja ekonomike që Karteri po përpiqet ta zbatojë, do të thotë që tridhjetë e pesë milionë njerëz mund të vdesin nga uria?

Tani pyesim: 'A i di Papa këto çështje për të dhënë përgjigje? Apo mos vallë informacionet që i kanë mbërritur janë të gabuara?' Nëse ai është i vetëdijshëm, atëherë mjerim mbi mjerimet! Është për të ardhur keq për të krishterët, e aq më tepër për dijetarët e fesë së krishterë. Nëse ai nuk ka njohuri për gjendjen e pengjeve, atëherë është për të ardhur keq për të gjithë ata që e kanë zgjedhur këtë prijës. Pse nuk u kujtoni zotërinjve, që shkuat në Vatikan, se cilat janë këto çështje? Pse nuk ia paraqitët ato? A nuk i pranon Vatikani këto nga ju? A mund të pranojë Vatikani që forcat e mëdha, të cilat mburren si të krishtera, të mbrojnë tiranët dhe të mos pranojnë të shtypurit? Ku duhet të ankoheni ndaj këtyre padrejtësive që kryhen ata që pretendojnë se janë të krishterë dhe përpiqen t'ia mbushin mendjen botës se janë ndjekës të Jezu Krishtit? Ku duhet të ankohemi për këto padrejtësi dhe ku duhet të shkojmë? A duhet të shkojmë të kërkojmë Papën? A do të arrijë zëri ynë te Papa? A do ta lejojnë të dëgjojë? Dhe nëse i arrin, a do të ndikojë tek ai? A ka ndërmend Papa të kundërshtojë tiranët dhe ata që jetojnë nën padrejtësi, ndërkohë që i trajton ata në kundërshtim me mësimet e Jezu Krishtit? A nuk e di Papa për padrejtësitë që po kryhen aktualisht, nën dorën e Presidentit të Republikës së Amerikës dhe më parë nën dorën e presidentëve të mëparshëm? A nuk e di ai për ngjarjet që ndodhin në Palestinë, Liban dhe Vietnam? A nuk e di për rritjen e këtyre krimeve? A nuk arrijnë këto çështje deri tek Papa? A është ai i rrethuar dhe nuk i arrijnë këto gjëra? Apo është i informuar, por hesht?

Ne pyesim: Pse kjo heshtje ndaj padrejtësisë? A është kjo nga mësimet e Profetit Mesih? Pse forcat e mëdha lejohen të bëjnë këto krime, pa asnjë kundërshtim dhe lejohen të zhdukin të shtypurit?

Profeti Mesih është profeti i paqes dhe dëshiron që paqja të mbretërojë në botë. Edhe sot është dita e paqes. A e dini ju çfarë po diskutohet sot në Ditën e Paqes? Dhe çfarë po bëjnë këta që janë në luftë? A besoni ju te udhëheqësit që shfaqen në të njëjtën kohë, duke ngritur duart për lutje? A e besoni ju lutjen e tyre? A jeni ju të vetëdijshëm për fushatën e madhe të mediave të drejtuara kundër nesh në Amerikë? Këto gazeta që shpifin, radiot dhe televizionet që shpifin, a e dini ju që këto media po mbrojnë të shtypurit dhe po përballen me padrejtësinë apo qëndrojnë në anën e tiranëve? A nuk bie mbi Papën përgjegjësia për t'i udhëhequr këta dhe për t'u përballur me padrejtësinë? Nëse këta e fillojnë sulmin e tyre me shkrimet, penat dhe veprimet e tyre dhe me të gjitha mjetet e tyre mediatike, a nuk bie përgjegjësia mbi Papën për ta kundërshtuar këtë? Atëherë, mbi kë bie kjo përgjegjësi? Kush duhet ta përhapë fenë e Mesihut? Kush duhet t'i transmetojë mësimet e Mesihut te njerëzit? A janë këto mësime të kufizuara vetëm për shtresat e pasura? A janë mësimet e drejtuara për banorët e pallateve? Apo nuk është më e para që ato të jenë të drejtuara për shtresat e shtypura? A nuk duhet të mësohen këta me mësimet e Mesihut? As koha juaj dhe as koha ime nuk na lejon që t'ju përcjell juve dhimbjet e një populli të shtypur. Unë, nëpërmjet jush, u bëj thirrje dijetarëve të krishterë. Nëpërmjet jush, i bëj thirrje popullit amerikan, dijetarëve të fesë së krishterë amerikanë, dhe dijetarëve të krishterë nëpër botë. U bëj thirrje atyre të ngrihen në mbrojtje të të shtypurve dhe të fesë së Mesihut. Feja e Mesihut dhe vetë hazreti Mesihu janë të ekspozuar ndaj akuzave; shpëtojeni këtë fe!

Në një rast tjetër, në këtë letër, Imami tregon se Krishterimi nuk u kushton rëndësi rregullave që organizojnë marrëdhënien e

njeriut me Allahun e Madhëruar, duke theksuar se Islami dallon nga Krishterimi për sa u përket ligjeve që lidhen me sistemin e qeverisjes dhe administrimin e shtetit, duke e konsideruar se ato nuk ekzistojnë fare në Krishterim për shkak të rrethanave të kohës së asaj periudhe, ose për shkak se nuk kanë arritur deri te të krishterët:

"Shumë prej rregullave që rregullojnë marrëdhënien e njeriut me Allahun e Madhëruar, si ato që solli Profeti Mesih (Paqja qoftë mbi të!), pra kjo anë e jetës së njeriut për të cilën u kujdes feja e Mesihut, marrëdhënia midis robit dhe Krijuesit të tij, ekzistojnë edhe në Islam në një mënyrë të plotë. Ka shumë ligje në këtë drejtim. Përveç kësaj, në Islam ka edhe ligje që rregullojnë marrëdhëniet e ndryshme mes njerëzve dhe, gjithashtu, të gjitha çështjet e jetës së tyre që nga para lindjes.

Janë shpallur ligje të veçanta që synojnë përgatitjen për lindjen e njeriut të shëndoshë dhe të drejtë; ato përfshijnë rregulla që lidhen me periudhën para martesës, përzgjedhjen e bashkëshortit dhe normat e bashkëjetesës mes bashkëshortëve, pastaj periudha e shtatzënisë, më pas periudha e gjidhënies dhe kujdesi i nënës për fëmijën dhe edukimi i tij, pastaj kalimi i edukimit të fëmijës në shkollë. Sigurisht, Islami ka dispozita në lidhje me të gjitha këto etapa dhe ka ligje që shpjegojnë mënyrat e edukimit të njeriut.

Përveç kësaj, Islami ndryshon nga Krishterimi, tek i cili mungojnë dispozitat e veçanta për sistemin e qeverisjes dhe administrimin e vendit, ose nuk ka arritur te të krishterët. Islami zotëron një sistem të plotë të qeverisjes që përngjan me sistemet e tjera, por institucionet e tij bazohen mbi themelet e drejtësisë.

Po ashtu, Islami ka dispozita dhe ligje që rregullojnë marrëdhënien e aparatit qeverisës me nënshtetasit e tij në aspekte të ndryshme,

marrëdhënien e nënshtetasve me qeverinë, marrëdhënien e qeverisë me pakicat fetare dhe marrëdhënien e shoqërisë islame me shoqëritë e tjera. Nuk mund të jem tani në gjendje t'ju shpjegoj këto dispozita dhe ligje në mënyrë të përgjithshme. Por, nëse Allahu i Madhëruar ju udhëzon në pranimin e Islamit, atëherë do t'i njihni dalëngadalë këto dispozita, sipas mundësisë dhe kapacitetit të secilit prej jush".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 296-297.

Feja hebraike

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e konsideronte fenë hebraike si një fe qiellore, njësoj si të gjitha fetë e tjera monoteiste, megjithëse rezervat e tij për devijimet që kanë ndodhur brenda saj. Ai ndalet në disa fjalë rreth një veçorie negative që i dallon hebrenjtë, e cila është prirja e tyre drejt materializmit, teprimi ndaj anës materiale dhe përbuzja ndaj aspektit shpirtëror. Ndërkohë, e kundërta është te Krishterimi, që është dalluar nga theksimi i tepruar i aspektit shpirtëror dhe moral, shpesh duke anashkaluar anën materiale. Islami, nga ana tjetër, ka qenë i ekuilibruar mes të dyjave. Ndoshta kjo është arsyeja që shohim te pasuesit e fesë hebraike në çdo epokë dhe në kohën tonë bashkëkohore, se ata përpiqen të zotërojnë gjithçka që munden nga mundësitë materiale, pushteti dhe ndikimi mbi këtë botë.

Gjithashtu, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tërhiqte vëmendjen për domosdoshmërinë e dallimit midis hebrenjve dhe Sionizmit. Sionizmi është një lëvizje politike kolonialiste që përdori Hebraizmin dhe Bektashizmin dhe sekte të tjera si platformë për të arritur qëllimet e saj të dënueshme. Shumë hebrenj dhe rabinët e tyre kundërshtojnë Sionizmin dhe shtetin e Izraelit, madje e urrejnë atë.

Imam Khmenini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) theksoi, gjithashtu, se hebrenjtë iranianë gëzojnë të drejta dhe detyrime të plota, njësoj si çdo iranian tjetër.

"Islami ndërton njeriun, duke synuar drejtësinë dhe duke e përhapur atë, ndërton një njeri që zbukurohet me virtyte fisnike dhe që bart dije hyjnore, që e bëjnë të përputhet me realitetin e jetës në këtë botë dhe pas udhëtimit të tij nga kjo botë. Në këtë mënyrë, ai bëhet një njeri i plotë, në kuptimin njeri. Këta janë ata që shohin një jetë të vetme dhe një rrugë të vetme në Islam dhe jo jashtë tij, duke thënë: **"Na udhëzo në rrugën e drejtë, rrugën e atyre që Ti i ke dhuruar begati, e jo të atyre që kanë merituar hidhërimin Tënd, as të atyre që kanë humbur".**[1]

Ka një transmetim (hadith), të cilin nuk mund ta pohoj me siguri, por e përcjell thjesht ashtu siç është thënë. I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Vëllai im, Musai, ishte i verbër nga syri i djathtë, vëllai im, Isai, ishte i verbër nga syri i majtë, ndërsa unë jam dysysh (pra, shoh me të dy sytë)".

Këta komentues thonë: Kjo është sepse "Teurati" (Torah) u përqendrua tek aspektet materiale, çështjet politike dhe materiale të kësaj bote. Shihni se si hebrenjtë, grykësisht, edhe pse i janë vërsulur botës me të dyja duart e tyre, nuk janë ngopur kurrë. Ata hanë Amerikën, hanë Iranin tani, gjithashtu, dhe përsëri nuk ndihen të kënaqur. Ata lakmojnë çdo vend tërësisht.

Ndërsa në librin e Isait, drejtimi ishte më shumë nga aspektet shpirtërore dhe hyjnore. Kështu "syri i majtë", që përfaqësonte anën materiale, ishte "i verbër" (dhe unë nuk mund të saktësoj vërtetësinë e hadithit të transmetuar nga i Dërguari i Allahut, por e përcjell siç është thënë): "Ai nuk ishte i kthyer nga ana e majtë", që nënkupton drejtimin ndaj natyrës dhe botës materiale, ose se ishte shumë pak i kthyer drejt saj.

1 Sure "El Fatiha", ajetet 6-7.

Ndërsa Torah, sipas natyrës së tij, ishte më shumë i orientuar drejt materiales.

"Dhe unë jam dy-sysh": domethënë, i drejtuar njëkohësisht si kah ana shpirtërore, ashtu edhe kah ana materiale. Ju shihni se si dispozitat e Islamit dëshmojnë për këtë; ju shihni ligjet dhe politikën e tij. Shumë njerëz, nga populli dhe nga dijetarët, si dhe të ngurtët e sipërfaqësorët, mendojnë se nuk duhet ta lidhin Islamin me politikën, se Islami dhe politika janë të ndara nga njëra-tjetra. Kjo është ajo që qeveritë nuk e lejojnë dhe të huajt e kanë përçuar te ne. Ato qeveri, prej kohësh thonë: "Ç'punë ka Islami ose një dijetar fetar me politikën?". Madje, disa kur donin të talleshin me ndonjë dijetar, thoshin: "Ky është një dijetar politikan".

Ata thonë: "Islami është larg politikës dhe politika është larg fesë". Këta nuk e njohin Islamin që themeloi qeverinë e tij në kohën e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe vazhdoi në përjetësi pas kësaj".[1]

Vërtet, fetë hyjnore monoteiste që kanë qenë të përhapura mes njerëzve, fatkeqësisht, nuk u zbatuan në formën e kërkuar, sepse mendjemëdhenjtë i penguan ato, sidomos feja e Profetit Mesih, Jezusit (Paqja qoftë mbi të!), e cila ra në duart e sekteve të ndryshme, ku ndodhën shtrembërime dhe u përmendën gjëra që nuk përshtateshin me Profetin Mesih.

Edhe më e keqe ishte nga ata sundimtarë që ia mveshën vetes fenë e krishterë, por që në të vërtetë nuk kishin asgjë nga Krishterimi. Pra, gjendja e tyre ishte larg zbatimit të mësimeve të Profetit Mesih.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 3, f. 215.

Sikur mësimet e profetëve të zbatoheshin ashtu siç duhej, ashtu siç ata vetë dëshironin, të zbatoheshin mësimet e Profetit Mesih mes të krishterëve, të zbatoheshin mësimet e Profetit Musa mes hebrenjve dhe të zbatoheshin mësimet e të Dërguarit më fisnik (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) mes myslimanëve, njerëzimit nuk do t'i kishin ndodhur sot këto fatkeqësi dhe probleme kudo.

Ne bëjmë ndarjen mes hebrenjve dhe sionistëve, sepse Sionizmi nuk ka lidhje me Hebraizmin; sepse mësimet e Profetit Musa (Paqja qoftë mbi të!) janë mësime hyjnore. Kur'ani e përmend Musain më shumë se çdo profet tjetër, pasi mësimet e tij ishin të vyera. Kur'ani përmend historinë e Musait dhe përballjen e tij me faraonin. Ai ishte bari dhensh, por zotëronte forcë dhe vullnet. Ai u ngrit për t'u përballur me tiraninë e faraonit dhe e mposhti atë. Ai mbështetej te fuqia hyjnore dhe kujdesej për të shtypurit, duke u ngritur kundër arrogantëve, me faraonin në krye, dhe duke u përballur me arrogantët. Metoda e Musait (Paqja qoftë mbi të!), në përballjen me arrogantët, është krejtësisht e kundërt me projektin sionist, sepse Sionizmi lidhet me arrogantët. Ata kanë spiunët dhe agjentët e tyre dhe veprojnë kundër të shtypurve, ndryshe nga mësimet e Musait (Paqja qoftë mbi të!), i cili mbështetej te njerëzit e zakonshëm, bijtë e tregjeve dhe lagjeve popullore, ashtu si edhe profetët e tjerë. Ai u ngrit me ta kundër faraonit dhe tiranisë së tij. Të shtypurit janë ata që iu kundërvunë arrogantëve dhe i rrëzuan nga arroganca e tyre, ndryshe nga sjellja e sionistëve, të cilët janë të lidhur me arrogantët dhe veprojnë kundër të shtypurve.

Ky numër hebrenjsh, që u mashtrua dhe u mblodh nga vende të ndryshme të botës në Palestinë, ndoshta tani janë penduar. Nëse dikush ishte hebre dhe nuk donte të ndiqte mësimet e shenjta të Musait, ndoshta tani është penduar që shkoi në Palestinë, sepse kushdo që shkon atje dhe sheh sjelljet e këtyre dhe se si ata vrasin njerëzit, pa asnjë arsye, nën emrin

e Judaizmit, nuk mund ta pranojë një gjë të tillë. Këto praktika bien ndesh me mësimet e Musait. Ne e dimë se shoqëria hebraike është ndryshe nga ajo sioniste. Ne, kur i kundërshtojmë ata (sionistët), kundërshtimi ynë nuk buron nga fakti se ata janë hebrenj, por sepse janë njerëz- politikë që, me veprimet e tyre, veprojnë nën petkun e Judaizmit. Prandaj, hebrenjtë i urrejnë, dhe të gjithë njerëzit duhet t'i urrejnë."[1]

Imami iu përgjigj një pyetjeje të një gazetari: "Ju kërkoni shfarosjen e Izraelit. Nëse kjo përfundon me shkatërrimin e tij dhe fitoren e palestinezëve, cili do jetë fundi i hebrenjve?"

"Hebrenjtë dallojnë nga sionistët. Nëse myslimanët fitojnë mbi sionistët, fundi i tyre do të jetë si fundi i Shahut të përmbysur. Kjo nuk është për hebrenjtë, sepse ata janë një popull si gjithë popujt e tjerë, vazhdojnë jetën e tyre të zakonshme dhe nuk shqetësojnë askënd për asgjë".[2]

Në një tekst tjetër, imami e plotëson përgjigjen e tij: *"Kur kërkojmë qeveri islame, nga ana tjetër ngrihen zëra që thonë: 'Ajo do të sillet keq me hebrenjtë dhe të krishterët'. Këto janë pretendime për të mbrojtur kurorën e mbretit dhe fronin e tij të prishur dhe për të detyruar pasuesit e tij të ndjekin drejtimin e tij me çdo mjet të mundshëm. Qeverisja islame është të sillet me mirësi dhe drejtësi me hebrenjtë, të krishterët, zoroadishtët dhe të gjitha pakicat fetare që jetojnë në vendin tonë. Ne, jemi pasuesit e atij që e konsideroi besimtarin si të paqortuar, nëse vdes i pikëlluar nga grabitja e zinxhirit të jahudit në hijen e shtetit islam. Ne përpiqemi për të ruajtur të drejtat e këtij lloj njeriu."*[3]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 219.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 11.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 224.

Për sa i përket thënies se përllogaritja e hebrenjve është ndryshe nga përllogaritja e shtetit uzurpues të Izraelit, imami thotë: *"Do të pritet çdo formë marrëdhënieje me Izraelin dhe hebrenjtë, kështu që ata do të jetojnë të lirë në vendbanimet e tyre në Iran dhe do të jetojnë në një mjedis më të lirë, se sa ishte në periudhën e monarkisë. Dhe kjo sepse Islami i respekton të gjitha fetë".*[1]

Kur ishim në Paris, thashethemet u përhapën kudo. Disa prej tyre, ishin, se, nëse myslimanët fitonin në Iran, ata do të kryenin masakra ndaj hebrenjve dhe të krishterëve; myslimanët planifikonin të vrisnin të gjithë hebrenjtë!

Unë e kam sqaruar shpeshherë në intervistat që kam dhënë, të vërtetën në të cilën beson Islami. Më erdhi edhe një përfaqësues i sektit hebre dhe bisedova me të për metodën e Islamit. Të gjitha fetë që janë shpallur nga Allahu i Lartësuar dhe të gjithë profetët e mëdhenj, janë për rehatinë dhe edukimin e njeriut. Allahu i Madhëruar ka dashur që ta shpallë shpalljen hyjnore mbi profetët e mëdhenj për udhëheqjen e njerëzve dhe edukimin e njeriut në të gjitha dimensionet e tij".[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 302.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 218.

Rrëzimi i thënies: "Feja është opium i popujve"

Thënia "Feja është opium i popujve" është një thënie kolonialiste shumë e rrezikshme. Perëndimi ka përfituar nga gabimet dhe praktikat e disa klerikëve të krishterë, në kohën e sundimit të kishës mbi çështjet e shoqërisë dhe të njerëzve, për ta kufizuar fenë e krishterë dhe kishën vetëm në marrëdhënien personale midis individit dhe Zotit të Lartësuar. Më pas, ata synuan ta zbatojnë këtë thënie të mbrapshtë edhe kundër fesë islame. Qëllimi i tyre, nga e gjithë kjo, ishte përjashtimi i feve monoteiste, në veçanti, Islamit, nga skena, për t'i krijuar vetes hapësirë, që të përhapnin atmosferën e korrupsionit, amoralitetit, shthurjes morale dhe ateizmit; si një hyrje për robërimin e popujve, grabitjen e tyre dhe zbrazjen e tyre nga vlerat e tyre morale dhe fetare. Në të vërtetë, qëllimi i tyre ishte të përgënjeshtronin fetë për t'i mashtruar popujt, ndërkohë që vetë ata ishin të kapluar nga dehja e botës dhe përvetësimi i pasurive dhe burimeve të saj.

Me gjithë gabimet, devijimet dhe mungesat te ndjekësit e feve monoteiste, ajo që këto fe ofruan përmes mësimeve morale, disiplinës dhe përkushtimit mbetet diçka me rëndësi të madhe. Po të mos ishte kështu, gjendja e botës sot do të ishte shumë më e keqe nga ajo që është dhe errësirat materialiste do ta kishin pushtuar qenien e njeriut dhe do ta kishin shuar dritën e udhëzimit drejt përjetësisë.

"Ekspertët e tyre, që prej një kohe të gjatë, u përqendruan në studimin e vendeve të Lindjes dhe në njohjen e pasurive të tyre. Ata studiuan vendet tona pëllëmbë për pëllëmbë dhe arritën të zbulonin çdo gjë që kishte brenda tokës sonë, nga minerale dhe pasuri, ashtu siç u përqendruan edhe në studimin e psikologjisë dhe shpirtrave tanë, si dhe në çdo gjë që ne i përmbahemi për të mbetur të bashkuar nën një flamur të vetëm. Nëse nuk do të arrinin të na mposhtnin dhe të na grabisnin pasuritë, ata u përpoqën të dobësonin ndikimin e fesë në shpirtrat e njerëzve.

Prandaj thanë: feja është një grup çështjesh të shpikura nga forcat sunduese; feja është opium i popujve! Thanë se rrënja e fesë është opium për shoqërinë. Nuk kishin tjetër synim, përveçse ta poshtëronin fenë në sytë e njerëzve dhe të mendimtarëve, dhe të zhduknin gjendjen e përkushtimit ndaj fesë.

"Zanafilla e fesë është opium"[1]*, kështu e përkufizuan ata fenë. Për fat të keq, disa prej tyre ndikuan edhe në Iran, te të rinjtë tanë, gjithashtu, edhe te një pjesë e intelektualëve tanë.*

Gjithashtu, ka akoma e sot mendësi të trazuara nga thënia "Feja është opium, opium i shoqërisë". Kuptimi i kësaj është se fenë e krijuan të fuqishmit, që t'i vënë njerëzit në gjumë, që t'i zhvasin ata, njësoj siç ndodh me të varurin nga opiumi, që kur e konsumon, e kaplon gjumi dhe nuk i kushton më vëmendje asgjëje. Po kështu, feja e krijuar nga të fuqishmit, sipas tyre, e bën njeriun të frikësohet prej saj dhe të flejë si fle i varuri nga opiumi, kur e konsumon. E ata (të fuqishmit) vijnë e i mësyjnë dhe grabisin çfarë të gjejnë. Kështu ata thanë për fenë. Këtë thënie e sollën edhe për Islamin, që është feja më e fuqishme. Ata e akuzuan atë me kotësa, si është

1 Kjo thënie i atribuohet Leninit, themeluesi i qeverisë komuniste në Bashkimin Sovjetik.

thënia: Islami ishte i rregullt para katërmbëdhjetë shekujsh, ndërsa tani nuk është e mundur që të gjitha rregullat e Islamit të zbatohen, sepse janë për të shkuarën, nuk janë të vlefshme për të tashmen. Këto janë fjalë që i thonë herë pas here, ndonjëherë hapur, ndonjëherë të fshehura, pa asnjë logjikë apo arsyetim. Këta janë armiq të Islamit, që nuk e njohin atë, nuk kuptojnë asgjë prej tij dhe nuk dinë se çfarë është Islami në thelb. Ata janë injorantë për çdo gjë. Kushdo që sheh historinë e njerëzimit, do të kuptojë se këta të pasur që shpifën kundër fesë dhe e shpikën këtë thënie, kanë qenë gjithmonë të pasurit që donin të ruanin pasuritë e tyre dhe të shtypnin të varfrit. Por, në të vërtetë, ata që i kundërshtuan kanë qenë gjithmonë shtresat e shtypura, shtresa e tretë, të cilët ngritën popullin kundër sundimtarëve arrogantë. Nga ata ishte edhe Profeti Musa (Paqja qoftë mbi të!), i afërm te ne, i cili ishte një bari i varfër, me shkop bariu që i shërbeu Shuajibit dhe ruajti dhentë e tij dhe në dukje ishte prej masës së njerëzve. Ai i ngriti njerëzit dhe i mobilizoi ata kundër faraonit. Musai udhëhoqi njerëzit[1] *dhe e rrëzoi fronin e faraonit "feja opium". Atëherë faraoni pretendoi se Musai kishte ardhur për t'i vënë njerëzit në gjumë, për t'i sunduar ata, por në të vërtetë ndodhi e kundërta. Musai i mobilizoi këta njerëz të shtresës së tretë dhe ecën përpara me ta, derisa e hodhi faraonin dhe fronin e tij drejt furtunës.*

Mirë, le të shohim historinë e afërt të Islamit. A mos vallë kurejshët dhe krerët e saj e përgatitën këtë fe që t'i vinin njerëzit në gjumë, që ata të vazhdonin me fitimet e tyre, me tregtinë e tyre, me pasuritë dhe shfrytëzimin e tyre? A nuk ishte vetë i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mi të dhe mbi familjen e tij!) armiku më i madh i kurejshëve, ndonëse ai vetë ishte prej tyre? Por nga shtresat e kësaj bote, ishte prej fisnikëve me kuptimin e të nderuarve dhe jo pasanikëve. Ai jetonte në kushte të vështira, pa pasur asgjë nga pasuritë dhe nuk mund të jetonte i

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 341.

qetë në qytet. Për këtë arsye u detyrua të emigronte në male dhe të fshihej në shpellë, derisa kreu misionin e tij sekret, larg të pasurve dhe tiranëve.[1] *Ai ishte në shpellë, derisa i kreu veprat e tij sekrete. Pastaj, kur e nderoi qytetin e nderuar (Mekë). E, kur ishte qyteti me Profetin Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mi të dhe mbi familjen e tij!)? Kush ishin ata që ishin me të? Kur kishte pranë tij njerëz me pushtet dhe forcë? Kur ishte me të shtresa e pasanikëve, tregtarëve jehudi që ishin prej të pasurve dhe pronarëve të mëdhenj të tokave? Ndërsa ajo që u shfaq tek i Dërguari (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mi të dhe mbi familjen e tij!) në Medinë, ishte se ai mblodhi rreth vetes të varfrit dhe të privuarit; shtëpia e tij nuk ishte gjë tjetër veçse një dhomë e mbuluar me gjethe palmash. Kështu ishte edhe xhamia e tij.*

Shumica e shokëve të tij, të njohur si "Ehlul Suffetu"[2]*, nuk kishin asnjë strehë tjetër përveç një vendi të mbuluar në xhaminë e tij, ku flinin. Kjo ishte jeta e tyre. Ishin këta që u përballën me mendjemëdhenjtë dhe arrogantët. Këtë grup të varfërish dhe të shtypurish, që i përkisnin shtresës së tretë, e cila nuk zotëronte asnjë shtëpi, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mi të dhe mbi familjen e tij!) i mblodhi dhe me ta shkatërroi arrogantët. I grumbulloi ata të varfër e të shtypur që ishin shtresa e tretë, që nuk zotëronin as shtëpi. Kur në luftë ndodhte që ndonjë prej tyre të hante vetëm një hurmë*[3]*, e cila sapo arrinte te goja e tij, ai e çonte te goja e shokut të tij, i cili vepronte njësoj, derisa hurma qarkullonte në mesin e të gjithëve.*

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 341.

2 As'habu Suffetu ishte një grup të varfërish dhe skllevërish që nuk kishin strehë dhe qëndronin pranë kasolles së të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 342.

"Këta janë ata që i përgatiti i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mi të dhe mbi familjen e tij!) për luftë kundër kurejshëve dhe ai i udhëhoqi të gjithë ata që nuk kishin fuqi apo pasuri, vetëm me atë që kishin nga varfëria, vuajtjet, besimi dhe dhënia e tyre. Realiteti është krejt ndryshe nga ajo që thanë armiqtë tanë: "Feja është opium". Jo, nuk është kështu! Islami dhe të gjitha fetë ishin lëvizëse për njerëzit dhe i ringjallnin ata. Të gjitha mësimet e feve i çuan njerëzit drejt përballjes me tiranët dhe drejt qëndrimit kundër arrogantëve. Kur'ani i shenjtë mund të përshkruhet si një libër lufte që e fton njerëzimin në luftë, por në të njëjtën kohë është i mbushur me mësime njerëzore dhe morale. Ai i përshkruan myslimanët, si: **"Të ashpër ndaj jobesimtarëve dhe të mëshirshëm ndërmjet tyre".**[1] *Dhe i fton njerëzit:* **"...luftoni të gjithë kundër idhujtarëve..."** *Kur'ani i nderon njerëzit, i zgjon, i ngushëllon, i përkrah, i mëshiron dhe i trajton me butësi, duke u dhënë edhe përgëzimin se me ta janë engjëjt. Edhe pse ishin një grup i vogël që lëvizte, ata mposhtën një forcë të madhe falë fuqisë së besimit dhe lëvizjes që solli i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Kur'ani i shenjtë tek ata. Është për të ardhur keq që propaganda e kundërshtarëve ndikoi te një pjesë e rinisë sonë, por këto ishin thirrje të dobëta përballë forcës së plotë të së vërtetës".*[2]

"Pra, opiumi është vetë ky pretendim se Islami është opiumi i popujve dhe jo vetë Islami. Përhapja e pretendimeve të tilla synon mashtrimin e njerëzve dhe vënien e tyre në gjumë. Ky është opiumi i vërtetë dhe jo feja që solli Profeti fisnik, që u përhap në Hixhaz me një grup të vogël të varfërish, duke përhapur drejtësinë dhe barazinë në të. Kjo ishte në kohën e Profetit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Sa për atë që ndodhi pas tij, fuqitë e myslimanëve u

1 Sure "Fet'h", ajeti 29.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 343.

shtuan edhe më shumë. Ata i mposhtën gjatë shekullit të parë të historisë islame, brenda tridhjetë ose tridhjetë e pesë vitesh pas tij, dy perandoritë e mëdha të asaj kohe: perandorinë romake dhe atë perse. Ata çliruan Iranin dhe vendet e Romës. A erdhi Islami, në këtë gjendje, që t'i thërrasë njerëzit në nënshtrim ndaj Kisrës (mbretit pers) ose ndaj sundimtarëve të Romës dhe bindjes ndaj tyre? Apo erdhi për të luftuar këto dy perandori dhe për t'i mposhtur ato, në mënyrë që të mos e shfrytëzonin popullin e varfër dhe me qëllim të përhapte drejtësinë në botë?!"[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 221.

Përfundimi i studimit

Islami dhe fetë e tjera monoteiste ndryshojnë rrënjësisht nga fetë jomonoteiste dhe doktrinat materialiste. Synimi i tyre është të formësojnë njeriun e plotë, të vendosin paqen dhe drejtësinë në botë, të sigurojnë një të ardhme të ndritur për njerëzit në Jetën Tjetër, e cila është jeta e përjetshme dhe e përhershme për njeriun. Tiranët dhe mendjemëdhenjtë, që nga koha e Ademit e deri në ditët tona dhe deri në Ditën e Gjykimit, gjithmonë janë përpjekur dhe vazhdojnë të përpiqen të arrijnë qëllimet e tyre, duke përdorur çdo mënyrë të mundshme dhe duke bërë gjithçka për të realizuar interesat e tyre personale. Për këtë arsye, ata përdorin të gjitha mjetet çnjerëzore dhe joetike për të arritur qëllimet e tyre të ulëta dhe të shëmtuara; ndezin konflikte fetare dhe sektare, përhapin armiqësi racore dhe nacionaliste, dhe nxisin urrejtje ndërmjet njerëzve.

Prandaj, është detyrë për të gjithë bijtë e feve monoteiste, sidomos për dijetarët, të bashkohen dhe të bashkëpunojnë mes tyre për t'u përballur me ata arrogantë dhe për të mbrojtur fenë e së vërtetës, si dhe për të dëshmuar për botën se feja nuk është opium për popujt, por është siguri për dinjitetin, vendosmërinë dhe përparimin e tyre. Dhe të marrin shembull nga Revolucioni Islamik në Iran, i cili është model frymëzues, sepse është revolucioni që riktheu jetën në të gjitha fetë monoteiste, pasi armiku ishte afër ta shkatërronte plotësisht.

Po ashtu, është detyrë e botës së krishterë të përqafojë atë që përmban Krishterimi nga parimet morale dhe shpirtërore me ndikim të gjerë dhe të ngrejë zërin kundër padrejtësisë së tiranëve që i shtypin njerëzit anembanë botës, me ShBA-në në krye të tyre. Ky detyrim, vetvetiu, u drejtohet edhe pasuesve të fesë hebraike, që të largohen nga Sionizmi dhe nga shteti i Izraelit, i cili u ndërtua në emër të hebrenjve dhe Judaizmit.

Fetë monoteiste kanë për detyrë që ndjekësit e tyre të mbështesin dhe plotësojnë njëri-tjetrin, duke u bazuar në vëllazërinë e profetëve dhe të dërguarve të tyre, si dhe në gjërat e përbashkëta dhe interesat e mëdha që i lidhin. Kur të bashkohen të shtypurit dhe të privuarit, nga ndjekësit e feve qiellore në botë, përballë tiranëve, me lejen e Allahut, do të meritojnë të vendosin drejtësinë njerëzore, t'i japin fund sundimit të arrogantëve të botës dhe të mos kufizohen brenda një rrethi të ngushtë.

KAPITULLI I DYTË

FEJA ISLAME

- Hyrje
- Të vërtetat e fesë islame
- Qeveria e Profetit Muhamed (a.s) dhe e Imam Aliut, modeli më i përsosur qeverisës
- Pengesat e zbatimit të Islamit
- Historia e Islamit dhe përplasja e së vërtetës me të pavërtetën
- Qeveritë e sundimtarëve në emër të Islamit
- Islami amerikan dhe Vehabizmi
- Qeveritë islame dhe kolonializmi
- Islami Muhamedan autentik

- Qeveria islame
- E ardhmja e umetit islam
- Uniteti islam
- Përfundimi i studimit

Hyrje

Islami është feja e fundit monoteiste dhe më gjithëpërfshirësja në gjerësi, thellësi dhe që kujdeset ndaj çështjeve të njeriut, si në botën e kësaj jete, ashtu edhe në Botën Tjetër. Kur'ani i shenjtë dallon nga librat e tjerë hyjnorë, duke pasur më shumë gjithëpërfshirje dhe thellësi dhe duke qenë i mbrojtur nga shtrembërimi, shtimi dhe pakësimi.

Profeti i Islamit, Muhamedi, biri i Abdullahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), vula e profetëve, trashëgimtari dhe vërtetuesi i tyre, si dhe plotësuesi i thirrjes së tyre, u lëndua për hir të Allahut në rrugën e thirrjes hyjnore si askush tjetër nga profetët. Ai duroi atë që nuk e kishte duruar asnjë profet tjetër më parë dhe u përpoq deri në maksimumin e mundshëm në rrugën e Allahut. Ai formoi një qeveri të drejtë hyjnore, në të cilën jo vetëm besimtarët dhe myslimanët ishin të sigurt, por edhe ithtarët e feve monoteiste, çdo i dobët dhe çdo njeri pa mbrojtje.

Allahu e dërgoi atë për gjithë njerëzimin, e bëri mëshirë për botët dhe e pajisi me moral të lartë. Ai u dërgua te një popull injorant (xhahil), me zemër të ashpër, që këputnin lidhjet familjare, varrosnin vajzat për së gjalli, vidhnin e grabisnin pasuritë dhe të dobëtit e të pambrojturit i linin në mëshirë të fatit. Profeti i nxori ata nga errësira në dritë dhe me ta ndërtoi qytetërimin e dritës e të

diturisë dhe formoi një umet të mesëm, që urdhëron për të mirën dhe ndalon nga e keqja.

Por, për fat të keq, këtij Profetit të madh nuk iu dha mundësia që umetin dhe mesazhin e tij ta çonte në atë nivel që duhej, që të ishte umeti më i mirë i dalë për njerëzimin, një umet i fortë, i lirë, fisnik dhe i bashkuar, që vendos drejtësinë, zhduk padrejtësinë, udhëheq kombet dhe ngre një shtet të drejtë global, që të përmbushej premtimi i Allahut të Lartësuar: **"Ai është që e dërgoi të dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, për ta ngritur mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë".**[1] Dhe premtimi i Allahut të Lartësuar: **"Ne kemi shkruar në Zebur pas Dhikrit se toka do t'u trashëgohet robëve të Mi të mirë".**[2]

Me të vërtetë, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familen e tij!) dhe shokët e tij, Islami dhe umeti islam janë përballur, që nga fillimi në Mekë e pastaj në themelimin në Medinë, me armiq të shumtë të Islamit, që kurdisnin plane dhe përpiqeshin ta zhduknin ose ta shtrembëronin vijën e drejtë të tij. Ata nuk arritën të mposhtnin Islamin, sepse premtimi i Allahut të Lartësuar është që Ai do ta ruajë fenë dhe Librin e Tij, ashtu siç ka ruajtur edhe mesazhin e profetëve të mëparshëm.

Të gjithë këta armiq i bashkon interesi vetjak dhe përfitimet materiale, lakmia për privilegje, padrejtësia ndaj njerëzve, vjedhja e pasurisë së tyre, skllavërimi i tyre, dominimi dhe nënshtrimi i tyre ndaj vendimeve të tyre. Dhe, sipas aftësive që u sigurojnë këtyre armiqve, ata shndërrohen në tiranë, faraonë, sundimtarë, mbretër

1 Sure "Et Teube", ajeti 33.

2 Sure "El Enbija", ajeti 105.

dhe udhëheqës, me emra e tituj të ndryshëm, por gjithmonë duke ndjekur epshet e tyre të pakufizuara: pasurinë, pushtetin dhe gjithçka tjetër që nuk ka kufi në dëshirat e tyre.

Meqenëse Islami i Muhamedit, birit të Abdullahut, dëshiron të mirën e përgjithshme për të gjithë njerëzit, drejtësi shoqërore, liri dhe barazi, ndalimin e skllavërisë dhe zhdukjen e padrejtësisë, është e natyrshme që shigjetat e armiqve, në forma dhe emërtime të ndryshme, në çdo kohë dhe vend, të drejtohen kah udhëheqësit e kësaj feje të vërtetë dhe kah kryetarit i saj, të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), kah Ehli Bejtit të tij të pastër, kah shokët e nderuar, kah dijetarët e devotshëm, luftëtarët sakrifikues dhe atyre më të afërt për nga sinqeriteti dhe përkushtimi për këtë thirrje të ndritur profetike.

Gjatë periudhave të shkurtra në historinë e Islamit dhe të umetit islam, është njollosur imazhi i Islamit të vërtetë, në kuptim dhe në zbatim, duke u kthyer shumë nga vlerat, synimet dhe parimet e tij në të kundërtën e tyre. Kalifati i Profetit shkoi në duart e Muavies dhe më pas u bë mbretëri e trashëguar. Roli i dijetarëve mbrojtës të Islamit shpesh u bë një tribunë për këshilltarët e sulltanëve dhe oborrtarëve.

Umeti i vetëm i bashkuar u bë një umet i përçarë, i dobët dhe i nënshtruar, pasi ishte dikur më i miri ndër njerëz. Islami i urtësisë dhe i këshillës së mirë u përshkrua si Islam i shpatës, vrasjes dhe therjes. Monoteizmi hyjnor i pastër u përzje me heshtjen ndaj mëkatit dhe u shndërrua në teuhid për mbretin, udhëheqësin, sundimtarin dhe kalifin në emër të Allahut. E më pas u përhap kolonializmi i padrejtë dhe mohues. Liria u zëvendësua me kolonializmin dhe parimi i mosdetyrimit në fe u kthye në forma të

ndryshme dhune dhe urrejtjeje, deri sa arriti në luftëra, therje dhe sharje të kundërshtarëve, madje brenda vetë Islamit, fatkeqësisht, në emër të teuhidit. Në vend të vëllazërisë, unitetit, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit mes myslimanëve, faqet e historisë u nxinë dhe vazhdojnë të nxihen, me trazira gjakderdhëse, përhapje të urrejtjes dhe përçarjes mes vëllezërve dhe bijve të një umeti të vetëm.

Islami, i cili erdhi të jetë si shpëtim për botët dhe për të dobëtit, me të vërtetat e tij të ndritshme dhe mësimet e tij hyjnore të sinqerta humane, që janë anije e sigurisë dhe e shpëtimit për njerëzimin, është njollosur nga armiqtë dhe vazhdojnë ta paraqesin fytyrën e tij të vërtetë si të shtrembëruar. Ka edhe nga ata myslimanë, që nuk e pranojnë më, e lëre më fetë e tjera dhe njerëzimi në tërësi. Megjithëkëtë, njerëzit, me natyrën e tyre të pastër, e pranojnë Islamin e vërtetë, sikur të pastrohej pluhuri i rëndë dhe maska e frikshme që armiqtë dhe injorantët i kanë hedhur mbi fytyrën e tij për shekuj me radhë.

Në këtë kapitull do të njiheni me mendimet dhe pikëpamjet e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) rreth asaj që ai paraqiti, për sa i përket Islamit, të vërtetave të tij, synimeve të tij, vështirësive me të cilat është përballur dhe vazhdon të përballet, si dhe me rrugët që duhet të ndiqen për ta nxjerrë umetin islam nga gjendja e mjeruar drejt hapësirës së dinjitetit, lirisë dhe fuqisë.

Të vërtetat e fesë islame

"Duhet të paraqitet Islami i vërtetë, jo ashtu siç njihet zakonisht sot, nëpërmjet disa gjërave sipërfaqësore. Duhet të paraqiten dispozitat e vërteta islame. Ne duhet t'i tregojmë botës atë që kemi si pasuri të çmuar dhe të lartë. Ne nuk kemi nevojë t'i referohemi askujt tjetër, përsa u përket ligjeve. Ne kemi ligje që përfshijnë çdo aspekt të jetës. Islami ka përcaktuar detyrimet për gjithçka dhe ka vendosur ligje për çdo gjë. Prandaj nuk ka nevojë që myslimanët të imitojnë dikë tjetër ose të ndjekin të huajt në ligjet e tyre.

Të rinjtë tanë universitarë, qofshin ata këtu, në Iran, apo në vende të tjera, sot nuk e njohin realitetin e Islamit. Ata nuk e dinë fare se çfarë është Islami. Ata nuk njohin nga Islami veçse se është namaz, pastrim ose disa rregulla të ngjashme. Argumenti i tyre për mosangazhimin me Islamin është fjala e tyre: "Nëse ne duam të angazhohemi me Islamin, ne duam të veprojmë sipas Islamit". Ata e thonë këtë për shkak se Islami nuk u është sqaruar atyre. Ata pyesin: "Cili është sistemi në Islam që duhet të zbatojmë?" Filan sekti ka një sistem, metoda filane ka një sistem, atje ka një mënyrë jetese të rregulluar dhe ne duam një mënyrë jetese të tillë. Ndërsa Islami, sipas tyre, nuk është gjë tjetër veçse një çështje individuale që ka të bëjë me njeriun si individ, si mohues. Prandaj, sipas tyre, Islami nuk ka sistem që të zbatohet.

Ata e thonë këtë, sepse nuk kanë njohuri për dispozitat e Islamit. Prandaj mendojnë gabim, se nuk ekziston një sistem në Islam. Për këtë arsye, përgjegjësia për ta sqaruar këtë bie mbi dijetarët e Islamit. Është e natyrshme që dijetarët e Islamit të jenë të aftë ta trajtojnë këtë çështje,

sidomos kur të rinjtë përballen me vështirësi të shumta. Prandaj, detyra e dijetarëve është që t'i shkruajnë të gjitha dispozitat e Islamit, të shpjegojnë rregullat e tij, të sqarojnë çështjet e tij dhe t'ia paraqesin ato botës. Ata duhet të shkruajnë ligjet e Islamit në formën e tyre të vërtetë, duke i përfshirë në çdo aspekt të jetës dhe t'i përhapin ato."[1]

Me të vërtetë, veçoritë e Islamit janë të fshehura për njerëzimin, madje edhe për vetë myslimanët. Kjo sepse duart e padrejtësisë dhe hajdutët e naftës nuk lejojnë që e vërteta e Islamit të shfaqet qartë para njerëzve. Po të zbatohej Islami, në të vërtetë, ne shpresojmë që njerëzimi do të ngrihej nën flamurin e tij dhe do të mposhtej çdo shkollë tjetër.

Por, për fat të keq, njerëzve nuk u është lejuar të njihen me Islamin. Herë e akuzojnë për prapambetje, herë tjetër për dhunë, e ndonjëherë thonë se Islami është kthim pas në kohë, një mijë apo nëntëqind vjet më parë dhe se nuk është në gjendje të rregullojë jetën bashkëkohore. Të gjitha këto janë propaganda të shpërndara nga të huajt, për të mbuluar dhe për të shtrembëruar të vërtetat e gjalla të Islamit.

Ne duam zbatimin e Islamit, ose të paktën vendosjen e një qeverie të afërt me atë që thërret Islami, në mënyrë që ju të njiheni me kuptimin e vërtetë të demokracisë dhe njerëzimi të kuptojë dallimin e madh mes demokracisë së vërtetë, të cilën e thërret Islami dhe demokracisë së njohur në qeveritë dhe republikat e sotme, pranë sulltanëve dhe sundimtarëve. Nuk është e mundur të sqarohet e vërteta e ligjeve hyjnore në një mënyrë të shkurtuar dhe të përgjithshme gjatë takimeve të tilla, por unë do të përmend këtu një shembull të thjeshtë për to.

Me të vërtetë, dispozitat e Islamit rregullojnë jetën e të gjithë individëve të njerëzimit. Ato rregullojnë marrëdhëniet e tyre me Allahun

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 34.

dhe me Profetin e Tij, marrëdhëniet me pushtetin dhe aparatin qeverisës. Po ashtu, rregullojnë marrëdhëniet që duhet të ekzistojnë midis individëve, marrëdhëniet e individëve me fëmijët e tyre dhe me familjet e tyre. Në fakt, Islami ka ligje që rregullojnë të gjitha këto marrëdhënie mes individëve dhe shoqërive.[1]

Një nga veprat më të rrezikshme që kanë ndodhur, dhe që mendoj se janë kryer nga ata djaj, është se na penguan të kuptojmë Islamin dhe Kur'anin në të vërtetën e tyre. Ata nuk i lejuan myslimanët të njihnin realitetin e Islamit. Propaganda e tyre ka depërtuar deri në thellësi të shkollave (hauzateve) fetare në Nexhef dhe në Kum, duke paraqitur një anë të Islamit, një pjesë iu paraqit vetëm dijetarëve, ndërsa ana tjetër mbeti e fshehur dhe e varrosur. Ata nuk na lanë ta njohim Islamin siç është në të vërtetë, sepse e shihnin se rreziku do t'i godiste, nëse myslimanët do të vetëdijesoheshin për të vërtetën e Islamit, sepse myslimanët do të bashkoheshin rreth tij dhe nuk do të mbetej më vend për armiqtë pas kësaj. Ata nuk donin që kjo të ndodhte për myslimanët, sepse vetë kishin njohuri për mësimet e Islamit. Kur britanikët hynë në Irak, një nga oficerët e tyre dëgjoi ezanin, kur muezini thërriste për namaz dhe tha: "Çfarë është kjo?" Ata i thanë: "Është ezani". Ai tha: "A e dëmton kjo Perandorinë Britanike?" Ata u përgjigjën: "Jo." Tha: "Atëherë le ta thërrasin sa të duan!"

Kërkimet dhe debatet akademike që zhvillohen, nuk e dëmtojnë as Britaninë, as Amerikën, e as Bashkimin Sovjetik. Përkundrazi, ata i nxisin shumë që të shtohen e të zgjerohen, sepse nuk u prishin punë në interesat e tyre. Por, gjendja ndryshon, kur myslimanët lidhen me mësimet e Islamit. Kur do të kthehen myslimanët te mësimet e Islamit? Kur do të rikthehen te pozita që kishin në fillimet e Islamit? Si ishte gjendja e të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 296.

Dërguarit fisnik (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), gjendja e umetit tonë dhe e kalifëve? Si jetonin? Si fitonin? Si mundi një grup i vogël të mposhtte dy perandori të mëdha?"[1]

"Unë e kam thënë shpesh se ne zotërojmë një thesar të çmuar, që i tejkalon të gjitha shkollat që përshkruhen si të përparuara. Por, për fat të keq, nuk kemi mundur ta paraqesim siç duhet; ka mbetur i fshehur në libra, te dijetarët e diturisë, por nuk është paraqitur jashtë. Ne nuk kemi qenë në gjendje ta shfaqim Islamin në formën e duhur dhe t'ia prezantojmë botës, që t'i themi: "Ky është produkti ynë. Dijeni se ata që u përballen me dijetarët e fesë dhe Islamit, kanë frikë nga paraqitja e këtij thesari, sepse, kur ai shfaqet, bëhet e qartë se është një realitet i gjallë që kërkon mbështetje dhe zbatim. Prandaj, duhet të punojmë për ta paraqitur Islamin siç është në të vërtetë – jo vetëm që Irani do ta pranojë, por të gjithë do ta pranojnë, sepse të gjithë këta armiq e kanë frikë Islamin, nëse ai paraqitet me të vërtetën e tij, pasi nuk do ta durojnë dot peshën e tij. Prandaj, ne jemi të detyruar të përpiqemi ta realizojmë këtë gjë, me vullnetin e Allahut, që bota ta njohë të vërtetën e Islamit".[2]

"Me të vërtetë, përpjekja dhe ndihma juaj e çmuar, o të rinj myslimanë me ideale të mëdha, në rrugën e kuptimit të saktë të Islamit dhe njohjes së realitetit të Kur'anit të shenjtë, ngjall shpresë dhe kënaqësi në zemrat e myslimanëve të ndërgjegjshëm. Është detyrë e imja të vlerësoj shpirtin tuaj islamik, të etur për të vërtetën. Ju jeni rinia e guximshme dhe besimtare. Ju kujtoj se ju po ecni në një rrugë të shenjtë, por të mbushur me shumë probleme dhe rreziqe. Duhet të dini se armiqtë e Islamit fshehin dhe pengojnë të vërtetën, prandaj jeni të thirrur që me çdo mjet të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 286.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 1, f. 104.

mundshëm të përpiqeni për realizimin e këtij qëllimi dhe për ta bërë të njohur realitetin e Islamit.

Me të vërtetë, agjentët e kolonializmit e dinë se rënia e kolonizatorëve dhe shkëputja e duarve të tyre nga interesat e popullit dhe të vendeve të pushtuara do të jetë e sigurt me vetëdijesimin e popujve, sidomos të brezit të ri në botë, përmes parimeve të Islamit të pastër. Ata përpiqen ta pengojnë këtë pa e shfaqur fytyrën e tyre të vërtetë. Këtë e bëjnë përmes përhapjes së ideve të prishura, ngatërrimit të mendjeve të të rinjve dhe devijimit të tyre me parulla mashtruese e shkolla të ndryshme. Është detyrë e juaja, o të rinj myslimanë, që, kur studioni realitetin e Islamit në fushat politike, ekonomike, shoqërore e të tjera, të merrni parasysh autenticitetin islam dhe të mos harroni veçoritë që e dallojnë Islamin nga të gjitha shkollat e tjera".[1]

"Me të vërtetë, jeta e denjë për vendet islame dhe lindore varet nga rikthimi i Islamit të humbur. Ne nuk e njohim më Islamin, për shkak të shumësisë së ideve të përhapura nga perëndimorët, që i futën në mendjet tona dhe na devijuan mendimet. Kështu e humbëm Islamin. Gjendja juaj nuk do të rregullohet pa e rigjetur Islamin. Islami nuk është një thesar i humbur vetëm te disa myslimanë, por është një thesar i humbur tek të gjithë myslimanët.

Askush nuk e njeh më të vërtetën e tij, duke filluar nga qendra e mbledhjes së myslimanëve çdo vit, Qabeja e Madhe, deri te çdo vend tjetër i botës islame. Prandaj, i sheh myslimanët që mblidhen çdo vit në Mekën e shenjtë, të cilën Allahu e ka bërë qendër të takimit të tyre, por pa e kuptuar thellësinë e asaj që bëjnë dhe pa përfituar prej saj diçka islame. Ky tubim i madh politik është kthyer në çështje që nuk kanë lidhje me problemet e umetit islam dhe myslimanëve. Edhe sikur myslimanët ta

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 403.

kryenin haxhin, me kuptimin e tij të vërtetë dhe me dimensionet reale që ai përmban, do të ishte e mjaftueshme për të realizuar pavarësinë e tyre. Por, për fat të keq, kjo nuk ndodh dhe kështu Islami ynë ka humbur. Islami që kemi në duar, është si një trup pa shpirt, pa kokë, sepse e kemi ndarë politikën në mënyrë të plotë dhe e kemi përjashtuar nga përmbajtjet e saj thelbësore. Kjo është arsyeja që na ka çuar tani në gjendjen e dobësisë dhe të poshtërimit, sepse kemi humbur kokën e Islamit. Sa kohë që nuk e gjejmë Islamin, dhe sa kohë që të gjithë myslimanët nuk e gjejnë Islamin, nuk do të jenë të aftë të rikthejnë lavdinë e madh të Islamit, i cili i lejoi myslimanët e asaj kohe të ngadhënjenin mbi dy perandoritë më të mëdha të kohës.

Qëllimi nuk ishte pushtimi i vendeve dhe zgjerimi, siç mendojnë disa gabimisht, por synimi i Islamit ishte gjithmonë çlirimi i këtyre vendeve nga prangat, gjallërimi dhe ngritja e tyre në nivelin e lartë të njerëzimit. Historia tregon se në një nga luftërat ku u robërua një numër i madh myslimanësh, ata u vunë në pranga. I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) i pa dhe tha: "Shikoni! Më duhet t'i çoj këta në Xhenet, edhe sikur të jenë të lidhur dy nga dy". Pra, Islami ka për qëllim përmirësimin e shoqërisë. Nëse shpata përdoret, atëherë është vetëm për të zhdukur prishësit që e pengojnë këtë rrugë dhe kundërshtojnë drejtësinë".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 326.

Qeveria e Profetit Muhamed (a.s) dhe e Imam Aliut, modeli më i përsosur qeverisës

"Profeti i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ngriti një qeveri, ashtu si të gjitha qeveritë e botës, por me dallimin se ai vendosi drejtësi shoqërore. Po ashtu, sundimi i kalifëve të parë myslimanë u përhap në vende shumë të gjera dhe të largëta. Qeveria e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) mbështetej mbi të njëjtin parim, por në një formë më të gjerë dhe më të plotë, gjë që është një prej çështjeve më të qarta në histori. Më pas, u formuan qeveritë e njëpasnjëshme, në emër të Islamit, të cilat gjenden edhe sot. Pretenduesit e qeverive islame, gjoja ecin në gjurmët e mbi gjurmët e Islamit dhe të Profetit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), janë të shumta".[1]

"Qeveria e Profetit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe qeveria e Prijësit të besimtarëve, Aliut (Paqja qoftë mbi të!), të dyja ishin qeveri të ligjit, d.m.th. qeveri ku ligji vinte nga Zoti i Madhëruar, siç thotë: **"Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që janë në pushtet nga mesi juaj".**[2] *Ky është gjykimi i Allahut. Dhe këta janë ata që duhet t'u nënshtrohen vendimeve të ligjit. Pra, gjykimi është i ligjit, që sundon në vendet islame dhe jo ndonjë qeveri tjetër".*[3]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 365. Prej porosive politike të Imam Khomeinit.

2 Sure "En Nisa", ajeti 59.

3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 224.

"Profeti i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) u përpoq të krijonte unitetin e fjalës në të gjitha skajet e botës së banuar. Ai u përpoq që shtetet e botës të bashkoheshin të gjitha nën flamurin e teuhidit (njësimit të Zotit). Ai dëshironte që një e katërta e banuar e tokës të jetonte nën hijen e "Fjalës së teuhidit". Por, ambiciet e sundimtarëve dhe dëshirat e tyre, nga njëra anë, si dhe prirjet e dijetarëve të të krishterëve, hebrenjve dhe të ngjashmëve të tyre, nga ana tjetër, penguan që i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ta realizonte këtë qëllim. Në të vërtetë, janë vetë ata që e pengojnë sot të njëjtin qëllim dhe të gjitha problemet tona janë shkaktuar prej tyre. Ai që është i mençur dhe kupton logjikën kur'anore, e kupton që Kur'ani është ai që e nxiti Profetin e Islamit për të luftuar kapitalistët e pasur dhe arrogantë, të cilët ishin zotërues të fuqisë në Hixhaz, Taif dhe Mekë. Dhe është po ai që e nxiti Profetin më të nderuar të luftonte shfrytëzuesit dhe kundërshtarët për të mirën e përgjithshme të njerëzve. Luftërat që Profeti i nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) zhvilloi gjatë jetës së tij, pasi iu përgatitën kushtet, ishin gjithmonë kundër tiranëve, siç ishte Ebu Sufjani dhe të ngjashmit e tij, të cilët ishin kundërshtarë të Islamit. Ata përvetësuan pozitat dhe pasuritë e popujve të tyre, duke sunduar mbi ta dhe duke përfituar prej tyre, në një kohë kur padrejtësia dhe shtypja sundonte mbi shoqërinë".[1]

"Ato luftëra shpërthyen midis të varfërve të shtypur, klasa e tretë dhe tiranëve që përpiqeshin t'u grabisnin të drejtat. Nuk ka vetëm një apo dy ajete që flasin për luftën dhe përballjen me idhujtarët, që ishin zotë të fuqisë në atë kohë, por ka shumë ajete të tilla. Të gjithë profetët e mëparshëm, që i njohim nga historia, i përkisnin kësaj klase të tretë, nga

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 140.

këta të varfër. Ata ngriheshin përballë sundimtarëve të kohës së tyre, ashtu siç u ngrit Musai (Paqja qoftë mbi të!) përballë faraonit".[1]

"Kur shikojmë jetën e thirrësve të fesë, si Profeti i nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe imami, Udhëheqësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!), dhe kalifët e dukshëm, pas Profetit, ata vepruan duke përfaqësuar parimin e kalifatit, përpara se të kthehej në sulltanat dhe mbretëri. Kur shikojmë jetët e shumë dijetarëve të Islamit, shohim se lufta ka qenë gjithmonë e pranishme mes tyre dhe tiranëve dhe ata kurrë nuk heshtën. Qëllimi kryesor ishte se ata ngriheshin në luftë, sipas mundësive të tyre të kufizuara, për arsye të ndryshme".[2]

"Po ashtu, të shpjegojmë edhe formën e qeverisë sonë dhe të qeverisë që synojmë, vërtetësia e së cilës përfaqëson Profetin e nderuar, i cili, gjithashtu, ishte udhëheqës. Por duam të tregojmë për udhëheqësit e qeverive dhe historinë e tyre, prej të cilës Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!).

Kushdo që ka shkruar për jetën e të Dërguarit të nderuar të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka përmendur se jetesa e tij ishte në një nivel më të ulët se niveli i jetesës së njerëzve të zakonshëm që jetonin në atë kohë. Ai kishte një dhomë prej balte, në xhami dhe njerëzit që jetonin në Medinë, e rrethonin. Ai hipte mbi gomar, ndërsa pas tij hipte një njeri tjetër, që i shpjegonte ligjet dhe ia përsëriste ato. Ku mund të gjeni një sundimtar, një kryetar policie apo një kryetar qyteti apo fshati që të sillej me popullin e tij në këtë mënyrë? Ai ulej me popullin e tij në xhami, që ishte selia e qeverisë së tij, duke biseduar me ta. Nëse hynte një i huaj në xhami, nuk mund ta dallonte lehtë se cili prej tyre ishte i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 141

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 142.

dhe mbi familjen e tij!). Ai nuk jetonte një jetë luksoze apo të privilegjuar; përkundrazi, kujdesej për gjendjen e të varfërve dhe të dobëtëve në një mënyrë që të gjithë e gjenin të pamundur ta përshkruanin. E njëjtë ishte gjendja e Imam Aliut, Prijësit të besimtarëve, gjatë kohës së kalifatit të tij, i cili përfshinte shumë vende, si: Irani, Hixhazi, Iraku, Jordania dhe Egjipti. Megjithëse territori i tij ishte shumë i gjerë, ne vërejmë se jeta e tij ishte tepër e thjeshtë. A është ky ai që mban mbi supe shqetësimet e masave? Apo ata që flasin për luksin dhe jetën e mbushur me rehati?! Krahasoni mes tyre dhe studioni atë që na përcjell historia nga jeta e tij: historia na tregon se ai flinte natën mbi lëkurën e deles me fëmijët e tij, ndërsa ditën i vendoste ushqim kafshës së tij. Kështu ishte jeta e Prijësit të besimtarëve. Mund të thuhet se ai nuk u ngop kurrë në jetën e tij, as edhe një herë të vetme me bukë".[1]

"Mendoni për jetën e njeriut më të madh në botë, pas të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), të Imamit Aliut (Paqja qoftë mbi të!), i cili qeveriste vende të gjera që përfshinin pjesë të Iranit, dhe në atë kohë ishte bërë kalif që qeveriste Egjiptin, Hixhazin, Irakun, Jemenin dhe një pjesë të Evropës. Kur reflektojmë mbi sjelljen e këtij udhëheqësi të madh, që ishte sunduesi i madh, bashkë me popullin e mbretërisë së tij, shohim se ai dëshironte që jeta e tij të ishte më e thjeshtë se ajo e njerëzve më të zakonshëm të shtetit të tij. Ai ishte shumë i ashpër me veten, aq sa ngjallte habi edhe mes familjes së tij, në kohën kur ishte në krye të një shteti. Enën që përdorte për ushqim, e mbyllte fort në një trastë që askush nga familja e tij të mos shtonte mbi të vaj.

Kështu sillej ai me veten e tij. Për sa i përket marrëdhënies së tij me njerëzit, ai dilte natën, duke bartur mbi shpinë ushqim për jetimët dhe

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 144.

të varfrit, pastaj ua shpërndante atyre. Askush nuk e mori vesh këtë gjë, deri pas martirizimit të tij, kur u zbulua e vërteta. Ashtu siç është përmendur, kur shkonte në një shtëpi, ku kishte disa fëmijë që vuanin nga uria, ai, pasi i ushqente, ulej me ta, i ledhatonte dhe i gëzonte deri në atë shkallë, sa imitonte zërin e deveve për t'i bërë të qeshnin. Pastaj u thoshte: "Unë dua që, kur të largohem prej këtu, ata të jenë të lumtur dhe të buzëqeshur.

Prijësi i besimtarëve jetoi si sundues mes njerëzve me një stil të veçantë. Thuhet se, kur ushtria e Muavies erdhi dhe mori prej një gruaje hebreje byzylykun e saj, ai u trondit shumë kur dëgjoi për këtë ngjarje dhe tha: "Po të vdiste një mysliman nga dhimbja për këtë ngjarje, nuk do të ishte për t'u qortuar".[1]

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, ishte i mëshirshëm, i butë dhe plot dashuri për popullin e tij, duke larguar prej tyre çdo ndjenjë frike, nën hijen e qeverisjes së tij.

Kur dikush hynte tek ai, nuk kishte mes tij dhe tyre as frikë, as tmerr, por të gjithë ndienin vetëm drejtësi. Në qeverinë e drejtësisë, njeriu nuk i frikësohet askujt veç vetes, ka frikë se mos ka bërë ndonjë gabim. Sa për ushtarët e vendit, ushtrinë apo policinë, nuk kishte frikë prej tyre, sepse të gjithë silleshin me dashuri me njerëzit.

Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!), megjithëse ishte kaq i mëshirshëm në sjelljen e tij me popullin, i cili e shihte si një njeri të zakonshëm që merrej me jetesën e tij si të tjerët, kur hynte në fushën e betejës, përballë armiqve të tij, mbillte tmerr në zemrat e tyre.

1 "Nehxhul Belaga", Pika 4, "Shënimet".

Kur Prijësi i besimtarëve u zgjodh nga populli, ai mori veglat e punës dhe shkoi për të përfunduar punën që kishte filluar, ujitjen e tokës. Më pas shkoi në selinë e qeverisë".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 6, f. 349-350.

Pengesat e zbatimit të Islamit

"Për fat të keq, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk arriti të punonte në mënyrën që dëshironte. Që nga dita e parë e hyrjes së tij në Medinë, ai u përball me luftëra që e penguan të themelonte qeverinë e tij sipas vizionit që kishte. Po ashtu, nuk arriti t'i paraqiste dijet që donte t'ua ofronte njerëzve në mënyrën e duhur. Kurse Kur'ani zbriti dhe përfaqësonte gjithçka, por problemet e penguan nga paraqitja e tij siç duhej, madje edhe në Hixhaz. Gjithashtu, edhe vuajtjet e Prijësit të besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) ishin më të mëdha, pas të Dërguarit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Duhet që ne ta përjetojmë këtë hidhërim në jetën tonë, sepse ata nuk e lejuan Profetin (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) që të themelonte qeverinë që ai dëshironte. Pretenduesit e Ilsamit ndezën flakët e luftërave dhe e kundërshtuan Islamin në emër të Islamit, madje i vunë përballë Islamit dhe Kur'anit të shenjtë tiparet e atyre që hiqeshin sikur ishin me Islamin, derisa e penguan nga arritja e qëllimit. Sikur ata që hiqeshin si të shenjtë dhe hipokritë të tjerë të mos e pengonin Prijësin e besimtarëve, dhe sikur të mos e kishin ndaluar atë nga shkatërrimi i dredhive të Muavies, sot Islami do të kishte pasur një fat tjetër dhe ndoshta nuk do të ndodhte ajo që ndodhi më vonë, dhe nuk do të kishim çështjen e Kerbelasë, as problemet e Imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!). Ata që hiqeshin si të shenjtë në Nahreuan, janë ata që mbajnë përgjegjësinë për pasojat e asaj ngjarjeje, ndaj mallkimi i Allahut qoftë mbi ta përgjithmonë. Po të mos ishin problemet me të cilat u përball i Dërguari i Allahut, ai do të kishte mundur ta themelonte qeverinë që dëshironte. Edhe pse ishte i aftë të vendoste themele shembullore për të ardhmen, nuk iu lejua. Edhe në kohën e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!),

ndodhi e njëjta gjë. Pengimi erdhi nga disa prej shokëve të tij, nga pretenduesit e Islamit, të cilët, me marrëzinë e tyre, e penguan dhe nuk e lanë të vepronte sipas asaj që dëshironte.

Kjo është një plagë e përjetshme për myslimanët. Sikur punët, në kohën e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të Prijësit të besimtarëve, të kishin shkuar siç ata dëshironin, nuk do të kishim përjetuar kaq shumë probleme. Por, ishte caktimi hyjnor që ndodhi kështu. Nëse do të donim ta përmblidhnim, mund të themi se ajo që përjetojmë sot, është shumë e ngjashme me atë kohë, por në përmasa edhe më të mëdha. Ne sot vuajmë nga të njëjtat probleme, por të shfaqura në mënyra të tjera. Këto probleme janë zgjeruar, duke parë ndryshimet dhe gjendjen e botës. Prandaj, ashtu siç Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Imam Aliu nuk u lejuan të arrijnë qëllimet e tyre për themelimin e një qeverie të drejtë islame edhe Islami sot po përballet me pengesa më të mëdha. Ka të tillë që përpiqen ta dëmtojnë, në emër të Islamit, ndërsa janë në të vërtetë injorantë dhe armiq të tij, duke u përpjekur në emër të Islamit të ndalojnë themelimin e një qeverie islame. Sigurisht një grup injorantësh dhe një grup prej dijetarëve të shthurur janë pengesë e themelimit të qeverisë islame. Profeti i nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Dy gjëra ma thyejnë shpinën: një dijetar i shthurur dhe një injorant i devotshëm". Unë nuk e di se cili prej tyre i ka shkaktuar Islamit goditjen më të madhe: a janë dijetarët e shthurur apo injorantët e devotshëm. Në çdo rast, Islami gjithmonë ka vuajtur nga këto dy sprova. Kjo është ajo me të cilën ne përballemi edhe sot dhe do të vazhdojë të jetë e pranishme edhe në të ardhmen, madje edhe në kohën e shfaqjes së Imam Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!) dhe marrjes së pushtetit

nga ai, siç thuhet në disa transmetime: "Kur të shfaqet Mehdiu, disa dijetarë do ta shpallin atë jobesimtar". Dhe kjo sprovë ekziston në botë".[1]

"Bota nuk e di se çfarë është Islami. Kjo botë për të cilën ju flisni, nuk di asgjë për Islamin. Këta nuk e dinë që qeveria islame nuk formohet në mënyrë që të krijohet një diktaturë. Jo vetëm në vendet islame nuk duhet të ketë diktaturë, madje as në Amerikë, gjithashtu. Një qeveri islame vjen vetëm për të zhdukur diktaturën. Personi që vendoset në qeveri, sipas Islamit, nuk sundon sipas dëshirës personale, por sipas parimeve të fesë së tij. Feja gjykon se nuk duhet të ketë diktaturë. Këta mendojnë gabim, se mjafton të thuhet se një jurist i drejtë u bë i njohur me ekuilibrat e padrejtësisë dhe, nëse njerëzit e zgjodhën atë si president të vendit dhe ai pranoi, atëherë do të ishte diktaturë. Por, nëse vjen një person tiran dhe sundon, atëherë kjo nuk është diktaturë.

Në Islam nuk ka udhëheqës si Hitleri apo si Karteri, i cili i ngjan Hitlerit, që shtyp njerëzit, i vret dhe i persekuton. Kur Islami vendos për të qeverisur një jurist të drejtë, të ditur, të sinqertë dhe të përkushtuar ndaj popullit, ai nuk është aty për të sunduar, por për të shërbyer. Kështu, nuk ka vend që të vijë një person tjetër i padrejtë për t'i shtypur dhe grabitur njerëzit.

Që nga shfaqja e Islamit e deri më sot, shihni se si kanë qenë qeveritë islame. Një shembull është qeveria e Ali ibn Ebi Talibit (Paqja qoftë mbi të!), një qeveri islame e ngritur mbi bazën e drejtësisë. Më pas, pushteti kaloi në duart e Beni Umejes, Beni Abasit dhe qeverive tiranike, monarkike dhe të ngjashme me to. Myslimanët i fituan ato vende, por sistemi u shndërrua në një sistem mbretëror dhe ata nuk arritën ta zbatonin Islamin dhe qeverinë islame në mënyrën e duhur.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 18, f. 327-328.

Sot Islami është bërë i huaj, sikur një i huaj që hyn në një qytet dhe njerëzit nuk e njohin. Islami është i huaj mes popujve, sepse ata nuk e njohin atë dhe nuk i njohin ligjet e tij. Madje, as disa prej të ashtuquajturve ekspertë të Islamit nuk i njohin ligjet e tij. Ata nuk e dinë se çfarë është Islami dhe, kur mendojnë për të, mendojnë se, nëse do të vendosej një qeveri e dijetarit (fakihut), ajo do të ishte një qeveri diktatoriale. Ndërsa, nëse nuk do të ishte dijetar, për ta nuk ka rëndësi kush sundon, qoftë edhe Shimri (vrasësi i Imam Hysenit).

Pra, problemi i tyre është me juristin dhe ky problem buron nga frika që ata kanë ndaj Islamit. Islami nuk u lë hapësirë të korruptuarve që të ndihen rehat. Disa janë mashtruar, ndërsa disa të tjerë shtiren qëllimisht sikur janë mashtruar. Përndryshe, qeveria islame, si ajo e Aliut, birit të Ebu Talibit, nuk është diktaturë. Ajo është një qeveri e ngritur mbi bazën e drejtësisë, ku udhëheqësi kishte një stil jete më të thjeshtë se çdo njeri i zakonshëm.

Aliu jetonte me një nivel jetese më të ulët se masa. Ai nuk ngopej as me bukë elbi; merrte vetëm një ose dy kafshata dhe i hante me kripë. A mund të quhet një qeveri e tillë diktaturë? Pse duhet të jetë diktaturë? Nuk kishte luks, që të kishte diktaturë. Në Islam nuk ka sundim, por drejtësi dhe shërbim.

I Dërguari i Islamit (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) kishte nën kokë një hasër kashte, ndërsa ishte ulur në xhami, i cili i linte shenja në ballë. Nuk dihet as nëse ajo hasër ishte e mirë apo jo. Myslimanët uleshin pranë njëri-tjetrit, pa dallime. Arabët që vinin nga jashtë, nuk e njihnin Profetin dhe për këtë arsye pyesnin: "Kush është Muhamedi mes jush?" Ata nuk e dallonin atë nga të tjerët.

Edhe sot, ne – të nderuar – duam një qeveri të këtij lloji, një qeveri udhëheqësi i së cilës jeton në një shtëpi prej balte dhe nuk ka asgjë më

shumë se kaq. Thuhet për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) se ai kishte vetëm një lëkurë: ditën mbi të vendoste ushqimin për devenë, ndërsa natën ai dhe Fatimja (Paqja qoftë mbi ta!) flinin mbi të. Si mund të quhet një gjendje e tillë diktaturë?

Ata që e quajnë këtë diktaturë nuk e kuptojnë realitetin e Islamit dhe nuk e njohin fik'hun islam. Ata mendojnë se ne pranojmë një qeveri të çdo juristi, edhe nëse ai është i korruptuar. Por, nëse një jurist kryen qoftë edhe një veprim të vogël të gabuar, ai humbet autoritetin e tij. A është autoriteti diçka që mund t'i dhurohet dikujt, siç mendojnë ata? Nëse do të ishte kështu, atëherë, vërtet do të kishim një sistem diktatorial dhe gjithçka do të shndërrohej në arbitraritet". [1]

Umeti islam ecën në gjurmët e një shkolle, programi i së cilës përmblidhet në dy fjalë: ***"Mos bëni padrejtësi dhe mos ju bëhet padrejtësi"."***[2]

Gjatë gjithë historisë sonë kemi jetuar nën hijen e forcave shtypëse të brendshme dhe të jashtme, veçanërisht në këtë gjysmë shekulli të fundit, kur fuqitë e mëdha botërore forcuan sistemin e mëparshëm të pushtetit. Kështu, anglezët sollën Reza Khanin, ndërsa aleatët sollën Muhamed Rezain në pushtet në vitet '50 të shekullit të kaluar.

Ne kemi jetuar nën lloje të ndryshme padrejtësie: padrejtësi ushtarake, kulturore, ekonomike dhe shoqërore. Për pesëdhjetë vjet kemi përjetuar sundimin e të huajve dhe të shërbëtorëve të tyre nga brenda vendit. Kemi qenë dëshmitarë të padrejtësive të tilla që, po të regjistroheshin të gjitha, historia do të shndërrohej në një libër të gjallë. Padrejtësitë e ushtruara kundër fesë, popullit, grave, të rinjve,

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 250-251.
2 Sure "Bekare", ajeti 279.

intelektualëve dhe dijetarëve të Islamit nuk mund të përshkruhen as brenda një dite e as brenda disa ditëve.

Kur presioni arriti në një pikë ku populli nuk mund ta duronte më, kupa u mbush dhe ata u ngritën fuqishëm kundër shtypjes. Në këtë kryengritje, e cila zgjati rreth pesëmbëdhjetë vjet, populli dha bijtë e tij, përjetoi masakra dhe pësoi shumë viktima. Të sakrifikuarit ishin të rinjtë, të moshuarit dhe të pafuqishmit, të cilët e panë padrejtësinë me sytë e tyre dhe nuk mund ta duronin më.

Kështu, ata u ngritën dhe përmbysën pushtetin tiranik dhe tradhtar, duke e larguar nga vendi i tyre. Po kështu u përzunë edhe duart grabitqare që plaçkitnin atdheun, duke marrë gjithçka falas, madje edhe gjërat më të thjeshta të popullit, të fshehura nën emrin e shitblerjes".[1]

"Ne duam t'i zbatojmë këto dy fjalë nën udhëzimin dhe drejtimin e Profetit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ne nuk duam të jemi as shtypës e as të shtypur. Gjatë gjithë historisë kemi qenë të shtypur, nga të gjitha anët. Sot duam që as të mos shtypemi dhe as të shtypim të tjerët. Ne nuk do të sulmojmë asnjë vend dhe nuk do të ushtrojmë padrejtësi, por gjithashtu nuk do të lejojmë që të na bëhet padrejtësi, sipas udhëzimit të Islamit dhe ligjit që kemi trashëguar.

Nuk na lejohet të sulmojmë asnjë vend apo person, por po aq nuk na lejohet të pranojmë që dikush të na sulmojë. Prandaj, duhet të pengojmë çdo agresion që ushtrohet ndaj nesh. Populli ynë sot, nga gratë te burrat, nga fëmijët te të moshuarit, është i vendosur të qëndrojë përballë agresioneve që i janë bërë deri tani dhe që vazhdojnë edhe sot, i gatshëm të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 67.

sakrifikohet për hir të lirisë, pavarësisë dhe çlirimit nga zgjedha e padrejtësisë.

Ne presim këtë qëndrim nga të gjithë popujt dhe shtetet e botës. Nëse këto vende janë islame, ato duhet të ndjekin ligjin e Islamit, i cili thotë se nuk lejohet as të bësh padrejtësi dhe as t'i nënshtrohesh asaj. Nëse ndjekin Mesihun (Paqja qoftë mbi të!), atëherë edhe Isai (Mesih) (Paqja qoftë mbi të!) nuk e ka lejuar padrejtësinë në asnjë formë. Nëse ndjekin Musain (Paqja qoftë mbi të!), atëherë edhe Musai (Paqja qoftë mbi të!) nuk e lejoi padrejtësinë dhe nuk iu nënshtrua asaj.

Këtu qëndron programi i profetëve: programi hyjnor që iu shpall njerëzimit përmes profetëve është që njerëzit të mos bëjnë padrejtësi, qoftë edhe për dy dirhemë apo për dy okë, dhe të mos e pranojnë padrejtësinë. Edhe ne, që e kemi përjetuar vetë padrejtësinë, e dimë mirë se çfarë është ajo.

Nën regjimin e mëparshëm, të shëmtuar, pamë forma të panumërta padrejtësish ndaj kombit: shkelje kulturore, shkelje ndaj fesë dhe çdo lloj tjetër shtypjeje. E kam fjalën për sistemin e mallkuar të mëparshëm. Ne shihnim se si sillej pushteti me popullin, në një mënyrë që nuk praktikohej as ndaj kafshëve. Kishte njerëz që silleshin si kafshë dhe sundonin mbi ne, ndërsa nuk kishte asnjë respekt për dinjitetin njerëzor".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 68.

Historia e Islamit dhe përplasja e së vërtetës me të pavërtetën

Kush e vëzhgon historinë e profetëve, historinë e Islamit dhe jetën e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), si dhe jetën e imamëve të pastër dhe të shokëve të tij, do të vërejë se, që nga çasti i parë i hyrjes së tyre në skenë, që nga arritja e moshës së pjekurisë e deri në momentin kur iu ngarkua misioni hyjnor të Dërguarit fisnik, madje deri në çastin e vdekjes së tij, të gjitha veprimet dhe aktivitetet e tij ishin të përqendruara në luftë ose në mbrojtje për hir të së vërtetës.

Po ashtu, kush e studion jetën e Imam Aliut (paqja qoftë mbi të!), gjen të njëjtën gjë: jeta e tij ishte tërësisht xhihad në rrugën e Allahut dhe përballje për zbatimin e ligjeve të Tij. Kështu ishte edhe jeta e imamëve të tjerë të pastër (Paqja qoftë mbi ta!), në krye të të cilëve qëndron prijësi i dëshmorëve, Imam Hyseni (Paqja qoftë mbi të!). Sikur ai të kishte ndjekur mendimin e disa prej atyre që në kohën e tij shfaqeshin me petkun e shenjtërisë dhe i propozonin të qëndronte në qetësi, pranë adhurimit dhe larg shoqërisë, ngjarja e Kerbelasë nuk do të kishte ndodhur.

Po të kishte menduar vetëm për qetësi, lutje, përmendje dhe tërheqje, gjendja mendore dhe vetëdija që ekziston sot nuk do të ishte formuar. Megjithatë, edhe pse imamët tanë të pastër gëzonin respekt të madh, kalifët ishin gjithmonë të gatshëm t'u shprehnin respekt vetëm nëse ata do të pajtoheshin me dëshirat e tyre. Por imamët nuk e ndalën kurrë thirrjen e tyre.

A nuk ishte Imam Musa ibn Xhaferri (Paqja qoftë mbi të!) i burgosur për vite me radhë? Disa nga imamët u internuan nga Medina, disa të tjerë u sollën në pallatet e kalifëve, por ata nuk u shndërruan kurrë në njerëz që thjesht të qëndronin aty për lutje dhe adhurim. Përkundrazi, ata vazhdonin të jepnin mësim, të studionin, të edukonin dhe të adhuronin Allahun, duke ndjekur rrugën e të Dërguarit të Tij (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Sikur mendimi i tyre të kishte qenë i njëjtë me atë të disa njerëzve që i njohim sot, atëherë medh'hebi që ne ndjekim, nuk do të kishte ekzistuar. Ai u formua pikërisht duke qëndruar kundër padrejtësisë përgjatë gjithë historisë.

Përballë padrejtësisë ekzistojnë dy rrugë: rruga e angazhimit me Islamin, xhihadi dhe qëndrimi i palëkundur kundër padrejtësisë dhe rruga e kompromisit, pajtimit me të keqen, diktaturës, forcave djallëzore dhe nënshtrimit".[1]

"Historia e Islamit është e afërt me ne. Kushdo që e shqyrton atë, e kupton se Profeti i Islamit, gjatë periudhës së qëndrimit në Mekë, nuk kishte asnjë nga shtresat e fuqishme dhe të privilegjuara në anën e tij. Përkundrazi, ai përballej me kundërshtimin e tregtarëve kurejshë, të pasurve, të fuqishmëve dhe atyre me ndikim.

Profeti i Islamit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) gjatë gjithë periudhës mekase nuk mund të vepronte hapur; ai punonte fshehurazi dhe përqendrohej në formimin e grupeve. Kur e pa se veprimtaria në Mekë nuk ishte më e mundur, ai emigroi në Medinë. Kur hyri në Medinë, u vendos te një person që i përkiste shtresës së tretë, sipas

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 40.

terminologjisë së asaj kohe, dhe njerëzit që e rrethonin, ishin kryesisht të varfër.

Të gjitha luftërat e Profetit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishin kundër të pasurve dhe atyre me pushtet. Kjo bie ndesh me propagandën që përhapin disa, të cilën, për fat të keq, e kanë ndjekur edhe disa prej të rinjve tanë të painformuar. Çështja nuk ishte se faraoni përgatiti Musain (Paqja qoftë mbi të!) për t'i mpirë njerëzit; përkundrazi, Musai ishte ai që i zgjoi njerëzit për t'u ngritur kundër faraonit.

Po ashtu, çështja nuk ishte se kurejshët dhe të pasurit e sulmuan Profetin (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) vetëm sepse ai i paralajmëronte njerëzit. Përkundrazi, Profeti (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) u ngrit bashkë me të varfrit dhe i nxiti ata për revolucion kundër të pasurve dhe përballje me ta. Dhe pasi Islami u përhap dhe rrënjët e tij u forcuan, bijtë e shtresave të dobëta – ata që më parë ishin të shtypur – u ngritën kundër dy perandorive më të mëdha të asaj kohe, romakëve dhe persëve, dhe arritën t'i mposhtnin ato".[1]

"Kushdo që shqyrton historinë e Islamit vëren se një grup të varfërish, të cilët nuk kishin as strehë, u mblodhën rreth Profetit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe qëndronin në një pjesë të xhamisë, aq sa u quajtën "Banorët e Sufës". Siç përshkruhet në histori, gjatë disa luftërave, ata ndanin mes tyre një hurmë të vetme, sepse ky ishte i gjithë ushqimi që kishin. Pra, ata që qëndronin pranë të Dërguarit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ishin të varfrit, të pastrehët dhe të dobëtit. Pikërisht këta, përmes mësimeve të Kur'anit të shenjtë, çliruan Hixhazin në kohën e

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 283.

Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

I Dërguari i nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk mundi të qëndronte më në Mekë, ndaj u shpërngul në Medinë, pasi kishte vendosur lidhje me banorët e saj. Në Mekë ai nuk mund të arrinte më asgjë. Ata që ishin mbledhur rreth tij, ishin të varfër, jo të pasur. Si mund të bënte ai aleancë me të pasurit për t'i heshtur të varfrit?!

Të gjitha luftërat që ai zhvilloi, ishin kundër idhujtarëve arabë, të cilët ishin të dhunshëm, të fortë dhe luftëtarë të ashpër. Megjithatë, mësimet e Islamit, forca shpirtërore që ai u dha atyre pak myslimanëve dhe edukimi i tij i veçantë, bënë që njëri prej tyre të ishte i aftë të përballej me njëqind. Pikërisht, për këtë arsye, mësimet e Islamit ndërtojnë një njeri që nuk frikësohet nga përballja me forcat tiranike dhe bëjnë që tridhjetë prej tyre të shpallin gatishmërinë për t'u përballur me gjashtëdhjetë mijë, duke thënë se ata janë pararojat e ushtrisë romake".[1]

"Po ashtu, duhet të vërejmë se Kur'ani – burimi i parë i Islamit dhe teksti i tij autentik, i paprekur nga duart e shtrembërimit – nuk i thërret njerëzit për nënshtrim ndaj të pasurve, as për heshtje përballë pushtetarëve dhe të fuqishmëve kur ata vjedhin dhe abuzojnë me pasuritë. A mos vallë Kur'ani u premtonte Xhenetin për këtë heshtje?

A nuk ishte pikërisht Kur'ani ai që i çoi njerëzit drejt çlirimit të Hixhazit dhe drejt shkatërrimit të tiranëve, ndërsa ata që u ngritën, ishin të varfër dhe të pafuqishëm, njerëz që për shumë prej tyre nuk kishte tjetër strehë veçse një qoshe xhamie, ku flinin të mbledhur e të mbështetur njëri te tjetri? Ata nuk kishin asgjë përveç asaj që u jepej herë pas here, vetëm

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 220.

sa për të mbajtur frymën gjallë. Madje, ndanin mes tyre edhe një hurmë të vetme!

A do të lindte vallë e gjithë kjo nga një thirrje për nënshtrim dhe heshtje? Apo je ti ai që dëshiron t'i paralajmërosh të tjerët me këto pretendime?"[1]

"Historia e Islamit është e mbushur me tradhti të disa personaliteteve ndaj vetë Islamit. [2] *Që në fillimet e tij dhe veçanërisht pas ndarjes nga jeta të Vulës së Profetëve (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), themeluesit të drejtësisë dhe lirisë, Islami u përball me rrezikun që të shndërrohej në një kafshatë të lehtë në gojën e tiranëve.*

Përmes shpikjeve dhe devijimeve që Beni Umeja i sajuan duke u mbështetur në besëtytni dhe duke e shkelur drejtësinë përmes njerëzve të korruptuar, Islami u çua drejt një errësire të thellë, deri në çastin kur zbardhi agimi i Prijësit të dëshmorëve, Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të! Ai, me flijimin e tij, me gjakun e tij dhe me gjakun e familjarëve dhe shokëve të tij, e shpëtoi Islamin dhe drejtësinë, duke tronditur themelet e propagandës së tyre mashtruese.

Edhe në kohën tonë, Islami pothuajse u gëlltit nga familja Pahlavi, zotërinjtë dhe oborrtarët e saj, të cilët, përmes devijimeve, tiranisë dhe pushtetit të tyre të mbështjellë me petkun e hipokrizisë dhe mashtrimit, pothuajse shuan drejtësinë, pavarësinë dhe lirinë".[3]

"Në logjikën e arrogancës botërore, kushdo që përpiqet të largohet nga kufri dhe shirku, do të akuzohet me shirk dhe fetvaxhijtë fëminorë prej

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 221.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 301.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 195.

nipërve të 'Ibn Baura' (Qoftë i mallkuar!), do të japin fetva se është i pafe dhe të vritet. Duhet të shfaqet shpata e kufrit dhe nifakut që fshihet pas veshjes së ihramit të rremë të jezidëve e të shitur prej Beni Umejes (Mallkimi i Allahut qoftë mbi ta!), e cila u ngrit për të vrarë dhe për të copëtuar bijtë më të mirë të Profetit të Islamit të sinqertë, zotëria ynë, Imam Hysenin dhe mbështetësit e tij besnikë. Duhet të shfaqet sërish zemërimi për trashëgimtarët e Beni Umejes, që masakruan trupat e pastër dhe grykat e pastra të ndjekësve të Hysenit (Paqja qoftë mbi të!) në të nxehtin e Kerbelasë dhe në masakrën e Harresë, duke iu ngarkuar atyre akuza të kota, ashtu siç akuzuan bijtë e sinqertë të Islamit, duke i akuzuar, si: kharixhij, mohues dhe idhujtarë dhe duke derdhur gjakun e tyre. Përveç dhimbjes sonë të thellë, ne, me lejen e Allahut, në kohën e duhur do të marrim hakun tonë nga Amerika dhe Al Saud, dhe do të mbushim zemrat e tyre me pikëllim ndaj këtij krimi të madh. Ne do të hyjmë në Xhaminë e Shenjtë jo vetëm për të festuar fitoren e së vërtetës mbi ushtarët e kufrit dhe nifakut, por edhe për të çliruar Qaben nga duart e atyre që nuk u lejohet ta prekin".[1]

"Edhe sot, ashtu si në të kaluarën, gjuetarët e kolonializmit veprojnë në vende të ndryshme të botës – Egjipt, Pakistan, Afganistan, Liban, Irak, Hixhaz, Iran dhe tokat e pushtuara si Palestina. Dijetarët luftëtarë të Islamit, ata që qëndrojnë besnikë parimeve të Islamit të pastër dhe i kundërvihen padrejtësive të Lindjes dhe Perëndimit, shpesh persekutohen dhe sulmohen.

Sot jemi dëshmitarë të një shpërthimi të madh të presionit ndërkombëtar kundër një grupi dijetarësh të përkushtuar. Dijetarët e Islamit të pastër kurrë nuk iu nënshtruan kapitalistëve, feudalëve apo adhuruesve të parasë; ata ruajtën integritetin e tyre dhe qëndruan

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 74.

gjithmonë kundër padrejtësisë. Disa mund të mendojnë se përkrahësit e varfër dhe të shtypur të dijetarëve janë dorëzuar për kapitalistët dhe borgjezët, por ky është një keqkuptim i madh.

Dijetarët e përkushtuar të fesë, të ushtruar në asketizëm dhe devotshmëri, arritën shkallë të larta të dijes dhe shpirtërore, jetuan në varfëri dhe privime, duke hequr dorë nga luksi i kësaj bote. Ata nuk e njihnin poshtërsinë dhe nuk pranonin nënshtrimin ndaj padrejtësisë. Kushdo që shqyrton jetën e dijetarëve të hershëm, sheh se shpirti i tyre ishte i përgatitur për dijen, për jetesën e thjeshtë, për studimin nën dritën e qiririt dhe shkëlqimin e hënës, duke jetuar me kënaqësi dhe madhështi shpirtërore".[1]

"Nuk ka dyshim se shkollat e dijes dhe dijetarët e përkushtuar kanë qenë gjithmonë në historinë e Islamit dhe të Shi'izmit, baza më e rëndësishme dhe mbështetja më e fortë përballë fushatave të devijimeve dhe sjelljeve ekstreme. Dijetarët e mëdhenj të Islamit, gjatë gjithë jetës së tyre, janë përpjekur të përhapin mësimin e çështjeve të hallallit dhe haramit hyjnor, pa ndërhyrje apo ndikim të huaj. Po të mos ishte prania e dijetarëve të nderuar (fukahatë), sot nuk do të ishte e njohur se çfarë dije u ofrohet njerëzve, duke përfshirë njohuritë për Kur'anin, Islamin dhe Ehli Bejtin (Paqja qoftë mbi ta!). Me të vërtetë, mbledhja dhe ruajtja e shkencave të Kur'anit, Islamit dhe Sunetit të të Dërguarit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), si dhe jeta dhe biografia e imamëve të pagabueshëm, regjistrimi, shkrimi, sistemimi dhe sqarimi i tyre, nuk ishte një punë e lehtë në ato rrethana, kur mundësitë ishin shumë të pakta. Sundimtarët dhe tiranët i vunë të gjitha mundësitë e tyre për të zhdukur gjurmët e Mesazhit.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 252.

Megjithatë, falë përpjekjeve të mëdha të dijetarëve, na kanë mbetur vepra dhe shkrime të bekuara, fryt i mundit të dijetarëve të hershëm dhe të mëvonshëm. Sot, falë Allahut, shohim libra dhe përmbledhje të ngjashme me "Katër Librat", si dhe në fusha të ndryshme të shkencës islame: jurisprudencën, filozofinë, matematikën, astronominë, teologjinë, hadithin, tefsirin, gjuhën, letërsinë, misticizmin (irfanin), shkencën e transmetuesve (ilmu rixhal) dhe të gjitha degët e tjera të dijes.

Këto arritje u realizuan vetëm me përpjekje të mëdha dhe sakrifica në rrugën e Allahut. Nëse nuk i quajmë këto përpjekje dhe sakrifica "xhihad", atëherë si mund t'i emërtojmë ndryshe? Ky është termi më i përshtatshëm. Shërbimet shkencore të ofruara nga shkollat fetare nuk kanë fund për t'u përmendur. Medresetë dhe qendrat shkencore fetare janë të pasura me burime për kërkimin dhe metodologjinë e ixhtihadit, të pajisura me kreativitet dhe rigorozitet.

Historia mijëvjeçare e kërkimit, verifikimit dhe ndjekjes së dijes nga dijetarët e sinqertë të Islamit dëshmon për kujdesin dhe zhvillimin e filizit të shenjtë të Islamit. Për shekuj me radhë, dijetarët e Islamit kanë qenë strehë për të varfrit dhe të shtypurit, duke i ushqyer me dije të vazhdueshme, si një lum i pakufishëm i dijes.

Në këtë xhihad shkencor e kulturor, që shpesh mund të konsiderohet më i vlefshëm se gjaku i dëshmorëve, në disa aspekte, ata kanë përballuar mundime të mëdha: internime, burgje, tortura dhe poshtërime. Në këto rrethana, dijetarët dhanë dëshmorë të mëdhenj në rrugën e së vërtetës. Dëshmorët nga radhët e dijetarëve të fesë nuk janë të kufizuar vetëm te betejat ushtarake; shumë prej tyre humbën jetën në rrugën e përhapjes së dijes dhe rregullave hyjnore, duke u përballur me tradhtarët dhe të poshtër.

Në çdo lëvizje popullore dhe hyjnore, dijetarët e Islamit qëndronin gjithmonë në ballë: mbajtës të vulës së gjakut dhe martirizimit mbi ballët e tyre. Cila kryengritje popullore islame nuk ka pasur burra të medresesë dhe dijetarë të fesë në radhët e para të dëshmorëve? A nuk ishin ata që nuk u tërhoqën para vështirësive, nuk kursyen trupin e tyre të pastër, dhe nuk shmangën flijimin në altarët e martirizimit?"[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 251.

Qeveritë e sundimtarëve në emër të Islamit

Në fillim të Islamit, sidomos në Medinën e ndritur, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), trupëzoi dy personalitete: personalitetin e të Dërguarit të shpalljes dhe të shpalljes hyjnore nga Allahu i Madhëruar dhe personalitetin e Imamit, udhëheqësit të drejtë mysliman. Ky bashkim në një personalitet të vetëm, ndërmjet çështjes së shoqërisë dhe fesë, ishte i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm. Islami është fe e Ahiretit, por, gjithashtu, edhe e kësaj bote, dhe në formën më të hollë, Islami kujdeset për dynjanë për Ahiretin. Hadithi i Profetit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) thotë: "*Dynjaja është ara e Ahiretit*". Sipas kësaj logjike, udhëheqësi më i lartë në shoqërinë islame duhej të ishte më i përkushtuari ndaj Islamit, që është i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Dhe ky ishte besimi i Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili besonte në ekzistencën e një teksti profetik mbi imamatin e dymbëdhjetë imamëve nga pasardhësit e të Dërguarit të Allahut, të cilët zotëronin aftësitë dhe meritat e duhura për të udhëhequr. Megjithatë, pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe shfaqjes së mosmarrëveshjes së madhe në umet rreth natyrës dhe aftësisë së Imamit ose kalifit, dhe rolin e detyrës së tij, myslimanët, atë ditë e zgjidhën çështjen, duke i dhënë përparësi aspektit kohor dhe politik në çështjen e kalifatit, me më pak kujdes për anën

shpirtërore, morale dhe mesazhin (profetik), ai u ruajt për shkak të afërsisë në kohë me të Dërguarin e Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, gjë që u mbështet te Aliu (paqja qoftë mbi të) dhe shtylla të tjerë nga Ehli Bejti (Paqja qoftë mbi ta!), si dhe te sahabët e mëdhenj, të cilët vendosën një themel thelbësor në aspektin mesazhor dhe profetik të kalifatit.

Mirëpo devijimi i madh dhe i rrezikshëm që ndodhi në ummet pas martirizimit të Imam Ali ibn Ebi Talibit (Paqja qoftë mbi të!), si dhe marrja e pushtetit nga Muavija ibn Ebi Sufjani dhe shndërrimi i kalifatit në një mbretëri të trashëgueshme, ishte një ndryshim i thellë.

"Që nga shfaqja e Islamit, muslimanët kanë qenë mbrojtës të fesë islame të sigurtë, aq sa hiqnin dorë edhe nga të drejtat e tyre personale për ta ruajtur fenë. Prandaj, Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) bashkëpunonte me kalifët, sepse ata – sipas asaj që dukej nga jashtë, vepronin sipas dispozitave të fesë dhe nuk kishte diçka që ta turbullonte pastërtinë e saj, derisa erdhi Muavija dhe devijoi nga rruga dhe metoda e kalifëve, duke e zëvendësuar kalifatin me sundim mbretëror. Atëherë, Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) u detyrua të ngrihej, sepse nuk mund të qëndronte i heshtur.

Sipas peshoreve të Sheriatit dhe arsyes, ai nuk mund ta shihte Muavijen si uzurpues të kalifatit qoftë edhe për një ditë të vetme. Edhe ata që e këshillonin që ta linte Muavijen derisa çështja e kalifatit të forcohej për të, e pastaj ta shkarkonte, nuk e kuptonin se nëse Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) do të duronte për t'u përballur me kundërshtimin e muslimanëve, ai nuk do të mund ta shkarkonte Muavijen pasi punët të konsolidoheshin dhe të stabilizoheshin.

Ndoshta disa të pavëmendshëm e shohin si të arsyeshme idenë që Prijësi i besimtarëve ta linte Muavijen, e pastaj ta shkarkonte pasi pushteti të forcohej për të; por kjo është një mendim i pabazë.

Prandaj, kur Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) pa se një qeveri tirane po synonte të sundonte, u bë detyrë për të që të ngrihej kundër saj, dhe kështu veproi.

Po ashtu shohim se imamët e tjerë të pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!), edhe pse me pak përkrahës, u përpoqën të zbatonin detyrimet fetare dhe të forconin dispozitat e fesë, dhe mbetën në këtë rrugë derisa u larguan nga kjo botë. Disa prej tyre nuk e shihnin të arsyeshme ngritjen (revoltën), por qëndronin në shtëpitë e tyre dhe ushtronin rolin e tyre në përhapjen e udhëzimit. Kjo metodë dhe kjo qasje ishte rruga mbizotëruese që nga fillimi i Islamit.[1]

"Biri im, ndërsa jetoj në këtë mërgim të dytë, i var shpresat te të rinjtë e arsimuar dhe universitarë myslimanë. Pres prej jush që, përmes pastrimit të shpirtit dhe sinqeritetit, të ndërmerrni studime dhe kërkime të gjera e të thelluara në fushën e njohjes së dispozitave të Islamit dhe të parimeve të Kur'anit fisnik. Që ta njihni Islamin e vërtetë, ta kuptoni atë dhe ta njihni umetin islam, si dhe të dalloni ndryshimin ndërmjet Islamit të të Dërguarit të Allahut dhe kujdestarëve të Tij, dhe Islamit të shtrembëruar nga njerëz si Muavija, nga qeveritë grabitqare dhe agjentët e kolonializmit.

Që ta prezantoni këtë te populli përmes stacioneve televizive, radiove dhe ministrive, dhe ta bindni botën se ky Islam që kërkojnë qeveritë grabitqare dhe që e paraqesin me emrin "konferenca e unitetit islam", është

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 1, f. 128.

Islami i fabrikuar nga sulltanët umajadë dhe abasidë, i cili u vendos përballë Kur'anit dhe fesë së shenjtë të Profetit më të madh të Islamit.

Prandaj shohim se kolonialistët dhe vetë ata persona që dikur ngrinin Kur'anin (si parullë), thonë: Ne nuk mund të sundojmë mbi myslimanët për sa kohë që Kur'ani mbetet gjykatës mes tyre. Kështu, ata sot përkrahin një Islam të tillë dhe një "bashkim islam" të tillë, që ta devijojnë umetin islam, ta braktisin Kur'anin Fisnik dhe të zhdukin fenë e Allahut, duke përgatitur rrugën për realizimin e qëllimeve dhe synimeve të tyre kolonialiste."[1]

Benu Umejje po synonin ta zëvendësonin plotësisht Islamin. Qëllimi i Islamit hyjnor dhe shpirtëror ata u përpoqën ta shndërronin në një qeveri arabe, që synonte t'u jepte përparësi arabëve ndaj kombeve të tjera. Kjo bie ndesh me synimin e Islamit, i cili dëshironte të bashkonte njerëzimin në një umet të vetëm, nën një sistem të vetëm, në mënyrë që të mos mbizotërojë një popull mbi një tjetër dhe as një racë mbi një racë tjetër. Benu Umejët promovuan kapjen pas arabizmit. Sikur ta kishin arritur të ndryshonin Islamin në një koncept që synon rikthimin e arabizmit të periudhës paraislame, ata në fakt donin të ringjallnin injorancën (xhahilijetin). Edhe sot, disa udhëheqës arabë në disa rajone ku jetojnë arabë pretendojnë se po përpiqen të ringjallin arabizmin umejad, domethënë arabizmin e periudhës së injorancës; ata duan të ringjallin arabizmin emevit.[2]

"Unë nuk besoj se ndër ata sulltanë ka pasur njeri në kuptimin e vërtetë të fjalës. Propaganda mediatike ishte shumë e madhe, veçanërisht për Shah Abbasin (Safaviun), megjithëse ndër mbretërit safavidë nuk kishte më të keq e më të poshtër se ai. Po kështu edhe për Naseruddin

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 449.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 358.

Shahun në periudhën kaxhare; propaganda për të arriti deri aty sa ta quanin "mbreti martir" dhe të ngjashme, ndërkohë që ai ishte tiran dhe gjakatar, ndoshta edhe më i keq se të tjerët. Këto propaganda boshe vazhdonin në atë kohë. Flitej për "drejtësinë e Anushirvanit", për "dashurinë e presidentit të Amerikës për paqen", për "komunizmin e Bashkimit Sovjetik" dhe gjëra të tilla. Edhe sot i shohim këto gjëra në kohën bashkëkohore."[1]

"Ekspertët e kolonializmit, përmes falsifikimit dhe mashtrimit, kanë përgatitur terrenin. Ata vendosën një mbulesë mbi fytyrën e ndritshme të Islamit, në emër të dashurisë për Islamin dhe ndriçimit, dhe nuk u përqendruan te ana e pasur e Islamit, e cila shfaqet në arkitekturën madhështore, në pikturë, në ndërtesat madhështore dhe në artet e bukura. Qeveritë tirane dhe armiqësore ndaj Islamit – umajade, abasite dhe osmane, u paraqitën para shoqërive me emrin e "kalifatit islam", dhe e fshehën fytyrën e vërtetë të Islamit pas këtyre perdeve. Kjo ka bërë që sot të jetë e vështirë që shoqëritë njerëzore, madje edhe vetë myslimanët, të binden për qeverinë islame dhe për formësimet e saj themelore politike, ekonomike dhe shoqërore. Ne duhet të bëjmë përpjekje për të hequr perden nga propaganda e helmuar që prej qindra vitesh."[2]

"Tani të gjithë mbajmë një përgjegjësi të madhe. Unë si student i hawzës (shkollës fetare), dhe zotërinjtë e pranishëm që janë përgjegjës të sistemit, janë gjithashtu përgjegjës, ashtu si edhe shtresat e tjera. Përgjegjësia jonë është të përpiqemi ta shfaqim Islamin ashtu siç është, jo atë fytyrë që i dhanë sundimtarë si Muavija dhe shumë prej kalifëve umajadë e abasidë, të cilët vepronin në kundërshtim me Islamin ndërkohë

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 374.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 266.

që pretendonin se e përfaqësonin atë; gjë që ndonjëherë shkaktoi shtrembërimin e fytyrës së Islamit në botë.

Ne tani jemi në një sprovë të madhe, dhe Allahu po na sprovon në këtë kohë me mundësi, për të parë çfarë do të bëjmë me to. A do të jemi ne si ata (të mëparshmit) në një formë tjetër, apo do të veprojmë sipas Islamit?"[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 10.

Islami amerikan dhe Vehabizmi

Ashtu si në periudhat e mëparshme, kur Islami dhe umeti islam u goditën nga sundimtarë që qeverisnin në emër të Islamit dhe të Profetit, por që në të vërtetë shtrembëruan fytyrën e ndritur të fesë dhe zbehën mësimet e saj, edhe në kohën moderne, Islami dhe bota islame u përballën me goditje të reja nga shtete arrogante e kolonialiste. Kjo valë nisi me kolonializmin e vjetër evropian, në krye me atë britanik, vijoi me krimet e sovjetikëve ateistë dhe komunizmit armiqësor ndaj feve, dhe më pas me arrogancën amerikane. Sot, këto faza i përkasin muzeut të historisë politike, falë Zotit.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) u përball me komplotet e arrogancës botërore, si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim, si dhe me rrezikun e veglave të saj në rajon, veçanërisht me familjen Al Saud dhe Vehabizmin e korruptuar, që, sipas tij, nuk kishin lidhje me fenë e vërtetë islame. Ai denoncoi synimet e tyre kundër Islamit dhe umetit islam, duke paralajmëruar për rrezikun e vazhdueshëm që ato paraqisnin.

"*Vërtet, arroganca botërore, si ajo lindore, ashtu edhe ajo perëndimore, për shkak të paaftësisë për t'u përballur drejtpërdrejt me botën islame, nga njëra anë, iu drejtua atentateve dhe eliminimit të figurave fetare e politike, ndërsa, nga ana tjetër, përhapjes dhe promovimit të asaj që u quajt 'Islami amerikan'. Ndoshta do të kishte qenë më e lehtë sikur agresionet e dy fuqive të mëdha të ishin të hapura e të drejtpërdrejta,*

siç ishte agresioni i Bashkimi Sovjetik ndaj vendit mysliman të Afganistanit dhe krenarisë së dëshmorëve të tij; në atë rast, myslimanët do të mund ta përballnin haptazi arrogancën dhe fuqinë e saj të rreme.

Por përballja me 'Islamin amerikan' është më e ndërlikuar. Ajo kërkon përpjekje të vazhdueshme për t'ua bërë të qarta myslimanëve të sinqertë të gjitha dimensionet dhe prapaskenat e tij. Fatkeqësisht, për shumë popuj islamë mbetet ende i paqartë kufiri ndarës ndërmjet 'Islamit amerikan' dhe 'Islamit autentik muhamedan'. Nuk është sqaruar sa duhet dallimi midis Islamit të të shtypurve e të varfërve dhe të atyre që shtiren si të shenjtë; midis Islamit të njerëzve të thjeshtë dhe atij të kapitalistëve pa ndjenjë hyjnore e të pasurve që nuk e njohin dhimbjen.

Të bëhet e qartë se është e pamundur që brenda një feje dhe një doktrine të vetme të bashkëjetojnë dy vizione të kundërta e armiqësore me njëra-tjetrën, përbën një detyrë me rëndësi të madhe politike dhe shoqërore".[1]

"Profeti i Islamit nuk kishte nevojë për xhami madhështore e minare të stolisura; ai ndërtonte madhështinë e besimtarëve të tij – njerëz që kishin vuajtur poshtërim e nënshtrim si pasojë e politikave të gabuara të sundimtarëve dhe veglave të tyre. A i kanë harruar myslimanët masakrat kolektive ndaj dijetarëve, si dhe vrasjet e mijëra grave e burrave nga ndjekësit e medh'hebeve të ndryshme islame gjatë sundimit të turpshëm të Al Saudit? Po masakrën e haxhinjve në Shtëpinë e shenjtë të Allahut? A nuk e shohin sot se si qendrat e Vehabizmit nëpër botë janë shndërruar në vatra përçarjeje dhe spiunazhi?

Nga njëra anë promovohet "Islami i mjerimit", "Islami i Ebu Sufyanit", "Islami i mullahëve të oborrit", "Islami i atyre që shtiren si të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 112.

shenjtë, pa vetëdije në shkollat fetare e universitete", "Islami i përuljes dhe i humbjes", "Islami i parasë dhe i forcës", "Islami i mashtrimit dhe i kompromisit", "Islami i sundimit të pasurisë dhe kapitalistëve mbi të shtypurit e të varfrit"; me një fjalë: "Islami amerikan". Madje, Shtetet e Bashkuara janë shndërruar në flamurtaren kryesore të kësaj rryme në botë.

Nuk dihet se kah po drejtohen myslimanët përballë kësaj gjendjeje të dhimbshme, ndërkohë që familja Al Saud merr garanci nga "shërbëtori i dy haremeve" dhe nga Izraeli, se armët e tyre nuk do të përdoren kundër tij. Për ta dëshmuar këtë qëndrim, ata këmbëngulin edhe në ndërprerjen e marrëdhënieve me Iranin. Sikur marrëdhëniet e udhëheqësve të vendeve islame duhet të jenë të forta e të ngushta me sionizmin, aq sa nga agjenda e samiteve islame të hiqet edhe kundërshtimi simbolik e i hapur ndaj Izraelit.

Po të kishin qoftë edhe një grimcë xhelozie fetare dhe ndjenje të sinqertë islame e arabe, nuk do të pranonin marrëveshje të tilla të turpshme politike, as do të ishin të gatshëm të shisnin veten dhe vendet e tyre"[1]

"Unë nuk e kuptoj arsyetimin e imamëve të xhematit në dy haremet e shenjta, ku myslimanëve u ndalohet ndërhyrja në politikë, sipas dëshirave të Amerikës, Izraelit dhe armiqve të tjerë të Islamit, në kundërshtim me traditën e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe me rrugën e myslimanëve në fillimet e Islamit. Ata, me vetëdije apo nga padituria, po përgatisin terrenin për sundimin e të huajve mbi vendet islame. Madje edhe dy haremet e shenjta, vendi i zbritjes së shpalljes dhe i engjëjve të Allahut, si dhe haxhi në Shtëpinë e shenjtë të Allahut, janë të mbushura me dimension politik; nga sekretet e mëdha të tyre është ngritja e njerëzve për drejtësi dhe zhdukja e padrejtësisë dhe plaçkitjes. Kjo është politika e profetëve,

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 78.

veçanërisht e të Dërguarit të fundit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Megjithatë, ata në emër të Islamit, ua ndalojnë vizitorëve të dy haremeve të shenjta ndërhyrjen në politikë, madje edhe ngritjen e parullave kundër Izraelit dhe Amerikës".[1]

"Sot shohim se mbreti Fahdi shpenzon çdo vit shuma të mëdha nga pasuria e myslimanëve për shtypjen e Kur'anit fisnik dhe përhapjen e Vehabizmit. Ky medh'heb përhap besime të kota dhe të pavërteta, në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar, me synimin për të nënshtruar myslimanët dhe popujt e pavëmendshëm ndaj fuqive të mëdha dhe zhdukjen e Islamit të pastër e të fuqishëm dhe të Kur'anit fisnik në emër të Islamit dhe Kur'anit".[2]

"Çështja e Hixhazit ka dimensione të ndryshme, por dimensioni i rëndësishëm është shkelja e shenjtërisë së vendit të shenjtë. Myslimanët nuk do të qëndrojnë duarkryq përballë kësaj. Fahdi dhe të tjerët si ai do ta kuptojnë më vonë madhësinë e krimit që kanë kryer për t'iu bindur zotërinjve të tyre. Nëse ky krim i shëmtuar do të kishte ndodhur në Taif, mund të ishte përballuar, sepse Taifi nuk është si Qabja. Nga ana tjetër, shumë prej nesh janë vrarë në luftëra para dhe pas kësaj, dhe kjo e lehtëson dhimbjen për ne. Por ky krim ndodhi në Haremin e sigurt të Allahut, i cili tani është i pushtuar nga duart e këtyre kriminelëve, që e quajnë veten "Shërbëtorë të dy të shenjtave". Kush ua dha atyre këtë titull? Me çfarë arsye, përveç se një shtet me emër islam, e ndryshuan emrin nga Hixhazi në Mbretërinë e Arabisë Saudite? Çfarë përshtatshmërie ka ky emërtim? Të gjitha këto gjëra janë të lidhura dhe nuk dimë si ta pastrojmë këtë turp".[3]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 15, f. 257.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 358.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 20, f. 297.

"Ne lexojmë në suren "Et Teube", të cilën Allahu e urdhëroi të Dërguarin e Tij ta shpallte në Mekë gjatë Haxhit të madh: **"Shpallje nga Allahu dhe i Dërguari i Tij drejtuar njerëzve në ditën e Haxhit të madh, se Allahu dhe i Dërguari i Tij janë të pafajshëm nga politeistët".** *Kjo shpallje e shkëputjes nga politeistët gjatë ceremonive të haxhit, të cilën e përmend kjo ajet i bekuar, është një thirrje politike. Kjo është politika e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij, Muhamedit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Dhe këtu duhet t'u themi këtyre dijetarëve të blerë dhe klerikëve që e shohin si të gabuar thirrjen kundër Amerikës, Izraelit dhe Bashkimi Sovjetik, a është ndjekja e urdhrit të Allahut dhe zbatimi i tij diçka në kundërshtim me Islamin? A janë ceremonitë e haxhit në kundërshtim me Islamin? A po e konsideroni bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe zbatimin e asaj që Allahu urdhëroi për t'u distancuar nga jobesimtarët dhe politeistët si diçka kundër Islamit, dhe e dënoni shpalljen e kësaj gjatë haxhit? A i shpërfillni urdhrat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij për interesat tuaja të kësaj bote, dhe e konsideroni si "mosbesim" shkëputjen nga armiqtë e Islamit që luftojnë Islamin dhe shtypin myslimanët?*

Ne presim nga qeveria saudite që të mos i dëgjojë pëshpëritjet e këtyre njerëzve, që janë injorantë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe t'u lejojë myslimanëve, ashtu siç ka premtuar, që të kryejnë ceremonitë e haxhit dhe ta shpallin lirshëm shkëputjen nga jobesimtarët dhe politeistët; të bashkëpunojë me ta në këtë detyrë hyjnore, sidomos me haxhinjtë që vijnë nga vende të ekspozuara ndaj agresionit të jobesimtarëve, si: Irani, Palestina, Libani dhe Afganistani, në mënyrë që e gjithë bota të dëgjojë një thirrje të vetme dhe të kuptojë se kush është armiku i përbashkët i të gjithë të shtypurve dhe të dobëtëve në këtë botë".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 18, f. 83-84.

"Islami amerikan" këmbëngul që mullahët të merren vetëm me mësimet e tyre dhe të mos kenë asnjë lidhje me politikën. Këtë e thoshin hapur. Por shumë mendje filluan ta besonin këtë; se ne duhet të merremi vetëm me mësimdhënie dhe me shkollën fetare, dhe nuk kemi punë me atë që ndodh me popullin. Le të qeverisin ata, ne ç'rëndësi kemi? Ndërsa një grup tjetër mendon se duhet shtuar më shumë kryerja e mëkateve, që të përgatitet rruga për shfaqjen e "Sahibit të kohës" (Imam Mehdiut). Kur ai të shfaqet, do të vijë për të zhdukur mëkatet. Pra, ne duhet të bëjmë mëkate, që ta përshpejtojmë shfaqjen e tij?!

Përpiquni të çliroheni nga këto devijime. Për hir të Allahut, nëse jeni myslimanë; dhe për hir të vendit tuaj, nëse jeni atdhetarë, mos ecni kundër rrymës që po lëviz përpara me këtë popull, sepse dallgët e saj do t'ju thyejnë duart dhe këmbët".[1]

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!), në një takim me artistë myslimanë, gjatë diskutimit të çështjeve të artit dhe përballjes së këtij arti me "Islamin amerikan", midis të tjerash, ka thënë: *"Gjakrat e pastra të mijëra artistëve të urtë, që janë derdhur në frontet e dashurisë, dëshmisë, nderit dhe dinjitetit, janë një pasuri e pashtershme për artin, që duhet gjithmonë t'u japë frymë shpirtrave kërkues të së vërtetës dhe dashamirës të bukurisë, në përputhje me madhështinë dhe bukurinë e Revolucionit Islamik. Arti që përputhet me Kur'anin, është ai që mishëron Islamin autentik muhamedan, Islamin e imamëve të udhëzimit, Islamin e atyre që janë njollosur me gjak gjatë historisë së dhimbshme dhe të përgjakshme.*

Arti i bukur dhe i pastër është ai që godet kapitalizmin modern dhe komunizmin gjakpirës, që lufton Islamin e luksit dhe të rehatisë, Islamin e

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 17, f. 431.

oportunizmit, Islamin e kompromisit dhe të robërisë, Islamin e të pasurve që nuk e njohin dhimbjen; me një fjalë, "Islamin amerikan".

Arti në shkollën e dashurisë synon të zbulojë pikat e errëta dhe të paqarta të problemeve shoqërore, ekonomike, politike dhe ushtarake. Arti në vizionin islam është mishërim i qartë i drejtësisë, nderit dhe dinjitetit, dhe pasqyrim i dhimbjeve të të varfërve e i të shtypurve nga ana e pushtetarëve dhe pronarëve të pasurisë.

Arti, në qasjen e tij realiste, duhet të pasqyrojë gjakun e të pafajshmëve që derdhet, kulturën autentike islame, kulturën e drejtësisë dhe të së vërtetës. Prandaj, është i domosdoshëm drejtimi kah arti që mëson përballjen me fuqitë grabitqare lindore dhe perëndimore, në krye me Amerikën dhe Bashkimin Sovjetik".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 133.

Qeveritë islame dhe kolonializmi

"Me keqardhje, si pasojë e shmangies së shumicës së qeverive islame, rreth një miliard myslimanë jetojnë nën presionin e fuqive të mëdha djallëzore, ndërsa pasuritë e tyre të mëdha përpihen nga këto fuqi. Për këtë arsye, popujt duhet të ngrihen dhe të çlirohen si nga duart e qeverive të tyre, ashtu edhe nga kthetrat e fuqive të mëdha.

Sikur populli iranian të ishte ulur e të priste ndihmës nga jashtë, për ta çliruar, ai do të kishte mbetur nën të njëjtin presion dhe do të kishte vazhduar sundimi tiranik i dinastisë Pahlavi. Por ai nuk priti. Edhe pse shtetet lindore dhe perëndimore e mbështetën Mohamed Reza Pahlavin, me gjithë fuqinë e jashtme dhe aparatin e tij të brendshëm ushtarak, populli iranian u ngrit në revoltë. Burra e gra, të rinj e të moshuar, u bënë një zë i vetëm, duke shpallur: 'Ne nuk e duam këtë qeveri tirane dhe këtë pushtet mohues'. Asnjë fuqi e jashtme nuk arriti t'i ndalte, dhe madje edhe forcat e brendshme përfundimisht u bashkuan me popullin".[1]

"Problemi i Islamit janë qeveritë islame, jo popujt. Këta janë popuj islamë që duhet të ngrihen përkrah qeverive të tyre, për të prerë prej tyre duart e të huajve. Me keqardhje, disa qeveri, për të arritur fuqinë e pushtetit, veprojnë kundër interesave të tyre dhe kundër të interesave të popujve të tyre. Meqenëse duan të arrijnë forcën dhe pushtetin, ata qëndrojnë në anën e kriminelëve ndërkombëtarë për të ushtruar presion mbi qeveritë dhe popujt e përkushtuar. Këto janë fatkeqësitë që u ndodhin popujve islamë. Qeveritë dhe popujt e zgjuar, që e dinë se çfarë po u ndodh

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 218.

myslimanëve nga fatkeqësitë, duhet të qëndrojnë në anën e myslimanëve të përkushtuar dhe t'i zgjojnë popujt dhe qeveritë e tjera që të heqin dorë nga komplotet kundër nesh dhe të ndalojnë kundërshtimin e interesave të vendeve dhe popujve islamë, në mënyrë që të mund të presin duart e fuqive të mëdha nga vetvetja e tyre".[1]

"Problemi i qeverive dhe i popujve qëndron në faktin se të dyja palët e kanë humbur identitetin dhe funksionin e tyre. Qeveritë ende besojnë se duhet të sundojnë dhe se popujt duhet t'u binden me bindje të verbër. Për sa kohë që qeveritë tona luajnë rolin e xhelatit dhe i shtypin popujt e tyre, për të forcuar pushtetin dhe ndikimin e tyre, kjo çështje nuk do të zgjidhet. Dhe për sa kohë që kjo problematikë nuk zgjidhet, problemet tona themelore – që nga sundimi i Perëndimit mbi ne dhe mbi burimet tona – nuk do të marrin fund kurrë.

Qeveritë islame janë plotësisht të vetëdijshme për përmasat e ndikimeve negative që shkaktohen nga përçarjet e tyre, por, për shkak të disa qëllimeve të shtrembra, nga njëra anë dhe tradhtisë së disa palëve, nga ana tjetër, këto probleme do të vazhdojnë të rëndojnë mbi qenien tonë islame.

Deri kur do të vazhdojmë të vuajmë nga këto probleme dhe të jetojmë nën mëshirën e Lindjes dhe të Perëndimit? Kur do të zgjohen qeveritë islame? Kur do të rikthehet Islami, të bëhet model, që të ndiqet, në mënyrë që qeveritë të ndryshojnë sjelljen ndaj popujve të tyre? Deri kur qeveritë do të qëndrojnë të ndara popujt e tyre?"[2]

"Çështjes së qeverive islame duhet t'i shtohet gjithçka që u përmend. Shumë nga fatkeqësitë e myslimanëve burojnë nga vetë qeveritë

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 110.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 304-305.

islame. Qeveritë islame duhet të jenë një zë i vetëm dhe një mendim i vetëm; të gjitha i përkasin një feje dhe një libri të vetëm. Por dallimet mes tyre kanë bërë që të tjerët të përfitojnë prej tyre. Ata i njohin detyrat e tyre, por nuk përpiqen t'i zgjidhin problemet; përkundrazi, mosmarrëveshjet dhe përçarjet e tyre shtohen dita-ditës, duke e ditur se fuqitë e mëdha janë të bashkuara për të forcuar përçarjen dhe armiqësinë mes nesh, që ne të mbetemi gjithmonë të zënë me këto konflikte, ndërsa ata korrin frytet.

Myslimanët duhet të mendojnë për një zgjidhje rrënjësore për veten e tyre dhe qeveritë islame, gjithashtu, duhet të mendojnë për një zgjidhje rrënjësore për këto mosmarrëveshje, sepse ata që vrapojnë pas pushtetit dhe rehatisë, të cilat zgjasin vetëm pak ditë, duhet të mendojnë për shërimin e përçarjes që i ka goditur. Përndryshe, gjërat do të arrijnë në një fazë ku asnjë ilaç nuk do të bëjë dobi, dhe asnjë konferencë apo takim nuk do t'u sjellë përfitim myslimanëve.

I lutem Allahut të Madhëruar që t'i zgjojë myslimanët, veçanërisht qeveritë islame, që të mund të kapërcejnë problemet e tyre dhe ta mishërojnë Islamin e vërtetë që ekzistonte në fillimet e Islamit, në vendet e tyre. Po, një nga problemet me të cilat përballen myslimanët është problemi i qeverisë dhe popullit; qeveritë dhe popujt, siç e dimë, nuk kanë mirëkuptim me njëri-tjetrin; marrëdhënia mes tyre është si marrëdhënia e armiqve me njëri-tjetrin. Populli i kthen shpinën qeverisë dhe qeveria e fajëson popullin për mangësitë, dhe, për këtë arsye, popujt nuk u japin asnjë ndihmë qeverive të tyre; përkundrazi, i trajtojnë ato si armiq, gjë që çon në dobësimin e qeverisë".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 9, f. 39-40.

Islami autentik muhamedan

Sot bota është e etur për kulturën e Islamit autentik muhamedan. Myslimanët, përmes ngritjes së strukturave të mëdha islame, do të jenë në gjendje të shembin luksin e pallateve të bardha dhe të kuqe. Imam Khomeini hapi gjoksin e tij për të përballuar shigjetat e fatkeqësive dhe situatave të vështira, si dhe predhat dhe raketat e armiqve; ai i konsideronte ditët për të arritur martirizimin si ditë të ëmbla, sepse të gjithë janë dashamirë të dëshmisë (martirizimit).

Lufta jonë është luftë e besimit; ajo nuk njeh kufij gjeografikë. Në këtë luftë, ne duhet të përqendrojmë përpjekjet tona për mobilizimin e madh të ushtrisë së Islamit në mbarë botën. Populli i madh iranian, me mbështetjen e tij materiale dhe shpirtërore për Revolucionin, do të përballet, me vullnetin e Allahut, me vështirësitë e luftës për të shijuar ëmbëlsinë e fitores ndaj armiqve të Allahut në këtë botë. Çfarë është më e ëmbël se të shohësh popullin iranian duke rrëzuar shtyllat dhe themelet e regjimit mbretëror tiran dhe duke thyer xhamin e pranisë amerikane në këtë vend? Çfarë gëzimi më të lartë ka se kjo?

Populli ynë i dashur po çrrënjos rrënjët e hipokrizisë, oportunizmit dhe prirjeve nacionaliste; duke e ditur se ëmbëlsinë e përjetshme do ta arrijnë, me dëshirën e Allahut, në Botën Tjetër, jo vetëm ata, por edhe ata që i paraprinë në rrugën e dëshmisë (martirizimit) dhe sakrificës në frontet e luftës. Dhe jo vetëm ata, por edhe ata që mbështetën frontet përmes qëndrimeve të tyre fisnike dhe lutjeve të sinqerta, kanë arritur pozitën e

muxhahidëve të mëdhenj dhe kanë marrë shpërblim të madh; sepse arti ynë është art i muxhahidëve dhe është frymëzuar nga trashëgimia e Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!). Amerika duhet ta dijë se martirizimi në rrugën e Allahut nuk është diçka që mund të krahasohet me fitore apo humbje në fushën e betejës".[1]

Ata që janë të vetëdijshëm për dhimbjet e shoqërive islame dhe që kanë lidhur besën me të shtypurit dhe të varfrit, duhet ta kuptojnë se janë në fillim të rrugës së përpjekjes dhe se para tyre është një udhëtim i gjatë, për të thyer pengesat e kolonializmit dhe të shfrytëzimit, për të arritur te Islami autentik muhamedan. Për figura, si eruditi Arif el Hyseni, nuk ka pozitë më të lartë se ajo që nga mihrabi i adhurimit të së vërtetës të niset drejt Zotit me trup të përgjakur, duke thënë: **"Kthehu te Zoti yt…",**[2] *dhe të pijë kupën e dashur të martirizimit, që mijëra të etur për drejtësi të arrijnë te burimi i dritës.*

Dallimi i madh mes dijetarëve të përkushtuar të Islamit dhe atyre që vetëm shtiren si të tillë ,qëndron në këtë: dijetarët luftëtarë të Islamit kanë qenë gjithmonë shënjestër e shigjetave të fuqive arrogante; në çdo ngjarje, shigjetat e para synonin zemrat e tyre. Ndërsa dijetarët e zbukuruar dhe të lidhur pas kësaj bote kanë qenë gjithmonë nën mbrojtjen e skllevërve të arit; ata i nënshtrohen të pavërtetës, lavdërojnë tiranët dhe i mbrojnë ata".[3]

"Deri më sot, nuk kemi parë asnjë dijetar të oborrit apo klerik vehabi që të përballet me padrejtësinë, politeizmin dhe mohimin, veçanërisht kundër agresioneve të Bashkimi Sovjetik dhe ndaj Shteteve të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 82.
2 Sure "Fexhr", ajeti 28.
3 Pjesë nga fjalimi drejtur popullit pakistanez, me rastin e martirizimit të Sejid Arif el Hysenit.

Bashkuara, të cilat veprojnë si fuqi grabitqare në botë. Për shembull, nuk kemi parë asnjë dijetar të sinqertë fetar, i cili jeton për shërbimin dhe adhurimin e Allahut, që të heqë dorë edhe për një çast nga mbështetja e të shtypurve dhe që të mos luftojë me gjithë qenien e tij kundër mohimit dhe politeizmit për të realizuar qëllimet e tij.

Arif El Hyseni ishte një nga këta dijetarë të sinqertë. Padyshim, nëse popujt islamë do ta kuptonin plotësisht pse figura të shquara, si Morteza Motahari dhe Mohamad Beheshti, dijetarë të nderuar të fesë dhe dëshmorë të mihrabit në Iran; Sadri Najafi dhe Hakimi në Irak; Ragheb Harbi dhe Abdul Karim Obeidi në Liban; Arif El Hyseni në Pakistan, së bashku me dijetarët që janë të vetëdijshëm për vuajtjet e Islamit autentik muhamedan në të gjitha vendet, bëhen objekt i komploteve dhe atentateve, situata do të ishte krejt ndryshe".[1]

"Perëndimi dhe Lindja e dinë mirë sot se forca e vetme që mund t'u përballet dhe t'i nxjerrë nga skena, është Islami. Gjatë dhjetë viteve të kaluara të Revolucionit Islamik iranian, ata i kanë dhënë goditje të rënda Islamit dhe kanë vendosur ta shkatërrojnë Islamin, me çdo mjet të mundshëm, në Iran,në atdheun e Islamit autentik muhamedan.

Nëse armiqtë nuk arrijnë qëllimet e tyre përmes forcës ushtarake, ata përdorin përhapjen e kulturës së tyre të degjeneruar për ta bërë popullin të huaj ndaj Islamit dhe traditave të tij vendase. Kur kjo dështon, ata gjejnë rrugë të tjera: përdorin elementë të paguar, hipokritë dhe liberalë pa fe, të cilët veprojnë si "vrasës profesionistë", për të eliminuar dijetarët e fesë dhe të pafajshmit, si dhe për t'u infiltruar në institucionet e shtetit dhe në strukturat e tij. Këta të infiltruar shpesh mbrohen duke përdorur

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 111.

pretendime të rreme dhe parulla mashtruese për të justifikuar veprimet e tyre.

Unë kam deklaruar disa herë se nuk lidhem me asnjë person vetëm për shkak të emrit apo pozitës së tij; kriteri i miqësisë sime qëndron te drejtësia e rrugës që ndjek individi në mbrojtje të Islamit. Partia e Allahut ka parime të qëndrueshme në politikën e Republikës Islamike dhe duhet të mbrohemi nga hipokritët që presin kokat e të rinjve dhe të fëmijëve tanë në tryezën e iftarit. Gjithashtu, duhet të përballemi me ata që dokumentet e tyre zbulojnë bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara dhe aktivitetet e tyre spiunazhi.

Çdo dashuri për Allahun duhet të regjistrohet në histori. Ata që mbrojnë hipokritët dhe liberalët, nuk kanë vend mes popullit tonë të dashur, që ka dhënë dëshmorë. Nëse armiqtë dhe të mashtruarit e pavetëdijshëm bëhen vegla të të tjerëve dhe këmbëngulin në rrugën e tyre të gabuar, populli ynë do t'i largojë pa asnjë tolerancë".[1]

Imami (Allahu qoftë i kënaqur me të!), në vitin e fundit të jetës së tij fisnike, në vitin 1409 hixhri, i dërgoi një letër historike z. Gorbaçov, të cilën me të drejtë e konsideroi si dokument të rënies së njërit prej shtyllave të arrogancës botërore, Bashkimit Sovjetik, madje edhe para se të ndodhte rënia. Kjo letër shpjegon qartë dallimin midis Islamit autentik muhamedan dhe shkollave materialiste, si dhe "Islamit amerikan" dhe atyre që e ndjekin atë. E shoh të përshtatshme të përmend një pjesë të saj në këtë rast:

"Shkëlqesia Juaj, z. Mikhail Gorbachev, Kryetar i Presidiumit të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike,

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 297.

Me urimet më të mira për sukses dhe lumturi për Ju dhe popullin sovjetik.

Duke marrë parasysh besimin tuaj në udhëheqje, kjo më krijon ndjenjën se ndodheni në prag të një faze të re rishikimi dhe ndryshimi në analizat politike botërore, veçanërisht në lidhje me çështjet që prekin Bashkimi Sovjetik. Shpresoj që guximi dhe trimëria Juaj, në përballjen me realitetin, të bëhen pikënisje për ndryshimin e ekuilibrave që mbizotërojnë në botë. Për këtë arsye, e pashë të nevojshme të përmend disa çështje.

Megjithëse orientimet dhe vendimet Tuaja të reja mund të shërbejnë thjesht për të zgjidhur disa probleme partiake të kombit Tuaj, guximi për të rishikuar ide që për dekada kanë mbajtur bijtë revolucionarë të botës në pranga, meriton vlerësim dhe lavdërim.

Një nga çështjet kryesore që do të shënojë suksesin e përpjekjeve Tuaja, është rishikimi i politikës së bazuar në "luftën kundër Zotit" dhe përpjekjet për zhdukjen e fesë nga shoqëria; kjo, pa asnjë dyshim, i ka shkaktuar një goditje të rëndë identitetit të popullit sovjetik. Trajtimi realist i çështjeve botërore nuk mund të arrihet përveçse përmes këtij rruge.

Natyrisht, bota perëndimore mund t'Ju duket si një parajsë me kopshte të gjelbëruara, për shkak të qasjes së gabuar të liderëve të mëparshëm komunistë në fushën ekonomike; por e vërteta gjendet diku tjetër. Nëse në këtë fazë kërkoni zgjidhje ekonomike, duke u strehuar në qendrën e kapitalizmit perëndimor dhe duke u larguar nga ekonomia socialiste dhe komuniste, jo vetëm që nuk do t'i shëroni plagët e shoqërisë Suaj, por të tjerët do të plotësojnë boshllëqet Tuaja. Dijeni se komunizmi, edhe nëse sot është i ngecur në rrugë pa krye në qasjen ekonomike e shoqërore, nuk ndryshon faktin që bota perëndimore përballet me probleme të ngjashme, vetëm në forma të tjera.

Shkëlqesia Juaj, z. Gorbaçov,

Duhet të përballeni me të vërtetën: problemi kryesor i vendit Tuaj nuk qëndron te pronësia, ekonomia apo liria, por te mungesa e besimit të vërtetë në Zot. E njëjta problematikë e çoi Perëndimin në degjenerim dhe në rrugë pa krye. Problemi Juaj qëndron në luftën kundër Zotit, kundër besimit dhe kundër parimit të ekzistencës dhe krijimit.

Është e qartë se tani Marksizmi duhet të kërkohet vetëm në muzetë e historisë politike. Komunizmi nuk plotësoi asnjë nga nevojat reale të njerëzimit, sepse është një doktrinë materiale, dhe materializmi nuk mund ta shpëtojë njerëzimin nga kriza e mungesës së besimit në vlerat shpirtërore, një nga dhimbjet më të mëdha që vuajnë shoqëritë njerëzore si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim.

Shkëlqesia Juaj, z. Gorbaçov,

Mund të mos hiqni dorë plotësisht nga Marksizmi në disa aspekte teorike, por Ju e dini se realiteti është ndryshe. Udhëheqësi i Kinës i dha goditjen e parë komunizmit dhe Ju po i jepni goditjen e dytë, e cila pritet të jetë përfundimtare. Sot në botë pothuajse asgjë nuk mbetet me emrin "komunizëm".

Megjithatë, Ju këshilloj të veproni me kujdes, që, ndërsa rrëzoni muret e iluzioneve marksiste, të mos bini në burgun e Perëndimit dhe të 'djallit të madh.'"

"Shpresoj që të arrini nderin e vërtetë, duke kryer detyrën e rëndësishme të çlirimit nga idetë degjeneruese që kanë mbetur si pasojë e shtatëdhjetë viteve devijimi nën botën komuniste, duke i fshirë ato nga faqet e historisë dhe nga vendi juaj. Qeveritë e tjera aleate, që më parë ofronin mbështetje për hir të vendeve dhe popujve të tyre, sot nuk janë më

të gatshme të shpërdorojnë pasuritë e tyre dhe të sakrifikojnë popujt e tyre për të treguar pavlefshmërinë e komunizmit. Pasojat e mëdha të rënies së tij janë përhapur gjer në veshët e bijve të këtyre vendeve.

I nderuari z. Gorbaçov,

Kur u ngrit thirrja madhështore "Allahu Ekber" dhe dëshmia për mesazhin e Vulës së Profetëve (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nga minaret e disa xhamive të republikës suaj, pas shtatëdhjetë vitesh, shpërthyen lotët e mallëngjimit nga sytë e të gjithë mbështetësve të Islamit. Kjo më shtyn t'ju kujtoj për domosdoshmërinë e të menduarit dyfish: me dy lloje vizionesh: atë material dhe atë hyjnor, sepse materialistët besuan vetëm në shqisën e tyre, duke e marrë atë si kriter njohurie në perceptimin e tyre të botës materiale, dhe e konsideruan çdo gjë të padukshme e të paprekshme si të jashtëm për rrethin e dijes. Si pasojë, ata e quajtën botën e të fshehtës, ekzistencën e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar, shpalljen, profetësinë dhe ringjalljen, thjesht legjenda të sajuara.

I nderuari z. Gorbaçov,

Tani, pasi përmenda këto tema dhe hyrje, ju kërkoj që të studioni me saktësi dhe seriozitet mbi Islamin, jo sepse Islami dhe myslimanët kanë nevojë për ju, por për shkak të vlerave të larta dhe vizionit gjithëpërfshirës me të cilin ai karakterizohet, vizion i cili mund të shërbejë si mjet për shpëtimin e popujve dhe qetësinë e tyre, dhe për të gjetur zgjidhje për problemet kryesore nga të cilat vuan njerëzimi.

Me të vërtetë, vizioni serioz i Islamit mund t'ju shpëtojë dhe t'ju nxjerrë nga ngërçi i Afganistanit dhe nga ngërçet e tjera të ngjashme në

botë. Ne i konsiderojmë myslimanët në botë si myslimanë të vendit tonë; e shohim veten si partnerë të përhershëm në fatin e tyre. Ju, përmes lejimit deri në një farë mase të kryerjes së riteve fetare në disa republika sovjetike, dëshmuat se nuk besoni më se feja është "opium i popujve".

Vërtet! A është vallë feja që e bëri Iranin të qëndrojë përballë fuqive të mëdha si një mal madhështor, opium i shoqërisë? A është vallë feja që thërret për zbatimin e drejtësisë në botë dhe kërkon çlirimin e njeriut nga prangat materiale e shpirtërore, opium i shoqërisë?

Po, feja që shndërrohet në një mjet për të vënë pasuri materiale dhe shpirtërore në shërbim të vendeve islame dhe joislame, nën sjelljen e fuqive të mëdha dhe arrogante, dhe që shpall hapur para masave se feja nuk ka të bëjë me politikën, është vërtet opium i popujve. Mirëpo, një fe e tillë nuk është më një fe e vërtetë, por është ajo që populli ynë e quan "feja amerikane".

***Në përfundim**, e them me sinqeritet: Republika Islamike e Iranit, si baza më e madhe dhe më e fortë për botën islame, ka mundësi dhe lehtësi të plotë për të mbushur boshllëkun ideologjik të sistemit tuaj. Dhe, sido që të jetë, vendi ynë beson si më parë në parimin e fqinjësisë së mirë, marrëdhënieve të barabarta dhe respektimin e paqes për ata që ndjekin udhëzimin.*

E mbyllim këtë paragraf me fjalët e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!):

"Mbroni Islamin e të varfërve, Islamin e të zbathurve, me fjalë dhe me vepra, Islamin e të shtypurve, Islamin e të torturuarve përgjatë historisë, Islamin e dijetarëve mistikë e sakrifikues, Islamin e dijetarëve me prejardhje të pastër, Islamin e arifëve dhe luftëtarëve. Populli do të votojë

për mbrojtësit e Islamit dhe do t'i dëbojë të gjithë ata që mbrojnë Islamin kapitalist, Islamin e arrogantëve, Islamin e luksit, Islamin e hipokritëve, Islamin e oportunistëve dhe thirrësve të dembelisë, në një fjalë të vetme: Islami amerikan dhe t'i zbulojë ata".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 16.

Qeveria islame

"Islami nuk është si qeveritë e tjera dhe dallimi mes tij dhe tyre është se ai është i drejtë, ndërsa ato jo. Ky është një nga ndryshimet thelbësore mes qeverisë islame dhe sistemeve të tjera. Dallimet janë të shumta: një prej tyre është se qeveria islame është qeveri e drejtë.

Cilat janë cilësitë e sundimtarit? Cilat janë cilësitë e policisë? Cilat janë cilësitë e ushtrisë? Dhe cilat janë cilësitë që duhet të dallojnë punonjësit e tjerë të qeverisë? Këto janë dallime, të cilat, në thelb, janë të dukshme dhe minimale, por përmbajnë gjëra që e ngrenë njeriun nga materiali në shpirtëroren. Islami erdhi për t'i dhënë përparësi shpirtit mbi materien dhe për të zbutur egërsinë e saj.

Kur thuhet se Islami i jep rëndësi materies, kjo është e vërtetë, por jo sepse ai mbetet tek ajo. Përkundrazi, Islami synon një zhvillim më të lartë dhe përpiqet ta arrijë atë. Prandaj, qeveritë islame, në kulmin e qytetërimit, kanë treguar veten se përqendrohen te vlerat më të larta. Por ky nuk është ai qytetërim që mbizotëron sot në vendet e zhvilluara, që shikon vetëm materien. Islami e pranon qytetërimin në shkallën e tij më të lartë dhe përpiqet ta arrijë atë të plotë dhe përpiqet ta realizojë atë. Kjo është arsyeja pse qeverisjet islame janë të mbushura me të gjitha llojet e qytetërimeve, por ndryshe nga vendet e qytetëruara sot. Islami e pranon plotësisht qytetërimin dhe përpiqet në sigurimin e tij. Në kohën që këto vende mendojnë vetëm materialen, Islami mendon të tërheqë drejt anës shpirtërore, udhëzimit dhe monoteizmit. Nga kjo anë shfaqet dallimi mes Islamit dhe të tjerëve, mes qeverisë islame dhe qeverive joislame. Ato gjëra që solli Islami dhe ato që sollën fetë e tjera, janë të ndryshme. Shumë nga

fetë e tjera të mangëta, e paraqitën veten sikur janë të plota, por kufijtë e tyre janë të kufizuar. Ndërsa Islami ka një vizion gjithëpërfshirës. Materien, Islami e shikon në kuptimin e saj të ulët dhe bota e qortuar është ajo që profetët e kanë quajtur "dynja", një botë e pavlerë dhe e poshtër, dhe "esfelu's-sāfilīn" (më e ulëta e të poshtërve) siç përmendet në Kur'an. Pra, fjala "dynja" tregon pavlefshmërinë, ndërsa ajo që Islami kërkon, është të arrihet qëllimi më i lartë, "il lijjin."[1]

"Ne shpresojmë të arrijmë të themelojmë një qeveri të drejtë islame. Lutuni që Allahu i Lartësuar të na japë sukses në këtë rrugë. Dhe atëherë bota do ta kuptojë se çfarë do të thotë qeveri islame, pasi tani për tani, thelbi i saj është i panjohur. Ata nuk e dinë ende se si do të ishte vendosja e një qeverie islame. Ata mendojnë se, nëse Islami do të vinte, gratë do të izoloheshin në dhoma dhe do të mbylleshin pas dyerve!. Këto nuk janë gjë tjetër veçse propagandë e shtrembëruar.

Dy ditë më parë, erdhën disa hebrenj këtu. Atyre u kishin thënë se, nëse ky revolucion do të ketë sukses dhe do të themelohet qeveria islame, ajo do t'i shkatërrojë hebrenjtë! Unë iu përgjigja: "Mirë, ja revolucioni ka triumfuar, a ju ka ndodhur juve diçka? A ju ka prekur ndonjë dëm?" Ata thjesht duan t'ju shqetësojnë me këto fjalë dhe me këtë zhurmë, në mënyrë që lëvizja revolucionare të mos arrijë frytet e saj dhe qeveria islame të mos realizohet, sepse, nëse themelohet qeveria islame, atëherë dora e të huajve do të ndërpritet nga vendet islame dhe nuk do të jetë më e mundur për njerëz si Reza Pahlavi që të sundojë e të udhëheqë pas kësaj. Vërtet, ata dëshirojnë që të tillë persona të qëndrojnë, që të bëjnë çfarë të dëshirojnë. Këta njerëz duan të mbeten të ngjashmit e tyre, deri sa t'u jepet mundësia të bëjnë çfarë të duan. Por kjo qeveri do të realizohet, me vullnetin e Allahut dhe njerëzit do të shijojnë frytin e saj, njësoj siç shijuan njerëzit

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 315.

qeverinë islame, që u realizua në fillim të Islamit, për një periudhë të shkurtër. Njerëzit do ta njohin të vërtetën e qeverisjes islame".[1]

"Dhe do të fitoni...Nëse do Allahu, do të ngrihet një qeveri e drejtë islame, hap pas hapi; nëse do Allahu, njerëzit dhe bota do ta kuptojnë kuptimin e Islamit dhe kuptimin e qeverisë. A është qeveria ajo që ka ekzistuar deri tani? Do ta kuptojmë pas largimit të sundimtarit tiran se çfarë mori me vete nga thesaret, çfarë vodhi dhe çfarë depozitoi në banka. Ata grabitën pasuritë e popullit dhe u larguan. A mund të quhet kjo qeveri e vërtetë, apo është një qeveri ku, nëse sundimtari dëshiron të hajë ushqimin e tij, ai ushqim nuk është gjë tjetër veçse bukë e thatë me pak kripë? Në mëngjesin e asaj nate, kur u martirizua Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ai solli ushqim të thjeshtë, qumësht, kripë dhe bukë. Kur pa bukën që ishte e fortë dhe e thatë, që nuk mund të hahej lehtë, tha: "Sillni bukën e 'sankakut' që hani ju." Tregohet se ka thënë: "Kur më shihni të ha dy lloje ushqimi në një ditë, atëherë më qortoni!" Pastaj ai i betoi ata që të largonin qumështin dhe mbeti vetëm me bukë dhe kripë. E hëngri atë dhe në mëngjesin e ditës tjetër u martirizua. A është ky lloj qeverisjeje më i mirë, apo janë qeveritë tiranike të së kaluarës? Apo qeveria e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishte më e drejtë, ku ai, kur ulej me shokët e tij në xhami, vinte ndonjëri dhe pyeste: "Cili nga ju është i Dërguari i Allahut?" A janë ndoshta këto nderime dhe privilegje që e bëjnë të gjithë të mendojnë se sundimtari ekziston vetëm për t'i shijuar ato?

Kjo është qeveria e Islamit. Sigurisht, ne nuk mund të ngremë një qeveri të tillë sipas mundësive tona të kufizuara, por mund të afrohemi disi me këtë metodë të qeverisjes. Mund të presim duart e hajdutëve dhe falë Zotit, janë prerë duart e shumë të mëdhenjve që grabitën pasuritë dhe i

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 235.

depozituan në banka. Ne shpresojmë të arrijmë të vendosim dorë mbi ato pasuri dhe të mund t'i konfiskojmë ato, për t'ua marrë hajdutëve që i vodhën dhe i rrëmbyen".[1]

"Qeveria e Republikës Islame duhet të bëjë çmos për të përmbushur nevojat e popullit në mënyrën më të mirë të mundshme. Megjithatë, kjo nuk duhet të nënkuptojë neglizhimin e objektivave madhore të revolucionit të madh, të cilat përfaqësohen me themelimin e një qeverie islame botërore.

Populli i dashur iranian, i cili përfaqëson, me të drejtë, fytyrën e lavdishme të historisë së madhështisë islame në kohën tonë, duhet të përballet me vështirësitë dhe sakrificat, për hir të Allahut të Madhëruar. Kjo bëhet që udhëheqësve të lartë dhe përgjegjësve të mëdhenj t'u mundësohet përmbushja e detyrës së tyre kryesore: përhapja e Islamit në botë. Unë i ftoj ata që të mbajnë parasysh parimin e vëllazërisë dhe të sinqeritetit, gjithmonë brenda kornizës së interesit të Islamit dhe të myslimanëve".[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 6, f. 259-260.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 297.

E ardhmja e umetit islam

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) nuk dyshoi asnjë çast në rrugën e tij të luftës, të revolucionit dhe të themelimit të Republikës Islamike në Iran, se e ardhmja i përket Islamit të vërtetë. Ai besonte se krijimi i një qeverie të drejtë islame do të sillte përhapjen e Islamit në të gjithë botën islame dhe mbizotërimin e të vërtetës, drejtësisë, sigurisë, nderit dhe dinjitetit për umetin dhe të shtypurit.

Ai e konsideronte themelimin e qeverisë islame në Iran një hap të rëndësishëm drejt këtij qëllimi të madh, duke rritur vetëdijesimin e qeverive dhe popujve islamë mbi realitetet e Islamit të vërtetë dhe mbi nevojën për unitet, bashkëpunim dhe harmonizim mes të gjithë popujve dhe qeverive islame, pa dallim shkollash, racash apo vendndodhjesh gjeografike. Synimi i tij ishte krijimi i një shteti islam të vetëm, me qeveri dhe rajone të lira e të pavarura.

Në një prej fjalimeve të tij, në prag të përfundimit të mijëvjeçarit të katërt të hixhretit të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe fillimit të mijëvjeçarit të pestë, ai tha:

"Në prag të përfundimit të mijëvjeçarit të katërt të hixhretit të Profetit të fundit (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), të bekuarit, që përkon me pararojën e ringjalljes islame revolucionare, dhe nën udhëzimin e Kur'anit famëlartë dhe udhëheqjen e

ndërtuesve të umetit, i takon qeverisë dhe popullit të kontribuojë në organizimin e programeve të revolucionit, për të festuar këtë ngjarje të shenjtë.

Është e vërtetë që shekulli i kaluar ka qenë i mbushur me fatkeqësi për popullin tonë, për Islamin dhe për vendin tonë. Por revolucioni islamik iranian, i cili u shfaq në vitet e fundit të këtij shekulli, do të ndryshojë fatin e umetit islam në shekullin e ardhshëm. Shpresa e madhe është që popujt e shtypur, veçanërisht vendet islame, të vazhdojnë luftën e tyre nën flamurin e unitetit, për pavarësi dhe liri, duke shpëtuar veten nga kthetrat e perëndimit komplotues dhe nga intrigat e lindjes, dhe që ky shekull të bëhet një shekull i dritës për të gjitha vendet islame.

Kërkoj nga Allahu i Lartësuar madhështinë e Islamit dhe të myslimanëve".[1]

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka theksuar domosdoshmërinë që umeti islam dhe qeveritë e tij të kapërcenin dy pengesa themelore për një të ardhme të ndritur dhe të lavdishme:

"Sipas mendimit tim, themeli i problemeve në vendet islame qëndron në dy çështje kryesore. E para është marrëdhënia midis qeverive dhe popujve të tyre. Shumë qeveri janë të shkëputura dhe të largëta nga populli; qeveria nuk e sheh veten pjesë të popullit dhe populli nuk e ndien veten pjesë të qeverisë. Zgjidhja e kësaj çështjeje varet nga vetë qeveritë. Nëse ato do të ndienin se janë në shërbim të popullit, populli do të bashkëpunonte plotësisht me to.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 265.

Shikoni gjendjen në vendin tonë: megjithëse ende nuk kemi arritur të zbatojmë Islamin në mënyrën e duhur, ajo që ekziston sot, është thjesht një fllad i lehtë i Islamit. E megjithatë, ky fllad i lehtë ka mjaftuar që populli ynë të mos ndahet nga qeveria apo ushtria. Sot, nëse qeveria apo ushtria përballen me ndonjë problem, populli menjëherë i del në ndihmë, me gjithë forcën e tij, për ta përballuar dhe për ta larguar atë. Ky është sekreti i fitores sonë kundër fuqive të mëdha.

Problemi i dytë, po aq thelbësor, që godet vendet dhe popujt islamikë, qëndron në mosmarrëveshjet dhe përçarjet midis vetë shteteve islame. Ndërkohë që Islami thërret për unitet dhe Kur'ani i shenjtë i konsideron myslimanët vëllezër, ne shohim se shtetet islame jetojnë në përçarje dhe mosmarrëveshje mes tyre. Pse ndodh kjo? A nuk i përkasin të dy qeveritë Islamit? A nuk besojnë sinqerisht në një Zot, një Kur'an dhe një Profet? Si mund të mos e pranojnë thirrjen e Islamit, e cila i thërret në dobi të tyre dhe në interesin e umetit? Sikur shtetet islame t'i përgjigjeshin kësaj thirrjeje dhe të bashkoheshin, edhe pse kufijtë e tyre do të mbeteshin të pandryshuar, myslimanët, që janë më shumë se një miliard, do të bëheshin forca më e madhe në botë, përveç fuqisë së besimit, i cili është mbi çdo armatim.

Këto dy probleme, të cilave iu referova në mënyrë të përgjithshme, përbëjnë bazën e të gjitha vuajtjeve të myslimanëve. Nëse ato zgjidhen dhe gjenden rrugë për problemet e myslimanëve, lavdia e tyre e dikurshme nga Islami do t'u rikthehet. Por nëse myslimanët (Allahu mos e dhëntë!) mbeten të ndarë nga qeveritë e tyre dhe të përçarë mes vetes, atëherë nuk ka shpresë që të rikthejmë lavdinë tonë të kaluar dhe shkëlqimin e Islamit".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 256-257.

Uniteti islam

Rreth kushteve të tjera për të arritur krenarinë e umetit, që janë uniteti, bashkimi dhe bashkëpunimi, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë:

"Unë gjithmonë, në fjalimet dhe shkrimet e mia, kam theksuar dy çështje kryesore. E para është se në Islam nuk ka vend për dallime racore, fanatizëm apo gjuhë të ndryshme. Islami është për të gjithë dhe për dobinë e të gjithëve. Ne jemi vëllezër, sipas gjykimit të Kur'anit dhe të Islamit. Kurdët, turqit, baluçët – të gjithë janë vëllezër dhe duhet të jetojmë së bashku si vëllezër.

Ne e kemi përzënë armikun nga vendi ynë. Këta kriminelë të vendosur ose kanë ikur dhe janë fshehur në vrimat e tyre, ose janë kthyer tek të huajt që dikur na grabisnin pasuritë. Ata nuk do të jenë në gjendje të kthehen sërish kaq lehtë. Me ndihmën e Allahut, ne nuk do t'i lejojmë.

Ajo që dua të theksoj, është se vëllezërit suni nuk duhet të mendojnë se në Islam ka ndarje midis nesh dhe tyre. Ashtu si katër medh'hebe suni janë të gjithë vëllezër me njëri-tjetrin, ashtu edhe ne nuk përbëjmë medh'hebin e pestë. Nuk ka armiqësi mes nesh; të gjithë jemi vëllezër dhe myslimanë. Të gjithë jemi ndjekës të Kur'anit dhe të Dërguarit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Për sa i përket përhapjes së përçarjes, këtu e atje, kjo bëhet nga elementet e kalbura që kanë mbetur nga regjimi i kaluar, ose nga të huajt

dhe agjentët e tyre, të cilët ndezin përçarje për interesat e tyre. O vëllezër, kini kujdes ndaj kësaj çështjeje! Ata përpiqen t'ju mashtrojnë, të pengojnë Islamin, që të kryejë rolin e tij dhe duan të nxisin armiqësi midis kurdëve, persëve dhe të tjerëve. Por ata nuk janë kundër nesh personalisht; ata janë kundër Islamit.

Është detyra e myslimanëve, që të qëndrojnë të gjithë së bashku përballë tyre dhe të shkatërrojnë planet e tyre".[1]

"Prej shumë devijimeve që armiqtë e Islamit kanë shpikur për të mbjellë përçarje ndërmjet grupeve të ndryshme të myslimanëve, si dallimi mes sunive dhe shi'itëve, lindin keqkuptime dhe konflikte. Natyrisht, ka ndryshime në shumë çështje të besimit, por marrëdhëniet mes tyre duhet të mbeten të shëndosha, sepse secili është i lirë në bindjet e veta. Megjithatë, nuk duhet të lejojmë që këto dallime të na pengojnë në detyrën tonë kryesore: dëbimin e Amerikës nga vendi ynë dhe luftimin e atyre që përdhosin Islamin, myslimanët dhe qeverinë islame.

Një prej dijetarëve oborrtarë dhe të rremë ka shkruar një libër nxitës për përçarje dhe e ka botuar në Mekë. Nuk di si mendojnë këta njerëz; nuk ka shpjegim tjetër përveç faktit se ata janë agjentë të Amerikës ose të disa vendeve të tjera, të cilët detyrohen të bëjnë veprime që nxisin përçarje. Ka gjithashtu shpërndarje mes nesh – ky shi'it, ky sufi, ky lajmëtar i rremë – gjëra që në thelb nuk prekin bindjet tona. Këto janë përçarje të krijuara nga jashtë.

Pse të lejojmë që këto çështje të na ndajnë? Pse të nxisim konflikte që nuk kanë të bëjnë me ne të gjithë? Këto përçarje janë në fakt një lloj

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 9, f. 285.

edukimi i imponuar nga konspiratorët, që na shoqëron nga fëmijëria deri në rininë e hershme, dhe pastaj edhe më tej".[1]

"Sundimtarët e myslimanëve, mbretërit dhe udhëheqësit e tyre mbajnë sot përgjegjësinë për të kapërcyer mosmarrëveshjet e vogla që ndodhin ndonjëherë mes tyre. Në Islam nuk ka arab, joarab, turk apo pers; është vetëm fjala e Islamit. Ata duhet të ndjekin metodën e të Dërguarit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në xhihad për hir të Allahut, të praktikojnë Islamin dhe të arrijnë unitetin e fjalës së tyre, duke kapërcyer dallimet dytësore dhe duke u bashkuar si një dorë e vetme.

Atëherë ata do të jenë të fortë dhe me ndikim të madh. Përndryshe, edhe pse numri i myslimanëve i afrohet shtatëqind milionë, ky numër i shpërndarë nuk ka ndikim të barabartë me një milion të bashkuar. Shtatëqind milionë njerëz të shpërndarë nuk përfitojnë asgjë; edhe sikur të arrinin në miliarda, ata nuk do të kishin dobi për sa kohë që mbeten të përçarë.

Ndërsa, nëse njëqind milionë ose katërqind milionë nga këta shtatëqind milionë do të bashkoheshin në vëllazëri me njëri-tjetrin, duke respektuar kufijtë dhe territoret e tyre, atëherë do të kishte ndryshim. Nëse do të bashkoheshin në konceptin e umetit islam të vetëm dhe në një fjalë të përbashkët për unitetin dhe interesat islame, duke unifikuar fjalën e tyre, nuk do të kishte lakmi nga hebrenjtë për Palestinën, dhe as lakmi të hinduve për Kashmirin".[2]

"Me të vërtetë, përçarja mes ndjekësve të dy palëve dhe shkollave të ndryshme të Islamit ka rrënjët e saj që nga fillimi i Islamit. Aso kohe,

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 20, f. 101.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 32.

kalifët emevitë dhe më pas abasidët, përpiqeshin të krijonin ndarje dhe përçarje, duke mbajtur kuvende dhe takime për ta forcuar dhe për ta përhapur këtë ndarje. Gradualisht, kjo çoi në rivalitet mes masave të sunive dhe masave të shi'itëve. Në të vërtetë, as njerëzit e thjeshtë suni dhe as ata shi'itë nuk vepronin plotësisht sipas Sunetit të të Dërguarit të Allahut, as sipas udhëheqjes së Imamëve të pastër.

Imamët tanë të pastër përpiqeshin të mbanin të gjithë myslimanët brenda kuadrit të një shoqërie të bashkuar: ata faleshin së bashku, bashkoheshin dhe merrnin pjesë në funeralet e njëri-tjetrit. Por gradualisht situata ndryshoi dhe tiranët përdorën akte të caktuara për të ndezur përçarje mes dy palëve, duke i shtyrë kundër njëri-tjetrit, për të vepruar sipas interesave të tyre.

Rreth treqind vjet më parë, u zbatuan politika të huaja në Iran dhe në Lindje, të cilat synonin të arrinin rezultate të tilla. Ekspertët e tyre studiuan dy sekte dhe disa personalitete, psikologjinë e njerëzve dhe aspektet materiale që lidhen me ne, duke u përpjekur të na shfrytëzonin në dy mënyra: materialisht – siç shihet edhe sot – dhe psikologjikisht, duke zgjeruar hendekun e përçarjes mes nesh. Për shembull, nëse dikush ngrihet me një fjalë të vetme, ata e transformojnë atë në një zjarr të madh dijesh, e botojnë dhe e shpërndajnë. Kjo nuk është thjesht puna e një individi të zakonshëm; janë qeveritë dhe të huajt që përpiqen ta përhapin dhe të zgjerojnë ndikimin e saj.

Ne jemi një trup i vetëm, i pandashëm dhe dallimet mes dy shkollave të mendimit (suni dhe shi'ia) nuk duhet të shndërrohen në përçarje mbi bazat e Islamit. Ne shohim rreziqe që kërcënojnë Islamin, prandaj të gjithë duhet të bashkohemi, të shmangim dyshimet dhe përçarjet

e së kaluarës dhe të qëndrojmë të bashkuar përballë atyre që përpiqen të na ndajnë".[1]

"Islami erdhi për të bashkuar të gjitha kombet në këtë botë – arabët, turqit, persët… – që me unitetin dhe solidaritetin e tyre të formojnë një umet të fortë, të madh dhe të fuqishëm. Një umet i tillë islam, i fuqishëm dhe i bashkuar, vendos një pengesë serioze ndaj lakmive të fuqive të mëdha që kërkojnë të dominojnë vendet islame dhe të marrin pasuritë e tyre.

Plani më i madh i fuqive të mëdha dhe i agjentëve të tyre në vendet islame është të mbjellin përçarje dhe armiqësi mes myslimanëve. Allahu i Madhëruar i ka qortuar ata në Librin e Tij të shenjtë me fjalët: **"Vërtet, besimtarët janë vëllezër".**[2]

"Ndërsa këta duan të ndajnë myslimanët në kombe të ndryshme: umeti arab, umeti kurd, umeti pers, umeti turk… që të copëtojnë umetin islam dhe të mbjellin armiqësi mes myslimanëve. Kjo është krejtësisht në kundërshtim me rrugën islame dhe Kur'anin që thërret në vëllazëri dhe barazi, në bashkim dhe në unifikimin e radhëve nën flamurin e Islamit dhe nën flamurin e teuhidit".[3]

"Shpresoj që të mbizotërojë vëllazëria islame midis shteteve islame, vëllazëria që e ka lartësuar Kur'ani, sepse, nëse këto shtete do të udhëhiqeshin nga kjo vëllazëri, do të bëheshin një forcë e madhe, të cilën asnjë nga fuqitë e mëdha nuk do të mund ta ndalte".[4]

"Çohuni ju, o të shtypurit e botës dhe ju o shtete islame dhe myslimanë në mbarë botën! Merrni të drejtat tuaja me duart dhe dhëmbët

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 6, f. 80-81.
2 Sure "Huxhurat", ajeti 10.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 13, f. 348
4 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 77.

tuaj, dhe mos ju trembë zhurma mediatike e fuqive të mëdha dhe shërbëtorëve të tyre skllevër. Dëboni sundimtarët tradhtarë nga vendet tuaja, sepse ata ua dorëzojnë mundin dhe frytet e mundimeve tuaja armiqve tuaj dhe armiqve të Islamit.

Nxitoni ju, veçanërisht ju të sinqertët dhe të përkushtuarit, për të marrë përsipër detyrat dhe për t'u ngritur së bashku nën flamurin e madhështor të Islamit, për të qëndruar përballë armiqve të Islamit, duke mbrojtur të privuarit në botë.

Vazhdoni përpara, për të themeluar një shtet të bashkuar islamik, që do të përfshijë republika të lira e të pavarura nën flamurin e saj. Me këtë, ju do të vendosni në vend të gjithë arrogantët në botë, do të përmbushni drejtimin e të shtypurve dhe do të bëheni trashëgimtarët e tokës. Ndoshta Allahu i Madhëruar do ta shpejtojë atë çështje, të cilën Ai na e ka premtuar".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 394, nga testament politik i imam Khomeinit.

Përfundimi i studimit

Të vërtetat e fesë islame nuk janë njohur nga shumica e myslimanëve dhe e botës në shumicën e epokave, për shkak të padrejtësisë së tiranëve dhe sundimtarëve despotë. Këto të vërteta, nëse do të zbatoheshin si duhet, do ta bënin njeriun të lumtur si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

Modeli më i përsosur i qeverisjes islame ishte qeveria e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe, pas tij, qeveria e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Por për shkak të komplotit dhe injorancës, këto dy qeveri nuk arritën të realizonin plotësisht objektivat e tyre politike dhe hyjnore.

Historia islame ka qenë e mbushur me pengesa, për zbatimin e një qeverie të tillë të drejtë, dhe mbi këto pengesa kanë qëndruar sundimtarë dhe qeveri islame që sunduan në emër të fesë, por ishin materialistë, të cilët shfrytëzonin Islamin dhe myslimanët për interesat e tyre personale.

Në kohën tonë bashkëkohore, kolonializmi perëndimor dhe lindor, së bashku me ndihmësit e tyre, përfunduan atë që kishin filluar këta sundimtarë, duke marrë në dorë fatin e umetit islam përmes kontrollit mbi qeveritë islame ekzistuese dhe përmes themelimit të principatave dhe mbretërive, siç është Mbretëria Al

Saud, si dhe përmes doktrinave të korruptuara, si Vehabizmi, me qëllim shkatërrimin e Islamit dhe të umetit islam.

Me fitoren e revolucionit islamik në Iran, nën udhëheqjen e Imam Ruhullah Musauvij Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), u shfaq kuptimi i pastër i Islamit të vërtetë, i dalluar qartë nga Islami amerikan dhe Vehabizmi. U mishëruan tiparet e qeverisjes islame të drejtë, dhe përvoja e unitetit islamik u shndërrua në një premtim për një të ardhme të ndritur për umetin islam, me lejen e Allahut të Lartësuar.

KAPITULLI I TRETË

SHI'IZMI, MEDH'HEBI MBROJTËS

- Hyrje
- Shkolla e Shi'izmit
- Imam Aliu dhe bijtë e tij janw rojet e Islamit
- Shi'izmi, medh'hebi mbrojtës
- Dijetarët shi'itë, mbrojtës të fesë dhe të umetit
- Jurisprudenca shi'ite dhe vazhdimësia e Islamit
- Udhëheqja e dijetarit, siguri dhe udhëzim
- Shi'izmi, pararendës i unitetit islam
- Shteti islam dhe mbrojtja e Islamit
- Përfundimi i studimit

Hyrje

Nuk ishte e fshehtë për të Dërguarin e Islamit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) rrjedha e ligjit hyjnor universal në umetin e tij. Hadithet profetike që janë përcjellë shumë dhe në mënyrë të vazhdueshme nga të gjitha medh'hebet, tregojnë qartë se Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) kishte frikë për devijimin e umetit të tij nga rruga e drejtë, pas largimit të tij, e cila ishte përgatitur që ta ndiqte dhe të mos shmangej prej saj. Ai ia tërhoqi vërejtjen umetit për ato rreziqe që mund të kërcënonin thelbin e mesazhit.

Ishte krejtësisht e natyrshme që themeluesi i fesë islame të merrte masa paraprake përballë këtyre rreziqeve, duke caktuar piketat e nevojshme për mbrojtjen e fesë dhe ruajtjen e mesazhit. Kjo u vërtetua në realitet. Profeti besnik e dinte se epshet dhe duart e politikës do të bënin ndarje në mesin e umetit të tij dhe do ta shtrembëronin pamjen e Islamit, duke devijuar besimet dhe dispozitat e tij. Ai, që nga dita e parë e thirrjes islame në fazën e saj mekase, punoi për të ngritur një bërthamë të fortë, përmes familjes së tij dhe shokëve të tij besnikë, dhe i ngarkoi asaj bërthame ruajtjen dhe mbrojtjen e fesë përballë stuhive dhe sprovave që sjell koha. I Dërguari madhështor (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) themeloi atë që sot do ta quanim "partia në pushtet" ose "roja e revolucionit", ose "forcat e ruajtjes së rendit". Këta janë zakonisht më besnikët ndaj qendrës së pushtetit dhe vendimmarrjes, ata që mbrojnë atë në kohë krize dhe fatkeqësish.

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë shin mbi të dhe mbi familjen e tij!) këtë mision të rojës së Islamit ua besoi njerëzve më të afërt dhe më të pastër në lidhjen e tyre me Zotin, që ta udhëhiqnin me përkushtim këtë detyrë të vështirë e të rrezikshme. Ky ishte kushëriri i tij dhe ai që u rrit në shtëpinë e tij, Imam Ali ibn ebu Talibi (Paqja qoftë mbi të!), i cili ishte ndër të parët që pranoi Islamin dhe më i dalluari ndër të gjithë për nga besimi. Sipas teksteve kur'anore dhe haditheve të shumta, kjo detyrë nuk ishte vetëm një ngarkesë nga Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë shin mbi të dhe mbi familjen e tij!), por një detyrë e urdhëruar nga Allahu i Madhëruar. Dhe kjo detyrë përfshinte edhe imamët nga pasardhësit e Aliut (Paqja qoftë mbi të!), duke filluar me dy nipërit e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë shin mbi të dhe mbi familjen e tij!), Hasani dhe Hyseni (Paqja qoftë mbi ta!), dhe nënën e tyre Fatimen, zonjën e grave të botëve (Paqja qoftë mbi të!), si dhe të pastruarit nga pasardhësit e tyre, të cilët janë pasardhës të posaçëm të të Dërguarit të Allahut Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Nëse do të shqyrtonim detajet e historisë islame që nga lindja e Islamit e deri më sot, do të gjenim se Aliu (Paqja qoftë mbi të!) dhe imamët nga pasardhësit e tij, si dhe ndjekësit e tyre të sinqertë, mbrojtësit e devotshëm dhe të përkushtuarit, nuk u ndalën asnjëherë nga ruajtja e fesë dhe mbrojtja e saj nga çdo shtrembërim dhe devijim.

Të gjithë këta të mëdhenj kanë dhënë gjakun e tyre, shpirtrat e tyre dhe pasuritë e tyre në rrugën e Allahut dhe në mbrojtjen e fesë. Të gjithë ata janë flijuar në fushën e xhihadit dhe luftës ndaj armiqve. Që kur Aliu fjeti në shtratin e Profetit Muhamed (Paqja e

bekimi i Allahut qoftë shin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në natën e hixhretit, deri te dëshmorët e Kerbelasë, të gjithë u flijuan për Islamin dhe për mbrojtjen e tij.

Në këtë rrugë kanë rënë martirë dhjetëra mijëra ndjekës të pastër, duke filluar te martirizimi i Aliut në mihrabin e martirizimit e të adhurimit, e më pas helmimi i Imam Hasanit, flijim për unitetin islam, e deri te martirizimi i Hysenit, së bashku me një karvan të madh nga gjeneza e pastër. Ata bënë sakrifica të mëdha, duke vërtetuar, me gjakun dhe mundin e tyre, vijimin e rrugës islame. Dhe kjo vijoi edhe në kohën tonë, në të cilën shpërtheu Revolucioni Islamik, përmes dorës së Imam Ruhullah El Musavi El Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), në kohën e Hizbullahut, (Partia e Allahut), ruajtësi dhe mbrojtësi i Islamit, të cilët dhanë shpirtin e tyre për rikthimin e Islamit origjinal, ashtu siç e dëshironte i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoti mbi të dhe mbi familjen e tij!). Rojet e Islamit dëshmojnë efekshmërinë e shpikjes hyjnore profetike me themelimin e medh'hebit mbrojtës.

Të qenit shi'it i Aliut, që është të qenit shi'it i Islamit dhe Muhamedit, nuk do të thotë ndjekje e një medh'hebi, sekti apo grupimi të veçantë, por është mbrojtje e Islamit origjinal, Islamit të pastër të Muhamed ibn Abdullahut. Ky shi'izëm nuk u themelua për të shfuqizuar medh'hebet e tjera islame, por u themelua për ruajtjen e të gjitha medh'hebeve nëpërmjet ruajtjes së Islamit dhe thelbit të tij, për ruajtjen e feve monoteiste dhe për ruajtjen e robëve të Allahut në këtë tokë.

Kështu e kuptonte edhe Imami Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) Shi'izmin, dhe kështu punoi përmes tij për të

forcuar lavdinë e umetit islam dhe për të mbrojtur të shtypurit në botë.

Shkolla e Shi'izmit

"Shi'izmi është një shkollë revolucioni dhe shfaqje e pandërprerë e Islamit origjinal (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Shi'itët, gjatë gjithë historisë, kanë qenë të ekspozuar ndaj sulmeve të frikacakëve tiranë dhe kolonizatorëve".[1]

"Një nga tiparet e Shi'izmit, që nga themelimi e deri më sot, ka qenë revolucioni kundër tiranisë dhe padrejtësisë. Kjo është vërejtur në të gjitha etapat e historisë së Shi'izmit dhe kjo luftë ka arritur kulmin në disa periudha historike".[2]

"Shi'izmi ka qenë gjatë gjithë shekujve një simbol i rezistencës. Që nga lindja e Islamit, Shi'izmi ka qenë një simbol i përballjes dhe mbrojtjes së së vërtetës, duke mos qenë kurrë mbështetës i tiranisë, padrejtësisë dhe shtypjes.

Nëse ndonjë qeveri arrin të ngrihet mbi bazën e sheriatit islam dhe ecën sipas metodës shi'ite, ajo duhet ta ndjekë këtë qasje gjithmonë, duke mos ushtruar presion mbi asnjë njeri dhe duke mos ia mohuar askujt lirinë për të besuar në medh'hebin e tij fetar. Të gjithë njerëzit, sipas medh'hebit shi'it, janë të lirë dhe të pavarur.

Shi'izmi, në marrëdhënie me të gjithë popujt dhe qeveritë, bazohet mbi respektin reciprok. Kur medh'hebi shi'it ngadhënjen diku, ai i trajton njerëzit në mënyrë të tillë që ata nuk poshtërohen në qeverisjen e tij dhe

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 365.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 275.

nuk bien në ndonjë padrejtësi nga ana e tij. Historia tregon se Islami gjithmonë ka hapur horizonte të reja për njerëzit dhe i ka çliruar ata nga qeveritë e mëparshme shtypëse. Shembulli më i afërt për këtë është Irani".[1]

Shi'izëm do të thotë rezistencë për të vërtetën dhe drejtësinë. Drejtësia nënkupton që të mos bësh padrejtësi dhe të mos i nënshtrohesh padrejtësisë. Imami ynë e ka përmbledhur Shi'izmin në dy fjalë: ***"Mos prano padrejtësinë dhe mos bëj padrejtësi."*** *Ky është programi i përgjithshëm për shi'itët dhe për Islamin. Ky është Shi'izmi i nxjerrë nga Kur'ani".*[2]

"Medhhebi shi'it është medh'hebi i martirizimit. Ai është ndërtuar që në fillim mbi dëshminë dhe ka vazhduar me të, dhe shpresa është që të vazhdojë përgjithmonë kështu".[3]

Medh'hebi shi'it ka qenë i lidhur ngushtë me Islamin gjatë gjithë historisë, janë si binjakë. Imamët e shi'itëve ishin të parët që besuan në Islam dhe ecën së bashku me të në rrugën e tij. Pas kësaj, medh'hebi shi'it u bë një medh'heb politik dhe shoqëror. Ai ka luftuar kundër padrejtësisë në të gjitha epokat dhe ka qenë kundërshtari kryesor i qeverive tiranike në Islam, siç ishin emevitët abasitët dhe të tjerë nga qeveritë tiranike që ishin gjithmonë armiq të këtij medh'hebi. Armiqësia e tyre me pasuesit e medh'hebit shi'it buronte nga fakti që sundimi i tyre ishte i bazuar mbi padrejtësinë që ata e praktikonin, qoftë përmes marrjes së pushtetit ose përmes trajtimit tiranik që i bënin popullit.

Dijetarët dhe personalitetet e mëdha shi'ite kanë pasur gjithmonë një rol të rëndësishëm në përballjen me sundimtarët gjatë gjithë historisë,

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 363.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 364.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 309.

duke u përballur me vështirësitë dhe sprovat që shkaktuan emevitët dhe pas tyre abasitët, madje edhe më ashpër. Mund të thuhet se burgjet e këtyre sundimtarëve tiranikë nuk janë zbrazur as edhe për një ditë nga personalitetet e mëdha shi'ite dhe dijetarët e tyre, prej të cilëve shumë prej tyre e kaluan gjithë jetën në internim. Ky medh'heb është veçuar gjithmonë për përndjekjet e pandërprera që i janë bërë ndjekësve të tij, në të gjitha vendet ku sundonin emevitët dhe abasitët.

Medh'hebi shi'it është i vetmi që ndërhyn në të gjitha çështjet e vendeve islame për t'i reformuar ato. Ky është medh'hebi i drejtë islam që dëshiron që të gjitha çështjet e vendeve islame të jenë sipas asaj që do Islami, ashtu siç dëshiron edhe të shkatërrojë sundimin e padrejtë mbi vendet islame dhe të shtypurit.

Medh'hebi shi'it gjithmonë qëndron në krah të të shtypurve dhe u kundërvihet tiranëve dhe arrogantëve. Këto janë veprat e shi'itëve, që përputhen me bindjet e tyre, të cilat i trashëguan nga dijetarët e tyre të mëdhenj. Ata gjithmonë do të mbeten në këtë rrugë të drejtë, për aq kohë sa Islami do të ekzistojë".[1]

"Një nga tiparet e medh'hebit shi'it është se në asnjë kohë nuk ka qenë i nënshtruar ndaj qeverisë, por ka qëndruar përballë saj dhe ka sakrifikuar me madhështinë e tij. Ky është një medh'heb që është i aftë ta njohë dhe ta përhapë Islamin, duke qëndruar me vendosmëri përballë komunizmit dhe ka dëshmuar se feja nuk është opium për popujt dhe se dijetarët nuk janë të nënshtruar ndaj shtetit".[2]

"Me të vërtetë, muaji Muharrem për medh'hebin shi'it është muaji në të cilin realizohet fitorja me sakrificë dhe gjak. Që nga fillimi i Islamit

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 111-112.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 187.

dhe pas largimit të vulës së profetëve, themeluesit të drejtësisë dhe lirisë, Islami ishte në rrugën e tij për t'u bërë një kafshatë në gojën e tiranëve, për shkak të trillimeve që shpikën Benu Umeja dhe për shkak se ata shkelën drejtësinë me këmbët e prishësve. Derisa shpërtheu agimi i udhëheqësit të dëshmorëve, Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!), me kryengritjen e Ashures së madhe. Ai ringjalli Islamin dhe drejtësinë me sakrificën e tij, me gjakun dhe nderin e tij, duke e shpëtuar Islamin dhe duke i rrëzuar themelet e pushtetit të Benu Umejës. Në kohën tonë, Islami është bërë si një gojë e Benu Umejës dhe është lëkundur në themelet e tij, saqë u përpi nga familja Pahlavi, zotërinjtë dhe oborrtarët e saj, të cilët goditën drejtësinë, pavarësinë dhe lirinë me devijimet dhe tiraninë e tyre, duke u mbuluar me petkun e hipokrizisë dhe falsifikimit".[1]

"Me kalimin e kohës, besimi shi'it mbeti i gjallë dhe aktiv dhe kjo që nga koha e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) e deri më tani. Dihet se numri i shi'itëve, në fillim, ishte i vogël, aq sa nuk mund të përllogaritej, por tani janë shumë, falë Zotit. Prandaj duhet të dimë sekretin e qëndrueshmërisë së këtij besimi. Ky është sekreti i qëndrueshmërisë së Islamit në përgjithësi dhe i ruajtjes së tij. Një nga sekretet më të mëdha dhe më të rëndësishme është ajo që bëri Prijësi i dëshmorëve, Imami Hyseni, biri i Aliut (Paqja qoftë mbi ta!), sepse ai e ruajti Islamin nga devijimi përmes sakrificave të mëdha që bëri, me jetën e tij dhe me jetët e të tjerëve përballë Umajadëve dhe të tjerëve, ia riktheu Islamit rrugën e drejtë. Prandaj duhet ruajtur ajo lëvizje e madhe e Hysenit".[2]

Që në fillimet e Islamit, deri në ditët e sotme, Islami dhe bota e shi'izmit kanë një histori të ndritur xhihadi ,në fushat e gjakut dhe të shpatës. Shi'itët morën mbi vete detyrën madhore për të çrrënjosur

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 195.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 89.

korrupsionin, sipas urdhrit të Kur'anit të shenjtë, Sunetit të të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe jetës së imamëve të pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!), si dhe për realizimin e objektivave të shenjta islame. Ata kanë bërë sakrifica të mëdha në këtë rrugë të shenjtë. Populli i madh iranian, ndjekës i miqve të Islamit, të cilët u dalluan në mbrojtjen e kësaj çështjeje të shenjtë, dhe u veçuan në gatishmërinë për të derdhur gjakun dhe pasuritë e tyre për përmbushjen e saj dhe për arritjen e qëllimeve kur'anore hyjnore, e kreu detyrën me një mënyrë që i ka hije. Ata i përmbushën përgjegjësitë e tyre përballë dijetarëve dhe e prezantuan Islamin hyjnor ashtu si i takon. Ata ndërmorën hapa të mëdha në rrugën e prezantimit të Islamit. Edhe pse kemi humbur personalitete me vlera të larta, kemi fituar vlera më të larta në sytë e Allahut të Madhëruar. A nuk është kënaqësia e Allahut shpërblimi më i lartë që mund të fitojmë?"[1]

"Ne themi se jemi shi'itë të Ali ibn ebu Talibit. Por shi'iti i vërtetë është ai që ecën sipas rrugës së tij dhe ndjek shembullin e jetës së tij.

Shi'izëm do të thotë ndjekje. Të thuash se jemi shi'itë, pa ndonjë vepër apo përpjekje në veprim, do të thotë se në realitet nuk jemi shi'itë, por vetëm pretendojmë të jemi të tillë. Ashtu siç do të ishte, nëse ne do të pretendonim se Kur'ani është Libri ynë, por nuk veprojmë sipas tij, atëherë ai nuk do të ishte libri ynë në realitet. Po ashtu është edhe çështja, nëse themi se Muhamedi është profeti ynë, por nuk veprojmë sipas asaj që ai solli dhe nuk ndjekim fjalën e tij, atëherë profecia e tij nuk do të na sjellë dobi. Gjithashtu, nëse nuk veprojmë sipas asaj që thonë imamët e Ehli Bejtit, atëherë nuk na sjell dobi ndjekja e tyre, ose do të ketë pak dobi. Prandaj, përpiquni për vepra, në mënyrë që Kur'ani të jetë libri juaj

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 427.

përmes veprës, jo vetëm përmes fjalës; i Dërguari fisnik të jetë profeti juaj dhe Aliu, biri i Ebu Talibit, të jetë imami juaj".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 391-392.

Imami Aliu dhe bijtë e tij janë rojet e Islamit

Profeti fisnik (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) e dinte se është e pamundur të ketë një të ngjashëm me Imamin, Prijësin e besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!). Ai e bëri atë si një shembull për sundimtarin dhe për të tjerët që duhet të ndjekin shembullin e tij të përsosur.

Vetë Imam Aliu e shpjegoi metodën e qeverisjes gjatë kohës së tij, në letrën që i ka dërguar Malik el Ashtarit, ku ai përcaktoi detyrimet e sundimtarit dhe të nëpunësve që i caktojnë për udhëheqjen e qyteteve. Duke u mbështetur në modelin e kalifatit që e kishte caktuar Profeti fisnik (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ai paraqiti modelin e punës së qeverisë dhe të drejtuesve që pasonin metodën e tij.

Të gjitha qeveritë që erdhën pas qeverisjes së tij, me përjashtim të atyre pak ditëve të qeverisjes së Imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!), nuk e zotëronin kompetencën e nevojshme për drejtimin islam. Atyre u mungonte përkushtimi ndaj etikës së udhëheqjes islame, ashtu siç e mishëronte plotësisht gjykimi dhe drejtimi i të Dërguarit të Allahut. Sa herë që haset një qeveri që nuk i përmbahet kësaj norme, ajo është e padenjë për të qeverisur.

Edhe vetë Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) u ngrit kundër Muavies, i cili fshihej pas petkut të Islamit dhe vepronte në emër të tij. Ndoshta ai besonte në disa parime islame, e ndoshta nuk besonte fare; në çdo rast, Imam Aliu e kundërshtoi hapur dhe nuk u përmbajt në shprehjen e qëndrimeve të tij ndaj tij. Ai nuk i dëgjoi ata që mendonin se po e

këshillonin, kur i sugjeruan ta linte përkohësisht Muavien si guvernator të Shamit (Sirisë), derisa të forcohej kalifati i tij, e pastaj ta shkarkonte. Ai e refuzoi prerazi këtë propozim.

Argumenti i tij ishte i qartë: ai nuk mund të lejonte që dikush të vepronte si kalif, në kundërshtim me kriteret hyjnore dhe të përhapte padrejtësi nëpër vende, duke u bërë sundimtar mbi njerëzit, qoftë edhe për një periudhë të shkurtër. Po ta kishte bërë këtë, veprimi i tij do të shërbente si precedent se një mëkatar apo i padrejtë mund të emërohej sundues nga prijësi i çështjes.

Por Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) nuk pranoi një gjë të tillë, sado që mund të dukej e dobishme nga këndvështrimi i interesit politik, sepse, nëse pozita e Muavies do të forcohej, më pas do të ishte shumë më e vështirë rrëzimi i tij. Për këtë arsye, ai nuk lejoi për veten e tij atë që nuk ishte e drejtë.

Ky qëndrim përbën një argument të fuqishëm për ne: nuk duhet të pajtohemi që një tiran të sundojë qoftë edhe për një ditë të vetme. Pranimi i një gjëje të tillë është në thelb pajtim me padrejtësinë, agresionin dhe grabitjen e pasurisë së njerëzve. Nuk i lejohet një myslimani të jetë i kënaqur me një pushtet të padrejtë, qoftë edhe për një orë të vetme".[1]

"Ajo që të bën të trishtohesh për të, është se ata nuk e lanë Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!), për të treguar Islamin në formën që ai duhet të shfaqej. Ai u përfshi në tre luftëra gjatë periudhës së kalifatit të tij të jashtëm, të cilat i ndezën vetë myslimanët kundër tij".[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 24.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 59.

"Festa e Gadirit është ndër festat më madhështore fetare. Ajo është festa e të shtypurve, e të privuarve dhe e të pambrojturve. Është festa më e madhe në mbarë botën, në të cilën Zoti i Madhëruar dhe i Lartësuar, përmes të Dërguarit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), zgjodhi Prijësin e besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!), që të zbatojë objektivat hyjnore, t'i shpallë ato dhe të vazhdojë rrugën e profetëve.

Por, për fat të keq, ngjarjet, tradhtitë dhe luftërat që shpërthyen, ndezën fitilat e tyre, bënë që personaliteti i vërtetë i këtij burri të madh të mos shfaqej plotësisht. Personaliteti i tij i jashtëzakonshëm ka shumë dimensione, të ndryshme e të thella. Ai është pasqyrim i emrit hyjnor "El Xhami'" (Ai që i përmbledh të gjitha) dhe i cilësive hyjnore. Në qenien e tij u bashkuan dimensione të shumta, madje edhe të kundërta e në dukje kontradiktore.

Në një çast e sheh si asketin më të madh ndër asketët; ndërsa në të njëjtën kohë e gjen si një luftëtar të guximshëm e të pathyeshëm në mbrojtje të Islamit. Këto dimensione dhe cilësi rrallë bashkohen te njerëzit e zakonshëm: asketi i zakonshëm nuk është luftëtar, dhe luftëtari i zakonshëm nuk është asket, siç dihet zakonisht".[1]

"Çdo grup, sipas fushës dhe prirjes së vet, e konsideron atë si pjesë të vetën. Trimave u duket se Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) është prej tyre; po kështu edhe filozofët, arifët (mistikët), juristët dhe shtresat e tjera të shoqërisë — secili grup e sheh atë si përfaqësues të vetin. Dhe e vërteta është se ai u përket të gjithëve, sepse në veten e tij i bashkon të gjitha cilësitë dhe përsosmëritë.

Megjithatë, disa nga këto përsosmëri mbeten të fshehura dhe njihen përmes lutjeve të tij. Lutja e Kumejlit është tejet e thellë dhe mahnitëse;

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 59.

disa pjesë të saj nuk mund të burojnë nga një njeri i zakonshëm. Ai thotë: "O Zoti im, o Sunduesi im, o Mbrojtësi im dhe o Zotëruesi im! Nëse i duroj dënimet e Tua, si mund ta duroj ndarjen prej Teje?" Kush mund të shprehë fjalë të tilla? Vetëm ai që është i dashuruar me bukurinë e Allahut me një dashuri aq të zjarrtë, saqë nuk i frikësohet Zjarrit të Xhehenemit në vetvete, por i frikësohet ndarjes nga Ai – i frikësohet se mos humbet gradën e afrimit dhe privohet nga dashuria hyjnore. Ai vajton për ndarjen nga pranimi i së Vërtetës së Lartë.

Kjo dashuri, që digjet pandërprerë në zemrën e tij, është burimi nga i cili rrjedhin të gjitha veprat e tij. Vlera e këtyre veprave që burojnë nga dashuria për Allahun qëndron në faktin se ato lindin nga përkushtimi i pastër dhe teuhidi i tij. Për këtë arsye është thënë: "Goditja e Aliut në Ditën e Hendekut është më e vlefshme se adhurimi i njerëzve dhe i xhindeve". Sikur të supozohej se ajo goditje do të jepej nga një njeri tjetër në mbrojtje të Islamit, por pa këtë dashuri të thellë, ajo nuk do të kishte të njëjtën vlerë. Edhe nëse një veprim i tillë do të sillte forcimin e Islamit, përderisa burimi i tij nuk do të ishte dashuria hyjnore, ai nuk do të ishte më i mirë se adhurimi i të dy botëve".[1]

"Vërtet, Aliu, biri i Ebu Talibit, ishte vetëm rob i Allahut. Ky është tipari më i madh i tij, për të cilin nuk ka hadith më madhështor, se sa të shihet ai si i rritur në prehrin e Profetit të madh (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Kjo është madhështia më e madhe e tij. Cili person tjetër mund të pretendojë se ishte rob i Allahut, i çliruar nga çdo lloj adhurimi tjetër? Ai ishte rob i veçantë, i shkëputur nga gjithçka, përveç Allahut, i lidhur me të dashurin, i cili zbuloi për të mbulesat e dritës dhe errësirës dhe e çoi deri te burimi i madhështisë. Cili personalitet tjetër mund të pretendojë se, që nga fëmijëria dhe deri në fund të jetës, u rrit nën kujdesin e të Dërguarit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 59.

dhe mbi familjen e tij!), në prehrin e tij dhe nën hijen e tij, nën edukimin e shpalljes, përveç Aliut, biri i Ebu Talibit, në shpirtin e të cilit u mbollën rrënjët e Shpalljes dhe edukimin i sjellësit të Shpalljes. Vërtet, ai është rob i Allahut dhe edukim i robit më të madh të Allahut".[1]

"Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte një personalitet i përkryer, në të gjitha dimensionet: në adhurim, në dije, në asketizëm dhe në edukim shpirtëror. Është e pamundur t'i përmendim të gjitha këto në pak fjalë. Për sa i përket përkores dhe mënyrës së jetesës, ai mjaftohej me bukë e kripë, duke jetuar me thjeshtësi të skajshme, ndonëse i kishte të gjitha mundësitë në dispozicion. Në histori përmendet rasti i Bejtul Malit (thesarit publik), kur ai e fikte llambën, sapo biseda dilte nga çështjet që i përkisnin pasurisë së myslimanëve. Këto nuk janë thjesht tregime, por dëshmi të një realiteti të gjallë të drejtësisë dhe ndërgjegjes së tij.

Edhe në fushën e luftës nuk e teprojmë kur themi se ai nuk e uli shpatën përballë armiqve deri në fund të jetës së tij, përveç rasteve shumë të rralla. Ai mori pjesë në të gjitha betejat e të Dërguarit të Allahut dhe, pas ndarjes nga jeta të Profetit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), për një kohë të gjatë shërbeu si këshilltar i sinqertë, megjithëse ishte privuar nga e drejta e tij për udhëheqje.

Kur më në fund njerëzit i dhanë besën, ai e kaloi jetën e tij fisnike duke u përballur me luftëra të brendshme dhe trazira. Ai nuk ishte thjesht një mistik që të izolohej si arif; nuk ishte vetëm një asket që të tërhiqej nga përgjegjësitë shoqërore; nuk ishte vetëm një jurist që të mbyllej në studim e të mos merrej me çështjet e myslimanëve. Përkundrazi, ai i përfshinte të gjitha këto dimensione brenda vetes dhe arriti majat më të larta në secilën prej tyre: në teuhid, në dije e njohuri, në jurisprudencë në nivelet më të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 274.

larta dhe në çdo fushë tjetër të dijes. Krahas kësaj, në xhihad ai qëndronte në radhën e parë.

Kjo përmasë e plotë dhe e harmonizuar në të gjitha këto dimensione e bën të pamundur që ai të përkufizohet me një cilësi të vetme, duke lënë në hije të tjerat"[1]

"Nëse do të supozonim se një njeri si Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) do të sundonte një vend, banorët e atij vendi, duke parë jetën dhe sjelljen e tij, do të kuptonin menjëherë se si jetonte ai në të vërtetë: si sillej me njerëzit e afërt, si i edukonte fëmijët, si ishte përditshmëria e tij, si ishin shokët, fisi dhe të afërmit e tij. Njerëzit e zakonshëm, kur shihnin ushqimin dhe veshjen e udhëheqësit të tyre, do ta gjenin atë më të thjeshtë se të tyren. Ai zotëronte vetëm një këmishë. Kur vinte dita e xhumasë, e lante dhe e vishte ende të lagur; kur ngjitej në minber për të mbajtur hutben, këmisha ishte ende e njomur dhe ai e lëvizte gjatë ligjërimit që të thahej, sepse nuk kishte tjetër. Kur bleu një këmishë të re, më të mirë, ia dha shërbëtorit të tij dhe për vete mbajti më të thjeshtën.

Kur njerëzit shihnin jetën e tij, thoshin: "Shikoni sa e thjeshtë është jeta e këtij njeriu!" – dhe ky ishte sunduesi i një shteti të gjerë, që përfshinte Iranin, Egjiptin, Hixhazin, Irakun, Jemenin dhe vende të tjera. Megjithatë, mënyra e jetesës së tij mbetej e njëjtë: e thjeshtë, e përkorë dhe e drejtë.

Sipas historisë, një herë ndodhi një mosmarrëveshje mes tij dhe një hebreu. Kur u paraqitën para gjykatësit, ai nuk tha: "Unë jam sunduesi i këtyre vendeve të mëdha dhe ti je një gjykatës i caktuar prej meje, prandaj mos më trajto kështu!" Përkundrazi, shkoi, u ul dhe mori pjesë në gjyq si palë e barabartë. Kur gjykatësi iu drejtua me fjalët: "O Ebu Hasan, nuk

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 20, f. 25-26.

duhet të ketë dallim mes teje dhe këtij hebreu", ai e pranoi pa kundërshtim. Madje, kur vendimi u dha në favor të hebreut, ai e pranoi gjykimin me drejtësi.

Kur në krye të shtetit qëndron një njeri i tillë, shoqëria përmirësohet. Islami kërkon pikërisht një udhëheqës të këtij lloji. Kur flasim për një qeverisje dhe një republikë islame, synimi është ky model. Pa dyshim, është e vështirë të gjendet një njeri i tillë; edhe ai vetë ka thënë: "Unë nuk kam fuqi ta përmbush këtë i vetëm; më ndihmoni me devotshmëri, më ndihmoni me përpikëri dhe me vepra të drejta".[1]

Imam Hasan ibn Aliu (Paqja qoftë mbi të) është imami i dytë prej imamëve të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi të!). Është e domosdoshme që jeta e tij të lexohet me kujdes, sidomos pas dëshmimit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të), i cili ishte imam dhe kalifi legjitim i umetit islam, sipas konsensusit të myslimanëve. Pas tij erdhi Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të), i cili qëndroi në pozitën e imamatit dhe të kalifatit të përgjithshëm për gjashtë muaj. Ai fillimisht qëndroi i patundur dhe luftoi kundër Muavies, i cili, me ushtrinë e tij, sulmoi qendrën e kalifatit legjitim.

Por, kur Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të) vuri re se ushtria e tij po dobësohej dhe disa prej komandantëve po tundoheshin nga joshjet e Muavies, pranoi të bënte paqe me të, duke vendosur kushte për të mbrojtur Islamin. Edhe pse Muavia i shkeli ato kushte më vonë, paqja u arrit. Kështu, Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të) ka një histori të mbushur me mbrojtjen e Islamit, sipas nevojave të rrethanave dhe kohës.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 198.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "*Nëse thellohemi me vëmendje, shohim se Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!) iu kundërvu Muavies, i cili ishte sundues në kohën e tij, megjithëse të gjithë ia kishin dhënë besën atij dhe frikësoheshin nga pushteti i tij të rremë. Megjithatë, Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!) qëndroi kundër tij, aq sa mundi, deri në atë kohë, kur një pjesë e thjeshtë e njerëzve krijuan një gjendje që e detyroi të pranonte paqen me Muavien. Në ato rrethana, pranoi marrëveshjen e paqes, por gjatë periudhës së saj nuk kurseu asgjë për të zbuluar tradhtitë dhe turpet e Muavies, madje nuk u përmbajt të tregonte gjithçka që ai bënte nga poshtërsia dhe turpi. Imam Hyseni (Paqja qoftë mbi të!) iu drejtua Jezidit*".[1]

"*Historia e Imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!) është një dëshmi tjetër për çështjen e paqes. Paqja e tij ishte e detyruar, pasi tradhtarët që e rrethonin, e shtrënguan Imamin duke e detyruar ta pranonte atë. Kështu që ajo ishte një paqe e imponuar. Pas nënshkrimit të saj, sipas asaj që është transmetuar, Muavia u ngjit në minber dhe tha: 'Dijeni mirë! Çdo gjë që është kushtëzuar nga Hasani, është nën këmbët e mia; unë nuk do ta përmbush atë'*".[2]

"*Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!) sundoi për një periudhë shumë të shkurtër, por trashëgimia e tij mbeti. Allahu i Lartësuar kishte përcaktuar që imamët, Aliu (Paqja qoftë mbi të!) dhe Hasani (Paqja qoftë mbi të!), të mos e mbanin pushtetin, dhe pas tyre kjo vijoi edhe për imamët udhëzues. Kjo ndodhi, sepse qeveria i pengoi ata që të jepnin frytet e tyre. Duke u bazuar në këtë, Allahu bëri që qeveria e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), të mbetej e përzier me politikën, që do të thotë, e përshkuar nga politika. Kjo shpjegon, se pse shumë devijime ndodhën, dëshmon për ekzistencën e duarve të fshehta që ndërhynin në*

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 345.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 100.

histori, deri në kohën e kalifëve emevi dhe abasi (Allahu i mallkoftë!). Këta thoshin: 'Feja duhet të ndahet nga politika dhe qeveria të jetë e pavarur nga politika'. Por sa më shumë që largohemi nga koha e legjislacionit dhe e shpalljes, aq më shumë forcohet dhe thellohet kjo bindje".[1]

Imam Hyseni, biri i Aliut (Paqja qoftë mbi të!), ishte gjithmonë mbrojtës i Islamit, në të gjitha etapat e jetës së tij: qoftë pranë babait të tij, qoftë pranë vëllait të tij, Hasanit; pas martirizimit të Imam Aliut dhe Imam Hasanit (Paqja qoftë mbi ta!), deri në fund të jetës së tij të nderuar, në shkretëtirën e Kerbelasë, ku ai u flijua më të madh për hir të Islamit.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: *"Uroj qytetarët në përgjithësi dhe, në veçanti, rojtarët e revolucionit islamik, në këtë ditë të bekuar të muajit Shaban të madhëruar, Dita e rojës dhe e mbrojtjes së shkollës së lartë islame. Me të drejtë, kjo ditë quhet "Dita e Rojeve", sepse përkon me ditëlindjen e mbrojtësit të Kur'anit dhe të Islamit të nderuar, të çmuar e lumturues (Imam Hysenit), i cili u shpëtoi nga rënia e devijimit zullumqar të omejadëve despotikë, që e shtrembëruan dhe e paraqitën të ndryshëm nga e vërteta e tij e shenjtë dhe nga ajo që solli i Dërguari i Allahut. Në emër të Islamit, Muavia dhe i biri i tij bënë me Islamin atë që më pas Xhingizkani bëri me Iranin, duke e shndërruar shkollën e shpalljes në një sistem djallëzor. Sikur të mos ishte flijimi i rojtarit të madh të Islamit dhe martirizimi i mbrojtësve të tij të mëdhenj dhe të shokëve të tij të përkushtuar, që zbuluan fytyrën e vërtetë të Islamit të shtrembëruar nga padrejtësitë e Beni Umejes, përpjekjet e të Dërguarit të nderuar të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të shokëve të tij sakrifikues, do të ishin shuar".*[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 97.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 240.

"Sikur të mos ishte Imam Hyseni, Prijësi i dëshmorëve, Muavia dhe Jezidi, babai dhe i biri, nuk do ta kishin zbuluar e shfaqur sistemin e tyre tiranik. Ata të dy do të vazhdonin ta paraqisnin sistemin islam si një sistem hyjnor, ndërkohë që në të vërtetë ishte një regjim tiranik. Po të mos ishte Imam Hyseni, Prijësi i dëshmorëve, ata do t'i mashtronin njerëzit dhe do t'i kthenin drejt epokës së injorancës. Por unë dhe ti, myslimanë husenianë, nuk duhet të heshtim ndaj një njeriu që zgjodhi dëshmorin dhe me rënien e tij dëshmor shpëtoi Islamin. A mos vallë nuk duhet ta përkujtojmë atë çdo ditë me lot? Ne duhet të ngjitemi çdo ditë në minber për ta ruajtur dhe për ta vazhduar këtë shkollë, dhe për t'i dhënë jetë vazhdimësisë së këtyre revolucioneve, të cilat janë të lidhura me përmendjen e Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!)".[1]

"Unë dhe ju të gjithë, përmes këtij mesazhi që kemi, veçanërisht gjatë muajve Muharrem dhe Safar, të cilët janë muaj të begative islame dhe për ringjalljen e çështjes së Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), duhet t'i gjallërojmë këta dy muaj, duke përkujtuar fatkeqësitë e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!). Islami ka qëndruar gjallë deri më sot përmes përkujtimit të fatkeqësive të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!). Kështu që, ky medh'heb (medh'hebi shi'it) ka mbetur gjallë deri më sot falë gjallërimit tradicional, përmes leximit të elegjive dhe përkujtimit të fatkeqësisë.

Me të vërtetë, gjaku i Prijësit të dëshmorëve, Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!) është ai që ka lëvizur gjakun e popujve myslimanë. Karvanët e Ashures janë ata që zgjojnë njerëzit dhe i përgatisin për hir të Islamit dhe për ruajtjen e qëllimeve islame. Duhet që në këtë çështje të mos ketë neglizhencë dhe, gjithashtu, të mos lihen pa përmendur ngjarjet që ndodhën".[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 388.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 15, f. 291-292.

"Ashtu siç u përball Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) me dështim në luftën kundër Muavies- në kuptimin që ushtria e tij u dobësua dhe u mashtrua nga disa injorantë që shtirreshin si mbrojtës të shenjtërisë, po ashtu, edhe Prijësi i dëshmorëve, Imam Hyseni (Paqja qoftë mbi të!), u rrethua, u mposht dhe u vra. Por fitorja e vërtetë dhe përfundimtare ishte e tyre, sepse ata nuk u mundën me vdekjen; përkundrazi, me sakrificën e tyre i demaskuan dhe i zmbrapsën armiqtë.

Muavia dhe aparati i tij synonin ta shndërronin Islamin në një perandori, duke e kthyer atë në frymën e injorancës së vjetër. Ndërsa Jezidi dhe pasuesit e tij mbetën të njollosur përgjithmonë në histori, të përfshirë nga mallkimi dhe përçmimi i brezave. Emrat e tyre u shuan me turp, ndërsa kujtimi i imamëve mbeti i gjallë.

Krenaria jonë jeton në zemrat tona pikërisht përmes kësaj sakrifice. Edhe nëse, në pamje të jashtme, duket si humbje, për ne ajo është nder. Nëse u mposhtëm si "Umet", kjo është një krenari, sepse është e njëjta rrugë që ndoqën luftëtarët e parë të Islamit: sakrificë, qëndresë dhe përkushtim. Përpjekja vazhdon, rruga ecën përpara dhe Islami mbetet i mbrojtur. Me lejen e Allahut, ai do të mbetet i ruajtur deri në përjetësi".[1]

"Data 3 e Shabanit të madhëreshëm është Dita e Ruajtjes-dita në të cilën u sigurua mbrojtja e Islamit, e së vërtetës dhe e besimit hyjnor. Ajo është dita e lindjes së rojtarit të madh, Imam Hyseni (Paqja qoftë mbi të!), i cili e ringjalli fenë me gjakun e tij, me gjakun e bijve dhe të shokëve të tij. Ky besim, që pothuajse ishte zbehur e shuar nga devijimet e mbeturinave të injorancës dhe nga komplotet e qëllimshme për të ringjallur nacionalizmin arab nën parullën: "Asnjë lajm nuk ka ardhur, asnjë

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 289.

shpallje nuk ka zbritur", synohej të zëvendësohej me një sistem mbretëror në vend të qeverisjes së drejtë islame, duke anashkaluar shpalljen hyjnore.

Por papritur u ngrit një personalitet madhështor, i ushqyer me frymën e shpalljes, i rritur në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të prijësit të evlijave, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), i edukuar në prehrin e pastër, Fatime Zehraja (Paqja qoftë mbi të!). Me sakrificën e tij unike dhe me lëvizjen e tij hyjnore, ai shpërtheu në histori me një ngjarje madhore: rrëzoi pallatet e tiranëve dhe shpëtoi besimin islam. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi shpirtin e tij të pastër, mbi Ehli Bejtin dhe mbi shokët e tij, të cilët e nxorën njerëzimin nga errësira e injorancës në dritën e Islamit.

Dhe tani, o popull i Islamit, o pasues të Muhamedit! Le të ndjekim Imamin tonë të madh; le ta ruajmë fenë dhe parimet tona me sakrificë; të ruhemi nga epshet dhe pasionet, që janë trashëgimi e shejtanit; dhe të vazhdojmë ecjen në këtë besim të çmuar, i cili synon çlirimin e të shtypurve dhe përuljen e arrogantëve".[1]

"Vërtet, të gjithë imamët tanë u vranë, sepse kundërshtonin aparatin shtypës të sundimtarëve. Edhe sikur të qëndronin në shtëpitë e tyre dhe të mos i thërrisnin njerëzit kundër sundimit të Benu Umejes dhe Benu Abasëve, do të jetonin si figura të nderuara e të respektuara, me pasuri të mëdha dhe mbështetje të gjerë. Por realiteti ishte se umeti ynë nuk kishte mundësi të formonte ushtri për mungesë mjetesh, prandaj veprimtaria e tyre zhvillohej në fshehtësi dhe kjo mjaftonte që autoritetet t'i burgosnin. Disa prej tyre kaluan madje vite të tëra në burg.

A u burgosën vallë për shkak të namazit dhe agjërimit të tyre? A u burgos Imam Musa el-Kazimi (Paqja qoftë mbi të!), sepse falej dhe

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 353.

agjëronte? Apo sepse i thërriste njerëzit të largoheshin nga Harun el-Rashidi dhe të mos i bindeshin sundimit të tij? Prandaj, heshtja përballë padrejtësisë nuk ishte kurrë rruga e tyre. Ata e shihnin veten si një rrezik për qeverinë tiranike, dhe për këtë arsye u burgosën, u vranë dhe u helmuan.

Thuhet se El-Ma'muni dërgoi një të dërguar në Medinë për të sjellë Imam Ali ibn Musa el-Rida (Paqja qoftë mbi të!) në oborrin e tij. Po ashtu, Imam Hasan el-Askariu (Paqja qoftë mbi të!) u mbajt për vite me radhë nën mbikëqyrje të rreptë në Samarra, duke iu rënduar gjendja. A ndodhi e gjithë kjo sepse ata dëshironin vetëm të faleshin? Apo sepse ishin pasardhës të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe përfaqësonin një autoritet moral e shpirtëror që sfidonte pushtetin?

Sikur të qëndronin të izoluar dhe të mos përziheshin në çështjet e njerëzve, do të ishin lënë të qetë. Por sa herë që lindte ndonjë trazirë, shpesh një nga Hashimitët ngrinte krye kundër qeverisë, duke shprehur pakënaqësinë ndaj sundimit. Kjo ndodhte sepse imamët (Paqja qoftë mbi ta!) i nxisnin njerëzit drejt ndërgjegjësimit dhe qëndresës kundër kalifëve dhe njerëzve të pushtetit, ashtu siç kishte vepruar edhe Zejd ibn Aliu dhe të tjerë, që u ngritën kundër autoritetit të padrejtë".[1]

"Me të vërtetë, bijtë e Fatimes (Paqja qoftë mbi të!), gjatë gjithë historisë së Islamit, janë ngritur kundër pushteteve tirane dhe të padrejta, dhe kanë mbrojtur Islamin. Ata përballuan dhe duruan dhimbjet, fyerjet dhe sharjet e ashpra, kokat e tyre u prenë dhe u vranë me shumicë, u martirizuan dhe u persekutuan. Megjithatë, ata qëndruan, u treguan të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 22.

vendosur dhe nuk lejuan kurrë që e keqja të sundonte, as të shuhej Islami dhe të zhdukeshin ligjet e Allahut".[1]

"Vërtet, lutjet që na kanë ardhur nga Imamët e pastër, janë ndër mjetet më të fuqishme për çlirimin e njeriut: ato e nxjerrin nga errësirat, e pastrojnë nga papastërtitë e brendshme dhe e lirojnë nga robëria e dëshirave.

Imamët tanë përjetuan vuajtje të shumta. Kur padrejtësia e sundimtarëve nuk ua bëri të mundur veprimin e hapur dhe thirrjen e drejtpërdrejtë drejt Allahut, ata u detyruan të vepronin në fshehtësi. Në vend të shpatës, i armatosën njerëzit me lutje, duke u dhënë një forcë të thellë shpirtërore, e cila e çliron njeriun nga zinxhirët e epshit dhe prangat e pasioneve, dhe e lartëson atë drejt sakrificës e martirizimit.

Lutjet e transmetuara në muajin Rexheb, e sidomos ato të muajit Shaban, janë një përgatitje shpirtërore për të hyrë në mikpritjen hyjnore të muajit Ramazan. Ato e përgatisin njeriun për t'u ulur në "tryezën" e shtruar të Allahut, Kur'ani i Shenjtë dhe për ta gjallëruar Nata e Kadrit.

Kjo është një mikpritje që pastron, argumenton dhe edukon; një proces që e përgatit shpirtin që nga dita e parë për agjërim, përpjekje dhe lutje, derisa të arrijë te tryeza e vërtetë dhe të furnizohet nga thesaret e Natës së Kadrit-nata në të cilën u shpall Kur'ani dhe e cila është më e vlefshme se një mijë muaj". [2]

Në testamentin e tij të përjetshëm politik hyjnor, Imami Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) krenohet me ndjekjen e Aliut dhe fëmijëve të Fatimes (Paqja qoftë mbi ta!), rojet e Islamit.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 1, f. 169.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 13, f. 33.

Këta heronj u përgatitën në mënyrë hyjnore për këtë detyrë madhështore historike. Midis të tjerash, Imami Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "*Sa për ne dhe popullin tonë të lavdishëm, i frymëzuar nga Kur'ani i shenjtë dhe nga Islami, ne krenohemi që jemi pasues të një metode që synon shpëtimin e së vërtetës kur'anore dhe unitetin e myslimanëve, madje edhe të gjithë njerëzimit, duke i nxjerrë nga robëria e injorancës dhe varrezat e errësirës, drejt një lëvizjeje të gjallë dhe shpëtimtare. Kjo është receta më madhështore për çlirimin e njerëzimit nga prangat që lidhen me duart, këmbët, zemrat dhe mendjet, dhe për të mbrojtur njerëzit nga humbja, skllavëria dhe sundimi i tiranëve.*

Ne krenohemi që jemi pasues të këtij medh'hebi, i themeluar me urdhër të Allahut nga Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i udhëhequr nga Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), biri i Ebu Talibit, një rob i liruar nga të gjitha prangat dhe i ngarkuar me detyrën e çlirimit të njerëzimit nga zinxhirët dhe robëria.

Ne krenohemi me Nehxhul Belagën, që është kushtetuta më madhështore, pas Kur'anit, e cila udhëheq jetën materiale dhe shpirtërore, dhe shërben për çlirimin e njerëzimit përmes urtësisë dhe mësimeve shpirtërore. Rruga më e lartë drejt shpëtimit është ajo që vijon nga Imami ynë i pagabueshëm. Ne krenohemi që imamët tanë, duke filluar nga Aliu, bir i Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi të!) dhe deri te shpëtimtari i njerëzimit, Imam Mehdiu (Paqja qoftë mbi të!), imami i kohës, shohin të gjitha çështjet me fuqinë e Allahut të Plotfuqishëm.

Ne krenohemi me lutjet e pagabueshme që na kanë ardhur nga umeti ynë, të njohura si Es Sahifetu Es Sexhadijetu, të cilat janë mjetet më të larta për edukim shpirtëror dhe lidhje të ngushtë me Allahun. Krenohemi me përgjërimet e imamëve tanë në muajin Shaban dhe me

lutjen e Imam Hyseni në Arafat. Krenohemi që kjo Sahifa është Zeburi i Ehli Bejtit të Profetit.

Ne krenohemi me Imam Bakirin (Paqja qoftë mbi të!), më i dituri i dijetarëve në histori, një pozitë e fshehtë që i është dhënë vetëm Allahut, Profetit të Tij (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe imamëve të pagabueshëm. Ne krenohemi me medh'hebin tonë Xhaferri dhe me jurisprudencën e tij të pafundme, një pikë nga deti i pambarimtë i dijes.

Ne krenohemi me të gjithë imamët e pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!), që duruan burgosjen, dëbimin, therjen dhe martirizimin për zbatimin e plotë të Kur'anit të shenjtë, përfshirë edhe formimin e qeverisë islame. Ata punuan deri në fund, duke u bërë dëshmorë në rrugën e Allahut për rrëzimin e qeverive tiranike dhe tagutëve të kohës së tyre.

Dhe sot, ne krenohemi që përpiqemi për të realizuar objektivat e Kur'anit dhe Sunetit, dhe se shtresat e ndryshme të popullit tonë janë të përkushtuara në këtë rrugë vendimtare, duke mos kursyer jetën, pasurinë dhe gjithçka të çmuar për rrugën e Allahut të Lartësuar". [1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 358-359.

Shi'izmi, medh'hebi mbrojtës

U bë e qartë se si Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) kuptonte thellësisht Shi'izmin dhe si e shihte atë jo thjesht si një besim fetar, por si një revolucion që mund të ndryshojë historinë dhe si themel për një shtet të drejtësisë njerëzore. Shi'izmi, sipas tij, nuk është një doktrinë e ngushtë, as një mendim i dobët, as një shkollë teorike e shpikur nga njerëzit, por një medh'heb që mbron Islamin, të gjitha shkollat dhe ndjekësit e tij, dhe ruan parimet fetare, njerëzore dhe etike.

Në çdo kohë, shi'itët kanë dëshmuar se janë roje të fesë, duke sakrifikuar shpirtin dhe jetën e tyre për të mbrojtur Islamin dhe shenjtërinë e tij me çdo mundësi. Kushdo që nuk është shi'it i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), i liruar nga të gjitha prangat, i përkushtuar ndaj adhurimit të Allahut dhe mbrojtës i Islamit me metodën më të lartë, nuk mund të përfaqësojë këtë model njerëzor të lartë. Ky është modeli që Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ndoqi gjatë rrugës së tij, duke ecur në gjurmët e zotërisë së tij dhe të prijësit të tij, Aliut, birit të Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi të!).

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "*A jam unë më i mirë se Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!)? Sa vite e shau Muavia Aliun në minbere dhe Imami duroi. A mos vallë Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) fliste ndryshe nga ajo që ne themi sot? Ne themi: duhet të zbatohen dispozitat e Kur'anit të shenjtë në vendet tona. Edhe Imami i madh e përsëriste këtë mesazh.*

A jeni ju më të lartë se shokët e Prijësi i , që flijuan shpirtin e tyre për hir të fesë? Vërtet, imamët tanë dhe personalitetet më të shquara të fesë, si dhe imamët e pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!), përjetuan fyerje, rrahje, martirizim, burgosje dhe helmim për mbrojtjen e Islamit.

Pasuesit e Aliut dhe Fatimes, dhe bijtë e tyre, shpirtërisht dhe njerëzisht, gjithmonë u përballën me sundimtarët tiranë. Amar ibn Jasiri, i cili i kaloi vitet e tij duke u përballur me padrejtësinë, u martirizua në moshën nëntëdhjetëvjeçare nga dora e grupit të humbur. Mejthem Et-Tammar, gjuha e gjallë e Islamit, fliste vazhdimisht për fenë, derisa xhelatët e Muavies (Allahu i mallkoftë!) ia prenë gjuhën, ia prenë duart dhe e torturuan me format më të këqija të ndëshkimeve".[1]

"Ne nuk jemi penduar për gjakun më të pastër, të derdhur në martirizim për hir të Islamit. Nuk jemi penduar që martirizimi u bë pjesë e nderit tonë; ky është rrugëtimi i besimtarëve që nga lindja e Islamit deri më sot. Nëse Islami u përhap, kjo ndodhi falë heroizmit të shi'itëve, sepse Islami gjithmonë lidhej me heroizmat e udhëhequra nga Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), heroi i madh i Islamit dhe hero i botës.

Imam Aliu dhe shi'itët e tij të afërt ishin pionierë në luftërat që mbronin Islamin. Po ashtu edhe bijtë e tij të pastër, si Imami i dëshmorëve, u ngritën, derdhën gjakun e tyre dhe e dhuruan atë për rrugën e Islamit. Të gjithë imamët tanë, që fillimisht vepruan fshehurazi për shkak të kujdesit (takija), më pas, kur erdhi koha e tyre, sfiduan diktaturat e epokave të tyre dhe qëndruan me vendosmëri.

Ata janë shi'itët e Imam Aliut, që njëri pas tjetrit vazhduan revolucionet e tyre deri në kohën tonë, sepse shi'itët e Aliut gjithmonë u ngritën përballë tiranisë. Në kohën tonë të tashme, ju, o shi'itë e lavdishëm

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 1, f. 169.

të Islamit, ishit ajo pakicë madhështore që u përball me diktaturat dhe fuqitë e mëdha, dhe triumfuat me duart tuaja të zbrazëta mbi tanket dhe topat.

Kështu, Islami mbeti i gjallë falë sektit të shi'itëve dhe revolucioneve të njëpasnjëshme të shi'itëve të Imam Aliu, të cilat janë ato që ringjallën Islamin".[1]

"Ndër shtyllat kryesore të shi'itëve është lufta kundër tiranisë dhe qeverive shtypëse. Që nga shfaqja dhe lindja e despotizmit, shi'itët kanë luftuar padrejtësinë, ashtu siç u flijuan dhe dhanë shumë dëshmorë. Ata ruajtën medh'hebin shi'it me gjakun e tyre. Nuk ka ndonjë shkollë si shkolla e Shi'izmit në kryengritjen e saj kundër të pavërtetës. Ky është një tipar dallues te shi'itët."[2]

"Për të arritur të vërtetën, nuk mund të mos ketë sakrificë dhe shkolla e shi'itëve ka qenë gjithmonë shkolla e sakrificës përgjatë historisë. Populli gjithmonë është ngritur për hir të drejtësisë dhe të drejtave të mohuara, duke derdhur gjakun e tij. Prandaj, ne nuk jemi të shqetësuar për këtë çështje, sepse ne i bindemi Allahut të Madhëruar".[3]

Është transmetuar se Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) merrej me çështjet e myslimanëve në përgjithësi, duke u dhënë rëndësi të veçantë të uriturve. Ai vetë vuante nga varfëria dhe uria e rëndë, por gjithmonë shqetësohej se ndoshta dikush, në skajet më të largëta të botës islame, ishte më i uritur se ai vetë.

Ky ishte udhëheqësi, zotëria dhe imami ynë. Sa e madhe është lavdërimi që i bëjmë, e megjithatë nuk arrijmë dot ta ndjekim plotësisht!

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 6, f. 283-284.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 6, f. 284.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 116.

Kjo është domethënia e "imamit": ai ecën përpara dhe shi'itët ndjekin gjurmët e tij, ashtu si bartësit e arkës që, duke e mbajtur së bashku, lëviznin në një anë dhe të gjithë ndiqnin atë drejtim pa përjashtim.

Kështu duhet të jenë shi'itët: të ndjekin Aliun (Paqja qoftë mbi të!). Sigurisht, askush nuk mund të arrijë të jetë si ai në tërësi. Por mund ta ndjekim në aspektet e asketizmit, devotshmërisë, mbrojtjes së të shtypurve dhe ndihmës ndaj të varfërve.

Ai ishte një mrekulli që bashkoi të gjitha të kundërtat në vetvete: një njeri me aftësi të jashtëzakonshme, që në betejë godiste pa mëshirë armiqtë e Islamit, por natën ngrihej i përulur për t'u lutur dhe për t'iu përkushtuar Allahut me adhurim dhe asketizëm. Asketi zakonisht nuk lufton dhe luftëtari zakonisht nuk është asket, por Aliu (Paqja qoftë mbi të!) i bashkoi të gjitha këto cilësi në një personalitet të vetëm.

Ne nuk mund ta arrijmë këtë nivel, por mund të ndjekim shembullin e tij: të ndihmojmë të varfrit dhe të dobëtit e vendit tonë, duke u përpjekur të jetojmë sipas frymës dhe mësimeve që ai la pas".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 19.

Dijetarët shi'itë, mbrojtësit e fesë dhe të umetit

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) gjithmonë i konsideronte dijetarët shi'itë si vazhdim të vijës së imamëve të pagabueshëm. Ata ruajtën fenë dhe e mbrojtën atë me pendën e tyre, me diturinë, kuptimin dhe gjakun e tyre, me përpjekjet dhe durimin e tyre. Për këtë arsye, përballja e tyre me sunduesit tiranë i ekspozoi gjithmonë përballë shumë vështirësive. Megjithatë, këta sakrifikues të përhershëm gjithmonë kanë qenë dhe mbeten si mburojë e gjallë, duke u përballur me shigjetat e armiqve.

Midis të tjerash, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "*Paqja qoftë mbi dijetarët e hershëm shi'itë, të cilët qëndruan me vendosmëri dhe u solidarizuan në mënyrë të pathyeshme, duke u përballur me agjentët e huaj, pa nder, pa u trembur nga armët e tyre, zhurmat apo përpjekjet e dështuara.*

Paqja qoftë mbi burrat e fesë dhe dijetarët më të virtytshëm të shkollës shi'ite, nga Nexhefi i nderuar deri në skajet e largëta të Iranit, të cilët, me veprën e tyre të madhe, qëndruan të bashkuar përballë tiranëve dhe grabitësve.

Paqja qoftë mbi të rinjtë e guximshëm në shkollat fetare të Kumit, të vetëdijshëm dhe vigjilentë, që vazhduan lëvizjen e rilindjes së dijetarëve fetarë dhe e bënë atë të lulëzojë me madhështi.

Paqja qoftë mbi të rinjtë entuziastë dhe të vetëdijshëm në universitetet iraniane, të cilët dëshmuan besnikërinë e tyre ndaj Islamit të

madh dhe ndaj atdheut të tyre të çmuar, përmes kryengritjeve të vazhdueshme dhe të ndërgjegjshme.

Paqja dhe përshëndetjet qoftë mbi popullin e madh iranian, i cili, pavarësisht të gjitha shtypjeve dhe presioneve, ka mbrojtur Islamin, ka mbështetur drejtësinë dhe ka bërë sakrifica, duke përfshirë edhe jetën e tij, në mbrojtje të të shtypurve dhe në rrugën e fesë".[1]

"Dijetarët tanë janë ngritur në kryengritje që nga fillimi i Islamit e deri më sot. Edhe në kohën e imamëve, bijtë e imamëve janë ngritur. Kjo ka qenë në mbrojtje të fesë. Gjithashtu, edhe në kohën tonë kemi parë disa revolta të udhëhequra nga dijetarët. Por, disa të majtë dhe të devijuar thonë se janë bashkëpunëtorë të oborrit mbretëror. Nuk është çudi që ata flasin kështu, sepse nuk kanë studiuar dhe veshët e tyre janë të shurdhër. Le të dinë ata sa herë janë ngritur dijetarët e Islamit në kohën e Riza Shahut dhe Muhamed Riza Shahut, kur mblidheshin dijetarët e Isfahanit, Azerbajxhanit, Meshedit dhe Kumit dhe shprehnin kundërshtimet e tyre".[2]

"Askush pas të Dërguarit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk ka qenë më i mirë se ai, as nuk do të ketë dikush si ai në të ardhmen. Por për të siguruar vazhdimësinë e udhëheqjes së umetit islam, duhej të caktoheshin të aftët nga vetë Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Prandaj, para se të largohej te Zoti i Tij, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) caktoi pasuesin e tij, dhe ata pasues, nga ana e tyre, caktuan imamët e umetit, deri në kohën e fshehjes (gajbi). Edhe pasardhësit e tyre, me përgjegjësinë e caktimit,

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 3, f. 283.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 4, f. 69.

përcaktuan imamin e umetit. Kështu, ky umet nuk është lënë kurrë pa një Imam dhe udhëheqës.

Kur imamatët e udhëzimit ishin të pranishëm, ata vepronin si udhëheqës të drejtpërdrejtë. Pas tyre, rolin e ruajtësve të drejtësisë dhe dijes e morën dijetarët e fik'hut, të përkushtuarit, ata që njohin të vërtetën e Islamit dhe ia kthejnë shpinën botës, të cilët nuk joshen nga zbukurimet e saj, asketët e përulur dhe të sinqertët në shërbimin e popullit dhe e konsiderojnë veten pjesë të tij. Këta janë ata që janë caktuar si pasues të të Dërguarit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) për të ruajtur umetin islam".[1]

"Kumi, është vendi i shenjtë i Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) dhe qendra e dijes, devotshmërisë, burrërisë dhe sakrificës. Nëpërmjet tij janë përhapur dritat e dijes në të gjitha vendet e botës dhe deri më sot ky pishtar ndriçon rrugën për shumë njerëz. Ky qytet ka regjistruar faqet më madhështore të burrërisë dhe heroizmit dhe, që prej kohës së imamëve të pastër (Paqja qoftë mbi ta!), ka qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes së myslimanëve, fortesa e Islamit dhe kështjella e tij e pathyeshme. Prej tij kanë shpërthyer burime dijeje dhe devotshmërie. Në të janë rritur farërat e besimit, dijes dhe devotshmërisë.

Lus Allahun e Lartësuar që ta mbrojë dhe ta ruajë atë, dhe ta mbajë si një burim të pashtershëm për dijen dhe devotshmërinë deri në shfaqjen e Imam Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!)".[2]

Për të përkujtuar dhe për të shprehur mirënjohjen ndaj rolit të dijetarëve dhe juristëve të fesë (fakihëve) së shi'itëve, në mbrojtjen e Islamit dhe të umetit, imami u kushtoi atyre një

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 25.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 13, f. 128.

deklaratë historike, në vitin e fundit të jetës së tij të ndritur. Ndër të tjera tha: "*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij dhe mbi shpirtrat e pastër të martirëve, veçanërisht mbi martirët e shkollave fetare dhe dijetarët e dashur të fesë. Një përshëndetje e veçantë për ata që bartin amanetin e shpalljes dhe mesazhit, gardianët e martirëve, të cilët morën mbi supe detyrimin për të ruajtur madhështinë dhe krenarinë e Revolucionit Islamik!*

Paqja qoftë mbi ata që krijuan epopenë e pavdekshme! Paqja qoftë mbi dijetarët e fesë, që shkruan veprat e tyre shkencore dhe praktike me gjakun e tyre dhe thelbin e fesë, dhe që nga jeta e tyre ndërtuan një llambë që ndriçon natën mbi minberin e udhëzimit, këshillës dhe thirrjes për njerëzit!

Paqja qoftë mbi pasardhësit tuaj, që u ngritën me të vërtetën deri në shfaqjen e saj dhe u bënë paralajmërues të sinqertë për popullin dhe kombin e tyre, duke e provuar këtë me sinqeritetin, devotshmërinë, piklat e gjakut dhe flijimin e trupave të tyre. Vërtet, nuk pritej ndryshe nga dijetarët e Islamit dhe burrat e sinqertë të Shi'izmit, veçse të ishin ata të parët që flijoheshin për të ndjekur të vërtetën dhe për të ecur në rrugën e luftës për bijtë e popullit të tyre, duke bërë që dëshmia të bëhej vula përfundimtare e veprës së tyre.

Ata arritën rrethin e kujtimit të dijetarëve të Zotit dhe lutjes së atyre që ngrihen për falje në agimin e natës, në mes të hauzeve fetare dhe dijetarëve të fesë. Ata nuk panë asgjë tjetër në vetveten e tyre përveç dëshirës për martirizim dhe nuk kërkuan nga dhuratat e Allahut tjetër gjë përveç sinqeritetit dhe afrimit tek Ai, përmes dhuratës së dëshmisë. Sigurisht, jo të gjithë ata që e dëshirojnë dhe e kërkojnë dëshminë, e arrijnë atë. Shumë si unë kanë kaluar jetën në errësirën e pengesave dhe mbulesave, pa gjetur një shans për veprim përveç letrës dhe librit. Njëri

prej tyre digjet në natën e parë të gjatë të jetës nga epshet, pastaj lidhet me dashurinë dhe dëshminë në mëngjesin e magjepsjes së saj.

Ndërkohë që unë, i hutuar dhe ende larg nga të gjitha gjërat në ekzistencë, si mund ta përshkruaj karvanin e zotërinjve të ekzistencës? Unë dhe të ngjashmit e mi nuk kemi dëgjuar prej këtij karvani tjetër gjë përveç tingullit të kambanave…

Në çdo rast, shumë cilësi, si: kënaqësia, guximi, durimi, asketizmi, kërkimi i dijes dhe pavarësia nga fuqitë e mëdha dhe mbi të gjitha ndjenja e përgjegjësisë përpara popujve, bënë nga dijetarët një trup të gjallë, të qëndrueshëm dhe të dashur. A ka nder më të madh se sa revolucioni i dijetarëve të fesë, të cilët, edhe me pak mundësi, mbollën farat e mendimit të pastër islam në tokën pjellore të ideve të myslimanëve dhe kujdesit të tyre, duke bërë që filizi i shenjtë i jurisprudencës të lulëzojë në kopshtet e jetës shpirtërore të mijëra studiuesve?

Megjithëkëtë madhësi, lavdi dhe ndikim, a nuk është naive të mendohet nga disa se dijetarët e fesë mund të ndjekin kolonializmin?"[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 250-253.

Jurisprudenca shi'ite dhe vazhdimësia e Islamit

Nga vetë këndvështrimi i Shi'izmit, imamëve, udhëheqësve dhe dijetarëve të tij, jurisprudenca shi'ite shihet si ligji ynë dhe burim për realizimin e një jete të denjë, në përputhje me objektivat e Islamit të vërtetë dhe me përparimin e shoqërive fisnike islame. Nuk është një jurisprudencë e ngrirë dhe e ngurtë, por një jurisprudencë lëvizëse, dinamike, që zhvillohet dhe përshtatet me kohën dhe hapësirën, dhe një interpretim i hapur ndaj kërkesave të epokave dhe brezave. Prandaj, jurisprudenca shi'ite është ndër më të pasurat në botë.

"Tani mund të shikoni pasurinë e jurisprudencës shi'ite. Jurisprudenca shi'ite është më e pasura në botë. Ligji i shpjeguar dhe i zhvilluar nga dijetarët shi'itë është më i pasuri ndër të gjitha ligjet. Nuk ka në botë ndonjë sistem tjetër ligjor që të ketë një pasuri të tillë. Ligjet e tjera, edhe sikur të duken të pasura, nuk arrijnë te kjo thellësi, sepse ato janë ligje tokësore, të vendosura nga njerëz të kufizuar dhe perceptimet e tyre janë të pamjaftueshme. Siç thuhet në një transmetim: 'O biri i Ademit, edhe sikur të hahej zemra jote, nuk do të ngopej asnjë zog prej saj'.

Ai që ka ligje për çdo gjë, është Islami dhe ndër jurisprudencat islame, më e pasura është jurisprudenca shi'ite. Nuk ka në botë një jurisprudencë të ngjashme me të, as mes myslimanëve për nga numri i tyre, e as mes jobesimtarëve.

E gjithë kjo pasuri u arrit falë përpjekjeve të mëdha të dijetarëve shi'itë. Që nga koha e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë

mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe pas kohës së Imamëve (Paqja qoftë mbi ta!), dijetarët shi'itë mblidheshin te imamët dhe merrnin prej tyre rregullat islame, duke i dokumentuar dhe duke i transmetuar për gjeneratat e ardhshme".[1]

"Kjo jurisprudencë është shpjeguar me gjuhën e vetë Kur'anit, u nevojitet njerëzve deri në fund të kohës dhe u përgjigjet të gjitha çështjeve të reja.

Me të vërtetë, kjo është jurisprudenca e përmendur në Librin dhe Sunetin, e cila u shpjegua nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), dhe përmban shumicën e nevojave të dukshme dhe shpirtërore, filozofike dhe mistike, për të gjithë njerëzimin, deri në Ditën e Gjykimit. Po, kjo është përmbajtja e Kur'anit fisnik dhe zbulimi i kësaj madhështie, që ne nuk mund t'ua përshkruajmë atyre veçse me atë që u takon".[2]

"Shkollat juridike islame janë ato që kanë ruajtur Islamin ndër shekuj dhe gjatë qindra viteve. Dijetarët tanë e filluan rrugën e tyre duke mbrojtur jurisprudencën në kohën e imamëve të pastër dhe ata ende vazhdojnë përpjekjet e tyre për të mbrojtur jurisprudencën islame deri më sot".[3]

"Pra, çdo gjë që gjendet në Islam dhe në Kur'an, çdo njohuri që njerëzit janë të aftë ta kuptojnë, është ruajtur dhe zhvilluar nga ky grup dijetarësh të devotshëm, me çallma dhe mjekra. Sipas fjalëve dhe shkrimeve të këtyre dijetarëve, ata e transmetuan Islamin te ne. Librat që ata shkruan, në çdo degë dhe fushë që ju mund të shihni, bënë të mundur që Islami të vijë deri te ne. Këta dijetarë u përkushtuan për të shkruar, për të mësuar

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 3, f. 223.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 20, f. 330.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 13, f. 17.

dhe bënë përpjekje të mëdha, duke e përcjellë dijen islame deri te brezat e sotëm. Çdo arritje, në nivelin e dijes islame sot, është rezultat i përkushtimit dhe i sakrificës së tyre".[1]

"Për sa u përket mësimeve dhe kërkimeve brenda medreseve, unë besoj në jurisprudencën tradicionale dhe në ixhtihadin e Xhevaherit, dhe e shoh të papranueshme shmangien prej tyre. Ixhtihadi, me këtë metodë, është i saktë, por kjo nuk do të thotë se jurisprudencës islame i mungon fleksibiliteti. Përkundrazi, koha dhe vendi janë dy elemente kryesore të ixhtihadit.

Është e mundur që një çështje, e cila më parë kishte një gjykim të caktuar, sot të kërkojë një gjykim të ri, për shkak të ndryshimeve në marrëdhënie dhe rregullat që sundojnë mbi politikën, shoqërinë dhe ekonominë. Përmes njohurive të sakta mbi këto marrëdhënie të reja, ajo çështje, që duket sikur nuk ndryshon nga e mëparshmja, në të vërtetë, bëhet një problem tjetër që kërkon një gjykim të ri dhe të domosdoshëm. Prandaj, muxhtehidi duhet të jetë i njohur mirë me çështjet e kohës së tij. Njerëzit dhe të rinjtë, madje edhe masa e përgjithshme, nuk do të pranojnë nga një marxh ose muxhtehid justifikimin e mungesës së njohurive mbi çështjet politike. Njohja e plotë është mënyra e vetme për të përballuar mashtrimin, manipulimin dhe shtrembërimin në kulturën vendase.

Njohja e qartë e ekonomisë, e politikave dhe e marrëdhënieve me ekonominë botërore, si dhe kuptimi i rolit të kapitalizmit dhe marksizmit, me pikat e tyre të forta dhe të dobëta, janë elemente që përcaktojnë tiparet dhe strategjinë e sistemit botëror. Të gjitha këto janë pjesë e veçorive të një muxhtehidi të plotë. Ai duhet të jetë i mençur, i zgjuar dhe i aftë, sepse udhëheq një shoqëri të madhe islame, madje edhe joislame. Ai duhet të jetë

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 3, f. 223-224.

një drejtues dhe administrator i vërtetë, përveç devotshmërisë, përulësisë dhe asketizmit që e karakterizon.

Nga këndvështrimi i një muxhtehidi të vërtetë, qeveria është aplikimi praktik i dispozitave juridike islame në jetën e përditshme. Qeveria mishëron praktikën e jurisprudencës në përballjen me sfidat shoqërore, politike, ushtarake dhe kulturore. Jurisprudenca është teoria e realitetit të integruar për drejtimin e njeriut nga djepi deri në varr. Qëllimi themelor është të zbatojmë bazat e rregullave të fik'hut në jetën e individit dhe të shoqërisë, duke ofruar përgjigje të sakta për problemet që lindin. Arroganca më e madhe lind kur shikohet se praktikimi i fik'hut dhe ixhtihadit mungon në përkthimin praktik dhe përballjen me realitetet, të cilat krijojnë fuqinë dhe aftësinë për përballje".[1]

"Prandaj, dera e ixhtihadit duhet të jetë gjithmonë e hapur në qeverinë islame. Natyrshëm, natyra e revolucionit dhe e sistemit kërkon gjithmonë që mendimet juridike dhe fetare të paraqiten në të gjitha fushat, edhe nëse ato janë të ndryshme, në mënyrë të lirë dhe askush nuk ka të drejtë ta pengojë këtë. Por e rëndësishme është që njohuria e saktë për qeverinë dhe shoqërinë, e cila e bën të aftë sistemin islam për planifikim dhe organizim në përputhje me këtë, të orientohet drejt së mirës së myslimanëve, sepse uniteti i vizionit dhe veprimit është një çështje e domosdoshme. Në këtë aspekt, ixhtihadi, në kuptimin e tij tradicional, nuk është më i mjaftueshëm. Përkundrazi, edhe nëse muxhtehidi është më i dituri në shkencat e seminarit tradicional, por është i paaftë të përcaktojë interesin e shoqërisë, ose nuk është në gjendje të dallojë midis personave të drejtë e të dobishëm nga të tjerët, pra, i mungon vizioni i drejtë dhe aftësia për të marrë vendime në fushën shoqërore dhe politike, një njeri i tillë nuk mund të quhet më muxhtehid në çështjet shoqërore dhe qeveritare, dhe nuk

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 262.

mund t'i dorëzohet atij drejtimi i punëve të shoqërisë. Si rrjedhim, nuk është i aftë për këtë detyrë".[1]

"Është e domosdoshme që të mos lejohet që dijetarët dhe mësuesit e respektuar të devijojnë në studimet e tyre në fushën e fik'hut dhe të parimeve, duke u larguar nga rruga e dijetarëve të mëdhenj, rrugë që përfaqëson mënyrën e vetme për ruajtjen e fik'hut islam. Ata duhet të punojnë për të shtuar çdo ditë saktësinë, kërkimin, kreativitetin, si dhe të kujdesen për ruajtjen e metodës tradicionale në fik'h, të cilën na e kanë lënë trashëgim paraardhësit e drejtë. Largimi prej tij çon në dobësimin e bazave të verifikimit, kërkimit dhe kontrollit, duke e kthyer atë në hetime të tjera. Është e natyrshme që të përgatiten programe për fusha të tjera shkencore, në përputhje me nevojat e vendit dhe të Islamit.

Gjithashtu, është e domosdoshme të përgatiten specialistë në ato fusha, por fushat më të larta, mbi të cilat duhet të përqendrohen përpjekjet e arsimit dhe mësimit, janë shkencat shpirtërore islame, si: shkenca e moralit, edukimi i shpirtit dhe udhëzimi në rrugën drejt Allahut, sepse ky është xhihadi më i madh".[2]

"Me pak fjalë, duhet të kujdesemi që të mishërojmë fik'hun praktik islam, larg nga diplomacia dominuese në botë dhe pa iu nënshtruar Perëndimit mashtrues apo Lindjes agresore. Përndryshe, përderisa fik'hu mbetet i fshehur në libra dhe në kraharorët e dijetarëve,, nuk do të ndikojë te tiranët ndërkombëtarë. Por, nëse dijetarët e fesë nuk kanë një prani aktive në çështjet dhe problemet madhore, nuk do të jenë në gjendje të kuptojnë se ixhtihadi, në kuptimin terminologjik, nuk është i mjaftueshëm për drejtimin e shoqërisë. Hauzet fetare dhe dijetarët e fesë janë gjithmonë të thirrur të përballen me lëvizjen e shoqërisë, me nevojat dhe kërkesat e

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 162.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 379.

saj të ardhshme, dhe duhet të jenë të përgatitur për të marrë vendimet e duhura përballë ngjarjeve, përpara se ato të ndodhin, sepse është e mundur që metodat e zakonshme për drejtimin e shoqërisë, të ndryshojnë në vitet e ardhshme dhe vetë shoqëritë njerëzore të kenë nevojë për ide të reja islame për të gjetur zgjidhje për problemet e tyre. Prandaj, dijetarët e mëdhenj të Islamit duhet të mendojnë për këtë që tani".[1]

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: *"Unë shpresoj që popujt islamë, me përulësi të plotë dhe këmbëngulje, të ndjekin shembullin e imamëve të pastër, udhëheqësve të mëdhenj të njerëzimit dhe të përpiqen me seriozitet të madh për të ndjekur metodën e tyre politike, shoqërore, ekonomike dhe ushtarake, në format më të përshtatshme dhe të më buta, me përulësi dhe krenari në këtë rrugë. Ndër këto përpjekje është edhe shmangia nga kufizimi vetëm në jurisprudencën tradicionale, e cila përfaqëson identitetin e shkollës së mesazhit dhe imamatit, që është siguri për udhëzimin dhe nderimin e popujve. Qoftë kjo në dispozitat parësore apo dytësore, të dyja i përkasin shkollës së jurisprudencës islame, duke theksuar mosdëgjimin ndaj atyre që pështpëritin në fshehtësi dhe ndaj të shkëputurve nga e vërteta dhe feja. Le të jenë të bindur se çdo hap devijues nënkupton lejen për të shkatërruar fenë, dispozitat islame dhe qeverisjen e drejtësisë hyjnore".*[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 264.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 360.

Udhëheqja e dijetarit, siguri dhe udhëzim

Nga thellësia e mendimit politik dhe jurisprudencës shi'ite, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) nxori teorinë e "*uilajetul fakijh"* (udhëheqjes së juristit). Ai e zgjeroi horizontin e saj dhe e nxori nga korniza teorike në kornizën praktike, duke e shndërruar atë në siguri për revolucionin islamik dhe për shtetin e Islamit në Iran dhe udhërrëfyes për myslimanët dhe të lirët e botës, në mënyrë që ata të mund ta ruajnë Islamin dhe të mbrojnë humanizmin e njeriut në këtë tokë. Teoria e udhëheqjes së juristit, megjithëse iu nënshtrua shumë kritikave dhe intrigave nga armiqtë, u mbrojt fuqimisht nga Imami, duke e konsideruar atë si shtyllën kryesore të qëndrueshmërisë së revolucionit islamik dhe të mbrojtjes së arritjeve të tij.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "*Është vërtet për të ardhur keq që disa njerëz, të cilët nuk kuptojnë thellësisht realitetin e sistemit islamik, mendojnë se, nëse udhëheqja e juristit përcaktohet në kushtetutë, kjo do të çonte në krijimin e një diktature. Në fakt, është krejt e kundërta: ekzistenca e saj pengon shfaqjen e diktaturës dhe tiranisë.*

Mungesa e "udhëheqjes së juristit" është ajo që krijon mundësinë e diktaturës. Fak'hiu është faktori i vetëm që mbron umetin nga tirania, qoftë e Presidentit të Republikës, e komandantit të përgjithshëm të forcave të armatosura, e shefit të xhandarmërisë, e kryetarit të policisë apo e kryeministrit. Ai është fak'hiu i caktuar për të udhëhequr umetin islam me

cilësitë e duhura, sepse roli i tij është të shkatërrojë çdo formë tiranie dhe të bashkojë umetin nën flamurin e Islamit dhe nën sundimin e ligjit.

Qeveria islame është qeveri e ligjit, d.m.th e ligjit hyjnor, bazuar në Kur'anin e shenjtë dhe në Sunetin e ndritur. Shteti është i varur nga ky ligj. Madje edhe i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishin të dy të nënshtruar ndaj ligjit. Historia nuk na ka treguar se ata asnjëherë nuk e kanë shkelur ligjin në ndonjë çështje. Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar ka thënë: ***"Sikur ai*** *(Muhamedi),* ***në mënyrë të rreme, të Na kishte veshur ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim atë për dorën e djathtë dhe me siguri që do t'ia prisnim damarin e qafës".***[1] *Prandaj, në Islam nuk ka diktaturë dhe as tirani. Të gjitha çështjet në Islam janë të bazuara mbi ligjin.*

Nëse rojet e Islamit duan të sillen me tirani, atëherë ata, me gjykimin e Islamit, bien dhe rrëzohen nga postet e tyre. Unë i paralajmëroj ata që përpiqen t'i trembin njerëzit nga kushtetuta, për të cilën më parë votuan një numër i madh dijetarësh të Islamit dhe specialistësh. Prandaj, mos lejoni që këta t'ju mashtrojnë duke ju thënë: 'Kushtetuta nuk ka asgjë demokratike.

Ata, gjithashtu, thonë se Islami nuk ka asgjë të përbashkët me demokracinë, prandaj mos lejoni që ata t'ju mashtrojnë. Kushtetuta do t'ju paraqitet për votim (pas një jave, dy javësh ose tre javësh), prandaj mos i dëgjoni këta për të mos votuar. Shkoni dhe votoni, dhe pas kësaj do ta shihni këtë ligj të shpallur dhe të botuar në gazeta. Ju jeni të lirë më pas të jepni mendimin tuaj; mund ta pranoni atë ose ta refuzoni. Nëse e refuzoni, do të shkruhet sërish në një formë tjetër, më të qartë. Nëse e pranoni, votoni për të. Mos qëndroni indiferentë, sepse e ardhmja juaj dhe Islami juaj dhe

1 Sure "Hakkatu", ajetet 44-46.

vendi juaj lidhen me këtë ligj. Ajo që duhet të diskutohet sot në shesh, janë çështjet themelore: dua të them çështja e kushtetutës, çështja e republikës, çështja e këshillit të Shuras (Konsultimi) dhe e Këshillit Konsultativ Islamik. Ju duhet të jeni të vëmendshëm ndaj kësaj dhe të mos hezitoni përballë saj, sado të mëdha të jenë kostot".[1]

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: *"Mos kini frikë nga çështja e udhëheqësit fetar. Fak'hiu nuk synon përdorimin e forcës dhe imponimin e mendimeve të tij mbi popullin, sepse, nëse do të bënte kështu, do të rrëzohej autoriteti i tij. Në Islam nuk ka asgjë mbi ligjin; sundimtari i vërtetë është ai që i bindet ligjit. Ky ishte edhe i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili vetë ishte i nënshtruar ndaj ligjit hyjnor dhe nuk kishte të drejtë ta shpërfillte atë. Allahu i Lartësuar thotë në Librin e Tij Madhështor:* **"Sikur ai** (Muhamedi), **në mënyrë të rreme, të Na kishte veshur ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim atë për dorën e djathtë dhe me siguri që do t'ia prisnim damarin e qafës".**[2]

Prandaj, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk ishte diktator dhe as Imami Aliu (Paqja qoftë mbi të!) nuk ishte diktator. Po ashtu, fak'hiu i kohës sonë nuk është diktator. Udhëheqësi i fesë nuk ka të bëjë fare me diktaturë, sepse diktatura është e përjashtuar në mënyrë absolute nga ky këndvështrim.

Udhëheqës i fesë do të thotë të mbikëqyrës çështjet dhe t'i ruash ato, që të mos dalin nga rruga e tyre natyrore, të mbikëqyrës funksionimin e parlamentit, të mbikëqyrës Presidentin e republikës që të mos gabojë, të mbikëqyrës kryeministrin dhe të mbikëqyrës të gjitha organet qeveritare, përfshirë ushtrinë. Ne jemi duke luftuar diktaturën, në të gjitha format e

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 26.
2 Sure "Hakka", ajetet 44-46.

saj dhe nuk synojmë ta rikthejmë atë përsëri. Udhëheqësi i fesë nuk është kundër të vërtetës, siç ju e imagjinoni apo e mendoni gabimisht. Pse e ngatërroni kështu? Ju supozoni se ai ka të drejtë të bëjë çfarë të dojë, por kjo nuk është e vërtetë. Sado që të shkruani apo të përhapni dyshime e iluzione, nuk do të arrini gjë. Unë mendoj se braktisja e kësaj gjuhe, e këtyre trazirave dhe iluzioneve është më e mira për ju".[1]

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: *"Mos u merrni me atë që thonë të devijuarit e çoroditur, të cilët e quajnë veten të ndriçuar dhe duan të refuzojnë udhëheqësin e fesë. Nëse nuk është fak'hiu në krye të punëve, atëherë aty do të sundojë tirania. Udhëheqësi i fesë është ose Allahu, ose tirania… Nëse Presidenti i Republikës nuk emërohet sipas urdhrit të Allahut dhe me urdhër nga fak'hiu, atëherë udhëheqja e tij nuk e ligjore. Nëse presidenca e tij nuk është legjitime, atëherë ajo është tiranike dhe bindja ndaj tij është bindje ndaj tiranit; hyrja nën urdhrat e tij është hyrje nën urdhrat e tiranit. Përshkrimi i tiranisë nuk zhduket, derisa të caktohet sipas urdhrit të Allahut të Madhëruar. Prandaj, mos kini frikë nga disa individë të verbër që nuk e njohin thelbin e Islamit, nuk e kuptojnë çfarë do të thotë fak'hiu dhe çfarë do të thotë udhëheqësi i fesë, dhe e imagjinojnë atë si një katastrofë për shoqërinë. Në të vërtetë, ajo që ata e shohin si katastrofë, është mungesa e udhëheqësit të fesë. Ata e shohin në Islam katastrofën, kurse në të vërtetë, katastrofa është mosqenia e udhëheqësit të fesë. Udhëheqësi i fesë nuk është katastrofë, përkundrazi është një parim islam".*[2]

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka sqaruar dimensionet e mëdha dhe kompetencat absolute të *udhëheqësit të fesë* në një letër të qartë që ia dërgoi Presidentit të republikës. Midis

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 226-227.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 159.

të tjerash i shkruante: *"Nëse kompetencat e qeverisë kufizohen vetëm brenda dispozitave dytësore të jurisprudencës, atëherë qeveria do të ishte një institucion pa vlerë, pa kuptim dhe pa përmbajtje. Në fakt, koncepti i qeverisë hyjnore, që iu dha Profetit të Islamit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), lidhet me situata praktike që nuk mund të shmangen: për shembull, ndërtimi i rrugëve që kërkon marrjen e pronës ose shpronësimin e shtëpive; shërbimi ushtarak i detyruar dhe dërgimi i ushtarëve në fronte; ndalimi i hyrjes dhe daljes së valutës dhe mallrave; ndalimi i monopoleve dhe rregullimi i burimeve të tyre; doganat dhe taksat; ndalimi i mashtrimeve tregtare dhe manipulimeve të çmimeve; ndalimi i shpërndarjes së drogës; ndalimi i të gjitha formave të alkoolit dhe pijeve dehëse; posedimi i armëve në të gjitha format; dhe qindra çështje të tjera që përbëjnë kompetencat e shtetit, dhe që nuk hyjnë brenda dispozitave dytësore juridike.*

Duhet të theksojmë se qeveria, si degë e udhëheqjes së plotë të të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), është një nga dispozitat themelore të Islamit dhe ka përparësi ndaj të gjitha dispozitave dytësore, madje edhe ndaj detyrimeve të namazit, agjërimit dhe haxhit.

Sundimtari ka të drejtë, për shembull, të shembë një xhami ose një shtëpi që ndodhet në rrugë, duke i paguar pronarit vlerën e saj; madje mund të mbyllë dyert e xhamive dhe t'i përdorë në rast nevoje, ose të shembë një xhami që pengon interesat e Islamit. Po ashtu, qeveria mund të anulojë kontratat ligjore që bien ndesh me interesat e shtetit dhe të Islamit, duke vendosur kufijtë e tyre, qofshin ato çështje fetare apo jo. Madje, qeveria mund të ndalojë përkohësisht kryerjen e haxhit, nëse e

konsideron se kjo bie ndesh me interesat e shtetit islam, edhe pse haxhi është një nga obligimet më të rëndësishme hyjnore".[1]

Imami Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!), në testamentin e tij, këshillonte për domosdoshmërinë e mbështetjes mbi dispozitat e vilajetit të fukahave, për të administruar interesat e vendit. Ai thoshte: "*Unë e këshilloj Këshillin e Ruajtjes së Kushtetutës, si gjeneratën e tanishme, ashtu edhe gjeneratat e ardhshme, që të jenë të kujdesshëm në përmbushjen e detyrimeve të tyre islame dhe kombëtare, me saktësi dhe vendosmëri, të ruhen nga rënia, nën ndikimin e çfarëdo autoriteti, të mos lejojnë nxjerrjen e ligjeve që bien ndesh me sheriatin e pastër dhe me kushtetutën, pa marrë parasysh ndonjë konsideratë tjetër; të jenë gjithmonë vigjilentë ndaj interesave të vendit, të cilat duhet të realizohen herë përmes dispozitave dytësore, herë përmes udhëheqësit të fesë".*[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 20, f. 366-367.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 376.

Shi'izmi, pararendës i unitetit islam

Duke u qartësuar roli i Shi'izmit në Islam, bëhet e dukshme roli i tij në thirrjen për unitetin islam, duke e ngritur këtë jo vetëm si parullë, por edhe me vepra. Ky ka qenë gjithmonë zakoni i udhëheqësve dhe dijetarëve shi'itë. Mbi këtë frymë eci dhe jetoi edhe Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Për vlerën e tij në revolucionin islamik, midis të tjerash, ka thënë: *"Qëllimi ynë në thirrjen për unitet mes myslimanëve – qofshin shi'itë apo suni – si dhe ndërmjet popujve e qeverive të vendeve tona, është që të qëndrojmë pranë njëri-tjetrit dhe të veprojmë si një trup i vetëm. Nëse myslimanët janë të bashkuar, askush nuk do të guxonte t'i sulmonte, sepse ata përbëjnë një miliard besimtarë, me pasuri të mëdha dhe mjete të fuqishme në dispozicion. Atëherë, çfarë na bën të jetojmë nën ndikimin e dy fuqive të mëdha, kur zotërojmë kaq shumë pasuri dhe toka të gjera?*

Shkaku gjendet tek ne vetë: nuk i kemi qëndruar besnikë mësimeve të Kur'anit dhe as qeveritë tona nuk i kanë dëgjuar ato. Në të thuhet: "Mos i merrni çifutët dhe të krishterët për miq". Pra, jobesimtarëve nuk duhet t'u besohet e as të mbështetemi tek ata. Megjithatë, disa prej nesh u bënë agjentë të tyre. Në kohën e Muhamed Reza Shahut, pasuritë e vendit viheshin në shërbim të tyre, ndërsa mbi popullin rëndonte nënshtrimi dhe poshtërimi; u jepeshin të mirat, ndërsa prej tyre merreshin dëme e vuajtje. E njëjta dukuri vërehet edhe sot në disa vende të tjera. Pse ndodh kjo? Sepse ne jemi të përçarë mes vete".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 15, f. 392.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "*Që të gjitha grupet duhet të kujdesen për vëllezërit e tyre dhe të dinë se ka nga ata që kundërshtojnë Islamin dhe përpiqen të përhapin përçarje dhe ndarje midis vëllezërve shi'itë dhe suni. Këta nuk duan as të mirën e shi'itëve, as të sunive. Prandaj, të gjithë vëllezërit duhet të pajisen me vetëdije dhe të jenë të kujdesshëm për unitetin e tyre. Ne kemi një armik të përbashkët përballë nesh dhe duhet të mos e lejojmë këtë armik të na sulmojë dhe të depërtojë në radhët tona, duke përhapur përçarje e ndarje midis nesh*".[1]

Gjithashtu, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "*Vëllezërit tanë shi'itë, vëllezërit tanë suni, duhet të jeni vigjilentë. Nëse dikush ju vjen dhe ju flet për vëllezërit tuaj shi'itë dhe pastaj shkon te të tjerët e u flet për sunive, dijeni se ky është i njëjti plan i kurdisur nga disa udhëheqës shumë të korruptuar, madje edhe nga disa shtete. Jini të vetëdijshëm dhe punoni për t'i dështuar këto plane dhe kurthe djallëzore. Ju të gjithë jeni vëllezër me njëri-tjetrin dhe Kur'ani i shenjtë ka forcuar lidhjen e vëllazërisë mes myslimanëve:* **"Vërtet, besimtarët janë vëllezër".**[2] *Nuk është e lejueshme që një vëlla të dëgjojë fjalët e atij që dëshiron të fusë përçarje midis tij dhe vëllait të tij. Dijeni se, nëse ndodh një ndarje e tillë, ajo nuk do të jetë në dobi të shi'itëve dhe as në dobi të sunive, por do të jetë në dobi të jobesimtarëve, të cilët duan ta shkatërrojnë Islamin dhe do të përfitojnë prej saj. Ne i lutemi Allahut që të gjitha pasojat e çështjeve tona, t'i shndërrojë në mirësi, lumturi dhe gëzim për popullin tonë*".[3]

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "*Disa myslimanë janë shi'itë, disa janë suni, ky është hanefi, ai tjetri*

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 17, f. 402.

2 Sure "Huxhurat", ajeti 10.

3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 29.

hanbelit, e tjetri ehli hadith. Në realitet, paraqitja e këtyre çështjeve nuk është e saktë dhe nuk duhet të shpërndahet si e tillë në një shoqëri, ku të gjithë anëtarët e saj përpiqen t'i shërbejnë Islamit dhe lavdisë së tij. Të gjithë janë vëllezër në fe. I vetmi dallim mes tyre është se dikush vepron sipas një fetvaje hanefite, dikush tjetër sipas shafi'ite, e i treti si shi'it. Kjo nuk është një arsye për ndarje. Ne jemi vëllezër dhe nuk duhet të ndahemi për këto gjëra. Të gjithë vëllezërit, si shi'itët, ashtu edhe sunitë, duhet të ruhen nga ndarja. Nëse do të mendonim mirë, do të shihnim se përfituesi i vetëm nga kjo përçarje nuk është një grup shi'itësh, as sunitësh, as ndonjë grup tjetër, por një kategori që punon për të mbjellë mosmarrëveshje mes nesh dhe për të krijuar ndasi ndërmjet myslimanëve. Të gjithë janë myslimanë, të gjithë besojnë në Kur'an dhe në teuhid, dhe të gjithë luftojnë në rrugën e Kur'anit dhe i shërbejnë Islamit".[1]

"Imamët tanë të pastër gjithmonë janë përpjekur t'i vendosin të gjithë në kuadrin e bashkësisë, faleshin së bashku, ecnin nëpër funeralet e njëri-tjetrit. Por me kalimin e kohës gjërat ndryshuan dalëngadalë dhe përfituesit shfrytëzuan këto përçarje mes dy palëve, duke i ndezur kundër njëri-tjetrit, në mënyrë që t'u mundësohej të bënin çfarë të donin".[2]

"Për sa u përket çështjeve themelore të myslimanëve, ne e dimë se këta dy vëllezër, shi'itët dhe sunitë, nuk ia dolën mbanë, qoftë për shkak të pakujdesisë ose mungesës së përkushtimit, apo për shkak të duarve të liga që penguan arritjen e unitetit midis myslimanëve përballë jobesimtarëve dhe idhujtarëve. Këto duar të liga vazhdojnë ta pengojnë këtë proces.

Kështu, konfliktet midis Indisë, Pakistanit dhe Bangladeshit janë të shumta. Kjo çon në dobësimin e myslimanëve dhe forcon fuqinë e tiranëve. Ne presim nga udhëheqja që të përpiqet për zgjidhjen e

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 13, f. 49.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 6, f. 80.

mosmarrëveshjeve të brendshme dhe të bashkëpunojë edhe me vendet fqinje, në mënyrë që myslimanët të bashkohen me njëri-tjetrin përballë jobesimtarëve dhe idhujtarëve. Këta nuk duan që Islami të mbetet i fortë, prandaj përpiqen të na privojnë nga virtytet tona. Kur myslimanët përfshihen në grindje mes tyre, kjo i forcon jobesimtarët, idhujtarët dhe hipokritët. Prandaj duhet të braktisim përçarjen mes nesh".[1]

"Ka edhe një çështje tjetër që ishte planifikuar për ta, e cila është krijimi i përçarjes midis myslimanëve, duke i ndarë ata në sekte të ndryshme, veçanërisht shi'itë dhe suni, duke i larguar nga njëri-tjetri. Qëllimi nuk ishte që shi'itët të forcoheshin apo sunitë të bëheshin më të mëdhenj, por që të dy palët të dobësoheshin. Pra, qëllimi ishte dobësimi i të dyja palëve.

E pranuar nga të gjithë ishte se ndarja midis këtyre grupeve të mëdha, sunive dhe shi'itëve në Pakistan dhe Iran, dhe në vende të tjera, ku ka pakica, kishte për qëllim përçarjen dhe ndarjen.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 16, f. 372.

Shteti islam dhe ruajtja e Islamit

Shumë herë Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka shprehur rëndësinë e shtetit dhe qeverisë islame, duke e konsideruar atë si shtyllën kryesore, që pa të nuk mund të ngrihet as feja dhe as shoqëria e drejtë islame. Për hir të një qeverie të drejtë islame dhe themelimin e saj, dhe si kundërshtim ndaj qeverive të padrejta që vepronin në emër të Islamit, sakrifikoi jetën e tij Imam Hyseni, biri i Aliut (Paqja qoftë mbi të!), në Kerbela, duke u bërë shembull i përjetshëm me gjakun e tij. Kjo ishte ëndrra e madhe për të cilën dëshironte Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!), dhe që Allahu i Lartësuar e bëri realitet. Ëndrra për të cilën profetët kanë dëshiruar me mall. Revolucioni Islamik në Iran ishte rasti dhe hyrja e domosdoshme për ta nxjerrë shtetin dhe qeverinë islame në dritë. Shteti që ndërtoi Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ishte një shtet islam i vërtetë dhe i drejtë.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "*Falënderuar qoftë Allahu, Revolucioni Islamik në Iran erdhi për t'u dhënë fund të gjitha këtyre. Unë jam jashtëzakonisht optimist, jo sepse fituam mbi Muhamed Rezain, dhe kjo nuk është gjë e vogël, përkundrazi është një gjë shumë e madhe; jo sepse fituam mbi Perëndimin dhe Lindjen, por, sepse revolucioni ynë është një revolucion njerëzor. Përmes këtij revolucioni njerëzit njohën vetveten*".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 9, f. 317.

"Revolucioni Islamik në Iran është një nga revolucionet më të suksesshme në botë. Arsyeja për këtë është qëndrimi i popullit mysliman, pas këtij revolucioni. Ky revolucion nuk lidhet me ndonjë parti apo kah të caktuar, por vetë populli ishte ai që ndezi zjarrin e revolucionit dhe e udhëhoqi marshimin e tij fitimtar. Ai gëzon një natyrë islame, sepse nuk iu drejtua askujt për dhunë, nuk vrau askënd dhe nuk ia mohoi askujt ushtrimin e veprimtarive të tij".[1]

"Të gjithë së bashku duhet të punojmë për forcimin e shtetit islamik, në mënyrë që t'i mundësohet të vendosë drejtësinë. Qeveria duhet të kujdeset edhe për aspektet shpirtërore. Meqenëse qeveria jonë është e lidhur me Islamin, ajo duhet të frymëzohet nga Islami. Vizioni islam është që të kujdeset për të dyja anët: Islami ka urdhëruar të ruhet dimensioni shpirtëror, të vendoset drejtësia dhe të shpëtohen të shtypurit nga duart e zullumqarëve. Nuk ka dallim në këtë, nëse ata shtypeshin nga qeveritë, nga tiranët apo nga sundimtarët despotë. Islami erdhi për këtë qëllim.

Duhet të kujdesemi për zbatimin e ligjeve islame në formën e tyre më të lartë. Nëse ruajmë ligjet islame në nivelin më të mirë të tyre, atëherë do të realizohen dy synime madhore, që janë synimi i të gjithë profetëve: ngritja shpirtërore e njerëzve dhe vendosja e drejtësisë në shoqëri. Prandaj ata që qëndrojnë në krye dhe ata që përbëjnë autoritetet shtetërore dhe të tjerë jashtë aparatit shtetëror, të gjithë duhet ta mbajnë këtë përgjegjësi të madhe, të jenë të bashkuar në këtë qëllim dhe të ruhen nga përçarjet. Populli, gjithashtu, duhet të marrë pjesë në arritjen e këtij qëllimi, pasi është një detyrim i përbashkët. Gjithashtu, qeveria, parlamenti dhe pushteti gjyqësor duhet të kontribuojnë për realizimin e tij. E njëjta gjë

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 276.

vlen për dijetarët e vendit, kudo që ndodhen, ata duhet të marrin pjesë në këtë qëllim".[1]

"Vendi ynë mund të quhet islamik vetëm nëse në të zbatohen realisht mësimet e Islamit. Në të kundërt, ai nuk mbetet islamik, pavarësisht se sa herë e quajmë republikë islamike. Republika islamike nuk është një emër apo një parullë që shpallet me fjalë; ajo nuk realizohet thjesht duke u deklaruar si e tillë. Sistemi mund të quhet republikë në aspektin formal, por ai bëhet vërtet islamik vetëm kur në të zbatohen dispozitat dhe parimet e Islamit. As ekzistenca e një këshilli konsultimi (shura) dhe as një ligj themelor nuk mjaftojnë, nëse ligjet islame nuk gjejnë zbatim në jetën e përditshme.

Të thuash se vendi është islamik, do të thotë që drejtësia dhe morali të jenë të pranishme në çdo fushë të jetës. Tregu duhet të funksionojë mbi baza ndershmërie e përgjegjësie, me edukim dhe disiplinë shpirtërore, jo të shndërrohet në strehë monopoli, abuzimi e padrejtësie. Një vend bëhet islamik, kur edhe burri, edhe gruaja formohen sipas vlerave islame; kur individët mishërojnë moralin dhe sjelljen e lartë; kur shembull frymëzimi është Fatime Zehraja (Paqja qoftë mbi të!) dhe udhërrëfyes mbetet Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Vetëm atëherë kemi të drejtë të pretendojmë se kemi një republikë islamike, në kuptimin e plotë të fjalës, kur në të realizohen të gjitha parimet dhe vlerat që përmban Islami. Sot ndodhemi në fillim të kësaj rruge: kemi themeluar republikën islamike me votën tonë dhe kemi larguar tradhtinë, duke prerë rrënjët e saj, por kjo nuk mjafton. Rruga mbetet e gjatë, si në

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 17, f. 327-328.

përpjekjen për të siguruar një jetë me dinjitet për nevojtarët, ashtu edhe në arritjen e vlerave të larta shpirtërore, që përbëjnë synimin më të madh".[1]

"Shteti islam është ai shtet që mbështetet te zërat e popullit në vend, në mënyrë që çdo iranian të ndiejë se po ndërton fatin dhe të ardhmen e atdheut të tij përmes votës së tij. Dhe përderisa shumica dërrmuese e këtij populli janë myslimanë, është e natyrshme që të respektohen ekuilibrat dhe mësimet islame në të gjitha fushat. Nuk u takon atyre që kanë pasur tradhti dhe kanë grumbulluar pasuri, të kundërshtojnë standardet islame apo të shkelin të drejtat e të tjerëve, duke ndërhyrë në këtë shtet. Shpresa jonë është që Irani të bëhet vendi i parë ku secili individ, edhe më i vogli, të mund të kritikojë lirshëm më të lartin në shkallën e shtetit dhe ta pyesë për funksionet e tij me liri të plotë, pa iu nënshtruar ndonjë rreziku. Duam të krijojmë një shtet, ku kursin e tij nuk e përcakton pasuria apo vlerat bosh që dalin prej saj, por ku mbizotërojnë vlerat e larta islame".[2]

"Ne duam një shtet, të cilin ta udhëheqin burra nga shi'itët e Aliut, birit të Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi të!). Personat myslimanë e kanë kuptuar kuptimin e vërtetë të Islamit. Ne duam që të gjitha institucionet tona të jenë islame, nga kuvendet tona te këshillat e tyre, nga përvojat e tyre te ushtria e tyre, nga tregjet e tyre, madje edhe fusha e sportit dhe teatrit të tyre. Nëse kjo realizohet, nuk do të ketë vend për frikë, sepse myslimani nuk mund t'i bëjë dëm myslimanit, pasi myslimani është vëlla i myslimanit. Kur'ani i shenjtë e ka përforcuar këtë marrëveshje vëllazërie mes të gjithë myslimanëve, duke thënë: **"Besimtarët janë vetëm vëllezër".**[3] *Vëllai nuk i bën dëm vëllait të tij. Ata që nuk duan një shtet islamik, kanë frikë se do t'u humbin interesat dhe përfitimet e tyre,*

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 278-279.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 303.
3 Sure "Huxhurat", ajeti 10.

përndryshe populli ynë dëshiron Islamin, sepse aty sheh të mirën dhe drejtësinë, në këtë botë dhe në Botën Tjetër".[1]

"Lufta (xhihadi) e Iranit nuk i ka nderuar vetëm shi'itët, por ka nderuar Islamin dhe njerëzimin dhe ka ruajtur dinjitetin e tij. Ata që flasin për të drejtat e njeriut, nuk i kanë dhënë njerëzimit asgjë. Ata që thërrasin me parullën 'liri', nuk kanë bërë asgjë për njerëzit. Ajo që është më e lartë për njerëzimin, ishte puna për hir të tij, dhe nismëtari për të shpëtuar njerëzimin ishte lufta e popullit iranian. Ajo që na shpëtoi, ishte lufta jonë, duke u mbështetur te Islami dhe duke iu drejtuar Allahut të Madhëruar. Ky do të jetë shpëtimi, gjithashtu, nga tani e tutje."[2]

Ju duhet ta kuptoni Islamin, që të kuptoni sistemet dhe qeveritë, kuptimin e qeverisjes dhe kuptimin e vigjilencës për sigurinë dhe qetësinë e popullit. Por, për të kuptuar se çfarë lloj drejtësie kërkon Islami, duhet të ndryshohen idetë e gabuara që i kanë mbjellë agjentët e kolonializmit në mendjet e rinisë sonë. Shtrijeni ndihmën tuaj dhe zbatoni ju vetë dispozitat e Islamit, nxisni edhe të tjerët për t'i zbatuar ato. Hiqni velat e dendura që i kanë lëshuar devijuesit mbi fytyrën ndriçuese të Islamit. Allahu do t'ju japë sukses, nëse do Ai".[3]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 182.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 19.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 270.

Përfundimi i studimit

Shi'izmi përfaqëson një shkollë burimore brenda Islamit, e ngritur me synimin për ta ruajtur dhe për ta mbrojtur fenë në të gjitha dimensionet e saj. Kjo përgjegjësi, sipas traditës shi'ite, Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij)* ia besoi Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, që në fillesat e thirrjes islame, në Mekë.

Jeta e Imam Aliut, si dhe jeta e bijve të tij, Hasan ibn Aliut dhe Hysen ibn Aliut *(Paqja qoftë mbi ta!)*, bashkë me imamët e tjerë nga pasardhësit e Hysenit dhe nga familja e Fatime Zehrasë *(Paqja qoftë mbi të)*, bija e të Dërguarit të Allahut, ka qenë e lidhur ngushtë me këtë mision: mbrojtjen e Islamit dhe ruajtjen e parimeve të tij.

Duke ndjekur gjurmët e këtyre figurave madhështore, dijetarët dhe juristët e shkollës shi'ite kanë vazhduar përpjekjen për mbrojtjen e fesë dhe përkrahjen e të shtypurve, duke u përballur me padrejtësitë, me: sakrificë, durim dhe qëndrueshmëri të palëkundur. Kjo traditë e fuqishme juridike u bë një nga themelet mbi të cilat u ngrit shteti islam në Iran, ku u përballën dhe u thyen komplotet e armiqve, duke synuar ndërtimin e një shteti që mbron Islamin dhe forcon unitetin e umetit.

Në thelb të kësaj qasjeje qëndron vëllazërimi mes bijve të umetit islam, pavarësisht dallimeve në shkolla juridike apo

përkatësi kombëtare. Sipas kësaj perspektive, Shi'izmi e sheh veten si mbrojtës të Islamit dhe si një zë që synon forcimin e unitetit islam.

KAPITULLI I KATËRT

QASJA E IMAM KHOMEINIT NDAJ SHI'IZMIT DHE SHTYLLAT E PROJEKTIT ISLAMIK

- Hyrje
- Përqendrimi te Allahu i Lartësuar
- Kapja pas udhëzimit të dy rëndesave (Kur'anit dhe Ehli Bejtit)
- Veprimi sipas detyrës hyjnore
- Sundimi i moralit
- Përballja me arrogantët dhe mbrojtja e të shtypurve
- Qeveria e drejtësisë hyjnore
- Koncepti i të shtypurit dhe i arrogantit
- Dita botërore e Kudsit

- Themelimi i partisë së të shtypurve
- Partia e Allahut (Hizbullah)
- Partia e Allahut në Liban, argument ndaj botës
- Qeveria e drejtësisë hyjnore
- Imam Mehdiu i premtuar
- Liria dhe pavarësia në Islam
- Përfundimi i studimit

Fund

Hyrje

Mund të pohohet me guxim se Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) nuk ishte thjesht një reformator i zakonshëm në historinë e Islamit; përkundrazi, revolucioni i tij, personaliteti, parimet dhe sjelljet e tij përbënin një kthesë të madhe në rrugëtimin e projektit fetar dhe islamik.

Kjo kthesë do ta mbartë, gjatë dekadave dhe shekujve të ardhshëm, me lejen e Allahut të Madhëruar, madhështinë dhe realitetin e saj, duke synuar rikthimin e projektit autentik islam në shtegun e drejtë që e dëshiroi Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët. Është pikërisht ai shteg nga i cili projekti hyjnor u shmang, pas ndarjes nga jeta e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij), për shkak të mospajtimeve të thella të umetit rreth çështjes së imamatit dhe kalifatit, si dhe për shkak të kufizimit të "dy rëndesave"- Kur'anit dhe Ehli Bejtit, nga ndikimi i tyre efektiv në drejtimin e projektit.

Megjithatë, Imami më i madh, i mishëruar në figurën e Ali ibn ebu Talibi (Paqja qoftë mbi të!), punoi gjatë gjithë jetës së tij me përkushtim të pandërprerë dhe me një durim të papërsëritshëm, për të përballuar boshllëkun vdekjeprurës për Islamin, duke arritur të ruajë nivelin minimal të nevojshëm të tipareve themelore të projektit të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij). Mirëpo, pas martirizimit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), pas një sërë luftërash dhe përballjesh me

komplotet e emevitëve, të cilët synonin ta largonin projektin islamik përgjithmonë nga boshti i tij, ndodhi fatkeqësia e madhe për umetin dhe për vetë Islamin.

Në të vërtetë, projekti hyjnor profetik-islamik u zhvendos krejtësisht jashtë kornizës së tij të parashkruar, ndërsa administratat islame të njëpasnjëshme u shndërruan në mbretëri e, ndonjëherë, në perandori. Ato përfituan nga vrulli shpirtëror dhe hyjnor i Islamit në pushtimet e tyre, por qëllimi themelor u bë zgjerimi i territoreve të këtyre "perandorive islame" në dobi të familjeve sunduese dhe rrethit të tyre, duke grumbulluar pushtet, prestigj e pasuri, si dhe gjithçka që shoqërohej me to: luks, shfrenim dhe kënaqësi të ndaluara, të cilave iu hapën dyert gjerësisht.

Po të mos kishin qenë lëvizjet reformuese dhe revolucionare që u nisën në historinë e Islamit nga duart e reformatorëve, veçanërisht nga pasardhësit e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe mbi të gjitha kryengritjet e lavdishme të revolucionit hysenian, si dhe përpjekjet e shumta të qindra dijetarëve myslimanë, sidomos të pasardhësve të pastër të imamëve të pagabueshëm, feja islame do të ishte zhdukur si besim, si mendim dhe si adhurim.

Me guxim mund të them, gjithashtu, se projekti hyjnor profetik-islamik mbeti i paralizuar dhe i pavlefshëm gjatë periudhave të gjata të historisë islame, pas martirizimit të Aliut (Paqja qoftë mbi të!), derisa arriti në fitoren e lavdishme të Revolucionit Islamik në Iran, me dorën e robit të devotshëm, Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Prandaj, fitorja e Revolucionit Islamik në Iran dhe themelimi i Republikës Islamike mbi themelet e Islamit të pastër, konsiderohen si një ringjallje e re e projektit islamik hyjnor profetik, pas shumë shekujsh të fshehjes dhe për shkak të komplotit të detyruar nga ana e emevive, të cilin e ndoqën pas tyre abasidët dhe ata që erdhën pas tyre, u bë e zakonshme që të ecin në të njëjtën rrugë sipas modelit emevit. Edhe pse u shtuan parullat dhe u ndryshuan qasjet e shkollave, rezultati ishte i njëjtë: gjithmonë i vetëm. Por dëshirat dhe interesat ishin ato që e larguan projektin islamik të pastër nga jeta e umetit.

Kështu, sipas vizionit të Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), Islami, historia e tij dhe projekti islamik i anashkaluar dhe i margjinalizuar deri në shkallën më të lartë të neutralizimit dhe shtrembërimit të qëllimshëm, duhej të rikthehej përsëri në jetën e umetit përmes një revolucioni islamik origjinal dhe një shteti të bazuar mbi ndjekjen e "dy peshave të rënda" (Kur'ani dhe Ehli Bejti), si dhe përkushtimin ndaj tyre me zemër dhe shpirt. Me këtë vizion të thellë për Islamin dhe Shi'izmin, Imami përcaktoi tiparet e këtij kuptimi si udhëzim, mendim dhe veprim, duke vizatuar veçoritë, themelet dhe kornizat e tij në një epokë shumë të largët nga periudha e parë dhe nga faza e themelimit profetik, duke i përcaktuar ato me terminologjitë dhe konceptet e kohës moderne dhe në përputhje me kushtet e saj.

Përqendrimi te Allahu i Lartësuar

Përqendrimi tek Allahu i Lartësuar, tek kënaqësia e Tij dhe tek vetëdija e vazhdueshme për mbikëqyrjen e Tij në çdo fjalë, vepër e qëndrim, në çdo çështje të jetës private dhe publike, duke pasur bindje të plotë në praninë dhe sundimin e Tij mbi gjithçka, përbën thelbin e frymës së përkushtimit fetar dhe islam sipas mendimit të Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Qoftë në këmbë apo ulur, në zemërim apo durim, në luftë apo paqe, në adhurim apo në punë të mira; qoftë në aleancë apo në shkëputje, në ashpërsi apo në butësi, në miqësi apo në armiqësi, në buzëqeshje apo në vrazhdësi, në dashurinë e zemrës apo në urrejtjen e brendshme — të gjitha këto, deri edhe veprimi më i vogël apo qëllimi më i fshehtë i besimtarit, duhet të burojnë nga përqendrimi tek Allahu i Lartësuar dhe të jenë të varura nga vullneti, urdhri dhe udhëzimi i Tij.

Në këtë kontekst dhe sipas vijës që Allahu i Lartësuar ka përcaktuar për njeriun përmes Librit të Tij të shenjtë dhe Sunetit të Profetit të Tij fisnik (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e mishëroi këtë përqendrim të shenjtë me qëndrimet, fjalët dhe me veprat e tij gjatë gjithë jetës. Në këtë kuadër, do të paraqesim disa prej fjalëve ndriçuese të tij.

Ai ka thënë: "*Askush nuk duhet të mendojë se revolucioni lidhet me një person të caktuar, sepse unë nuk kam ndonjë meritë në të. Si një individ i zakonshëm i shoqërisë, gjithçka që ndodhi ishte nga Allahu i Madhëruar. Është Ai që ndryshon gjendjen e kësaj umeti nga një gjendje në tjetrën. Është Ai që kthen zemrat, që është mbi çdo gjë. Ne nuk jemi asgjë. Përkujdesja dhe mbështetja e Tij janë ato që ndryshuan këtë umet dhe e bënë të ecë në rrugën hyjnore, duke e mbrojtur atë nga shkaqet e humbjes dhe shkatërrimit.*

Unë kam përjetuar personalisht, gjatë periudhës së hyrjes sonë në luftë, se kur vendosëm të ndërmerrnim një veprim të caktuar, më pas u bë e qartë për ne drejtësia e veprimit të dytë, dhe gjithçka u duk se ndodhi sipas dëshirës së Allahut. Kam arritur në përfundimin se mendja jonë nuk mund t'i përfshijë të gjitha çështjet, ndaj duhet të besojmë se Allahu është Ai që mban çdo gjë nën kontroll. Populli ynë, gjithashtu, e beson këtë. Nëse për një moment të vetëm do të ndërpritej kujdesi hyjnor mbi botën, ajo do të shkatërrohej tërësisht.

Bota ekziston vetëm me vullnetin e Allahut të Lartësuar dhe të Madhëruar, por shumë gjëra mbeten të fshehura për ne dhe ne nuk i shohim shumicën e herëve. Ajo që është më e rëndësishme, është se sprovat dhe fatkeqësitë që përjeton njerëzimi, lindin nga kjo padituri. Nëse padituria largohet, bashkë me të largohen edhe fatkeqësitë dhe vështirësitë. Kur njeriu kupton se të gjitha çështjet i kthehen Allahut të Lartësuar, nuk mbetet asnjë vend për ankesa, dhe kjo përbën shkallën më të ulët të evlijave, të cilët kanë edhe nivele të tjera, që janë të paarritshme dhe ne nuk mund t'i përshkruajmë.

Duhet të kuptojmë se ne jemi thjesht një pjesë e kësaj bote; të mos mendojmë se jemi vetëm një komb i vogël me disa miliona njerëz. Në krahasim me gjithë botën, mund të dukemi të vegjël e të dobët, dhe kjo mund të na bëjë të ndiejmë frikë, pendesë, madje edhe të dorëzohemi para

rrezikut, duke parë shumësinë e komploteve dhe të kurtheve. Por Allahu i Madhëruar na ka ruajtur dhe na ka shpëtuar. Është Ai që ka mposhtur dhe vazhdon të mposhtë forcat më të mëdha. Edhe pse fuqia e Tij mund t'u japë forcë të fuqishmëve, ajo që ata nuk mund ta durojnë kurrë është padurimi dhe ankesat e tyre, të cilat bëhen shkak i dobësisë dhe shkatërrimit të tyre".[1]

"Allahu i Lartësuar e bëri Kur'anin e shenjtë udhërrëfyesin tonë. Nëpërmjet tij ne e njohim veten dhe të tjerët. Allahu thotë: **"Allahu është Mbrojtësi i atyre që besuan; Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë. Ndërsa ata që mohuan, mbrojtësit e tyre janë tagutët (idhujtarët e tiranët), të cilët i nxjerrin ata nga drita në errësira. Ata janë banorët e Zjarrit dhe aty do të qëndrojnë përgjithmonë".**[2]

Ajo që e dallon besimtarin e vërtetë nga jobesimtari, është ajo që thotë Libri i Allahut. Një njeri që është me të vërtetë besimtar, duhet të ketë Allahun e Lartësuar si mbrojtësin e tij. Allahu i Lartësuar i nxjerr besimtarët nga çdo lloj errësire, nga çdo pengesë që i ndalon ata të arrijnë të vërtetën dhe i fut në dritë. Një njeri i zhytur në perde dhe i mbuluar me errësirë, nëse ka besim të sinqertë, Allahu i Lartësuar do ta nxjerrë nga të gjitha format e errësirës dhe do ta fusë në dritë. Zemra që është e errët dhe e mbushur me mjegull, Allahu e pastron dhe e ndriçon me dritën e Tij. Zemra që është e mbuluar nga çdo gjë e kësaj bote dhe është kthyer në perde, Allahu i heq këto perde një nga një, dhe në vend të tyre vendoset drita. Drita absolute është bukuria e Tij, i Lartësuar dhe i Madhëruar qoftë Ai!

Nëse duam të provojmë pretendimet e atyre që thonë se besojnë, duhet të shikojmë, nëse ekzistojnë te ne dy kriteret që Allahu i Lartësuar ka vendosur për të dalluar besimtarët nga jobesimtarët. Nuk mjafton

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 20, f. 384-385.
2 Sure "Bekare", ajeti 257.

vetëm të themi: "Unë jam besimtar" ose "Ne jemi besimtarë në Allahun". Nëse nuk kemi atë matës që Allahu i Madhëruar ka vendosur tek ne, fjalët tona janë vetëm një pretendim bosh. A jemi miq të Allahut apo miq të tagutit? A i përkasim Allahut apo i përkasim tagutit?

Nëse e shihni veten të dalë nga prangat e botës materiale, nga padrejtësitë e natyrës dhe nga lidhjet me epshe dhe dobësi njerëzore, atëherë e dini se jeni në anën e Allahut. Por, nëse shihni se jeni të dobët dhe nuk veproni veçse për hir të Allahut, kjo tregon se ende jeni nën sundimin e tiranit.

Nëse sundimi i Allahut ka pushtuar fjalët tuaja, gjymtyrët, trupin dhe zemrën tuaj, dhe çdo gjë tek ju vepron sipas urdhrit të Tij, atëherë kjo është shenjë e miqësisë me Allahun. Por, nëse zemra juaj ende sheh botën materiale si të madhe dhe sytë tuaj të brendshëm e shohin me madhështinë e tyre, kjo tregon sundimin e tagutit.

Nëse hiqni këtë perde nga zemra, do të bëhet e qartë për ju kush është miku i Allahut. Ky është një kriter i qartë, me të cilin çdo njeri mund të njohë veten dhe të dallojë nëse besimi që pretendon, ekziston vërtet apo jo. Kur drita e besimit hyn në zemrën e njeriut, ajo ndriçon dhe largon çdo errësirë".[1]

"Kudo që të ndodhemi dhe cilido qoftë pozicioni ynë, në treg, në shkollë, në Gardën e Revolucionit, në forcat e armatosura të tjera apo edhe nëse jemi president, ministër, zëvendës apo pjesëtar i çdo kategorie tjetër, ekziston një kriter i përgjithshëm dhe i përbashkët për të gjithë. Ky është një udhërrëfyes që duhet ta zbatojmë: kur njeriu ulet natën dhe reflekton

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 289-290.

mbi veten, ai duhet të pyesë: 'a anon zemra e tij drejt dritës apo drejt shpresave dhe dëshirave djallëzore?'

Në zemër nuk ka rrugë të tretë: ose sundues i saj është Allahu, ose sundues është taghuti.

Nëse interesi ynë në këtë botë dhe gjithçka që na rrethon lidhet vetëm me botën materiale dhe, nëse i kërkojmë të gjitha për veten tonë, pa përmendur Allahun në asnjë nga veprat tona, atëherë ne bëhemi ndjekës të taghutit. Por, nëse e edukojmë veten, shikojmë përtej perdeve që na mbulojnë dhe arrijmë te burimi i së vërtetës, zemra jonë lidhet me dritën absolute. Atëherë bëhemi gjithmonë shërbëtorë të së vërtetës, duke u pajtuar me çdo gjë që Allahu ka caktuar për ne.

Kjo është shenja se kemi dalë nga errësira dhe kemi hyrë në dritë, madje edhe nëse ndonjëherë e ndjejmë vetëm në disa shkallë të saj".[1]

"Të gjitha qëllimet e profetëve kthehen në një fjalë të vetme: ***"Njohja e Allahut"****. Nëse ata thirrën për veprën e mirë, për edukimin e shpirtit dhe për shkencat e dijet, e gjithë kjo kthehet te ajo pikë kryesore, që është e ngulitur në natyrën e pastër të njerëzve. Ata synonin të hiqnin mbulesën nga kjo natyrë, që është njohja e Allahut të Lartësuar. Ky është synimi më i lartë.*

Profetët nuk dëshironin të ndiznin zjarrin e luftës, nuk thirrën për ndonjë thirrje tjetër, nuk thirrën për sundim mbi popujt, dhe nuk e synuan të sundonin mbi vendet dhe kombet nëpërmjet forcës. Ne nuk jemi shmangur nga rruga e profetëve, pavarësisht nga të gjitha fitoret e mëdha që kemi arritur. Falënderimi i takon Allahut!"[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 290.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 20, f. 21.

"Populli që u ngrit për hir të kënaqësisë së Allahut të Lartësuar dhe u çua për të realizuar vlerat shpirtërore dhe njerëzore, a e dëmton atë martirizimi i bijve të tij, plagosja e syve të tij dhe durimi i tij ndaj vështirësive dhe mundimeve? Takimi me Allahun është një xhenet që është përtej imagjinatës së dijetarëve shpirtërorë, të cilët i shohin vështirësitë më të ëmbla se mjalti. Xheneti i miqve të Allahut është i rrethuar me sprova. A nuk e kemi parë ne dhe ju bijtë tanë duke shijuar sprovat, si karvanët e Kerbelasë, të mbushur me dashuri, mall e etje për të ecur drejt heroizmit? A nuk e kemi parë çdo ditë në fushat e luftës së madhe kundër agresorëve, ku buzëqeshin ndaj vdekjes dhe krijonin mrekullinë? Vërtet, ç'është ky transformim që ndriçon me dritën e tij në të gjitha anët e vendit të imamit të kohës (Imam Mehdiu)?! Çfarë është kjo shtysë që largoi të gjithë të devijuarit dhe të zhyturit në mendime të gabuara dhe qëllime të ulëta nga brenda tij dhe i shkatërroi? Nuk është tjetër veçse vullneti i Allahut dhe skenarët hyjnorë nga të cilat ikin lakuriqët e natës e lidhen me zemrat e miqve të Allahut. Çfarë mund të them unë me këtë penë të dobët dhe këtë sy të mangët, në lidhje me këtë popull, për vendosmërinë dhe për luftën e tij? Është më mirë për mua ta thyej penën, të hesht dhe t'i kërkoj Allahut të Madhërishëm shpërblimin dhe dëmshpërblimin për luftëtarët, familjet e tyre, të dëmtuarit dhe të mësuarit prej tyre. Shpresoj që Ai, Zoti i mirësive, t'i pranojë këta mysafirë që iu drejtuan Atij, duke fituar praninë e Tij, dhe të mburret me luftëtarët e Tij, prodhuesit e lavdisë me fuqinë dhe madhështinë më të lartë.

Gjithashtu, të gjithë popullin e dashur, veçanërisht ata që kanë treguar aktivitet dhe pjesëmarrje në këtë xhihad në rrugën e Allahut, për hir të nderit dhe madhështisë. Dhe ata të dashur, që u ngritën drejt Allahut në këtë krim të urryer, uroj që Ai t'i shpërblejë me mëshirë dhe t'i udhëheqë drejt vendbanimit të Tij të veçantë me trëndafila dhe lule".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 428.

"Ne nuk jemi asgjë përballë ekzistencës së së Vërtetës së Lartë (Allahut) dhe nuk kemi asgjë që t'i ofrojmë të Dashurit, sepse çdo gjë që ekziston, është prej Tij. Lavdërimi dhe falënderimi i takon vetëm Atij dhe drejt Tij kthehet.

O të dashurit e mi! Mundohuni dhe bëni përpjekje në rrugën e arritjes tek e Vërteta dhe te grada e madhështisë dhe lavdisë së Tij, sepse këto ditë të pakta të jetës kalojnë shpejt. Sikur gjithë jetën tonë ta kishim shpenzuar në shërbimin dhe flijimin për Të, sërish nuk do të mjaftonte.

Unë i lutem Allahut të Madhëruar, që të na japë të gjithëve sukses dhe mbështetje, që të mos lejojë që kjo botë të na bëhet pengesë përpara syve tanë, dhe të shtojë në zemrat tona mallin për takimin me Të".[1]

"Ju duhet të ndërtoni vetveten, në mënyrë që të jeni në gjendje të ngriheni për të urdhëruar të mirën dhe për të ndaluar të keqen. Ndërtimi i vetes dhe përmirësimi i saj duhet të jetë duke ndjekur dispozitat e Allahut, duke iu bindur Atij në çdo gjë që Ai ka urdhëruar ose ka ndaluar, pa kundërshtim. Nëse arrini në këtë gjendje dhe gjendeni në një nga shkallët që njeriu duhet t'i arrijë, domethënë kur njeriu arrin në gjendjen e nënshtrimit të plotë ndaj asaj që Allahu i Madhëruar ka dashur, dhe i bindet Atij në të gjitha urdhrat dhe ndalesat e Tij, atëherë ai ka arritur një nga shkallët e vërteta të humanizmit".[2]

"Mos harroni të drejtoheni kah Ai, sepse drejtimi kah Allahu i Lartësuar është burimi i të mirave, i të mirave të kësaj bote dhe i Botës Tjetër. Me përmendjen e Tij qetësohen zemrat: **"Vërtet, me përmendjen e Allahut qetësohen zemrat".**[3]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 95.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 114.
3 Sure "Rra'd", ajeti .28

"Dhurata më e mirë është që njeriu të jetë i qetë, prandaj mos kini frikë nga unë dhe unë nuk kam frikë nga ju. Ne të gjithë jemi vëllezër. Kjo qetësi është ruajtja juaj, ruajeni! Dijeni se ju jeni në shërbim të robërve të Allahut, prandaj mos e humbni këtë. Mos u krenoni mbi njerëzit, sepse këta njerëz janë të mëdhenj, janë robërit e Allahut. Allahu nuk ua ka dhënë Botën Tjetër atyre që tregohen arrogantë ndaj njerëzve, që nuk kërkojnë pushtet mbi njerëzit dhe nuk duan lartësimin e postit të lartë në tokë: **"Ata nuk duan të ngrihen me mendjemadhësi në tokë dhe as të bëjnë shkatërrim".**[1]

Profetët, nga i pari e deri tek i fundit dhe pasuesit e tyre, që nga fillimi i historisë e deri në fund, kanë qenë gjithmonë mbrojtës dhe rojtarë të Islamit dhe të fesë së drejtë. Feja e vërtetë është nën mbrojtjen e tyre dhe dorëzimi tek e vërteta e Allahut të Lartësuar.

Ata nuk e ruajtën fenë vetëm me shpallje verbale, por, mbi të gjitha, me veprimet e tyre praktike, të cilat ishin më të rëndësishme. Me fjalë të tjera, veprat e tyre, gjatë gjithë historisë, ishin një shembull për ne dhe për gjithë njerëzit e historisë, dhe duhet të mbeten të tilla përgjithmonë".[2]

E përfundoj këtë kapitull me një pjesë të bukur nga testamenti i Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), sepse i ndjeri, Sejid Ahmed Khomeini, foli mbi natyrën e lidhjes me të Vërtetin e Lartësuar:

"Biri im! *Më ka zënë pleqëria (plakja e birit të Ademit) dhe tek unë janë shfaqur dy cilësi: lakmia dhe shpresa e gjatë. Por ti që je i ri, gëzon forcën e rinisë dhe fuqinë e vendosmërisë. Shpresoj të ecësh në rrugën e të drejtëve. Nuk dua të them që të largohesh nga shërbimi i shoqërisë dhe të*

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 109.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 208.

izolohesh, e të bëhesh barrë për robërit e Allahut, sepse kjo është prej cilësive të njerëzve të paditur ose të dervishëve tregtarë.

Edhe pse jeta e profetëve të mëdhenj (Paqja qoftë mbi Profetin tonë dhe mbi të gjithë imamët e pastër!) tregon se ata përfaqësonin kulmin e dijes mbi Allahun, përsëri ata nuk ishin të shkëputur nga përgjegjësitë. Ata ishin të lidhur me arenën hyjnore në revolucion kundër qeverive tiranike dhe faraonëve të kohës, duke u përballur me çdo vështirësi, për të zbatuar drejtësinë në botë. Kjo na mëson mësime të mëdha në këtë rrugë. Nëse kemi sy të mprehtë për të parë dhe veshë për të dëgjuar, atëherë thënia: "Kush zgjohet dhe nuk i kushton rëndësi çështjeve të myslimanëve, nuk është mysliman",[1] do të na hapë rrugën tonë.

O biri im! Vetmia sufiste nuk tregon lidhjen me Allahun, ashtu siç nuk tregon hyrja në shoqëri dhe themelimi i qeverisë, ndarje nga Allahu, në bazë të së vërtetës. Vërtet, etaloni i punëve është qëllimi i tyre. Sa të shumtë janë ata që jetojnë në ortakërinë e Iblisit, që i largon ata nga e vërteta dhe i shtyn drejt shirkut, duke i mbushur me mendjemadhësi, egoizëm, vetëkënaqësi, nënçmim të robve të Allahut dhe shirk të fshehtë, e gjëra të ngjashme me to.

Një zotërues i qeverisë që fiton mbrojtjen hyjnore, bëhet si profetët e Allahut, si Davudi, Sulejmani, si Profeti i madh Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), si zëvendësi i tij i vërtetë, Ali ibn ebu Talibi (Paqja qoftë mbi të!). Standardi i vërtetë në njohje e në privim është shtytësi. Sa më shumë të afrohet shtytësi i brendshëm te drita e natyrës së pastër dhe të largohet nga perdet, aq më shumë lidhet me burimin e dritës".[2]

1 "El Kafi", vëll. 2, f. 162.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 18, f. 409.

Kapja pas udhëzimit të dy rëndesave (Kur'anit dhe Ehli Bejtit)

Dy peshat e rënda janë Libri i Allahut të Lartësuar dhe pasardhësit e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka theksuar se ato nuk do të ndahen kurrë, derisa të arrijnë te burimi i Keutherit. Secili prej tyre është i barabartë me tjetrin, shpjegues, mbrojtës dhe plotësues i tjetrit.

Çdo ndarje mes këtyre dy peshave të rënda përbën shmangie nga rruga e drejtë dhe futje në hutimin ku ka rënë umeti islam, për shkak të braktisjes së peshës së madhe, që është braktisja e Librit të Shenjtë të Allahut. Në realitet, kur braktiset njëra, është braktisur edhe tjetra, siç e ka theksuar edhe Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) në parathënien e testamentit të tij të përjetshëm e të shenjtë politik, ku ka thënë:

"Profeti i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: 'Unë po lë mes jush dy pesha të rënda: Librin e Allahut dhe pasardhësit e mi, Ehli Bejtin tim. Ata nuk do të ndahen kurrë. derisa të më arrijnë te burimi i Keutherit".

Lavdi dhe falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botëve. O Allahu, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit! Shfaqja e bukurisë dhe e lartësisë Tënde, thesaret e fshehta të Librit Tënd, në të cilin janë shfaqur

të gjitha emrat e njëshmërisë deri tek ato që nuk i njeh askush përveç Teje. Mallkimi i Allahut qoftë mbi ata që u kanë bërë padrejtësi atyre dhe mbi trungun e keq të pemës së mallkuar.

Pas kësaj, gjeta të përshtatshme të përmend një shënim të shkurtër dhe të përmbledhur në lidhje me "Dy peshat e rënda, jo nga këndvështrimi i shkallëve të fshehta, shpirtërore dhe mistike, sepse një si unë është i paaftë të hyjë në një nivel që e tejkalon njohurinë, dhe që nuk mund të përballohet. Po të mos thosha: është i shtrirë mbi gjithë qarkun e ekzistencës, nga bota e mbretërisë (mulk) deri në mbretërinë më të lartë (melekut)[1] dhe deri te hyjnia absolute (lahut)[2]. Çdo gjë jashtë kësaj përfshin kuptimin dhe të kuptuarit tim të kufizuar.

Nuk është aspak për t'u habitur, që njerëzimi, si pasojë e largimit dhe braktisjes së tyre, ka humbur të vërtetat madhështore që u përkisnin pasardhësve të Peshës së madhe (thiklul akbar) dhe Peshës tjetër të madhe (thakalul kebijr)[3]- një peshë që është mbi gjithçka tjetër, përveç Peshës më

1 Mbretëria e Lartë (El Malakutul A'la): Filozofët dhe mendimtarët kanë argumentuar për domosdoshmërinë e ekzistencës së një bote ndërmjetëse, që ndodhet në kufirin ndarës mes botës së natyrës (El Mulk) dhe botës së Hyjnores (El Lahut). Kjo është bota e pastër, e lirë nga materia, koha dhe hapësira, në formën më absolute, e cila quhet bota e Mbretërisë (El Melekut). Dijetarët dhe njohësit (arifët) e kanë ndarë këtë botë në dy shkallë: të lartë dhe të ulët. Këtë ndarje e kanë mbështetur edhe tekstet islame. Shkalla më e lartë është quajtur El Melekutul A'la (Mbretëria e Lartë), e cila është bota e mendjes dhe vendi ku lind arsyeja. Ndërsa shkalla më e ulët është quajtur El Melekutu Es Sufla (Mbretëria e Ulët), që është bota e shëmbëlltyrave (El Methel).

2 El Lahut: Është vetë Esenca e Krijuesit të Madhëruar dhe të Lartësuar, e cila nuk perceptohet me shqisa, por vërtetohet përmes argumenteve dhe provave racionale. Duke qenë se Esenca Hyjnore përfshin të gjitha cilësitë e përsosmërisë, ajo është konsideruar si bota më e përsosur.

3 Pesha e madhe (El Thiqlul Kebijr): Nga burimet që kanë trajtuar konceptin e dy peshave të mëdha (El Thakalejn), kuptohet se Pesha e madhe është Kur'ani, kurse

të madhe (el thiklul ekbar)[1], e cila është më e madhja absolute. Ajo që që ka ndodhur me këto dy pesha nga armiqtë e Allahut dhe sunduesit tiranë (tagutët)[2], është aq e rëndë dhe e përmasave të tilla, saqë është e pamundur të përmblidhet apo të numërohet. Një listim i tillë do të ishte përtej mundësive të mia, për shkak të kufizimeve të dijes dhe kohës. Prandaj, e gjykova më të përshtatshme të ndalem vetëm në një shenjë kalimtare dhe shumë të shkurtër, si një përmendje e përmbledhur rreth këtyre dy peshave.

Ndoshta fjalia "Nuk do të ndahen, derisa të arrijnë te burimi", është një tregues se gjithçka që ndodhi me njërën prej këtyre dy peshave, do të pasqyrohej edhe tek tjetri. Pas ekzistencës së shenjtë të të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), braktisje e njërës është braktisje edhe e tjetrës. A është ky burim pozitë e bashkimit të shumicës me njëshmërinë,[3] ku shkrijnë pikat në det apo është diçka tjetër që shkon përtej arsyes dhe njohjes njerëzore?!

Pesha tjetër e madhe janë të pagabueshmit (El Ma'sumin), nga gjeneza e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

1 Pesha e madhe (thiklul ekber) përftohet nga hadithi i Dy peshave (thakalejn) dhe nga sqarimet e komentuesve dhe dijetarëve të hadithit, se pesha më e madhe është Kur'ani i Shenjtë.

2 Taguti: Një term i përdorur nga Kur'ani i shenjtë; tahut nënkupton tejkalimin e kufijve dhe rebelimin. Allahu i Madhëruar thotë: **"Pra, kush e mohon taghutin dhe beson në Allahun, ai është kapur për dorezën më të fortë që nuk këputet kurrë".** (Sure "El Bekare", ajeti 256).

3 Pozita e lidhjes së shumicës me njëshmërinë: Shumësia (el kethratu), sipas filozofëve nënkupton, një varg shkallësh të ekzistencës, ku shfaqen format dhe dukuritë e ndryshme të botës materiale dhe shpirtërore. Njëshi (el uahdetu): Është vetë Esenca Hyjnore, që është burimi i çdo gjëje dhe parimi i gjithë ekzistencës, me të gjitha qeniet dhe krijesat e saj. Bazuar mbi këtë, "madhështia e lidhjes së shumësisë me njëshmërinë" është një gradë dhe pozitë, të cilën filozofët dhe dijetarët e urtësisë e quajnë vendin ku shumësia bashkohet me njëshmërinë. Kjo gradë ndërmjetëse përfaqëson kufirin më të afërt dhe më të lartë

Duhet thënë se padrejtësia e sunduesve tiranikë që u ushtrua ndaj trashëgimisë së të Dërguarit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk ishte vetëm mbi umetin islam, por mbi gjithë njerëzimin. Pena është e paaftë ta shpjegojë plotësisht këtë. Prandaj është e domosdoshme të kujtohet gjithmonë kjo e vërtetë, që është se hadithi i Dy peshave (Eth Thakalejn) është përcjellë me zinxhir të vazhdueshëm ndër të gjithë myslimanët dhe është transmetuar në librat e Ehli Sunetit, në "Sahihët e gjashtë" dhe në librat e tyre të tjerë, me shprehje dhe në forma të ndryshme, por të gjitha të përsëritura dhe të besueshme nga i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Ky hadith fisnik është një argument i prerë ndaj të gjithë njerëzimit, veçanërisht ndaj myslimanëve të të gjitha medh'hebeve. Është detyrë për çdo mysliman, të cilit i është bërë e qartë prova, që t'i përgjigjet asaj. Nëse për disa injorantë ka justifikim për shkak të mosdijes dhe mosnjohjes, nuk ka asnjë justifikim për dijetarët e medh'hebeve.

Tani të shohim çfarë ndodhi me Librin e Allahut, këtë amanet hyjnor dhe përgjegjësi të madhe të dërguar përmes të Dërguarit të Islamit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Pa dyshim është një nga çështjet më të dhimbshme që të loton, e cila filloi pas martirizimit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).

Egoistët dhe tiranët e morën Kur'anin si një mjet për të ngritur qeveri armiqësore ndaj tij. Megjithëse thirrja "Unë po lë ndër ju dy gjëra të rënda" arrinte në veshët e tyre, ata e larguan atë me justifikime të ndryshme dhe me plane e konspiracione të përgatitura më parë.

---

të shumësisë përballë njëshmërisë. Është ura e lidhjes së krijesave me Njëshin dhe është ndërmjetësimi i kthimit të shumësisë te njëshmëria në fund të botës.

Interpretuesit e vërtetë të Kur'anit dhe njohësit e të vërtetave, të cilët merrnin gjithçka nga i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), në të vërtetë punuan për ta kufizuar Kur'anin, i cili është kushtetuta më e madhe për jetën shpirtërore dhe materiale, derisa të arrihet në praninë e tij.

Ata e shuan qeverisjen hyjnore të drejtësisë, e cila është një nga synimet kryesore të këtij Libri të shenjtë dhe themeluan devijimin nga feja e Allahut, nga Libri dhe ligjet e Allahut, deri në atë masë sa pena turpërohet ta shpjegojë.

Sa më shumë që ky ndërtim i shtrembër zgjatet dhe thellohet në devijim e deformim, aq më e domosdoshme bëhet që Kur'ani i shenjtë – i cili zbriti nga shkalla e unitetit të plotë hyjnor në shpalosjen e tij të plotë muhamedane,[1] për udhëzimin e botës dhe si pikë bashkimi për të gjithë myslimanët, madje për mbarë familjen njerëzore – të arrijë në vendin që i takon. Ai duhet të çlirohet dhe të shpëtojë nga errësira e lindur prej shtrembërimeve, nga ndikimi i "shkencës së emrave",[2] e përdorur keq nga

1 Zbulimi i plotë Muhamedan: është shfaqja dhe mishërimi i të gjitha të vërtetave kur'anore te Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky zbulim i plotë është një shkallë nga shkallët e zbritjes kur'anore. Në këtë shkallë, Kur'ani ishte i vendosur plotësisht në zemrën e Profetit *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në të gjitha dimensionet e tij. Kjo shkallë e zbulimit të të vërtetave kur'anore nuk është vetëm një perceptim intelektual, por një shikim i realitetit të fshehtë. Vërtet, Kur'ani i plotë dhe i përsosur nuk mund të kuptohet, përveçse nga Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, dhe ky zbulim i plotë është i veçantë vetëm për të.

2 Lindja e shkencës së emrave: Shkenca e emrave është një lloj diturie dhe njohurie që lidhet me njohjen e qenies themelore. "Njohja e emrave" që Allahu i Madhëruar ia paraqiti njeriut, e bëri atë të aftë për të qenë përfaqësues (khalife)

djajtë dhe nga tiranët, në mënyrë që drejtësia dhe barazia të vendosen përmes duarve të miqve të Allahut, të pagabueshmëve, qoftë prej të parëve apo të fundit. E më pas, ata ua besojnë këtë amanet atyre që i gjykojnë të denjë dhe të përshtatshëm për të mirën dhe përparimin e njerëzimit.

Ky Kur'an u kufizua dhe u largua nga fusha e tij, sikur të mos kishte hyrë ndonjëherë në rrugën e udhëzimit. Gjendja arriti deri aty sa të binte në duart e qeverive tiranike, këshilltarëve të këqij dhe tiranëve më të shëmtuar, duke e shndërruar Kur'anin në një mjet për vendosjen e padrejtësisë, korrupsionit dhe justifikimin e tiranisë. Me keqardhje, armiqtë komplotues dhe miqtë injorantë bënë që ai të mos ishte më Libri i Allahut të Madhëruar, por vetëm një libër që përdorej në varreza dhe kuvende mortore.

Libri që duhej të ishte mjeti i bashkimit të myslimanëve dhe i mbarë njerëzimit, libri i jetës dhe i udhëzimit të tyre, u shndërrua në mjet përçarjeje e konflikti, madje në shumë raste u la krejtësisht në harresë. Pamë se si, sa herë që dikush përmendte çështjen e qeverisjes islame dhe fliste për politikën – e cila është një nga detyrat më të mëdha të Islamit dhe të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij), trajtohej sikur të ishte një mëkat i rëndë. Ndërkohë, Kur'ani dhe Suneti janë të mbushura me udhëzime mbi këto çështje. Megjithatë, u krijua një klimë e tillë, saqë shprehja "shejh politik" u bë sinonim i "shejhut pa fe". Fatkeqësisht, kjo gjendje vazhdon edhe sot.

Forcat e mëdha djallëzore, përmes qeverive të devijuara nga mësimet e Islamit, të cilat padrejtësisht ia atribuojnë vetes këtë fe, kanë synuar ta zbrazin Kur'anin nga përmbajtja e tij jetësore dhe të vendosin në vend të tij objektivat djallëzore të fuqive arrogante. Kohët e fundit, ata madje u

---

në tokë. Dhe pa këtë aftësi, ai nuk do të ishte i përshtatshëm për këtë përfaqësim hyjnor.

përpoqën që, duke e shtypur me shkrim të bukur dhe duke e shpërndarë gjerësisht, ta largonin Kur'anin nga jeta aktive e myslimanëve, përmes këtij mashtrimi të rafinuar.

Ne pamë të gjithë Ku'ranin e shtypur gjatë kohës së Riza Khan Pahlavit[1] dhe si disa njerëz të mashtruar dhe predikues të paditur u ngritën për ta lavdëruar. E pamë mbretin Fahd[2] që shpenzonte çdo vit shuma të mëdha nga pasuritë e njerëzve për shtypjen e Kur'anit dhe propagandën vehabite. Ky sekt i devijuar dhe i mbështetur në besëtytni, pa asnjë themel të qëndrueshëm, është shndërruar në një mjet për të drejtuar njerëzit dhe popujt e pavetëdijshëm drejt forcave të mëdha djallëzore. Duke u fshehur pas emrit të Islamit dhe duke e përdorur n fisnik si mbulesë, ai synon në thelb shkatërrimin e vetë Islamit dhe të Kur'anit.

---

1 Muhamed Reza Han Pahlavi*:* Ai është mbreti i fundit i dinastisë Pahlavi në Iran. Lindi në vitin 1919. Babai i tij, Reza Han, mori pushtetin në Iran përmes një grushti ushtarak dhe e vendosi djalin e tij, Muhamed Reza, si pasardhës të tij. Ai kreu studimet fillore në Iran dhe vazhdoi studimet e larta në Zvicër, më pas u kthye në Iran për t'u bashkuar me Akademinë Ushtarake, me urdhër të babait të tij. Pas përmbysjes së babait nga pushteti në vitin 1941 dhe dëbimit të tij jashtë Iranit, aleatët ranë dakord që Muhamed Rezai të merrte vendin e tij në fron. Mbretërimi i tij ndahet në dy periudha:

-Periudha e parë (1941–1955): gjatë kësaj kohe nuk arriti të kishte kontroll të plotë dhe ndikimi i tij ishte i kufizuar.

- Periudha e dytë (1955–1979): në këtë periudhë sundoi Iranin me autoritet të plotë e absolut.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e ka bërë të qartë në testamentin e tij vendosjen e sundimit të Muhamed Riza-s për 37 vite.

2 Mbreti Fahd (1921–2005): Ai është Fahd ibn Abdulaziz ibn Saud, mbreti i pestë i dinastisë Saudite dhe i pari që e quajti veten "Shërbëtori i dy Xhamive të Shenjta". Gjatë periudhës së sundimit të tij, u bë shkrimi dhe leximi i testamentit politik hyjnor.

Në të vërtetë, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ishte i bindur se arritja e së Vërtetës së Lartë nuk mund të realizohet ndryshe, përveçse përmes pasimit të dy trashëgimtarëve madhorë dhe mbajtjes fort pas udhëzimeve të tyre të pandara.

Sipas hadithit të njohur e të besueshëm, hadithi i Dy peshave (Thekalejnit), Ehli Bejti i pagabueshëm qëndron përkrah Kur'anit, si i barabartë me të: ata janë interpretuesit dhe mishëruesit e tij në fjalë, në vepra dhe në sjellje. Pëlqimi i Allahut nuk mund të arrihet pa ndjekur këtë rrugë dhe pa iu përmbajtur këtij udhëzimi.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) shpreh dhimbjen dhe pikëllimin e thellë për devijimin e umetit nga kjo rrugë dhe për largimin prej saj. Ai theksonte se nuk ka rrugë tjetër për rikthimin e nderit, fuqisë dhe pavarësisë së umetit islam, përveç kthimit te burimi i dy peshave të pandara, të cilat do të qëndrojnë së bashku deri në Ditën e Kiametit.

Ai ka thënë: "*Unë ndiej keqardhjen më të madhe për dy çështje – dhe për njërën prej tyre më shumë se për tjetrën.*

E para është se, që nga lindja e Islamit, që nga koha e profetësisë e deri më sot, nuk u lejua të shfaqej një qeveri që ta mishëronte plotësisht Islamin. Në kohën e Muhamedit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), problemet, vështirësitë, luftërat dhe kundërshtimet e vazhdueshme nuk lejuan ngritjen e asaj qeverie ideale që ai dëshironte të ndërtonte.

Po kështu, edhe në kohën e imamëve të pastër (Paqja qoftë mbi ta!), përfshirë periudhën e Ali ibn ebu Talibit (Paqja qoftë mbi të!), i cili u përball me luftëra të brendshme dhe me hipokritë – të cilët ishin më të rrezikshëm se vetë jobesimtarët – dhe nuk iu dha mundësia të themelonte

qeverinë që synonte. Edhe sikur t'i ishte dhënë kjo mundësi, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, ajo do të kishte qenë një model madhështor dhe një mësim i përjetshëm për mbarë njerëzimin, deri në Ditën e Gjykimit".

"Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe imamët e pastër (Paqja qoftë mbi ta!) na lanë amanet që të mos e humbasim këtë bekim madhështor. Keqardhja më e thellë lidhet me faktin se ajo që ata synonin të realizonin, nuk u lejua të ndodhte: imamët tanë dëshironin t'i paraqisnin të vërtetat, ashtu siç janë në thelb, por kjo mundësi nuk iu dha.

Çështja më e dhimbshme është kjo: çfarë ishte ajo dije që Muhamedi (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ia mësoi Ali ibn ebu Talibit (Paqja qoftë mbi të!), sipas hadithit: "I Dërguari i Allahut më mësoi një mijë porta diturie dhe nga secila portë më hapeshin një mijë të tjera"? Pa dyshim, kjo nuk ishte dituri e zakonshme që gjendet sot në duart e dijetarëve, juristëve, filozofëve apo arifëve.

Çfarë ishte ajo dije për të cilën Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) vendosi dorën mbi gjoksin e tij dhe tha: "Këtu është grumbulluar një dituri e madhe; a ka ndokush që ta mbajë atë?" Kjo nuk ishte thjesht dituri e fik'hut, e cila është transmetuar pa mangësi, as filozofi e as ndonjë prej disiplinave që sot gjenden në duart tona.

Dhimbja më e madhe është se umetit nuk iu dha mundësia të zgjohej, sepse në atë kohë nuk u gjetën bartësit e duhur. Ata që mund ta mbanin atë dije dhe ta ngrinin në majat më të larta, nuk u shfaqën. Kjo është një dhimbje që duhet të na shoqërojë deri në Ditën e Kiametit, sepse nuk përfituam prej saj në asnjë mënyrë. Ajo dije ishte përtej çdo shkence që sot ndodhet në duart e njerëzimit apo të myslimanëve; këto që kemi sot nuk janë ajo dije.

Pikëllimi i madh qëndron në faktin se bartësit e saj nuk u gjetën. Ajo ishte trashëgimi e Ehli Bejti të pastër, por ata nuk gjetën njerëz të aftë për ta përçuar. Nuk iu dha mundësia të shpjegonin Kur'anin – thesarin e shkencave – në mënyrë që njerëzit të ushqeheshin nga burimet e thella të njohjes që ai përmban. Këto janë plagë që duhet të na mbajnë të pikëlluar edhe sot, sepse Kur'ani mbetet i mbuluar me perde. Edhe pse filozofë e arifë kanë folur për disa ajete, kjo nuk është ajo që duhet të jetë dhe as ajo që do të jetë në thelb.

Kur'ani ka ardhur me mesazhin se vetëm ai që i drejtohet atij me zemër të pastër, mund ta njohë vërtet. Të gjithë mund të kuptojnë kuptimet e jashtme, por cili ishte thelbi i asaj dijeje të brendshme? Kjo mbetet një dhimbje që do ta mbajmë përherë.

Edhe në rastin e Imam Rizait (Paqja qoftë mbi të!), të cilin e sollën me dredhi, ishte e qartë që nga fillimi se nuk e afruan për t'ia dorëzuar pushtetin. Ata as nuk i dhanë hapësirë për të shpallur udhëzime e urdhëresa dhe për ta përhapur hapur atë trashëgimi të madhe dijeje".[1]

"Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) iu dha mundësia të përhapte shkencën e fik'hut, ta zgjeronte dhe ta shpjegonte, si dhe disa çështje të tjera jashtë fik'hut. Por ai u mor edhe me shkencat që nuk mund të mbeteshin të pezulluara, me dijen e sheriatit. Megjithatë, kjo nuk ishte ajo që ai dëshironte, sepse nuk pati bartës të atyre shkencave. Ata që ishin bartës, ishin bartës të fik'hut. Por për ato shkenca të tjera nuk pati bartës. Për këtë arsye, duhet të vajtojmë për paaftësinë tonë për të arritur tek interpretimi i vërtetë i Kur'anit.

Këto tefsire që janë shkruar për Kur'anin, që nga kohët e hershme e deri më sot, në të vërtetë, nuk janë interpretim i mirëfilltë. Ato janë

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 19, f. 14-15.

thjesht përkthime të tij, në të cilat mund të ndihet aroma e Kur'anit, por që nuk përbëjnë një interpretim të tij. Në çdo rast, "Ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi. .Humbja jonë më e madhe është mungesa e vendosjes së qeverisjes hyjnore të drejtësisë, e cila nuk u realizua siç duhej. Kjo është ajo që duhet të kuptojmë dhe çfarë duhet të bëjmë".[1]

"Prandaj përpiquni për punë, në mënyrë që Kur'ani të jetë libri juaj me vepra dhe jo vetëm me fjalë. Dhe i Dërguari juaj i nderuar dhe Aliu, biri i Ebu Talibit, të jenë imamët tuaj".[2]

"Duhet të kënaqemi duke studiuar jetën e imamëve të pastër, të mësojmë prej tyre mësimet dhe përvojat dhe t'i zbatojmë ato sa të kemi mundësi; të largojmë nga vetja çdo kurth të djallit, si: egoizmin dhe dashurinë për veten; të ecim në gjurmët e udhëzimit dhe të mbrojtjes hyjnore, që të mund të arrijmë përmirësimin e vetes dhe të shoqërisë sonë".[3]

"Gjithashtu, u kërkoj popujve islamë, me përulësi dhe këmbëngulje, që të ndjekin imamët e pastër, prijësit e mëdhenj të njerëzimit dhe të angazhohen me përpikëri në ndjekjen e rrugës së tyre politike, shoqërore, ekonomike e ushtarake, në mënyrën më të përshtatshme, duke e pastruar shpirtin dhe duke u përforcuar në këtë rrugë".[4]

"Kush dëshiron të kuptojë pozitën e imamëve, duhet të kthehet te gjurmët e tyre, te lutjet e tyre të sinqerta, te thirrjet e tyre të ndjera, te predikimet e tyre elokuente dhe te lutja e tyre e përditshme, të cilën njeriu nuk arrin dot ta përshkruajë. Në çdo rast, ne jemi të pafuqishëm për të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 15.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 391-392.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 13, f. 150.
4 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 360.

shprehur mirënjohjen ndaj kësaj mirësie të madhe, që t'i përkasim një shkolle që mbështetet në dy burime të shpalljes dhe të mbrojtjes hyjnore. Shumica e ndryshimeve kthehen në burimin e dytë, ndërsa ne jemi të pafuqishëm për të falënderuar Krijuesin e Madhëruar për këtë bekim. Ne i lutemi Allahut të Lartësuar të na japë sukses në këtë".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 20, f. 330.

Veprimi sipas detyrës hyjnore

Kjo pikë përbën një nga shtyllat themelore të metodës autentike islame. Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i kushtoi një rëndësi të jashtëzakonshme kësaj çështjeje, duke e konsideruar atë shprehjen praktike të boshtit të fesë islame: ndjekjen e së Vërtetës së Lartësuar përmes kapjes së fortë pas dy peshave të rënda – Kur'ani dhe Ehli Bejti.

Sipas kësaj qasjeje, nëse myslimani, bashkësia myslimane apo shteti mysliman nuk e përcakton për vete detyrën hyjnore të shpallur në burimet ligjore dhe nuk e zbaton atë me përkushtim e vullnet të plotë, ai nuk mund të konsiderohet ndjekës i vërtetë i udhëzimit hyjnor. Ndjekja e kësaj rruge kërkon sinqeritet dhe përpikëri. Ai që nuk lidhet fort me Kur'anin dhe me udhëzimin e Ehli Bejtit të pastër, ose është i mbuluar nga dyshimet, ose i zhytur në materializëm, në lidhjet e kësaj bote dhe në padrejtësi që kryhen madje në emër të Islamit.

Në kohën e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), përcaktimi i detyrës hyjnore ishte i drejtpërdrejtë, sepse çdo fjalë, vepër apo miratim i tij përbënte argument dhe mbështetje ligjore. Por pas ndarjes së tij nga kjo botë, kjo detyrë u bë më e ndërlikuar – sidomos pas martirizimit të Ali ibn ebu Talibit (Paqja qoftë mbi të!). Në periudhat pasuese, vështirësia u shtua edhe më tej. Prandaj, kush dëshiron të kuptojë detyrën ligjore e hyjnore, duhet të ndjekë rrugën e Imam Aliut

(Paqja qoftë mbi të!), i cili u bë pikë referimi në shumë çështje të përcaktimit të saj.

Megjithatë, pas martirizimit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe largimit të imamëve të pagabueshëm nga fusha e qeverisjes dhe e ligjvënies, shumica e myslimanëve u përballën me një vështirësi të madhe në diagnostikimin e detyrës hyjnore, deri në atë pikë sa ndodhi një largim i dhimbshëm nga zbatimi i saj.

Në kohën e fshehjes së Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij fisnike!), u bë e domosdoshme që ndjekësit e imamëve të zhvillonin mekanizma të pavarur të ixhtihadit (arsyetimit juridik). Këta mekanizma ruajtën për myslimanët shi'itë aftësinë minimale për të përcaktuar detyrat hyjnore dhe çështjet e adhurimit në mënyrë të vazhdueshme.

Me vizionin e tij të gjerë, të thellë dhe gjithëpërfshirës për Islamin dhe për udhëheqjen e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), e sidomos pas fitores së Revolucioni Islamik i Iranit, Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) arriti ta zgjerojë konceptin e detyrës hyjnore, përtej sferës individuale, duke e shtrirë atë në të gjitha fushat e jetës: politike, shoqërore dhe shoqërore, në përputhje me objektivat madhështore të Islamit dhe me projektin e tij hyjnor e profetik për njerëzimin.

Dhe në këtë paragraf do të paraqesim një sërë tekstesh:

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: *"Ne jemi të ngarkuar me një detyrë hyjnore. Allahu na ka ngarkuar një detyrë që të përballemi me kundërshtarët e Islamit, duke përdorur mjetet e duhura për mbrojtjen e umetit islam. Pas kësaj përpjekjeje, ose do të*

arrijmë fitore, ose jo. Nëse fitojmë, falënderimi i takon Allahut që e kemi përmbushur detyrën dhe kemi arritur sukses. Nëse vritemi apo sakrifikohemi, sërish e kemi kryer detyrën tonë pa frikë. Në asnjë rast nuk jemi humbës, sepse çështja kufizohet në dy përfundime: ose fitore në këtë botë, ose nder dhe afërsi me Allahun në tjetrën.

Edhe miqtë e Allahut janë përballur me humbje të dukshme. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) në përballjen me Muavien nuk arriti fitoren politike që synonte, por kjo nuk e zbeh drejtësinë e çështjes së tij. Po kështu, Imam Hyseni (Paqja qoftë mbi të!), kur u përball me Jezidin, u duk sikur humbi, por në të vërtetë ai fitoi, sepse sakrifica e tij ishte triumf moral dhe i përjetshëm.

Kur njeriu vepron për Allahun, edhe nëse rezultati i jashtëm duket humbje, në thelb është fitore. Përmbushja e detyrës është vetë suksesi dhe në fund triumfi i vërtetë u takon atyre që qëndrojnë besnikë ndaj saj". [1]

"Prandaj, ne përqendrohemi vetëm në përmbushjen e detyrës sonë. Detyra jonë është të përballemi me padrejtësinë. Disa nga "këshilluesit" në Paris, të painformuar për realitetin, më thanë: 'Kjo çështje është e pamundur, duhet të gjejmë një zgjidhje dhe të bëjmë lëshime'. Unë iu përgjigja: 'Ne duhet të kryejmë detyrën tonë, pa u shqetësuar, nëse do të kemi sukses apo jo'. Allahu i Madhëruar na ka ngarkuar të përballemi me padrejtësinë, me shfrytëzuesit, egërsirat dhe gjakpirësit.

Ne do t'u kundërvihemi me të gjitha forcat që kemi. Nëse fitojmë, falënderimi i takon Allahut. Nëse nuk fitojmë, gjithsesi falënderimi i takon Allahut, sepse kemi përmbushur detyrën tonë. Besimtarët duhet të kuptojnë se mungesa e fitores së dukshme nuk do të thotë se janë të mundur. Nëse ruajmë shpirtin, forcën morale dhe mbështetjen te Kur'ani

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 9, f. 321.

i shenjtë, atëherë edhe sakrifica deri në vdekje është një fitore e madhe. Nëse arrijmë edhe fitore të dukshme, atëherë suksesi ynë është i plotë.

Prandaj, ne jemi gjithmonë të fituar në çdo rrethanë. Falënderimi i takon Allahut. Fati ynë është gjithmonë si ai i Hasanëve, Hasanit dhe Hysenit, nëse Allahu e do".[1]

"Çështja është detyra hyjnore ligjore. Nëse ai ka epërsinë, atëherë ka vepruar sipas detyrës së tij ligjore; dhe nëse nuk fiton, prapë ka kryer detyrën ligjore. Pra, themeli është qëndrimi sipas detyrës dhe përballja me ata që shkelin çdo dinjitet të Islamit dhe të myslimanëve, dhe që ushtrojnë sundim mbi të mirat e myslimanëve."[2]

"Duhet ta lexojmë Kur'anin për të parë gjykimin e tij, sepse ai cakton detyrën tonë përballë sundimtarit, me dëshmitë e tregimeve që përmban. Përndryshe, a thua mos ka dashur Zoti të na tregonte thjesht një histori? Historia e Musait (Paqja qoftë mbi të!) është përsëritur shpesh në Kur'an, por, nëse Zoti do të mjaftonte me tregimin e një historie, nuk do ta përsëriste disa herë. Kjo përsëritje dhe theksim në tregimin e Musait (Paqja qoftë mbi të!), për shembull, dhe kundërshtimi i tij ndaj faraonit, është për t'i thënë atij: 'O zotëri, kupto detyrën tënde. Kur'ani nuk përmend gjithçka rreth luftës kundër jobesimtarëve, luftës kundër hipokritëve dhe të tjerëve, thjesht për qëllim të tregimit narrativ".[3]

Kur një gazetar, në fillim të revolucionit, e ka pyetur Imam Khomeinin (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ai ka sqaruar se nxjerrja e detyrës hyjnore dhe përkushtimi ndaj saj në revolucionin iranian bazohej mbi kuptimin e drejtë të të vërtetave të fesë islame, të cilat

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 268.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 111.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 3, f. 305.

kishin qenë të harruara për shumë shekuj. Më poshtë po japim disa pyetje të gazetarit dhe përgjigjet që imami i nderuar i ka dhënë atij.

Pyetja e gazetarit: "Dua të kuptoj kontradiktën e dukshme midis udhëheqjes suaj fetare dhe rolit tuaj politik. Si ndikoi politika e Shahut në kundërshtimin tuaj? Çfarë bëri qeveria e Shahut, që ju shtyu të qëndroni në opozitë? Ju dukeni si një mal i palëkundur përballë këtyre rrymave dhe ngjarjeve të fuqishme e të dhunshme, ndërkohë që jeni i pranishëm mes tyre. A është e drejtë t'ju përshkruaj thjesht si një figurë revolucionare? Cili është ndikimi juaj mbi këto ngjarje dhe si e shihni rolin tuaj në zhvillimet që ndodhën?

Përgjigjja e Imam Khomeinit: *"Nëse kupton dhe percepton konceptin e fesë në kulturën tonë islame, do të kuptosh qartë se nuk ka asnjë kontradiktë midis udhëheqjes fetare dhe asaj politike. Përkundrazi, veprimtaria politike është pjesë e detyrave fetare. Udhëheqja dhe drejtimi i punëve politike janë pjesë e misioneve dhe përgjegjësive të udhëheqësit fetar.*

Mjafton të shikosh jetën e të Dërguarit të nderuar të Islamit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), të cilët ishin njëkohësisht udhëheqës fetarë dhe udhëheqës politikë. Kjo është shumë e qartë në kulturën e Shi'izmit. Çdo mysliman shi'it e sheh si detyrë të udhëheqësit të tij fetar dhe politik të ndërhyjë në fatin shoqëror dhe politik të komunitetit, të japë udhëzime dhe orientime, dhe të përmbushë obligimet e tij hyjnore.

Ka një ndryshim të madh midis konceptit të fesë dhe udhëheqjes fetare në kulturën islame dhe mënyrës se si ato kuptohen në kulturën tuaj. Në kulturën tuaj, feja shihet kryesisht si një marrëdhënie shpirtërore midis

individit dhe Zotit, pa përfshirjen direkte në udhëheqjen dhe drejtimin e punëve shoqërore dhe politike".[1]

***Pyetje*:** "A mund të na sqaroni kuptimin e saktë të fjalës "imam"? Çfarë do të thotë ai në përgjithësi? Cili është qëndrimi juaj për përdorimin e këtij termi në demonstratat e popullit iranian gjatë muajit Muharrem? Çfarë lidhje ka Imami me Hizbullahun?"

Përgjigje: *"Imam do të thotë udhëheqës, ai që udhëzon të gjithë dhe i drejton ata. Imami është sqaruesi i qartë i rrugës së Zotit dhe udhëheqësi i këtyre organizimeve të mëdha e gjithëpërfshirëse, të cilët e marrin udhëzimin e tyre nga Kur'ani dhe Suneti i Profetit në situata dhe kohë të ndryshme. Ata përpiqen të nxjerrin dispozitat dhe t'i përcjellin ato te njerëzit".*[2]

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thekson domosdoshmërinë e marrjes së detyrës hyjnore nga burime të drejta dhe të besueshme, përndryshe çështja do të kthehet në një katastrofë.

Midis të tjerash, ka thënë: *"Ajo që duhet të kuptohet nga të gjithë, është se nuk lejohet të veprosh sipas mendjes së tënde në çdo çështje. Të gjithë ata që shërbejnë për Islamin, duhet të përqendrojnë përpjekjet e tyre mendore, për të kuptuar thelbin e asaj që Islami kërkon, në mënyrë që ta ndjekin me saktësi.*

Pyetja "Çfarë kuptoj unë nga Islami?" ose "Unë dua të kuptoj këtë ose atë koncept" nuk është kriter. Vendimet individuale nuk mund të jenë standarde, sepse çdo çështje kërkon njohuri dhe ekspertizë të duhur. Le ta

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 262.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 272.

shpjegojmë me një shembull: një i sëmurë refuzon ilaçin që i ka përshkruar mjeku dhe thotë: "Dua të shërohem vetë". Pa dyshim, ai do të dështojë dhe mund të humbasë jetën. Po ashtu, ai që këmbëngul të veprojë vetëm me mendimin e tij, pa u mbështetur te specialistët e fesë, rrezikon shkatërrimin e vet dhe të komunitetit.

Nëse themeli nuk është të konsultohemi me dijetarët e fesë, që njohin rregullat dhe ligjet e Islamit, dhe veprojmë sipas mendimeve të kufizuara, kjo mund të çojë në ndikime të huaja mbi mendjet tona. Ideologjitë e huaja, qoftë komunistët, socialistët apo marksistët, mund të përpiqen të ngatërrojnë Islamin dhe ta shtyjnë atë në shërbim të idesë së tyre. Prandaj, është e domosdoshme që të gjithë të jenë të kujdesshëm ndaj këtij rreziku të madh dhe të punojnë seriozisht për ta parandaluar atë".[1]

"Dhe më e rëndësishmja nga e gjithë kjo është mishërimi dhe formësimi i autoritetit të juristit (faqih) në qeveri dhe në shoqëri. Të gjitha këto anë lidhen me mijëra çështje, me të cilat janë ballafaquar njerëzit dhe qeveria, dhe të cilat janë diskutuar nga juristët, duke shfaqur dallime në mendimet e tyre përreth tyre. Nëse disa prej këtyre çështjeve nuk ishin të trajtuara më parë, sot është detyrë e juristëve që të mendojnë për to".[2]

"Çështja që e pashë të nevojshme të përmend, është se themeli i sistemit islam qëndron në unitetin e metodës dhe lëvizjes brenda kornizës së politikës së përgjithshme që gëzon pranimin e Islamit. Për këtë arsye, të gjithë duhet të kenë kujdes në çdo veprim, qoftë në fushën politike, ushtarake, ekonomike apo shoqërore, të mos dëmtojnë këtë kornizë të përgjithshme. Nuk është e fshehtë se përcaktimi i parimeve të përgjithshme,

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 65.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 162.

të marra nga parimet themelore të ligjeve islame, udhëheq drejt udhëzimit të individit dhe shoqërisë".[1]

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thekson domosdoshmërinë e marrjes parasysh të elementeve të ndryshueshme për diagnostikimin e saktë të detyrimit hyjnor, në mënyrë që të mos ndodhë diagnostikim i gabuar. Përveç kësaj, duhet t'i referohemi shpirtit të Islamit, të njohim kontekstin e parimeve bazë dhe qëllimeve të përgjithshme, dhe t'i respektojmë plotësisht ato përballë çdo deduksioni për detyrimin hyjnor. Duhet të respektohen plotësisht edhe rregullat e jurisprudencës islame që i themeluan Imamët e pafajshëm, dhe që dijetarët e shkollës imamite i zhvilluan, duke e bërë një jurisprudencë solide. Për këtë arsye, konsiderimi i dy elementeve, kohës dhe vendit, përbën një faktor kryesor në nxjerrjen e saktë të detyrës së caktuar nga Allahu.

Për këtë çështje, midis të tjerash, ka thënë: "*Me të vërtetë, koha dhe vendi janë dy elemente kryesorë në ixhtihad. Mund të ndodhë që një çështje, e cila më parë ka pasur një gjykim të caktuar, të marrë një gjykim të ri, për shkak të ndryshimeve në politikë, shoqëri dhe ekonomi në çdo kohë dhe vend. Pra, përmes njohjes së saktë të marrëdhënieve ekonomike, shoqërore dhe politike që lidhen me çështjen, zbulohet se ajo, edhe pse duket e njëjtë, ka marrë një formë tjetër dhe kërkon një gjykim të ri.*

Prandaj, muxhtehidi duhet të jetë i lidhur ngushtë me çështjet e kohës së tij. Sepse njerëzit, të rinjtë dhe masa e gjerë, nuk do të pranojnë që autoriteti fetar të mos japë mendim mbi çështjet aktuale politike. Njohja e mënyrave për të përballuar mashtrimet dhe devijimet e kulturës mbizotëruese, zotërimi i vizionit të qartë ekonomik, kuptimi i politikave

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 64.

dhe ekuilibrave ndërmjet politikanëve, si dhe njohja e forcave dhe dobësive të sistemeve kapitaliste dhe marksiste përbëjnë pjesë të një strategjie globale të udhëheqjes.

Kjo është një nga cilësitë themelore të muxhtehidit të përgjithshëm. Ai duhet të ketë urtësi, inteligjencë dhe shikim të mprehtë për të udhëhequr shoqërinë islame dhe madje edhe joislame. Drejtuesi i madh duhet të jetë, gjithashtu, i sinqertë, i devotshëm dhe i përulur, cilësi që janë thelbësore për muxhtehidin, dhe të dijë të drejtojë.

Qeveria, nga këndvështrimi i muxhtehidit të vërtetë, përfaqëson zbatimin praktik të dispozitave juridike në jetën njerëzore. Ajo është mishërimi i jurisprudencës në trajtimin e problemeve shoqërore, politike, ushtarake dhe kulturore. Jurisprudenca është teoria e plotë e menaxhimit të jetës së njeriut, nga lindja deri në vdekje. Qëllimi themelor është të aplikohen parimet e forta të jurisprudencës në jetën e individit dhe të shoqërisë, duke u dhënë përgjigje sfidave të ndryshme. Ajo që frikëson më shumë arrogancën dhe forcat e huaja, është kur jurisprudenca dhe ixhtihadi bëhen përkthim praktik i realitetit objektiv, duke u dhënë myslimanëve aftësinë për t'u përballur me sfidat e botës".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 272.

Sundimi i moralit

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) besonte plotësisht në fjalën e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij): "*Unë jam dërguar vetëm për të plotësuar virtytet e moralit*". Ky kufizim tregon se synimi më i lartë i shpalljes ishte plotësimi dhe përsosja e moralit që sollën profetët e mëparshëm.

Prandaj, sipas Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), parimet islame të moralit dhe humanizmit sundojnë mbi çdo gjë. Qëllimi nuk e justifikon mjetin dhe as shkenca, pushteti, pasuria, politika apo edhe ndihma për njerëzit, nuk kanë vlerë, nëse janë kundër moralit islam dhe human. Përndryshe, ato shndërrohen në shkatërrim për njerëzit dhe barrë mbi mbajtësin e tyre.

Këtë do ta shohim qartë edhe në një grup tekstesh të Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Ai ka thënë: "*Allahu i Lartësuar e ka përmendur çështjen e edukimit dhe të mësimit në një ajet të vetëm. Ai nuk ka përmendur se ka dërguar të dërguar për çështje të kësaj bote, por, në lidhje me edukimin dhe mësimin, ka thënë:* **"Me të vërtetë Allahu u bëri besimtarëve një dhuratë të madhe kur dërgoi tek ata një të dërguar nga vetja e**

tyre, i cili ua lexon ajetet e Tij, i pastron dhe u mëson Librin dhe urtësinë".[1]

Pra, Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar përdor fjalën "pastrim", për të shprehur qëllimin te njerëzit, në çështjet e edukimit dhe të mësimit. Qëllimi i dërgimit të të Dërguarit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishte edukimi dhe mësimi. Kështu, është dërguar tek ne për edukim dhe mësim. Dhe përpara mësimit, përmendi edukimin: **"i pastron dhe u mëson Librin dhe urtësinë".**

Sigurisht, hyrja në hollësi të kësaj ajeti fisnik do të kërkonte kohë të gjatë. Por unë them shkurt se pastrimi është hyrje paraprake. Ky ajet i ndritur na paraqet realitetin e edukimit dhe të mësimit, të cilat kërkojnë sqarim dhe detaje të mëtejshme.

Pra, ajo që na shfaq ky ajet i ndershëm, është se themeli i misionit të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishte edukimi dhe mësimi: ai lexon ajetet, edukon dhe u mëson njerëzve. Ajetet e shenjta janë shkencat nëpërmjet të cilave shihet gjithçka.

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) u lexon atyre ajetet dhe i pastron, u pastron shpirtrat e më pas u mëson Librin dhe urtësinë. Pastrimi (tezkija) i paraprin mësimit dhe duhet ta shoqërojë atë, duke i dhënë përparësi. Nëse shpirtrat nuk pastrohen dhe nuk lirohen nga ato cilësi të këqija dhe nuk zbukurohen me cilësitë hyjnore, atëherë ky dije do të lërë pasoja të këqija mbi të.

Të gjitha sektet e pavërteta që janë shfaqur, pavarësisht mendimeve të ndryshme të dijetarëve, kanë ardhur pikërisht për shkak të mungesës së

1 Sure "Al Imran", ajeti 164.

teskijes. Sepse, nëse dijetari nuk është i pajisur me pastrimin e nevojshëm, atëherë ai bëhet i rrezikshëm. Nuk ka dallim mes një dijetari të fesë dhe një dijetari universitar në këtë drejtim. Nëse medresetë fetare dhe universitetet shkencore do të mbeteshin pa pastrimin shpirtëror, atëherë këto dituri do të përçudnoheshin dhe do të shndërroheshin në një thesar të papërdorshëm, ashtu siç i përshkruan Allahu i Lartësuar në Kur'an: **"Shembulli i atyre që u ngarkuan me Teuratin, por nuk e bartën atë** (në praktikë)**, është si shembulli i gomarit që mbart libra të rënda".**[1]

Kështu, edhe nëse një njeri merr dijen e teuhidit, dijen e fesë, të moralit dhe bart shumë shkenca, por nuk e pastron veten e tij, atëherë kjo dije kthehet në rrezik për shoqërinë dhe shndërrohet në një fatkeqësi të madhe".[2]

"Njeriu ka nevojë për mësim, pas pastrimit shpirtëror (tezkijes). Nëse ai hyn në dituri pa qenë i pastruar, atëherë kjo dije bëhet një shkak i prirur për korrupsion. Pa dyshim, nuk është e mundur që nga një dijetar i papastër të mos burojnë shenja korrupsioni. Hadithet tregojnë se era e qelbur e dijetarit të lig do të lëndojë banorët e Xhehenemit.

Gjatë gjithë periudhës në të cilën universitetet tona ishin në duart e njerëzve të paautorizuar dhe të papërgatitur, arsimi dhe edukimi bënin që i diplomuari nga këto universitete të dilte njeri i ndikuar nga Perëndimi, i lidhur me të dhe ndjekës i tij, i varur nga jashtë. Kjo ishte gjendja e arsimit në atë kohë. Nëse mësimi ishte i shëndoshë, ai ishte brenda kufijve të caktuar. Universitetet kolonialiste vendosnin kufizime mbi arsimin dhe nuk lejonin që të rinjtë tanë ta merrnin dijen në formën e duhur. Studimi kryhej në mënyrë të kufizuar, vetëm në një masë të caktuar. Kjo gjendje vazhdonte deri edhe për të rinjtë tanë që studionin

1 Sure "Xhumua", ajeti 5.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 393-394.

jashtë vendit. Ata nuk lejoheshin të mësonin përveç asaj që britanikët dhe amerikanët u lejonin të mësonin, gjë që do t'u shërbente atyre për interesat e shteteve kolonialiste.

Për këtë arsye, arsimi nxirrte njerëz, si: Sherif Imam, Nasiri e të ngjashëm me ta. Të gjithë këta kishin studiuar jashtë vendit dhe ishin bërë doktorë e inxhinierë. Por, për fat të keq, kjo nuk sillte gjë tjetër. Kur fara mbillet në një tokë të kalbur, edhe nëse bie shi, ai shi bëhet një mallkim mbi atë tokë të sëmurë. Në vend që të sjellë gjelbërim, ai vetëm do të rrisë kalbëzimin dhe mykun. Por, kur fara mbillet në një tokë pjellore, atëherë edhe vetë shiu do të përhapë një aromë të këndshme në të gjithë tokën".[1]

"Ne sot kemi nevojë të ndjekim një rrugë njerëzore, në mënyrë që vendi ynë, i cili pretendon të jetë Republikë Islamike, të jetë dëshmi për këtë thirrje. Dhe padyshim, Republika Islamike është sistemi i Iranit, i zgjedhur me votat e popullit. Por, përmbajtja e saj duhet të jetë, gjithashtu, islame, në të gjitha aspektet, në mënyrë që kudo që të vendosni këmbët tuaja, të duket sikur ndodheni në një vend adhurimi. Spitalet duhet të jenë në shërbim të Allahut, gjithashtu, edhe ushtria duhet të jetë në shërbim të Allahut. Shpresoj që ju të ngrini flamurin e Republikës Islamike edhe në vendet e tjera.

Shpresa ime është që të triumfojnë të shtypurit ndaj arrogantëve, nën flamurin e Islamit dhe të rimarrin nga duart e grabitësve tokat që Allahu ua ka lënë trashëgimi dhe të punojnë siç duhet, ashtu siç urdhëron Islami. Shpresa ime është që heronjtë tanë të nderuar të jenë gjithmonë me kokën lart, kudo që të jenë dhe të veprojnë me frymë bujare, me frymë islame dhe me shpirt të qetë. Madje edhe kur të udhëtojnë ngado, të duken

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 394-395.

si njerëz të sjellshëm, duke u shquar jo vetëm për qëndrueshmëri e trimëri, por edhe për epërsi në moral, sjellje dhe humanizëm".[1]

Me gjithë respektin më të madh, falënderoj popullin iranian fisnik për pjekurinë e tij politike islame dhe përkushtimin e tij, të cilin e tregoi me dinjitet në zgjedhjet e mëparshme, veçanërisht në zgjedhjet presidenciale, duke dëshmuar moralin islamik, tolerancën dhe madhështinë shpirtërore. Ata treguan se revolucioni ynë i madh islamik është mbi të gjitha një revolucion shpirtëror e moral përpara se të jetë një revolucion politik e shoqëror. Në ditët e fundit të jetës sime, ndërsa po përgatitem të shkoj drejt mëshirës së Allahut, unë i shoh me shpresë, madhështi dhe krenari të gjitha këto. Lartësia dhe lavdia e këtij populli do të shfaqet fuqishëm në zgjedhjet e ardhshme të Këshillit të Konsultës (shurasë) Islame, ashtu siç u treguan edhe në zgjedhjet presidenciale, me pjekuri të plotë njerëzore dhe politike".[2]

E gjithë shpresa ime është që Këshilli i Konsultës Islamike dhe qeveria e Revolucionit Islamik të nisin pastrimin e plotë të institucioneve përgjegjëse nga elementet armiqësore ndaj revolucionit dhe Islamit, një pastrim tërësor. Në fund, ju porosis të shmangni përçarjet që konsiderohen si burimi i të gjitha fatkeqësive dhe sprovave, të cilat bien ndesh me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar; deputetët e nderuar të këshillit duhet t'i shmangin ato, si në fjalë, ashtu edhe në veprime, duke hequr dorë nga metodat që bien ndesh me standardet juridike dhe morale islame, që të mos jetë e njëjta situatë, siç ndodhte në këshillat e kohës së tiranëve.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 91.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 127.

Mos e kaloni kufirin e moralit njerëzor në paraqitjen e mendimeve politike të ndryshme. I lutem Allahut që t'ju japë sukses të gjithëve në shërbim të Islamit, myslimanëve dhe vendit".[1]

"Kur të hyni në parlament, përveç se të diskutoni çështjet që shqetësojnë popullin, duhet të armatoseni me armën e moralit islam dhe ta shfaqni këtë moral para njerëzve, sepse, edhe nëse kalojnë disa vite në parlament, njerëzit do të gjykojnë mbi bazë të debateve dhe sjelljeve tuaja. Veprat tuaja pasqyrohen para Zotit të Madhëruar, sepse Ai është i pranishëm dhe vëzhgues në çdo vend dhe shkruesit e veprave janë të pranishëm në botën e njeriut dhe shënojnë gjithçka. Pra, duhet ta keni parasysh që çdo gjë ndodh në praninë e Zotit. Çdo frymëmarrje e juaja është në dihet prej Tij. Çdo fjalë që thoni, dëgjohet prej Tij. Shkelja e urdhrit të Zotit në praninë e Tij është krim i madh. Duhet ta dini se Zoti është Mbikëqyrës mbi veprat tuaja dhe duhet të edukoni edhe të tjerët për këtë. Gjithashtu, duhet të keni kujdes për individët që janë në poste të veçanta dhe të mos i shndërroni ato vende në qendra të korruptimit. Sepse, ashtu siç vëzhgohet gjendja e kryetarit të shtetit, e udhëheqësve dhe e komandantëve të ushtrisë, dhe njerëzit marrin shembull nga veprat e sjelljet e tyre, po ashtu edhe ju, që pretendoni se ndiqni gjurmët e të dërguarve dhe evlijave të Islamit, duhet të jeni shembull përmes veprave dhe sjelljes suaj".[2]

"Bashkohuni të gjithë rreth flamurit të Islamit, nëse dëshironi të ndërprisni duart e të huajve nga vendi juaj dhe të ndërtoni një shtet shembullor, ku të mishërohen moralet fisnike. Mos u bëni padrejtësi të tjerëve, as mos pranoni të mbani padrejtësinë e tyre; mos u joshni pas pasurive të tyre dhe mos lejoni që ata t'ju nënshtrojnë për interesat e tyre. Programi ynë është që të mos i bëjmë padrejtësi askujt dhe të mos pranojmë

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 132.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 285.

padrejtësi nga askush. Ne nuk duam të imponojmë asgjë mbi njerëzit, ashtu siç nuk pranojmë që të tjerët të na imponojnë diçka".[1]

"Duhet të ketë një dallim midis atyre që i përkasin sistemit islamik dhe atyre që i përkisnin sistemit të mëparshëm. Dallimi që duhet të ekzistojë sot, është se të gjitha institucionet e Republikës Islamike, qofshin ato organe administrative apo kategori të tjera të lidhura ngushtë me Republikën Islamike, si: ushtria, forcat e xhandarmërisë, policia, Garda e Revolucionit dhe forcat e tjera të armatosura, veprimet e tyre, besimet dhe moralet e tyre duhet të jenë në përputhje me Republikën Islamike".[2]

"Shpresoj që zotërinjtë kandidatë dhe përkrahësit e tyre t'i përmbahen moralit islamik dhe atij njerëzor në fushatat e tyre zgjedhore, dhe të largohen nga fyerjet dhe sulmet ndaj të tjerëve; sepse kjo sjellje shkakton përçarje dhe përmban shkelje të shenjtërisë së të tjerëve. Kryerja e veprimeve që bien ndesh me moralin dhe kulturën, vetëm për të arritur sukses në një qëllim, edhe nëse është islamik, është një çështje e papranueshme dhe nuk konsiderohet si motivim i vlefshëm islam".[3]

"Stili ynë i sjelljes në kuvend nuk duhet të shoqërohet me fjalë fyese, qoftë gjatë dhënies së udhëzimeve, parashtrimit të pyetjeve apo diskutimit të çështjeve të ndryshme. Përkundrazi, ai duhet të pasqyrojë kulmin e moralit dhe fisnikërisë, duke ndjekur elokuencën e imamëve të pastër dhe duke u frymëzuar nga fjalimet e tyre me sinqeritet e përkushtim.

Angazhimi ynë duhet të përqendrohet në trajtimin e çështjeve shoqërore për të mirën dhe përparimin e saj, e jo për nxitjen e grindjeve dhe polemikave. Në këtë mënyrë, kontribuojmë në edukimin e shoqërisë me

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 352.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 50.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 17-18.

virtyte të larta, duke i mishëruar ato në praktikë, në gjithçka që themi dhe bëjmë gjatë mbledhjeve dhe punimeve të kuvendit".[1]

"Duhet të bëjmë përpjekje të qëndrueshme dhe afatgjata për të ndërtuar një kulturë dhe një qytetërim njerëzor madhështor, të mbështetur në vlera të larta islame. Nëse sot përballemi me shpërdorimin e energjive njerëzore, kjo vjen si pasojë e një mendësie të ushqyer prej kohësh me një mënyrë të gabuar të të menduarit.

Prandaj, ngritja e një skene dhe ndërtimi i një teatri në përputhje me moralin njerëzor dhe islam kërkon përkushtim të madh, punë të vazhdueshme dhe hapësirë të mjaftueshme veprimi. Edhe kinemaja, nëse synojmë ta zhvillojmë mbi këto parime, kërkon kohë të gjatë dhe përpjekje të shumëfishta.

As në konceptin e teatrit e as të kinemasë nuk është thënë ndonjëherë se ato duhet të shndërrohen në qendra korrupsioni apo që arti të reduktohet në shfaqje të ulëta. Përkundrazi, ato duhet të qëndrojnë brenda kufijve të së lejueshmes, në mënyrë që të mos devijojë edukimi i fëmijëve dhe të rinjve tanë, brenda universiteteve dhe në shoqëri, duke i çuar ata në rrugë të gabuar".[2]

"Morali i lartë ka një rëndësi të veçantë për ushtrinë, gardën dhe forcat e tjera të armatosura, ndoshta kjo rëndësi është më e madhe se për institucionet tjera. Këta janë ata që ndonjëherë mund të përballen në frontet e luftës me një situatë, që mund të rezultojë tragjike, nëse nuk janë të pajisur me moralin islam. Prandaj është e domosdoshme që ata të vetëdijesohen për moralin islamik dhe lavdi Allahut që tani janë të gatshëm ta pranojnë këtë. Dhe vërtet, shumë prej tyre janë edukuar dhe lavdi

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 18, f. 43-44.
22 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 18, f. 185.

Allahut për këtë. Kur shihni frontet e betejës, shihni sakrificat e këtyre të rinjve të dashur në Gardë, në ushtri dhe në forcat e tjera të armatosura, si dhe përkushtimin e tyre të sinqertë ndaj Allahut të Lartësuar".[1]

"Prej këtu, duke u mbështetur tek Allahu i Lartësuar, duhet të punojmë për të forcuar moralin tonë dhe të jemi vëllezër të bashkuar mes nesh. Dijeni se ata që ndryshojnë prej jush nuk do të qëndrojnë gjatë. Ju do të triumfoni, sepse ruani respektin ndaj Krijuesit dhe mbani virtytet morale, mirësinë dhe sjelljen e bukur mes njerëzve. Edhe nëse mbani në duar automatikë dhe armë, duhet të përpiqeni të fitoni dashurinë e njerëzve dhe bindjen e tyre me anë të moralit, sepse kriteri është bindja e vërtetë; bindja që buron nga zemrat e njerëzve. Nëse arrini të fitoni zemrat e tyre, atëherë kjo është ajo që do të mbetet dhe do të zgjasë tek Allahu i Lartësuar. Me të vërtetë, unë lutem për ju dhe shpresoj që të punoni, me ndihmën e Allahut, me përgjegjësitë tuaja fetare, islame dhe kombëtare".[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 17, f. 194.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 17, f. 22.

Përballja me arrogantët dhe mbrojtja e të shtypurve

Ky titull është i pandashëm nga boshti i së vërtetës, teuhidit dhe bindjes ndaj Allahut të Madhëruar, sepse Kur'ani fisnik, nga fillimi deri në fund, na udhëzon drejt këtij synimi dhe e paraqet atë si themel të lëvizjes së profetëve dhe të dërguarve, si dhe të përballjes së tyre me tiranët dhe faraonët e padrejtë, në mbrojtje të të shtypurve dhe të dobëtëve në shoqëritë e tyre. Nuk gjejmë asnjë tregim profetik në Kuran që të mos përmendë një përballje të tillë.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) gjatë gjithë jetës së tij të ndershme, si një pasqyrim i jetës së profetëve (Paqja qoftë mbi ta!), që u përballën me padrejtësinë dhe sfiduan faraonët. Në krye të tyre, ai e quajti arrogancën amerikane "Djalli i madh" dhe, krahas saj, aleatët e saj, si Izraeli dhe sionizmin botëror, së bashku me të gjithë tiranët e tjerë të vegjël nëpër botë. Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) qëndroi i vendosur, gjithmonë duke u lutur, duke u përballur me të gjithë këta, duke u shtrirë dorën e ndihmës të shtypurve dhe duke i thirrur të formonin një front të bashkuar të të shtypurve në mbarë botën, pa marrë parasysh se cilës fe i përkisnin. Qëllimi kryesor ishte mbrojtja e nderit, lirisë, dinjitetit dhe të drejtave të njeriut, si dhe nxjerrja e tij nga errësirat e padrejtësisë në dritë.

Gjithashtu, ai bëri thirrje për formimin e një bërthame të fortë, për të mbrojtur të shtypurit, përmes themelimit të Gardës së

Revolucionit Islamik, ushtrisë së mobilizimit të miliona njerëzve dhe Partisë së Allahut (Hezbollah), të cilën ai e konsideroi si partinë hyjnore të përmendur në Kur'an. Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) nuk u mjaftua vetëm me themelimin teorik të këtyre kornizave të bekuara, por i drejtoi ato drejt fushave të xhihadit dhe mbrojtjes në vende islame, ku u arritën fitore dhe suksese të shumta, përfshirë mbrojtjen e Palestinës, Libanit, Sirisë, Irakut dhe vendeve të tjera. Dhe ende këto korniza të bekuara vazhdojnë të jenë në një gjendje mbrojtjeje dhe xhihadi të pandërprerë në rrugën e Allahut dhe në mbrojtje të çështjeve të mëdha të umetit, me synim çlirimin e Palestinës, Kudsit dhe pjesës tjetër të vendeve të shenjta, si dhe çlirimin e umetit dhe realizimin e projektit hyjnor islamik profetik.

Në këtë kuadër, do të paraqesim tekste sqaruese nga fjalët e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) mbi këtë temë:

"Falënderimi i takon Allahut, i Cili dëshiroi që të dobëtit të triumfojnë mbi arrogantët, t'i ndihmojë ata kundër mendjemëdhenjve, të pastrojë tokën nga papastërtia e tiranëve dhe t'i bëjë të shtypurit sundues mbi tokë. Islami erdhi pikërisht për këtë qëllim dhe mësimet e tij janë të gjitha për këtë mision: që të mos mbetet asnjë mendjemadh mbi tokë dhe arrogantët të mos mund të shfrytëzojnë dhe të shtypin të dobëtit.

Ne ndjekim mësimet e larta të Kur'anit, atë që na ka ardhur nga Islami, nga jeta e të Dërguarit të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe nga jeta e imamëve të myslimanëve. Jetët e profetëve, të përmendura në Kur'an, na mësojnë se të dobëtit të ngrihen, të sfidojnë dhe të rebelohen kundër mendjemëdhenjve, dhe të mos

lejojnë që ata të uzurpojnë të drejtat e tyre. Me këto mësime, ne kemi ecur përpara".[1]

"Historia e flijimit të Ibrahimit është një akt madhështor që i jep njeriut – madje edhe të dashurve të Zotit dhe të zgjedhurve – mësime të thella mbi sakrificën, luftën dhe vetëflijimin në rrugën e Allahut. Ky akt nuk mund të kuptohet plotësisht në dimensionet e tij monoteiste, politike dhe shoqërore, përveçse nga profetët e mëdhenj, të dërguarit fisnikë dhe të dashurit e Zotit, të cilët Allahu i dalloi me nder të veçantë. Vërtet, babai i monoteizmit dhe shkatërruesi i idhujve të botës na mësoi, jo vetëm, por gjithë njerëzimin, se sakrifica dhe vetëflijimi në rrugën e Allahut kanë dimensione politike e shoqërore, jo thjesht ato të adhurimit dhe të teuhidit.

Ai na mësoi të gjithëve që, gjatë ditëve të festave të sakrificës, të flijojmë jetët, pasuritë dhe frytet e jetës sonë për hir të Allahut; të flijojmë vetveten dhe të dashurit tanë, për të vendosur fenë e Allahut dhe drejtësinë hyjnore. Na mësoi gjithashtu se Meka dhe Mina janë altarë për adhuruesit, vend për përhapjen e monoteizmit dhe refuzimin e politeizmit, sepse lidhja me shpirtin dhe lavdinë e Zotit është, gjithashtu, një formë kundërshtimi ndaj shirkut.

Ai u mësoi bijve të Ademit mësimin e xhihadit në rrugën e së vërtetës, që t'i shpallin botës nga ky vend i madh mësimet mbi sakrificën dhe vetëflijimin në rrugën e Allahut. Na mësoi se për të ecur në rrugën e së vërtetës dhe për të vendosur drejtësinë hyjnore, sakrifica me çdo gjë të dashur është e domosdoshme, madje edhe sikur të ishte si Ismaili, therori i Allahut.

Vërtet, shkatërruesi i idhujve ishte Ibrahimi dhe pasardhësi i tij fisnik, shkatërruesi i idhujve, zotëria i profetëve, Muhamedi (Paqja e

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 91.

bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), na mësoi të gjithëve se shkatërrimi i idhujve, cilido qofshin ata, është i pashmangshëm dhe se pastrimi i botës duhet të nisë nga Meka, nëna e qyteteve, deri në çdo cep të tokës dhe deri në Ditën e Kiametit, nga çdo papastërti e këtyre idhujve, qofshin tempuj, kishë, yje, hëna, kafshë apo njerëz dhe nga çdo idhull i rrezikshëm dhe tiranik i historisë.

Që nga koha e Ademit, i zgjedhuri i Allahut, deri te Ibrahimi, mikut të Allahut dhe deri te i dashuri i Allahut, Muhamedi (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), u ngrit thirrja për monoteizëm dhe u përhap nga Meka në të gjithë botën.

A nuk janë këta arrogantët idhuj të mëdhenj që i thërrasin botës t'u bindet dhe t'u nënshtrohet atyre, herë përmes frikësimit dhe herë përmes joshjes dhe mashtrimit? A nuk është Qabja e ndritur qendra e vetme për shkatërrimin e këtyre idhujve? Brezat e profetëve kanë ardhur njëri pas tjetrit për të përmbushur këtë mision, nga Ademi, te Ibrahimi, e deri te Muhamed Mustafai, dhe deri te pasardhësi i tij shpirtëror, Mehdiu, i cili do të shkatërrojë idhujt e kohës së tij dhe despotët e errësirës. Toka do të ndriçohet me dritën e teuhidit dhe drejtësisë hyjnore, duke nisur nga qendra e teuhidit, Meka e nderuar.

Allahu i Madhëruar iu drejtua profetit të Tij, Ibrahimit dhe i tha: **"Dhe thirr në mesin e njerëzve për haxh, ata do të vijnë tek ti në këmbë dhe mbi çdo deve të dobësuar, duke ardhur nga çdo rrugë e largët".**[1]

1 Sure "Haxhxh", ajeti 27.

Gjithashtu, i tha: **"Pastrojeni Shtëpinë Time për ata që e vizitojnë, për ata që qëndrojnë aty, për ata që përkulen dhe bien në sexhde".**[1]

Ky pastrim përfshin të gjitha llojet e ndyrësisë; më i madhi prej tyre është shirku, për të cilin u përmend në fillim të kësaj sureje të bekuar dhe në suren "Et Teube", ku Allahu i Madhëruar thotë: **"Dhe është shpallur nga Allahu dhe i Dërguari i Tij për njerëzit ditën e Haxhit të madh se Allahu është i lirë nga idhujtarët, dhe i Dërguari i Tij gjithashtu".**[2]

Mehdiu i pritur, me gjuhën e të gjitha feve dhe sipas marrëveshjes së të gjithë myslimanëve, do të thërrasë nga Qabja dhe do të ftojë gjithë njerëzimin drejt teuhidit. Të gjitha thirrjet për teuhid u ngritën nga Qabja dhe nga Meka. Është detyrë e jona ta vazhdojmë këtë rrugë, të ngremë thirrjen e fjalës së teuhidit dhe ta përhapim këtë fjalë të shenjtë nga ky vend i bekuar.

Duhet të thyejmë idhujt e kohës sonë, me praninë tonë aktive dhe të gjallë në Mekën e nderuar, përmes mbajtjes së mbledhjeve, thirrjeve dhe marshimeve të largimit nga idhujtarët dhe arrogantët në këtë botë, duke ekspozuar krimet dhe poshtërsitë e tyre, dhe duke hedhur poshtë djajtë dhe përfaqësuesit e tyre me guralecë në akabe, dhe mbi kokën e djallit të madh, Amerika. Kështu, ne do ta kryejmë haxhin e Habibullahut, haxhin e Ibrahimit Khalilullah, haxhin për Allahun, haxhin për Imam Mehdiun e pritur. Përndryshe, siç është thënë: "Sa shumë ka zhurmë e sa pak ka haxh".[3]

1 Sure "Haxhxh", ajeti 26.

2 Sure "Et Teube", ajeti 3.

3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 18, f. 80.

"Duhet të punohet për zgjerimin e kësaj lëvizjeje të ringjalljes në gjithë botën, një ringjallje e të shtypurve përballë arrogantëve. Irani ishte fillimi dhe shembulli për të gjithë popujt e shtypur. Popujt e shtypur shikojnë drejt Iranit, për të parë se si një komb, i cili u ngrit pa ndonjë mbështetje të jashtme, me forcën e besimit, arriti unitetin e fjalës dhe lidhjen me Islamin përballë fuqive të mëdha dhe doli fitimtar. Kështu u frymëzuan edhe popujt e tjerë me këtë sekret islamik, me këtë sekret besimi. Le të ngrihen myslimanët në të gjitha vendet e botës, jo vetëm myslimanët, por të ngrihen edhe të shtypurit. Me të vërtetë, premtimi hyjnor ka përfshirë të shtypurit, siç thotë i Plotfuqishmi në fjalën e Tij: **"Dhe Ne dëshiruam t'u bëjmë mirë atyre që ishin të shtypur në tokë, t'i bëjmë ata prijës dhe trashëgimtarë".**[1]

Pra, udhëheqja u takon të shtypurve dhe trashëgimia u takon të shtypurve. Sa për arrogantët, ata janë pushtues. Arrogantët duhet të nxirren jashtë skenës, sepse ne e kemi dëbuar arrogancën nga Irani dhe në vendin e tyre u ulën të shtypurit".[2]

1 Sure "El Kasas", ajeti 5.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 221.

Koncepti i të shtypurit dhe i arrogantit

"Dikush më parë ka treguar për marrëdhëniet midis arrogantëve dhe të shtypurve, prandaj nuk më mbetet rrugë tjetër veçse të sqaroj kuptimin e "të shtypurit" dhe "arrogantit", aq sa ma lejon koha. "Arrogantët" nuk kufizohen vetëm te sundimtarët, as te krerët e shteteve, as te qeveritë tiranike; ata kanë një kuptim më të gjerë. Një nga shëmbëlltyrat e tyre janë të huajt, që e dobësojnë popullin, e shfrytëzojnë dhe e shtypin. Një tjetër shëmbëlltyrë janë qeveritë tiranike dhe mbretërit që i shtypin dhe i keqtrajtojnë popujt e tyre.

Ju ishit viktima të këtij realiteti për më shumë se pesëdhjetë vjet dhe gjithë popujt e tjerë e përjetuan të njëjtën gjendje. Edhe ne ishim viktima, dhe të gjithë popujt shiheshin nga syri i arrogancës, duke u shtypur dhe duke u poshtëruar. Sot, me dëshirën e Allahut, ata kanë ikur dhe nuk do të kthehen më. Sot është dita që Allahu i Lartësuar na ka bekuar me liri dhe pavarësi, dhe Ai na provon me to. Na ka dhënë mundësinë të shohim si do të përdorim këtë liri dhe pavarësi: a do të jemi nga arrogantët apo nga të shtypurit?

Çdo individ mund të jetë arrogant ose i shtypur. Nëse dikush i nënshtrohet një tjetri, edhe nëse ai tjetri është një grusht njerëzish që e shtypin, poshtërojnë dhe keqtrajtojnë, ai bëhet i shtypur, ndërsa ata bëhen arrogantë. Kështu, ky individ hyn në kuptimin e përgjithshëm që përfshin arrogantët dhe të shtypurit.

Nga ana tjetër, nëse ju shtypni ata që janë nën pushtetin tuaj dhe i keqtrajtoni, ju bëheni arrogantë, dhe ata nën pushtetin tuaj bëhen të

shtypur. Pra, le të reflektojmë: si do të dalim nga ky provim? Si do të dalim nga kjo sprovë? A do të dalim me kokën lart apo të përkulur? A do t'u sillemi robërve të Zotit ashtu siç na ka urdhëruar Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar? Tani që jemi të lirë, a do ta përdorim këtë liri për të shërbyer Krijuesin dhe krijesat e Tij apo do ta përdorim si mjet për t'iu kundërvënë Allahut dhe për të qenë arrogantë me njerëzit?"[1]

"Qoftë i bekuar për të gjithë fillimi i shekullit të pesëmbëdhjetë (hixhri)! Myslimanët duhet ta konsiderojnë këtë si fillimin e fitores së tyre. Bota nuk është më ajo që fuqitë e mëdha mund të bëjnë çfarë të duan. Tani është koha që të shtypurit të ngrihen, të çohen në këmbë të shtypurit kudo që janë, që vendet të marrin të drejtat e tyre me forcë dhe vendosmëri. Mos prisni që arrogantët t'ju japin të drejtat tuaja, ata kurrë nuk do t'i japin. Myslimanët duhet të jenë vëllezër, ashtu siç i ka quajtur Kur'ani i lavdishëm dhe të jenë partnerë, të ndajnë së bashku si vështirësitë, ashtu edhe gëzimet. Allahu ju ndihmoftë të gjithëve.

Shpresoj që flamuri i Islamit të valojë në çdo vend dhe myslimanët të arrijnë interesat e tyre nën flamurin e "La ilahe il-la Allah".[2]

"Allahu u ka premtuar të nënshtruarve në tokë se do t'i ndihmojë kundër arrogantëve me mirësinë dhe favorin e Tij, dhe do t'i bëjë ata udhëheqës dhe trashëgimtarë. Premtimi i Allahut është afër. Unë shpresoj që ta shohim këtë premtim të realizohet, që të nënshtruarit të triumfojnë mbi arrogantët, ashtu siç po përmbushet tani".[3]

"Në prag të hyrjes në mijëvjeçarin e katërt nga hixhreti i vulës së profetëve, Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 7, f. 350-351.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 123.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 6, f. 363.

familjen e tij!), i cili konsiderohet si udhëheqësi i ringjalljes revolucionare islame, dhe nën udhëzimin e Kur'anit fisnik dhe udhëheqjen e burrit më të madh në botë, për ringjalljen e këtij shekulli madhështor të mbushur me begati, është e domosdoshme që qeveria, me ndihmën e popullit, të zhvillojë programe revolucionare për të përkujtuar këtë rast të veçantë.

Është e vërtetë që shekulli i kaluar ka qenë i mbushur me sprova për popullin tonë, për Islamin tonë dhe për vendet tona. Por Revolucioni Islamik, i cili u përjetua gjatë viteve të fundit të këtij shekulli, do të ndryshojë fatin e umetit islam në shekullin e ardhshëm. Shpresa e madhe është që Lindja e Mesme e shtypur, veçanërisht vendet islame, të vazhdojnë luftën e tyre, për pavarësi dhe liri, nën flamurin e teuhidit, duke shpëtuar vetveten nga vargonjtë e Perëndimit komplotues dhe nga mashtrimet e Lindjes. Qëllimi është që ky shekull të bëhet një shekull drite për vendet islame.

Lus Allahun e Madhëruar për madhështinë e Islamit dhe për mbrojtjen e myslimanëve".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 10, f. 265.

Dita botërore e Kudsit

Dita e Kudsit është një ditë botërore, që nuk lidhet vetëm me Kudsin, por është një ditë përballjeje e të shtypurve me arrogantët, një ditë përballjeje e popujve që vuajnë nën barrën e padrejtësisë amerikane dhe joamerikane nga fuqitë e mëdha.

Është dita në të cilën të shtypurit duhet të përgatiten për t'u përballur me arrogantët dhe për t'ua thyer krenarinë. Është dita në të cilën dallohen besimtarët nga hipokritët, sepse besimtarët e konsiderojnë këtë ditë si ditën e Kudsit dhe e dinë detyrën që u takon. Ndërsa hipokritët, që gjithmonë fshihen pas perdeve dhe bashkëpunojnë me të mëdhenjtë kundër të vërtetës, që i shërbejnë Izraelit dhe luftojnë kundër Islamit, do të shfaqin në këtë ditë fytyrën e tyre të vërtetë.

Ata që i ndalojnë njerëzit të protestojnë në këtë ditë, janë vetë pjesë e lojës së armiqve. Dita e Kudsit është dita që e bën të qartë fatin e popujve të shtypur dhe shpall ekzistencën e tyre përballë arrogantëve. Ashtu siç u ngrit Irani dhe ua theu shtyllën kryesore arrogantëve, duke vazhduar rrugën e tij me vendosmëri, po ashtu edhe popujt e tjerë duhet të ngrihen, të kërkojnë llogari për krimet dhe korrupsionin dhe t'i hedhin ato në koshin e historisë.

Është dita kur përcaktohet fati i bijve të regjimit të mëparshëm në Iran dhe i atyre që kurdisin komplotet në shërbim të fuqive të mëdha, kudo që të jenë, veçanërisht në Liban. Është dita kur duhet të bëjmë betimin për shpëtimin e Kudsit dhe t'i japim fund vuajtjes së vëllezërve tanë libanezë. Është dita që duhet të çlirohemi nga thonjtë e arrogantëve.

O myslimanë të botës, o të shtypurit e tokës, ngrihuni dhe vendosni vetë për fatin tuaj! Deri kur do të rrini të ulur, duke pritur që të tjerët në Uashington dhe në Moskë të vendosin për ju? Deri kur do të shkelet dinjiteti juaj nën këmbët e mbeturinave të Amerikës dhe të Izraelit pushtues? Deri kur do të mbeten Kudsi, Palestina dhe Libani, myslimanët e shtypur në ato troje nën sundimin e kriminelëve, dhe ju vetëm do të shikoni? Disa sundimtarë tradhtarë do të vazhdojnë të luajnë rol negativ në këtë çështje".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 15, f. 59.

Themelimi i partisë së të shtypurve

"Para disa ditësh paraqita një propozim, i cili, nëse përkthehet praktikisht, do të ndihmojë në forcimin e komunikimit, nëse do Allahu. Ky është themelimi i një partie të të shtypurve, e cila do të përfshijë myslimanët dhe jobesimtarët në mbarë botën. Në këtë mënyrë, qeveritë arrogante që kanë shtypur popujt e tyre, nuk do të jenë më në gjendje të vazhdojnë shtypjen e tyre. Me ekzistencën e një partie të Allahut, që mbron të shtypurit dhe të padrejtët, do të mund të gjenden zgjidhje për problemet e të shtypurve dhe myslimanëve në përgjithësi".[1]

"Duhet të rikujtoj se kemi bërë thirrje më herët për themelimin e një partie të të shtypurve në botë. Por kjo nuk do të thotë anulim i partive të mira ekzistuese në Iran. Dhe nëse, me vullnetin e Allahut, myslimanët arrijnë të themelojnë një parti të të shtypurve, kjo do të ishte diçka shumë e mirë".[2]

"Të shtypurit tani janë të shpërndarë e të përçarë dhe, për shkak të kësaj përçarjeje, nuk mund të bëjnë gjë. Tani, meqë nuk është realizuar ende një bashkim gjithëpërfshirës i një grupi të të shtypurve, nuk është arritur, duhet që kjo parti të jetë shembull, të jetë një model përpara popujve të tokës, që ata ta marrin për udhëzim dhe të frymëzohen prej tij, dhe të realizohet partia e të shtypurve, e cila është Partia e Allahut

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 9, f. 263.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 9, f. 268.

(Hizbullah), duke mishëruar vullnetin e Allahut të Bekuar dhe të Madhëruar, pasi çështja e të shtypurve të tokës është një urdhër hyjnor.

Ne i ftojmë të gjithë të shtypurit e botës të bashkohen në këtë parti, për të zgjidhur problemet e tyre me një mënyrë kolektive dhe me një vullnet të fortë. Nuk do të zgjidhet asnjë problem në ndonjë vend apo për ndonjë popull veçse përmes rrugës së "Partisë së të Shtypurve".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 9, f. 224.

Partia e Allahut (Hizbullahu)

Përveç propozimit të Imamit për themelimin e Partisë së të Shtypurve dhe shpjegimin e objektivave dhe parimeve të saj, Imam Khomeini foli, gjithashtu, për themelimin e Partisë së Allahut në Iran dhe në botë, si bërthama thelbësore e Partisë së të Shtypurve me natyrë të gjerë, ku Partia e Allahut përbëhet nga individë të përkushtuar ndaj metodës autentike islame dhe projektit islamik madhor. Kjo gjë është përmendur në tekste:

Pyetje: *A mund të na shpjegoni konceptin e Partisë së Allahut (Hizbullahut)?*

Përgjigje: *Çdo mysliman që pranon standardet dhe ligjet islame, që i përmbahet në veprat dhe sjelljet e tij metodës së drejtë shi'ite, është anëtar i Partisë së Allahut. Të gjitha mësimet e këtij grupi dhe rruga e tij janë qartësuar nga Kur'ani dhe Islami. Kjo parti nuk është si partitë e zakonshme që ekzistojnë sot në botë. Sot, populli iranian lufton nën këtë parti, burra e gra, të rinj e të moshuar, duke ngritur parullat islame, dhe ata janë pjesë e Partisë së Allahut (Hizbullahut).*

Pyetje: *A mund të na shpjegoni më saktësisht kuptimin e saktë të imamit? Çfarë nënkupton ai? Cili është qëndrimi juaj për përdorimin e titullit Imam për ju në demonstratat milionëshe të popullit iranian gjatë muajit Muharrem? Çfarë marrëdhënie ka imami me Partinë e Allahut (Hizbullahun)?*

Përgjigje: *Imam do të thotë udhëheqës, ai që udhëzon të gjithë dhe i drejton ata. Imam është ai që sqaron rrugën e Shi'izmit dhe të Partisë së Allahut. Udhëheqësi i këtyre organizatave të mëdha dhe gjithëpërfshirëse e merr drejtimin e tij nga Kur'ani dhe Suneti Profetik në çdo kohë dhe rrethanë. Ata bëjnë përpjekje për të nxjerrë dispozitat (fetvatë), për t'i shpallur ato dhe për t'ua transmetuar njerëzve".*[1]

"Të gjithë ne, myslimanët, duhet ta paraqesim Islamin me të vërtetën e tij para gjithë botës dhe të bashkohemi të gjithë nën një flamur, që është Partia e Allahut. Nuk duhet të jemi parti të ndara e me krahë të ndryshëm. U takon dijetarëve, në çdo popull, që të nisin vetëdijesimin e njerëzve të tyre, për t'i larguar nga komplotet që i kanë vendosur të huajt dhe kolonizatorët për të mbjellë përçarje mes tyre. Kjo detyrë bie mbi supet e të gjithë udhëheqësve fetarë që t'i zbatojnë.

Populli ynë, që për një kohë të gjatë kishte jetuar nën zgjedhën e tiranisë mbretërore, dhe që në vitet e fundit u ekspozua ndaj kushteve shumë të këqija, përveç asaj që tashmë përjetonte nga padrejtësitë e tiranëve dhe grykësve, humbi pavarësinë dhe u bë pre e ndërhyrjes së shteteve të huaja në pasuritë dhe në çështjet e vendit. Padrejtësia, plaçkitja, krimet dhe tradhtia, arriti kulmin e vet, duke kaluar çdo kufi të durimit të popullit.

Populli e kuptoi se jeta me këtë poshtërim nuk kishte asnjë vlerë. Myslimanit nuk i takon të pranojë një turp dhe vuajtje të tillë. Prandaj, bijtë e popullit tonë u ngritën me guxim dhe burrëri. Kjo ishte një ngritje e frymëzuar prej Zotit që përfshiu të gjitha shtresat e popullit. I gjithë populli u bë një parti e vetme, Partia e Allahut (Hizbullah), që me fuqinë e besimit dhe mbështetjen hyjnore, arriti që me duar bosh dhe pa armë të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 5, f. 276.

mund të triumfonte mbi fuqitë e mëdha që ishin të pajisura me çdo lloj armësh".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 263.

Partia e Allahut në Liban, argument ndaj botës

Nuk ka dyshim se popujt islamë e kanë kuptuar plotësisht pse të tillë, si: *Mutahari, Beheshti, dëshmorët e mihrabit dhe pjesa tjetër e dijetarëve të nderuar në Iran, dhe të tillë, si: Sadri dhe Hakimi në Irak; si: Ragib Harbi dhe Abdul Kerijm Ubeijdi në Liban; si: Arif El Hyseni në Pakistan; si dhe dijetarët e vetëdijshëm për vuajtjet e Islamit të mirëfilltë Muhamedan, në të gjitha vendet: pse vallë të gjithë këta duhet të jenë objekt komplotesh dhe atentatesh? Vëzhgoni Libanin, ku janë grumbulluar të gjitha fuqitë e mëdha, por përballë tyre qëndroi një numër i vogël muxhahidësh, edhe pse ishin ndarë në dy grupe".*[1]

"Mbrojtja e shenjtërive të myslimanëve, nderit të tyre dhe të qëndruarit përballë sulmeve kundër vendeve të tyre dhe dinjitetit të tyre është një çështje e domosdoshme dhe e nevojshme. Prandaj duhet të përgatitemi për t'i mbrojtur myslimanët dhe për të realizuar objektivat hyjnore, sidomos në këto rrethana të rrezikshme, ku bijtë e Palestinës dhe të Partisë së Allahut, në Liban, po sakrifikohen, dhe myslimanët në tokat e pushtuara po japin jetët e tyre duke thirrur: "O myslimanë!"

"Duhet të qëndrojmë të fortë kundër Izraelit agresor, duke përdorur të gjitha mundësitë tona shpirtërore dhe materiale, dhe të synojmë për të ndihmuar myslimanët, për t'i shpëtuar ata nga ato masakra të tmerrshme, për të njohur tradhtarët dhe ata që bëjnë kompromis dhe për t'i demaskuar ata para njerëzve.

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 397.

Shpresoj që të fitoni dhe do të fitoni! Republika Islamike e Iranit do të qëndrojë përkrah jush dhe përkrah të gjithë myslimanëve, madje edhe përkrah të gjithë të shtypurve në mbarë botën".[1]

"Unë pohoj edhe një herë se bota e sotme është e etur për të vërtetat dhe ligjet ndriçuese të Islamit. Argumenti hyjnor mbi dijetarët është plotësuar, sepse, kur shkon Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), atëherë argumenti i Allahut plotësohet mbi dijetarët. Kjo ndodh kur një i ri i vendeve islame shkon deri në shkallën e shehidit, duke mbrojtur shenjtërinë e tyre fetare dhe duke e përballuar agresorët. Për këtë arsye, ata u hodhën vetë në detin e ngjarjeve, fatkeqësive, burgjeve dhe vuajtjeve.

Po ashtu, myslimanët e guximshëm dhe muxhahidët e nderuar nga Partia e Allahut në Liban dhe në vende të tjera u ngritën, qëndruan dhe luftuan kundër agresorëve. A ka dëshmi më të madhe se kjo? Cili është justifikimi për heshtjen, pajtimin, uljen nëpër shtëpi, duke u mjaftuar me fshehjen e besimit (takijen)?

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 397-398.

Qeveria e drejtësisë hyjnore

Themelimi i qeverisë së drejtësisë hyjnore në çdo cep të tokës, me synimin që ajo të përfshijë të gjitha hapësirat e saj, është qëllimi më i madh dhe më i rëndësishëm i projektit islamik profetik në këtë planet, sepse formimi i një qeverie të tillë dhe sundimi i saj në botë përbën bazën për realizimin e pjesës tjetër të objektivave të projektit, mbi të cilët qëndron udhëzimi i njeriut drejt përsosmërisë së tij njerëzore, derisa të bëhet i denjë për përjetësi në kopshtet e begatisë, duke u ngjitur në shkallët më të larta dhe duke arritur pozita të larta në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Me fitoren e Revolucionit Islamik dhe themelimin e Republikës Islamike u realizuan parakushtet e nevojshme për themelimin e qeverisë së drejtësisë hyjnore në Iran. Po ashtu, u shfaqën kushte për ngritjen e modeleve dhe përvojave të ngjashme në vende të tjera të botës islame, të cilat shpresohet të zgjerojnë dalëngadalë hapësirën e tyre, derisa, me lejen e Allahut, të ngrihet qeveria gjithëpërfshirëse e drejtësisë hyjnore në të gjithë sipërfaqen gjeografike të tokës, nga dora e pasardhësit të të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!).

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) është ndalur gjatë në predikimet e tij mbi rëndësinë e realizimit të kësaj drejtësie dhe qeverisjes së saj në Iranin islamik, si hyrje për realizimin e saj,

edhe në pjesë të tjera të botës islame, duke e përgatitur terrenin për shtetin e Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!).

Më poshtë janë disa tekste të përzgjedhura mbi këtë çështje:

"Ne përpiqemi të arrijmë drejtësinë islame në këtë vend, Islamin që nuk pranon që të ngacmohet qoftë edhe një grua hebreje nën mbrojtjen e Islamit. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Do të preferoja vdekjen, se sa të dëgjoja se një grua hebreje, nën mbrojtjen e Islamit, është fyer. Ne synojmë këtë Islam, i mbushur me drejtësi, ku nuk ka padrejtësi ndaj askujt, Islamin që nuk bën dallim mes udhëheqësit dhe të udhëhequrit, ku të gjithë janë të barabartë para ligjit hyjnor. Në Islam nuk gjykohet veçse me ligjin hyjnor. Profeti i nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) gjykoi sipas ligjit dhe ishte i kujdesshëm, që edhe vetë t'i nënshtrohej ligjit. Po ashtu, edhe ne duhet të veprojmë sipas ligjit. Nuk ka gjykim për askënd, as për të Dërguarin e Allahut, përveç gjykimit të Allahut. Gjykimi në Islam i përket vetëm Allahut dhe askujt tjetër".[1]

"Ju, të rinjtë e ditur dhe të mësuar, mbani përgjegjësi të mëdha kudo që të ndodheni: përgjegjësinë për mbrojtjen e Islamit, që është përgjegjësi e çdo myslimani; përgjegjësinë për mbrojtjen e atdheut dhe pavarësisë së tij, që është një nga detyrimet e patjetërsueshme; përgjegjësinë për ta prezantuar Islamin e madh te shoqëritë njerëzore, qoftë në metodën e tij të drejtësisë dhe ekuilibrit, qoftë në mënyrën se si sunduesi mysliman bashkëpunon me popullin, qoftë në formën e marrëdhënies midis qeveritarit dhe popullit apo në administrimin e pasurisë publike të myslimanëve".[2]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 9, f. 331.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 270.

"Ju duhet të përpiqeni, me gjithë fuqinë tuaj, që ta bëni të njohur sistemin e qeverisjes islame dhe sjelljen e udhëheqësve myslimanë me popujt e tyre, në mënyrë që të përgatitet terreni për ngritjen e një qeverie të drejtësisë dhe barazisë, në vend të këtyre qeverive kolonialiste, që e kanë ndërtuar themelin e tyre mbi padrejtësinë dhe plaçkitjen".[1]

Islami është shkolla e lëvizjes dhe Kur'ani është libri i saj. Është lëvizja nga e dukshmja drejt së fshehtës (gajbit), nga materialja drejt shpirtërores. Është lëvizja në rrugën e drejtësisë, lëvizja për ngritjen e qeverisë së drejtësisë". [2]

"Edhe Revolucioni ynë islamik ka disa dimensione. Është revolucion i rrëzimit të regjimit të korruptuar, një revolucion për ngritjen e sistemit të së drejtës, një revolucion që ka për qëllim të bëjë revolucionin e ndërtimit të njeriut dhe ndërtimin e një vendi njerëzor. Këtë revolucion duhet ta ruajë një roje revolucionare. Nëse dikur revolucioni kishte një roje të quajtur "roja e kufijve", sot duhet që ky brez revolucionar të ngrihet, të thërrasë dhe të përballet me të gjithë ushtarët arrogantë. Ju fituat, falënderimi i qoftë Allahut, në këtë front revolucionar, por fitorja nuk ishte e plotë; ende ekziston ky "mur i madh" për t'u rrëzuar dhe shpresa është që të zhduket. Revolucioni islamik duhet të realizojë qeverinë e drejtësisë dhe Republika Islamike të arrijë hapin e mëvonshëm. Rojet duhet ta ruajnë këtë kuptim dhe të gjithë duhet të jenë roje. Bëhuni të gjithë roje të Islamit dhe të qeverisë së të drejtës, sepse rojtari këtu arrin kuptimin e tij të vërtetë. Kjo është qeveria e drejtësisë dhe rojtari është ***rojtari i drejtësisë****".*[3]

"Islami nuk është fe që njeh kombësitë dhe kufijtë artificialë midis shteteve, por ai erdhi për të shkrirë të gjitha kombësitë në një unitet të

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 2, f. 326.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 8, f. 248.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 1, f. 48.

vetëm. Pra, nuk ka dallim midis Iranit dhe Libanit, për shembull, sepse çështjet tona janë të përbashkëta, dhimbjet dhe shpresat tona janë të njëjta, siguria dhe ëndrrat tona janë të përbashkëta. Islami nuk bën dallim mes arabëve dhe joarabëve; kjo ndarje është një produkt i yni, i materialistëve. Ky është iranian, ai është irakian. Kjo çështje është e papranueshme në Islam, sepse Islami përfshin çdo njeri që beson në Allahun e Lartësuar, pa marrë parasysh racën apo vendin e tij.

Islami erdhi që të përfshijë banorët e tokës në një familje të vetme, të udhëhequr nga qeveria e drejtësisë hyjnore. Nga ky këndvështrim, nuk na lejohet ta lëmë pas dore Islamin dhe të përqafojmë nacionalizmin dhe krenarinë mbi bazën e racës, sepse këto janë dy gjëra kontradiktore. Islami e ka dënuar nacionalizmin dhe fanatizmin etnik dhe ka punuar për zhdukjen e tyre.

Po, Islami respekton atdheun e njeriut ku ai ka lindur e është rritur, por Islami mbetet themeli bazë".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 13, f. 130.

Imami Mehdiu i premtuar

"Është e vërtetë se nuk është në mundësitë tona që të punojmë për mbizotërimin e drejtësisë në mbarë botën. Po të ishte në mundësitë tona, do ta bënim. Por, ndërsa nuk mundemi ta realizojmë këtë, kjo nuk do të thotë që nuk duhet të bëjmë asgjë. Bota sot është e mbuluar nga padrejtësia, dhe ne, përpara shfaqjes së Imamit të Pritur (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), duhet patjetër të fillojmë nga një pikë brenda kësaj bote. Nëse është në mundësitë tona të përballemi me padrejtësinë, duhet ta bëjmë këtë pa hezitim, sepse Islami dhe Kur'ani na kanë përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe detyrat tona.

Nuk është e domosdoshme që ta përhapim drejtësinë në të gjithë botën, sepse kjo është përtej fuqive tona, por është detyra jonë që të përgatisim rrugën për të, të sigurojmë shkaqet dhe rrethanat e nevojshme që do të përshpejtojnë shfaqjen e tij. Ne duhet të punojmë për të përgatitur botën për ardhjen e Imamit të premtuar, Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!)."[1]

"Çështja e fshehjes së Imamit të Kohës është një çështje shumë e rëndësishme, të cilën duhet ta kuptojmë përmes shumë çështjeve dhe nga çështjet e rëndësishme është se: Nëse Allahu nuk do të ngrejë një njeri, që ta ndërmarrë këtë punë të madhe, për të përhapur drejtësinë, me kuptimin e saj të vërtetë, në gjithë botën e banuar, pra Imam Mehdiun e premtuar (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), atëherë të gjithë profetët do të kishin ardhur kot. Të gjithë profetët u përpoqën për zbatimin e drejtësisë dhe synimi i tyre ishte përhapja e saj në mbarë botën, por nuk iu shkrua suksesi përfundimtar. Madje, edhe i Dërguari i fundit (Paqja e bekimi i Allahut

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 20.

qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij), i cili erdhi për përmirësimin e njerëzimit dhe vendosjen e drejtësisë, nuk ia doli të arrinte këtë synim madhor në kohën e tij. Nëse do t'i ishte shkruar suksesi i plotë, atëherë vendosja e drejtësisë në mbarë botën do të ishte realizuar.

Por, ky sukses i madh është lënë në duart e Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!). Ai do të përhapë drejtësinë e plotë, jo vetëm drejtësinë që njerëzit zakonisht e kuptojnë dhe e reduktojnë tek sigurimi i mirëqenies materiale mbi tokë, por drejtësinë në të gjitha nivelet dhe shkallët e jetës njerëzore. Nëse njeriu shmanget qoftë nga aspekti shpirtëror apo praktik apo nëse shfaqen shtrembërime në besimet e tij, atëherë ai është larguar nga rruga e drejtësisë dhe është zhytur në padrejtësi. Pra, vendosja e drejtësisë së vërtetë nënkupton rikthimin e njeriut te rruga e drejtësisë dhe ekuilibrit në brendësinë e tij. Nëse lind ndonjë devijim apo helm në bindjet dhe mendësinë e njeriut, këto besime të shtrembëruara duhet të korrigjohen, të reformohen dhe të kthehen në besime të drejta. Vetëm kështu vendoset drejtësia në botën e brendshme të njeriut.

Në këtë kuptim, vendosja e drejtësisë në nivelin shpirtëror dhe mendor është detyra e Imam Mehdiut të premtuar Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!). Kjo është një çështje e lënë për fundin e kohës, një vepër që nuk iu dha mundësia ta kryejnë profetët e mëparshëm dhe as ndonjë tjetër. Vetëm Imam Mehdiu (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) do të jetë ai që do të përhapë drejtësinë e plotë dhe gjithëpërfshirëse në mbarë botën. Ky është premtim i Allahut, edhe pse ka qenë dëshira e të gjithë profetëve dhe e të devotshmëve, megjithatë kushtet nuk ua mundësuan zbatimin e plotë të saj".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 12, f. 284.

Liria dhe pavarësia në Islam

"Nën hijen e Islamit dhe flamurin e tij, ne mund të arrijmë çdo gjë. Të gjitha liritë, të gjitha llojet e pavarësisë, gjithçka që dëshironi të bëni është e mundur në Islam: pavarësia mendore, pavarësia kulturore, pavarësia ekonomike – gjithçka është e mundur në Islam".[1]

"Nuk ka turp më të madh që një vend t'i shtrijë duart drejt Amerikës për t'i dhënë grurë! Të hapë dorën ndaj një armiku dhe të kërkojë prej tij ushqimin! Nuk ka turp më të madh që ky popull të mos përpiqet të forcojë bujqësinë dhe industrinë e vet. Nëse nuk e bëjmë këtë, nuk mund të arrijmë pavarësinë. Deri sa ky popull të vendosë që gjithçka të jetë nga ai vetë, nuk do të arrijmë atë që duam. Prandaj, duhet të ndërpresim varësinë tonë ekonomike dhe kulturore nga jashtë; kultura, ekonomia duhet të burojnë nga vetvetja. Nëse ky popull nuk e merr këtë vendim, dhe përderisa ky mendim i nënshtruar dhe kolonial nuk ndërrohet, dhe nuk bindemi që edhe ne jemi njerëz, nuk do ta arrijmë kurrë pavarësinë".[2]

"Pavarësia mendore është kushti i parë për pavarësinë. Kjo do të thotë të ndryshojmë mënyrën tonë të të menduarit dhe të dalim nga kjo gjendje fëminore. Ne duhet të kontrollojmë vullnetin tonë dhe të sundojmë vetveten. Kur populli ynë të kuptojë se të huajt na e kanë imponuar mënyrën e tyre të sjelljes dhe se ne i kemi pranuar ndërsa e kemi përzënë vetveten, atëherë duhet të vendosim të sundojmë veten me vetëdije. Nëse nuk e bëjmë këtë, do të mbetemi për një kohë të gjatë në këtë gjendje. Nëse

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 162.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 189.

nuk zgjohemi dhe vazhdojmë të shohim me sytë e të tjerëve dhe të ndiejmë me ndjenjat e të tjerëve, dhe të shohim përreth nesh me sytë e të huajve, atëherë ata do të na imponojnë çfarë të duan mbi ne. Ata do të na imponojnë gjithçka me duart tona!"[1]

"Derisa të mos e njohim vetveten dhe të mos e përdorim gjuhën tonë, mos thoni: "Gjuha arabe nuk është gjuha jonë". Gjuha arabe është gjuha jonë dhe është gjuha e Islamit, dhe Islami është për të gjithë. Ajo që është e huaj për ne, janë këto "shtesa" që na janë ngjitur. Derisa të mos çlirohet libri ynë nga kjo krenari e rreme dhe të pastrohet nga shirku, dhe, derisa të mos shfaqen librat tanë me emrat tanë, të ndryshojnë emrat e rrugëve tona dhe të hiqen ato emra të huaj që janë vënë mbi mallrat tona, të prodhojmë ilaçe vetë dhe t'i vendosim vetë emrat mbi to, dhe derisa të mos e njohim vetveten dhe të mos i ndërrojmë lotët tanë, nuk do të mund të arrijmë kurrë pavarësi në asgjë".[2]

"Me të vërtetë, kjo pavarësi që e arritët, ishte për shkak të besimit tuaj dhe bindjes se jeni të aftë. Besuat se Amerika nuk është në gjendje t'ju imponojë asgjë. Ky besim ishte arsyeja e asaj mrekullie që e realizuat. Dhe siç mund ta vini re, gjatë këtyre dy viteve, keni arritur shumë prodhime industriale. Ata që i kanë realizuar këto gjëra, janë po njerëzit tuaj. Besoni se edhe ne mundemi, mund të krijojmë dhe të shpikim. Ky besim rrit aftësitë tuaja".[3]

"Le ta dijë populli ynë fisnik, mysliman dhe i lirë në këtë botë se, nëse duan pavarësi dhe të qëndrojë mbi tokën e tij me krenari, atëherë duhet të paguajë një çmim të çmuar për këtë liri dhe pavarësi. Bijtë tanë të dashur e kanë kuptuar, ata që janë mbrojtës të vërtetë dhe të sinqertë të vlerave

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 190.
2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 11, f. 193.
3 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 14, f. 242.

islame, se lufta nuk përputhet me kërkimin e rehatisë. Ata që mendojnë se lufta për liri dhe mbrojtja e të shtypurve dhe të privuarve nuk bie ndesh me kapitalizmin dhe kërkimin për rehati e qetësi, gabohen; ata thjesht nuk i njohin bazat e luftës. Ata që mendojnë se është e mundur reformimi i kapitalistëve dhe të lartëve (të privilegjuarve), që nuk e kuptojnë kuptimin e dhimbjes, me këshilla, predikime dhe udhëzime dhe se ata mund të bashkohen me radhët e luftëtarëve për liri apo se mund t'i ndihmojnë, janë si ata që përpiqen të shtypin ujin me grusht".[1]

"Ju, o të dashurit e nderuar! Ju sillni gëzim në zemrën e Imamit të kohës, Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) dhe në shpirtin tim, nëpërmjet përkushtimit tuaj fisnik, në vijat e frontit dhe prapa tyre, me shërbimin tuaj të çmuar. Unë shpresoj që të mundeni të mishëroni politikën tonë parimore "As Lindje, as Perëndim, Republikë Islamike", sepse, nëse nuk planifikojmë për Iranin, nën dritën e pavarësisë së vërtetë, atëherë nuk kemi bërë asgjë. Unë shpresoj shumë te ju, sepse ju jeni krijuesit plot gjallëri dhe aktivizim islamik. Paqe dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju!"[2]

"U lë një këshillë të përzemërt pjesëtarëve të forcave të armatosura... Unë jam krenar për ta, ndërkohë që përgatitem për t'u larguar nga kjo jetë e kësaj bote, që të qëndrojnë të palëkundur në besnikërinë e tyre ndaj Islamit, ashtu siç kanë qenë gjithmonë. Islami është sot i vetmi rrugëtim për të arritur pavarësinë dhe çlirimin. Allahu i Lartësuar i fton të gjithë njerëzit, përmes dritës së udhëzimit të Tij, që të arrijnë gradën më të lartë të njerëzimit. Qëndroni të palëkundur! Sepse kjo do t'ju shpëtojë juve, popullin tuaj dhe vendin tuaj nga poshtërimi dhe pengmarrja e fuqive, të cilat duan që të jeni robër të tyre dhe përpiqen ta mbajnë vendin tuaj të prapambetur dhe të shndërruar në një treg

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 82.

2 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 187.

konsumator nën peshën e padrejtësisë së tyre të rëndë e poshtëruese. Zgjidhni jetën fisnike dhe të ndershme, edhe nëse ajo përmban disa vështirësi, kjo është më mirë se të jetosh me turp si skllav për të huajt".[1]

"U jap këshillë të gjithë myslimanëve dhe të shtypurve në botë që të mos e vendosin shpresën e tyre tek udhëheqësit e vendeve të tyre apo te zyrtarët në qeveritë e tyre, apo tek forcat e huaja. Këta nuk do t'ua sjellin pavarësinë dhe lirinë. Ne tashmë jemi dëshmitarë dhe historia e saktë e dëshmon këtë, që shekulli i fundit ishte periudha e dominimit të madh të fuqive të mëdha mbi vendet myslimane dhe mbi shtetet e dobëta, dhe asnjë nga këto qeveri që ishin në pushtet në këto vende, nuk e solli lirinë për popullin e vet, as nuk solli pavarësi për vendin, përkundrazi, shumica e tyre ishin qeveri që ushtronin shtypje dhe dhunë mbi popullin e tyre. Edhe nëse bënin ndonjë gjë, ajo ishte vetëm për interesat e tyre personale dhe të klasës së pasur dhe të privilegjuar. Ata nuk ishin të interesuar për mirëqenien e popullit dhe i lanë të shtypurit dhe të varfrit pa plotësuar as nevojat më bazike, si: uji, buka ose kushte minimale të jetesës. Përkundrazi, i shfrytëzuan dhe i shtypën edhe më shumë, dhe i rekrutuan për të shërbyer klasën e pasur dhe të privilegjuar, ose, më keq, i kthyen në vegla në duart e fuqive të mëdha, që përdoren për të forcuar sundimin mbi vendet e dobëta dhe popujt e shtypur. Ata (fuqitë e mëdha) futën përfaqësuesit e tyre në këto vende, vendosën qeveri kukulla, dhe i shndërruan në treg për Lindjen dhe Perëndimin, duke garantuar interesat e veta, ndërsa popujt vazhdojnë të jetojnë në një gjendje konsumimi dhe varësie, dhe sot janë ende duke ecur në të njëjtën rrugë.

Ngrihuni ju, o të shtypurit e botës! Dhe ju, o vende islame dhe myslimanë në të gjithë botën! Merrni të drejtat tuaja, me duart dhe dhëmbët tuaj! Mos u trembni nga propaganda mediatike e fuqive të mëdha dhe agjentëve të tyre skllevër. Dëbojini sundimtarët tradhtarë nga vendet

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 384.

tuaja, sepse ata ua dorëzojnë frytin e përpjekjeve tuaja armiqve tuaj dhe armiqve të Islamit të dashur".[1]

1 "Sahifetul Imam Khomeini", përkthyer në gjuhën arabe, vëll. 21, f. 394.

Përfundimi i studimit

Shi'izmi i Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) nis nga një bosht themelor, të cilin nuk e braktisi kurrë dhe në çdo rast, ky bosht mbetet qendra për të gjitha boshtet e tjera themelore. Ky bosht është e vërteta hyjnore, puna për të fituar kënaqësinë e Allahut të Lartësuar, dhe arritja e objektivave që çojnë në realizimin e projektit islamik profetik. Ky projekt siguron përsosmërinë materiale dhe shpirtërore të njeriut, si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër. Kjo nuk mund të arrihet veçse përmes mbajtjes së detyrueshme pas udhëzimit të dy peshave (Kur'anit dhe Ehli Bejtit) dhe punës, sipas ngarkesës hyjnore, në çdo gjendje dhe kohë. Gjithashtu, ai kërkon qeverisje morale, mosjustifikim të qëllimit përmes mjeteve të pandershme, përballje me të fuqishmit, mbrojtje të të shtypurve dhe mbajtjen e parimit të udhëheqësit të drejtë si bazë e qeverisjes. Kjo është rruga profetike, përmes së cilës mund të realizohet pavarësia dhe liria e vërtetë, vetëm nëpërmjet angazhimit të fuqishëm ndaj saj.

Fund

Nga kapitujt e mëparshëm të librit u bë e qartë se pikëpamja e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) për Shi'izmin, Islamin dhe fenë, në përgjithësi, lidhet ngushtë me rolin hyjnor dhe profetik që u është dhënë imamëve nga Ehli Bejti (Paqja qoftë mbi ta!) si dhe pasuesve të tyre.

Ky rol konsiston në mbrojtjen e Islamit në të gjitha shkollat dhe rrymat e tij, përmes ruajtjes së mësimeve dhe parimeve burimore, si dhe në mbrojtjen e fesë së shpallur nga profetët e Allahut për mbarë njerëzimin përgjatë historisë. Imamët e pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!) e përmbushën këtë mision të madh hyjnor me përkushtim të plotë, me sakrifica dhe devotshmëri, duke krijuar kështu kushtet që më vonë do të mundësonin lindjen e Revolucionit Islamik dhe themelimin e Republikës Islamike në Iran, si fryt i përpjekjeve të tyre shekullore. Krahas tyre qëndruan mijëra dijetarë dhe luftëtarë besnikë, të cilët ecën në një rrugë të vështirë e plot sfida ndër shekuj.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e realizoi ëndrrën e profetëve, evlijave dhe imamëve të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) përmes themelimit të shtetit islam dhe udhëheqjes së revolucionit të bekuar islamik, i cili u konkretizua në vitin 1979 dhe vazhdoi deri në ndarjen e tij nga kjo botë. Ai luajti me përkushtim dhe vendosmëri rolin e mbrojtësit të Islamit dhe të umetit islam.

Pas tij, këtë përgjegjësi e vazhdoi Imam Khamenei (Allahu ia shtoftë jetën!), me aftësi dhe përkushtim të plotë. Pa këtë rol mbrojtës e ruajtës, bota islame dhe vetë Islami do të ishin përballur

me goditje të rënda, ashtu siç kishte ndodhur para revolucionit islam, për shkak të komploteve dhe armiqësive të shumta ndaj Islamit.

Një vlerësim objektiv i zhvillimeve që nga fitorja e Revolucionit Islamik, si dhe i qëndrimeve dhe sakrificave të udhëheqësve të tij, dëshmon se funksioni themelor i këtij revolucioni dhe i shtetit islam ka qenë mbrojtja e Islamit në të gjitha shkollat dhe degët e tij, si dhe mbrojtja e popujve të umetit islam.

Imami besoi plotësisht në këtë mision dhe mbi këtë bazë e ndërtoi revolucionin dhe shtetin islam, duke u përpjekur deri në fund të jetës së tij që ata të mos devijonin nga rruga e tyre. Parimi i udhëheqjes së juristit të drejtë u konsiderua si siguria më e madhe për ruajtjen e drejtimit të revolucionit drejt qëllimeve të tij. Këtë rrugë e vazhdoi me vendosmëri edhe Imam Khamenei (Allahu e ruajttë!), i cili edhe sot mbetet i palëkundur në këtë drejtim.

Në këtë vazhdimësi, besimtarët në mbarë botën islame morën mbi vete përgjegjësinë e mbrojtjes së Islamit. Një rol të veçantë luajti edhe Partia e Allahut, e përshkruar nga Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) si partia e besimtarëve luftëtarë. Ajo u dallua nga partitë e tjera për përkushtimin dhe gatishmërinë e anëtarëve të saj, për të sakrifikuar në mbrojtje të Islamit dhe të umetit. Partia e Allahut në Liban, nën udhëheqjen e dijetarëve dhe komandantëve të saj, si: Sejid Abas el-Mussaui, Shejkh Ragib Harb, Haxh Imad Mugnijeh dhe më pas Sejid Hasan Nasrullah, ka pasur një rol të rëndësishëm në qëndresë dhe në mbrojtjen e çështjes islame në fronte të ndryshme.

Imam Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ishte i bindur se ky revolucion do të vazhdonte nëpërmjet mbrojtjes së Islamit dhe njeriut, si pjesë e projektit hyjnor profetik, duke u forcuar, derisa të realizohej plotësisht. Sipas këtij vizioni, përmbushja përfundimtare e këtij projekti do të ndodhë përmes Imam Muhamed ibn Hasan el-Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), kur, me lejen e Allahut, drejtësia do të mbizotërojë në mbarë botën.

Në dritën e këtyre zhvillimeve, përparimi i projektit hyjnor në kohën moderne mbetet i lidhur ngushtë me mendimin e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), me parimin e udhëheqjes islame dhe me përkushtimin e besimtarëve ndaj kësaj rruge. Sa më e fortë dhe më e thellë të jetë kjo lidhje, aq më afër do të jetë realizimi i plotë i këtij projekti hyjnor. Me vullnetin e Allahut, dita e përmbushjes së tij është më afër se kurrë.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Tiranë, 24 tetor 2025 / 2 Xhumada El Ula, 1447.

PËRMBAJTJA

Parathënia e botuesit 5
Hyrje 7
Kapitulli i pare 19
Hyrje 21
Dallimi midis feve monoteiste dhe shkollave materialiste 23
Arrogantët pengojnë arritjen e qëllimeve të feve monoteiste 28
Nevoja e bashkimit të feve monoteiste përballë tiranëve 31
Shenjat e fesë së vërtetë 34
Profetët dhe uniteti i qëllimit 38
Revolucioni Islamik ringjalli fetë monoteiste 42
Të përbashkëtat e feve monoteiste 46
Marrëdhënia vëllazërore mes pasuesve të feve monoteiste 53
Kombi i krishterë 55
Ruhullah Musauij Khomeini 59
Feja hebraike 73
Rrëzimi i thënies: "Feja është opium i popujve" 79
Përfundimi i studimit 85

KAPITULLI I DYTË 87
Hyrje 89
Të vërtetat e fesë islame 93
Qeveria e Profetit Muhamed (a.s) dhe e Imam Aliut, modeli më i përsosur qeverisës 99
Pengesat e zbatimit të Islamit 105
Historia e Islamit dhe përplasja e së vërtetës me të pavërtetën 112
Qeveritë e sundimtarëve në emër të Islamit 121
Islami amerikan dhe Vehabizmi 127
Qeveritë islame dhe kolonializmi 134
Islami autentik muhamedan 137
Qeveria islame 146
E ardhmja e umetit islam 150
Uniteti islam 153
Përfundimi i studimit 159
KAPITULLI I TRETË 161
Hyrje 162
Shkolla e Shi'izmit 166
Imami Aliu dhe bijtë e tij janë rojet e Islamit 172
Shi'izmi, medh'hebi mbrojtës 188
Dijetarët shi'itë, mbrojtësit e fesë dhe të umetit 192
Jurisprudenca shi'ite dhe vazhdimësia e Islamit 197
Udhëheqja e dijetarit, siguri dhe udhëzim 203

Shi'izmi, pararendës i unitetit islam 209
Shteti islam dhe ruajtja e Islamit 213
Përfundimi i studimit 218
KAPITULLI I KATËRT 220
Hyrje 222
Përqendrimi te Allahu i Lartësuar 225
Kapja pas udhëzimit të dy rëndesave (Kur'anit dhe Ehli Bejtit) . 234
Veprimi sipas detyrës hyjnore 246
Sundimi i moralit 255
Përballja me arrogantët dhe mbrojtja e të shtypurve 264
Koncepti i të shtypurit dhe i arrogantit 270
Dita botërore e Kudsit 273
Themelimi i partisë së të shtypurve 275
Partia e Allahut (Hizbullahu) 277
Partia e Allahut në Liban, argument ndaj botës 280
Qeveria e drejtësisë hyjnore 282
Imami Mehdiu i premtuar 286
Liria dhe pavarësia në Islam 288
Përfundimi i studimit 293
Fund 294

إسم الكتاب: **المذهب الحارس– التشيع في فكر الامام الخميني**

المؤلف: **الشيخ حسن فؤاد حمادة**

المترجم: **الحاج الشيخ وُلنَتْ (عباس) مَريَا**

التصحيح الأدبي: **يَرِيداَ كُولاَ**

التصحيح اللغوي: **إسراء مَريَا**

الإخراج النهائي: **صَبرِيه فَزاَ**

الغلاف: **صَبرِيه فَزاَ**

الناشر: **جمعية النَّسِيم**

تيرانا: 2026